PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

RRUGA E PARTISË

ORGAN I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

6
1979

Çmimi 2.50 Lekë

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Qershor 1979
Viti XXVI i botimit

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Përmbajtja:

ENVER HOXHA — Fronti Demokratik i udhëhequr nga Partia është organizata e madhe e bashkimit, e organizimit dhe e edukimit politik të popullit 5

NGA PUNIMET E KONGRESIT TË 5-TË TË FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA — Fjala e hapjes në Kongresin e 5-të të FDSH 13

RAMIZ ALIA — Raport «Mbi veprimtarinë e Këshillit të Përgjithshëm të FDSH dhe detyrat për të ardhmen» 16

ENVER HOXHA — Fjala e mbylljes në Kongresin e 5-të të FDSH 41

PROBLEME TË PLENUMEVE TË FUNDIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

LL. XHAJANKA — Më tepër vëmendje problemeve të përqendrimit e të specializimit në industrinë mekanike 45

S. KUKA — Zhvillimin dhe thellimin e revolucionit tekniko-shkencor e mbështetim në forcat tona 56

E. SANXHAKTARI — Disa probleme që kërkojnë rritjen e rolit udhëheqës të organizatave-bazë të Partisë në organet e drejtësisë 66

F. NANO — «Katër modernizimet» — reforma të kapitalizmit monopolist shtetëror në Kinë 76

EKSPERIENCË NGA PUNA E PARTISË

J. KOLA — DH. MAÇUKA — Për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së punës të grupeve të kontrollit punëtor e fshatar 90

LEKSIONE

J. SOTA — T'i kuptojmë ideologjikisht e politikisht dhe t'i zbatojmë me frymë revolucionare parimet dhe normat e Partisë 99

ENVER HOXHA

FRONTI DEMOKRATIK I UDHËHEQUR NGA PARTIA ËSHTË ORGANIZATA E MADHE E BASHKIMIT, E ORGANIZIMIT DHE E EDUKIMIT POLITIK TË POPULLIT

Nesër në Vlorën heroike hapet Kongresi i 5-të i Frontit Demokratik, i organizatës së madhe politike të vendit tonë, që udhëhiqet nga Partia e Punës e Shqipërisë.

Kongresi i Frontit shënon një ngjarje me rëndësi të madhe, pse ai do të shprehë ndjenjat dhe vullnetin e mbarë popullit tonë të bashkuar për një qëllim të lartë e fisnik, për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e Atdheut e të fitoreve të revolucionit.

Ky kuvend i gjerë, i cili do të diskutojë për të gjitha problemet e mëdha që shtron Partia dhe që interesojnë tërë shoqërinë, merr një kuptim të veçantë, sepse mblidhet në këtë vit jubilar, kur do të festojmë 35-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të vendosjes së pushtetit popullor. Kjo fitore, më e madhja, më e lavdishmja dhe më e shënuara në historinë shekullore të popullit tonë, u arrit në sajë të luftës heroike të partizanëve tanë trima, të bashkimit të popullit në Frontin Nacionalçlirimtar, të udhëheqjes së sigurt e largpamëse të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Në luftën e madhe për lirinë e Atdheut dhe për çlirimin shoqëror, populli shqiptar është ndeshur me armiq të tërbuar, të jashtëm dhe të brendshëm. Në këtë luftë atij i është dashur të mbante parasysh dhe të realizonte dy qëllime kryesore: të siguronte një udhëheqje besnike të interesave të veta dhe të arrinte bashkimin e tij. Pa arritur këto dy qëllime, ai nuk mund të merrte në dorë fatet e veta. Si i arriti populli shqiptar këto dy synime kapitale? Me ndihmën e huaj nga jashtë? Jo! Ai i arriti këto duke u udhëhequr nga vetë eksperienca e tij e madhe shekullore, si dhe i ndriçuar nga mësimet universale e të pavdekshme të teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Sa burra të shquar e të mençur, sa luftëtarë heronj e të sakrificës për lirinë e Atdheut ka nxjerrë ky vendi ynë i vogël! Trimëritë e popullit tonë i kanë habitur njerëzit në kohë të ndryshme. Mënçuria e

burrave të shquar të Shqipërisë ka kontribuar në thesarin e shkencës dhe të diturisë botërore.

Por, me gjithë përpjekjet, me gjithë sakrificat e mëdha të këtyre njerëzve, populli për të cilin ata dhanë çdo gjë, nuk i realizoi si duhej këto dy qëllime që përfaqësonin shpëtimin e tij përgjithmonë. Megjithatë puna dhe gjaku i të parëve tanë nuk shkuan kot. Ky gjak, që u derdh në truallin e Atdheut, i forcoi themelet e Shqipërisë, kurse mënçuria e tyre la gjurmë të pashlyera në brezat pasardhës. Ata na lanë një mësim të madh: Kush lufton bashkë me popullin dhe për popullin, ai do të fitojë, jo si individ, por do të fitojë populli, mbarë kombi.

Zëri dhe vepra e njerëzve të mëdhenj të Shqipërisë, thirrja e tyre e fuqishme ka qenë: Shqiptarë, bashkohuni! Kurse klithma e armiqve tanë ka qenë: Shqiptarë, përçahuni! Me këtë gjuhë kanë folur kurdoherë fuqitë e mëdha imperialiste, pse kështu do të na sundonin e do të na shtypnin, kështu do ta skllavëronin kombin tonë për interesat e tyre.

Njerëzit e mirë dhe patriotë shqiptarë kërkonin bashkim për çlirimin e vendit, për mbrojtjen e gjuhës dhe të alfabetit shqip kundër hallldupit dhe fanarit. Ata bridhnin nga një vend në tjetrin me shpresë se mos gjenin jashtë mbrojtje e përkrahje për të drejtat e kombit shqiptar, për çështjen e pavarësisë e të lirisë së tij, por asgjëkundi nuk gjetën mbështetje. Mbështetja e tyre e sigurt ishte vetëm populli, por bashkimi i tij nuk ishte i plotë, pse kishte edhe forca shoqërore nga radhët e pasanikëve, të feudalëve e të borgjezisë, që u shërbenin të huajve dhe e kundërshtonin këtë bashkim. Megjithatë kontributi i patriotëve shqiptarë ishte me vlerë, fara që mbollën ata nuk u kalb. Do të vinte medoemos një ditë që kjo farë të çante tokën, të mbinte e fuqishme dhe të lulëzonte.

Jo vetëm fjala dhe mendimet e të parëve, por dhe maliherët e nagantët e tyre s'kanë pushuar gjithë jetën për lirinë e popullit shqiptar. Të huajt dhe njerëz të ligj brenda vendit, që mbillnin përçarjen, pretendonin se një vend e një popull i vogël si yni, nuk mund të rronte dot pa ndihmën e një të madhi. Por njerëzit e mirë që luftonin me shpatë, me pushkë e me penë mendonin ndryshe. Dhe kishin shumë të drejtë.

Bashkim, thërriste plaku i bjeshkëve të Veriut, Bacë Bajrami, i fortë si malet e larta të Shqipërisë që e lindën. Bashkim o popull, thërriste Avni Rustemi, se kërkojnë të na robërojnë e të na mposhtin bejlerët. Dinte ç'thoshte e ç'mendonte Bajram Curri kur i shkruante Leninit se ti do të na e shpëtosh Shqipërinë. Dinte ç'bënte Avni Rustemi, ai djalë i ri, kur në mes të Parisit, shkrehu nagantin mbi pashën tradhtar. Dinte ç'kërkonte ai demokrat revolucionar kur në parlamentin e asaj kohe bëri thirrje të ngriheshin në këmbë e të nderohej kujtimi i Vladimir Iliç Leninit, këtij njeriu të madh të Rusisë dhe të të gjithë njerëzimit.

Dhe dita që prisnin këta martirë erdhi. Fara e hedhur prej burrave trima, të zgjuar e të mirë të vendit tonë mbiu në truallin shqiptar.

Kjo farë duhej spastruar, duhej larë që të mbinte e fortë, e shëndetshme, që të mos e rrëzonte asnjë erë e asnjë furtunë. Për këtë qëllim populli shqiptar duhej të ndiqte traditën e tij shekullore të luftës për liri e për bashkim, të ndiqte gjithashtu teorinë e madhe të Karl Marksit e të Vladimir Iliç Leninit, të ndiqte shembullin e Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Partia Bolshevike dhe nga Stalini. Nga gjiri i klasës punëtore, nga gjiri i popullit, duhej të dilte Partia Komuniste e Shqipërisë, udhëheqësja e luftës së popullit shqiptar.

Pas 1912-ës u krijuan disa parti në vendin tonë, por këto nuk kishin baza, nuk kishin program të qartë, pavarësisht se disa prej tyre udhëhiqeshin nga qëllime të mira. Jeta kërkonte ndryshime të thella sociale dhe kushtet objektive për këtë gjë përgatiteshin çdo vit e më mirë. Por mungonte faktori subjektiv, mungonte udhëheqja, e cila nuk mjaftonte të ishte vetëm një grup njerëzish me disa ide përparimtare, por duhej të ishte një parti që të përfaqësonte të ardhmen, përparimin. Kjo parti nuk mund të ishte tjetër, veçse partia e proletariatit, e klasës më të përparuar, më të fortë, më të organizuar e më të interesuar për revolucionin, e asaj klase që kishte teorinë e vet shkencore, e cila e printe atë dhe aleatët e saj në luftë e në revolucion për çlirimin kombëtar dhe shoqëror.

Për formimin e një partie të vërtetë të popullit nuk mjafton vetëm dëshira e mirë e disa personave. Kjo lyp përgatitjen e një terreni të përshtatshëm, lyp hartimin e një programi që të përfaqësojë interesat dhe aspiratat e popullit punonjës, që të mbështetet në idealet e pastra të këtij populli. Formimi i një partie të tillë lyp besnikëri të pafund ndaj popullit, që shpresat dhe ndjenjat fisnike, trimërore dhe dëshirat e tij të mos tradhtohen kurrë.

Bajram Curri e Avni Rustemi nuk krijuan ndonjë parti që t'i vinin dhe një emër, siç bënë disa intelektualë, elementë të paqartë e të lëkundshëm të feudalizmit e të borgjezisë. Këta intelektualë, që hiqeshin sikur ishin ata që e bënë revolucionin e 1924-ës, krijuan disa parti në shembullin e partive të borgjezisë evropiane. Kurse Bajram Curri e Avni Rustemi, më parë se të krijonin ndonjë parti, krijuan në Vlorë organizatën politike «Atdheu» dhe më pas shoqërinë «Bashkimi», me degët e tyre në të katër anët e vendit. Këto shoqëri kishin për qëllim pikërisht arritjen e atij bashkimi të të rinjve të varfër, të njerëzve të ndershëm e kurajozë që duhej të hidheshin në luftë për të fituar lirinë e pavarësinë e vërtetë të Atdheut dhe të drejtat shoqërore.

Komunistët shqiptarë, në momentet më të vështira që kalonte bota dhe Atdheu i tyre, u ushqyen me mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe në zjarrin e luftës formuan Partinë Komuniste të Shqipërisë, që do të bëhej, siç u bë, udhëheqësja e vërtetë, besnike deri në fund e klasës punëtore dhe e popullit shqiptar.

Me ideologjinë marksiste-leniniste që e frymëzonte dhe me shpirtin luftarak e përparimtar të popullit të vet që e karakterizonte Partia u hodh në zjarr për kauzën më të shenjtë, për të kryer revolucionin, për të realizuar edhe qëllimet e gjyshërve dhe të prindërve tanë, që kishin luftuar ta shihnin Shqipërinë të lirë, të pavarur e

demokratike. Në këtë periudhë kohe situatat kishin ndryshuar. Tashmë në Bashkimin Sovjetik kishte triumfuar Revolucioni Socialist i Tetorit. Shembulli i madh i Bashkimit Sovjetik u ndriti rrugën komunistëve shqiptarë, të cilët i treguan popullit tonë jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra, me luftë e me gjak, të vetmen rrugë të shpëtimit: rrugën e bashkimit dhe të luftës së vendosur kundër pushtuesve të huaj që na kishin shkelur vendin, si dhe kundër armiqve të brendshëm që bashkëpunonin me armiqtë e jashtëm.

Kominterni, Internacionalja e Tretë Komuniste, që e udhëhoqën Lenini dhe Stalini, i kështillonte komunistët shqiptarë të gjenin rrugën e drejtë të luftës, atë rrugë që u tregonte ideologjia marksiste-leniniste. Ai i mësonte ata të lidheshin me klasën punëtore, të futeshin në masat e popullit, të merrnin andej forca si Anteu dhe, në kushtet konkrete të përshtatshme, të krijonin Partinë e tyre Komuniste. Ne, komunistët shqiptarë, pikërisht pse ndoqëm këtë rrugë, fituam.

Pushtuesit nazi-fashistë na e kishin frikën, ata e dinin se Partia Komuniste që u krijua s'do t'i linte kurrë të qetë. Parësia, siç i thoshte populli, që përbëhej nga bijtë bastardë të përhershëm të kombit shqiptar, që kurdoherë kanë mbështetur pushtuesit e huaj për interesat e klasës së tyre dhe jo të Shqipërisë, e ndieu rrezikun e madh që i turrej, u bë një me pushtuesit, dhe së toku morën të gjitha masat që të na shkatërronin. Filloi kështu lufta kundër Partisë Komuniste.

Partia bëri thirrje: Të krijojmë Frontin Nacionalçlirimtar, që të bashkojë gjithë popullin! Dhe ashtu u bë. Fronti eci përpara dhe fitoi, se kishte rrënjë të thella në popull, se kishte në krye Partinë Komuniste të mençur, të sigurt, të fortë e të pafrikshme përpara demagogjisë dhe gënjeshtrës, përpara tankeve, topave dhe mitralozave të armiqve.

Thirrje për bashkim, veçse për qëllime të tjera, bëri edhe «Balli Kombëtar», por, siç dihet, ai u fundos në batak.

Në Pezën heroike Partia mblodhi përfaqësues të të gjitha shtresave të popullit dhe shtroi nevojën e krijimit të Frontit, që do të ishte një organizatë e madhe politike, e udhëhequr nga Partia, me një program të gjërë ku mund të bënin pjesë pa dallim njerëz të çdo bindjeje politike ose besimi fetar, por të bashkuar për një qëllim, për të luftuar kundër armikut me çdo mënyrë, me armë, me penë, me rezistencë të hapët e të fshehtë, pa u lëkundur e pa u ligështuar. Qëllimet e Frontit dhe detyrat e tij për luftë totale kundër armikut Partia i shprehu haptazi dhe me çiltërsi.

Në këtë mbledhje historike u caktuan edhe format organizative të Frontit Nacionalçlirimtar që do të shtrihej në të gjithë Shqipërinë, e cila lëngonte nën pushtimin e të huajve. Këshillave të Frontit Konferenca e Pezës u caktoi edhe detyra për furnizimin e ushtrisë dhe të Luftës Nacionalçlirimtare me çdo gjë të nevojshme, ajo u jepte këtyre këshillave formën embrionale të pushtetit popullor, që do të zhvillohej e përsosej më vonë si shtet i diktaturës së proletariatit. Armiqtë përdorën çdo mjet, që nga shpifjet e gënjeshtrat e më në

fund edhe armët, por Partia, Fronti Nacionalçlirimtar dhe populli i bashkuar i bënë ata pluhur e hi.

Pse i bënë pluhur e hi? Ç'ishte ky fenomen që po ngjiste në këtë vend të vogël? Ishte fenomeni që provonte se edhe një vend i vogël me një popull të vogël, të pastër e të ndershëm, por i bashkuar fort, me armë në dorë e i udhëhequr nga ide të mëdha revolucionare, mund t'i ruante traditat e tij të mëdha shekullore, mund të luftonte dhe të fitonte lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin, mund të bënte revolucionin e të vendoste pushtetin popullor. Kjo ishte fitorja e ideale liridashëse të të parëve tanë të mbrujtura me idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit. Revolucioni në Shqipëri fitoi, sepse ishte Partia Komuniste e Shqipërisë ajo që u vu në krye të masave të popullit dhe realizoi bashkimin e fuqishëm të tij.

Frontin Nacionalçlirimtar u përpoqën ta shtrembëronin, ta çoroditnin, ta dëmtonin dhe ta shkatërronin elementët e shitur të «Ballit Kombëtar», të kësaj organizate tradhtare e bashkëpunëtore e pushtuesve. Por më kot. Prej asaj dite historike që u formua, Fronti, i udhëhequr nga Partia, u bë organizata e madhe dhe e gjerë e popullit shqiptar, u bë mjet i bashkimit, i organizimit dhe i edukimit politik të popullit. Në bashkimin monolit qëndronte sekreti i forcës dërmuese të popullit tonë dhe i fitores së tij mbi armiqtë. E mbështetur fuqimisht në këto forca të gjalla Partia jonë do të bënte mrekullira, do të udhëhiqte me sukses revolucionin nga etapa demokratike, antiimperialiste, në etapën e revolucionit socialist në etapën e diktaturës së proletariatit e të ndërtimit të socializmit.

Pasi u fitua liria vendi kaloi përsëri ditë të vështira. U deshën përpjekje të panumërta, beteja madhështore e veprime të mençura të Partisë sonë heroike për të kapërcyer këto vështirësi. U desh të mobilizoheshin energjitë e popullit të bashkuar në organizatën e madhe të Frontit dhe në të gjitha organizatat e tjera të masave. Brenda dy vjetëve, pa ndihmën e kurrkujt, ne mundëm të rindërtonim të gjitha objektet që na shkatërroi lufta, e cila na vrau 28 mijë shokë e shoqe nga më të mirët dhe na dogji e përvëloi gjithë vendin. Dëmet e pësuara nga lufta ishin të mëdha, por Shqipëria e re nuk u ligështua, se kishte një popull vigan e se vigane ishte Partia dhe ideologjia që e udhëhiqte atë.

Forca e bashkimit të popullit tonë kalitej në luftë të ashpër me armiqtë, të jashtëm e të brendshëm, me mbeturinat e tyre, që përpiqeshin të ngrinin krye e të rivendosnin kapitalizmin. Ato fuqi imperialiste, që deri dje ishin aleate në luftën kundër fashizmit, me mbarimin e saj u kthyen në armiq të rrezikshëm që punonin për të rrëzuar pushtetin tonë popullor. Megjithëkëtë ata nuk mundën ta mposhtnin dot popullin shqiptar, klasën punëtore shqiptare dhe Partinë e saj të lavdishme të Punës.

Ndërtimi i socializmit dhe vendosja e diktaturës së proletariatit u bënë një realitet i madh në Shqipëri. Filloi ndërtimi i bazave të socializmit, sipas mësimeve të Leninit e të Stalinit. Mësimet e këtyre dy udhëheqësve të proletariatit botëror na ndihmuan në rrugën tonë

Stalini i madh, sa ishte gjallë, na ndihmoi me çka mundi. Atij i hodhën baltë tradhtarët revizionistë hrushovianë dhe gjithë tradhtarët e marksizëm-leninizmit në botë, por emrin e tij nuk e shuajnë dot. Josif Stalini, të cilit ne sivjet do t'i festojmë 100-vjetorin e lindjes, ishte një marksist-leninist i madh, një nxënës besnik i Marksit i Engelsit dhe i Leninit, ai ishte mësuesi që u dha komunistëve dhe popullit shqiptar dritë e forcë dhe kontribuoi shumë që Shqipëria e re të ecte sypatrembur e kryelartë dhe të mundte çdo armik që do t'i dilte përpara.

Armiq të jashtëm dhe armiq të brendshëm, armiq të hapët dhe armiq të maskuar vazhdimisht do të na dilnin në rrugë. Partia diti t'i zbulonte njërin pas tjetrit, t'i demaskonte dhe t'i bënte të pafuqishme komplotet e tyre kundër socializmit e lirisë së Atdheut, pse ishte një parti e klasës punëtore, një parti që ndiqte me besnikëri marksizëm-leninizmin, një parti që mbështetej te masat e gjera të popullit.

Pra, pa një parti marksiste-leniniste me një program të qartë minimal e maksimal, pa bashkuar popullin shqiptar si në luftën për çlirimin e Atdheut ashtu edhe për ndërtimin e vendit, fitorja do të ishte e pamundur. Për të çliruar këtë vend të vogël, u derdh vetëm gjak shqiptari. Për ta rindërtuar nga shkatërrimet e luftës e për të ndërtuar socializmin në këtë vend të vogël, u derdh vetëm djersë shqiptari.

Ka njerëz që thoshin e thonë akoma se Shqipëria paska jetuar në saje të ndihmave të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera socialiste, në saje të ndihmave të titistëve, kur dihet se këta të fundit jo vetëm që nuk na kanë ndihmuar, por në të kundërtën, na kanë grabitur sa kanë mundur. Thuhet gjithashtu se Shqipëria paska jetuar në saje të ndihmave të kinezëve! Kjo është një tjetër gënjeshtër. Kreditë, që ata na kanë akorduar ne i kemi pasë pranuar, duke menduar se kishim të bënim me marksistë-leninistë, megjithatë ato nuk përfaqësojnë veçse një përqindje fare të vogël të investimeve që ka bërë populli ynë.

Shtetet pseudosocialiste, që u demaskuan njëri pas tjetrit, dhe që për këtë luajti një rol me rëndësi Partia e Punës e Shqipërisë, me kreditë që jepnin kishin qëllime imperialiste. Por këto qëllime të errëta ua zbuloi Partia e Punës, e cila ua dogji kartat në duar. Ne nuk i kemi borxh kurrkujt. Kreditë e marra ua kemi shlyer, vetëm pak gjëra kanë mbetur akoma për t'u kthyer, prandaj ata le ta mbyllin gojën. «Ndihma» e tyre kishte qëllime të këqia, ata, nëpërmjet «ndihmës», kërkonin që Shqipërinë ta bënin vegël të tyre, ta bënin neokoloni. Por nuk u ndezi me ne. Partia e Punës e Shqipërisë nuk e tradhtoi kurrë popullin e vet, ideologjinë e saj, marksizëm-leninizmin, prandaj triumfoi.

Hrushovianët, titistët, kinezët, «eurokomunistët» etj. e tradhtuan marksizëm-leninizmin, ata u bënë lakejtë e borgjezisë, por, pavarësisht nga kjo, marksizëm-leninizmi është e do të mbetet doktrina e pamposhtur e proletariatit që do t'u ndrisë rrugën miliona e miliona njerëzve, të cilët janë ngritur e po ngrihen në revolucion për të shkatërruar shoqërinë e kalbur të kapitalizmit.

Shqipëria është e vogël, i vogël në numër është edhe populli i saj, por shembulli i tyre është i madh, pse mbrojnë një kauzë të madhe. Ndonjë përjashta shtron pyetjen: Ku e gjen tash populli shqiptar këtë forcë të madhe shpirtërore, ekonomike, kulturore dhe ushtarake, që t'u bëjë ballë valëve të tërbuara të kapitalizmit e të revizionizmit modern, të imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e reaksionit nez etj., urrejtjes së diktaturave fashiste e reaksionit të jashtëm, që përpiqen ta dëmtojnë e ta shkatërrojnë? Këtë forcë ai e ka gjetur jo në përkrahjen e ndonjë fuqie të madhe, por në veten e tij, në ndjenjat e tij patriotike dhe burrërore, në ideologjinë marksiste-leniniste, në vijën e drejtë të Partisë, në unitetin e çeliktë të tij me Partinë, në përkrahjen e komunistëve të vërtetë dhe të proletariatit e të popujve të botës. Janë pikërisht këta faktorë që e bëjnë Shqipërinë të mos ia ketë frikën kurrkujt.

Njerëzit e ndershëm dhe përparimtarë të të gjithë botës shohin te Shqipëria një shembull të gjallë ku një popull i vogël, i rrethuar nga të katër anët nga kapitalizmi dhe borgjezia, qëndron i patundur, i pamposhtur dhe ndërton socializmin me forcat e veta.

Në kohën kur kriza e madhe botërore ka mbuluar vendet kapitaliste, imperialiste dhe socialimperialiste, kur po ngrihen çmimet e të gjitha sendeve të nevojshme për njerëzit, kur miliona punëtorë flaken në rrugë pa punë, vendi ynë ndërton me sukses socializmin. Këtu lulëzon dhe zhvillohet një industri e fuqishme, një bujqësi e përparuar dhe një kulturë thellësisht njerëzore dhe e pastër. Kultura jonë i shërben jo vetëm përparimit të vendit, por çjep kontributin e vet edhe në thesarin e madh të kulturës botërore.

Në vendin tonë të pavarur e sovran njeriu rron i lirë dhe nuk ia shtrin dorën kurrkujt. Asnjëherë shqiptari nuk ia ka nderur dorën ndonjërit, ai ka qenë i zoti ta fitojë bukën me nder e me djersën e ballit. Të lypurit nuk është në natyrën tonë, por në të atyre që janë të shitur të kapitali. Ne ua kemi nderur dorën të tjerëve për miqësi të sinqertë, por jo për lëmoshë. Siç qe i zoti të derdhë gjakun për çlirimin e Atdheut dje, populli ynë është i zoti të derdhë djersën për ndërtimin e socializmit sot.

Tërmeti që ra te ne, para disa javësh, ishte tërmeti më i madh që mbahet mend të ketë rënë në vendin tonë. U shkatërruan fshatra të tëra! Ky dëm i madh do të përballohet me forcat tona. Brenda pesë muajve të gjitha fshatrat e rrënuara do të ndërtohen më të bukura se sa ishin, ato do të jenë fshatra të reja socialiste. Fshatarët që u dëmtuan nga tërmeti, për të shprehur mirënjohjen ndaj Partisë për kujdesin e saj prindëror, thonë: më parë se të na vinte gjitoni na u gjend pranë Partia. Gjithë Shqipëria, si një trup i vetëm, u ngrit në këmbë për të kapërcyer vështirësitë e mëdha që u krijuan. Kështu ka ndodhur e ndodh te ne kurdoherë që e do nevoja. Një për të gjithë, të gjithë për një. Me mijëra njerëz kanë shkuar dhe me dhjetëra mijë të tjerë kanë shprehur dëshirën të shkojnë për likuidimin e pasojave të rënda që u shkaktoi tërmeti vëllezërve e motrave në zonat e dëmtuara. Në linjat tona automobilistike e heku-

rudhore shikon vazhdimisht vargjet e pafund të kamionave e të trenave që transportojnë materiale ndërtimi. Popullit që i rëndoi fatkeqësia, sidomos në Veri, në Shkodër, në Lezhë, në Mat, në Mirditë, në Krujë, në Dibër, në Pukë e në Tropojë, që ditën e parë nuk i mungoi asgjë. Me një shpejtësi të rrufeshme u sistemuan njerëzit nëpër çadra dhe ata nuk e ndien veten ngushtë as për sheqer e për kafe, pa lere pastaj për bukë, mish e zarzavate që i kishin më me shumicë se më parë.

Ka të tjerë që po lypin ndihma anembanë. Kanë dhjetë vjet që nuk po i ndërtojnë dot ato fshatra dhe zona që i ka pasë rrënuar tërmeti. Natyrisht, neve na vjen keq për popullatën që vuan, se e dimë që kjo gjëndje nuk është për fajin e saj, por për arsye të sistemit shoqëror dhe shtetëror që ekziston atje. Në sistemin socialist çdo e keqe kapërcehet bashkërisht dhe me shpejtësi, kurse në sistemin kapitalist njeriu vuan jo vetëm në momentet e mjerimit që shkakton një fatkeqësi e natyrës, por gjithë jetën.

Organizata jonë e madhe e Frontit Demokratik ka pasur, ka dhe do të ketë një rëndësi shumë të madhe për ndërtimin e socializmit. Partia që e udhëheq dhe e frymëzon atë, i pajis anëtarët e Frontit me virtytet e larta patriotike të popullit tonë, me mësimet e ideologjisë marksiste-leniniste. Partia e Punës e Shqipërisë punon që Fronti të jetë kurdoherë i fortë dhe veprues, ashtu siç ka qënë deri sot, të vazhdojë edhe në të ardhmen luftën për të kryer me sukses detyrat që cakton ajo për ndërtimin e plotë të socializmit, për ruajtjen e lirisë së popullit dhe të pavarësisë së Atdheut, që Shqipëria të jetë kurdoherë një vend sovran, plot dinjitet, i respektuar nga popujt e tjerë.

Partia i mëson komunistët të qëndrojnë si gjithnjë në ballë të çdo pune e të çdo përpjekjeje, të tregojnë gjallëri e vetëmohim për kryerjen e detyrave. Duke qënë anëtarë të Frontit Demokratik të Shqipërisë, ata duhet të jenë nga militantët më të shquar, plot pjelidhur ngushtë me të, të ruajnë unitetin e Partisë me popullin, të forcojnë organizatën e Frontit dhe të gjitha organizatat e tjera të masave, që janë leva të Partisë dhe e gjallërojnë e i japin vitalitet e forcë aktivitetit dhe mendimit të madh të saj. Sa më shumë të diskutohen në Front direktivat dhe problemet që shtron Partia, sa më shumë kritikë t'u bëhet lëshimeve të palejueshme, veseve të dëmshme që ekzistojnë e që mund të lindin, shfaqjeve të huaja, liberalizmit e burokratizmit, aq më i fortë e më i qëndrueshëm do të jetë socializmi në Shqipëri, aq më i fortë do të jetë Atdheu ynë.

Për këtë arsye Partia i jep një rëndësi kaq të madhe organizatës së Frontit. Rruga që i ka caktuar Partia kësaj organizate është e lavdishme. Fronti Demokratik i Shqipërisë ka kaluar nga shumë etapa të vështira e historike dhe i ka kryer me nder detyrat e tij të mëdha. Ai me siguri do të vazhdojë edhe paskëtaj të jetë një organizatë e madhe politike e popullit tonë, e udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë.

(Artikull i botuar në gazetën «Bashkimi» më 3 qershor 1979)

Nga punimet e Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë

FJALA E HAPJES E SHOKUT ENVER HOXHA

Të dashur shokë e shoqe,

Jemi mbledhur këtu, në qytetin e bukur heroik të Vlorës së Ismail Qemalit, në gjirin e popullit të tij trim e bujar, që luftoi heroikisht më 1920 dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, për të zhvilluar punimet e Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Ju keni ardhur në Vlorë nga të katër anët e Atdheut për të sjellë dëshirat, mendimet e gjykimet e punëtorëve, të kooperativistëve e të intelektualëve, të grave e të rinjve dhe për të diskutuar mbi problemet e detyrat e mëdha që ëndrojnë sot përpara popullit tonë. Të gjithë së bashku do të diskutojmë si ta forcojmë edhe më shumë Shqipërinë tonë të dashur, si ta bëjmë edhe më të pathyeshëm unitetin e çeliktë të popullit tonë, si ta bëjmë jetën e tij më të lumtur e më të gëzuar, si t'i gjallërojmë edhe më tepër jetën e veprimtarinë e organizatës sonë të Frontit Demokratik. Me siguri ju, shokë e shoqe delegatë, do t'i përmbushni plotësisht dëshirat që ju ka shprehur dhe porositë që ju ka dhënë populli kur ju zgjodhi për të ardhur në këtë kongres.

Sot në këtë kongres nuk ndodhen më midis nesh anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm Gogo Nushi, Zylyftar Veleshnja, Persefoni Dervishi, Sulo Lutaj, Subi Bakiri, Qazim Baftjari, Aishe Doçi, Qibrie Ciu, Ismail Goci, Bilbil Klosi, Vasil Ziu, Kristaq Antoniu, Avdi Mulosmani, Kiço Gliozheni, të cilët, gjatë gjithë jetës së tyre, kanë luftuar e punuar me devotshmëri të pafund për çështjen e Partisë, të lirisë e të pavarësisë së Atdheut, për forcimin e unitetit të popullit tonë në Frontin Demokratik të Shqipërisë.

Ju ftoj, shokë delegatë, të nderojmë me një minutë heshtje kujtimin e tyre të ndritur e të paharruar.

Fronti Demokratik është organizata luftarake që, nën udhëheqjen e Partisë, bashkon mbarë popullin shqiptar, që organizon e mobilizon punonjësit në luftën për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë të fituara me gjak e sakrifica, që punon pa u lodhur për ndërtimin e jetës së re socialiste dhe për edukimin e masave të gjëra me dashurinë e pafund për Atdheun, me idealet e socializmit e të komunizmit.

Fronti Demokratik është bartës i traditave të shquara liridashëse të popullit tonë, është vazhduesi i përpjekjeve të mëdha që kanë bërë

patriotët e demokratët përparimtarë shqiptarë të të gjitha kohëve për bashkimin e popullit në luftë për Shqipërinë e lirë, për ruajtjen e unitetit të kombit kundër orvatjeve të fuqive imperialiste e shoviniste që synonin copëtimin e vendit, për një jetë më të mirë e drejtësi shoqërore, për mbrojtjen e gjuhës amtare e të kulturës sonë të lashtë.

Këto tradita e këto ideale të popullit tonë Partia Komuniste i ngriti lart e i pasuroi më shumë kur krijoi, në zjarrin e luftës heroike partizane, Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar.

Partia me këtë organizatë realizoi bashkimin më të fuqishëm në historinë e popullit tonë, të paparë për gjerësinë e tij, për forcën e organizimit e ndërgjegjen e lartë politike. Lufta kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit e forcoi dhe e kaliti unitetin e popullit, e bëri atë faktor vendimtar për fitoren historike të 29 nëntorit 1944.

Ishte ky unitet i popullit rreth Partisë që u ngrit në një shkallë të re e më të lartë në luftën për transformimin socialist të Shqipërisë, përpara të cilit janë thyer komplotet e sulmet e shumta të imperialistëve e të revizionistëve, përpara të cilit janë dërrmuar e janë bërë thërrime orvatjet kundërrevolucionare të armiqve të brendshëm. Është ky unitet që e bën të pathyeshëm e të pamposhtur Shqipërinë socialiste, që e bën të qëndrojë atë ballëlart e të ecë përpara e lirë dhe e pavarur në rrugën e socializmit.

Ky unitet dhe solidaritet i madh pupullor e tregoi përsëri vitalitetin dhe fuqinë e tij kur tërë njerëzit tanë u ngritën përnjëherë për t'u shkuar në ndihmë vëllezërve e motrave të tyre që u dëmtuan nga tërmeti i rëndë i 15 prillit.

Nga kjo tribunë e lartë e Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë ne u drejtojmë familjeve të viktimave ngushëllimet më të përzemërta të Frontit Demokratik, të Partisë, të mbarë popullit, të të gjithë ne delegatëve, për humbjet e hidhërimin që u shkaktoi kjo fatkeqësi e rëndë natyrore.

Ne admirojmë guximin dhe heroizmin e të gjithë atyre të cilët, me gjithë dëmet e mëdha që pësuan nga tërmeti, as u ligështuan, as u dëshpëruan. Ne admirojmë besimin e madh e të patundur që kanë ata te Partia e tyre e dashur dhe te pushteti popullor.

Nga ky kongres u dërgojmë përshëndetjet tona të gjithë vullnetarëve nga tërë Shqipëria që punojnë me vetëmohim, ditë e natë, për ndërtimin e shtëpive dhe të fshatrave të shkatërruara, për të çuar në vend fjalën e Partisë që më 1 tetor çdo gjë të jetë rindërtuar dhe të jetë ngritur më e bukur se më parë.

Kongresi i Frontit Demokratik mblidhet në një kohë kur populli ynë ka mobilizuar forcat dhe është ngritur i tëri në këmbë për të realizuar vendimet historike të Kongresit të 7-të të Partisë, për të vënë në jetë programin madhështor të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ai mblidhet në vitin jubilar të 35-vjetorit të çlirimit të vendit e të vendosjes së pushtetit popullor, të kësaj fitoreje të madhe të Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia jonë heroike. Le të shërbejë ky përvjetor i shënuar për fuqizimin dhe përparimin e mëtejshëm të Atdheut tonë të dashur, të Shqipërisë sonë socialiste!

Kongresi ynë, me punimet e vendimet e tij, me siguri do t'i japë një nxitje të re e të fuqishme punës së Frontit për mobilizimin e punonjësve në luftën për realizimin e planit të shtetit, për të rritur edhe më shumë prodhimin, për të çuar edhe më përpara zhvillimin e kulturës e për të ngritur më tej mirëqënien.

Punimet e këtij kongresi do t'u shërbejnë organizatave të Frontit për të intensifikuar punën e tyre për edukimin patriotik e revolucionar të masave. Duke e zhvilluar kurdoherë drejt luftën e klasave, ashtu siç na mëson Partia, të forcojmë edhe më shumë unitetin e popullit e lidhjet e tij me Partinë, të mprehim edhe më tepër vigjilencën, të rritim gatishmërinë e aftësinë e popullit për mbrojtjen e Atdheut.

Për mua është një kënaqësi e veçantë t'ju sjell juve, shokë e shoqe delegatë, përshëndetjet e zjarrta të Komitetit Qendror të Partisë dhe, në emër të tij, t'i uroj Kongresit të 5-të të Frontit Demokratik që ta përmbushë me sukses misionin e lartë e të rëndësishëm që i është ngarkuar.

Kongresin e deklaroj të hapur.

mokratik do të gjejë frymëzime të reja për t'i ngritur në një nivel më të lartë punën dhe luftën e saj revolucionare e patriotike për bashkimin edhe më të madh e më të fuqishëm të popullit rreth Partisë, për mobilizimin edhe më të organizuar e më energjik të tij për ndërtimin e socializmit, për ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjes e të hovit revolucionar të masave tona punonjëse në luftën për përparimin e begatimin e pandërprerë të Atdheut tonë socialist.

Një nxitje në këto përpjekje e në këtë luftë do të jenë edhe festimi këtë vit i 35-vjetorit të çlirimit të Atdheut dhe përkujtimi i 100-vjetorit të lindjes së marksist-leninistit të madh, Josif Stalinit.

Le t'i përvishemi, shokë, punës me një vrull edhe më të madh, le të hidhemi më me vendosmëri në betejat e reja që na presin! Le të ecim kurdoherë përpara me guxim në rrugën e lavdishme në të cilën na udhëheq Partia e Punës e Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye!

Rroftë Kongresi i 5-të i Frontit Demokratik të Shqipërisë!

Rrofshin populli shqiptar dhe uniteti i tij i çeliktë!

Rrofshin Partia e Punës e Shqipërisë, Komiteti i saj Qendror me shokun Enver Hoxha në krye!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

FJALA E MBYLLJES E SHOKUT ENVER HOXHA

Të dashur shokë e shoqe,

Kongresi ynë po u jep fund punimeve të tij. Këshilli i ri i Përgjithshëm që ju zgjodhët njëzëri, në mbledhjen e parë që bëri zgjodhi gjithashtu njëzëri e me duartrokitje kryesinë e tij.

1. ENVER HOXHA,	kryetar
2. MYSLIM PEZA,	nënkryetar
3. RAMIZ ALIA,	〃
4. PILO PERISTERI,	〃
5. GJELA BIBA,	〃
6. XHOXHI ROBO,	sekretar
7. ALEKS BUDA,	anëtar
8. AGIM KËLLIÇI,	〃
9. BESIM DAJA,	〃
10. DRITËRO AGOLLI,	〃
11. ET'HEM BARHANI,	〃
12. FARIJE SALIÇAJ,	〃
13. IDEALE HASKO,	〃
14. JORGO SELO,	〃
15. KOLI MONE,	〃
16. MAMAN SALIU,	〃
17. MEHMET RAMA,	〃
18. NAZAR BERBERI,	〃
19. NIAZI ÇEPANI,	〃
20. QIRJAKO HARITO,	〃
21. RAMIZ AGOLLI,	〃
22. SHPRESA JANO,	〃
23. TISH DAIA,	〃
24. VITO KAPO,	〃
25. VALDETE SALA,	〃

Më lejoni, shokë e shoqe, që, në emër të Këshillit të Përgjithshëm dhe të kryesisë së re të Frontit, t'ju falenderoj për besimin që treguat ndaj nesh dhe për nderin e madh që na bëtë duke na zgjedhur në udhëheqje të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Ne e sigurojmë Kongresin, gjithë organizatën e Frontit, mbarë popullin, si dhe Partinë tonë, se do të vëmë të gjitha forcat e nuk do të kursejmë asgjë për të plotësuar me sukses detyrën e lartë e me përgje-

gjësi që na ngarkuat. Ju premtojmë se do të punojmë pa u lodhur për të mobilizuar popullin në luftë për ndërtimin e socializmit, për realizimin e tejkalimin e planeve të shtetit, të tanishme dhe të ardhshme, për forcimin e mbrojtjes, të lirisë e të pavarësisë së Atdheut.

Punimet e kongresit tonë, diskutimet që u bënë këtu, ishin një dëshmi e gjallë e ndërgjegjes së lartë politike që karakterizon popullin tonë, e ndjenjës së përgjegjësisë e të preokupimit të njerëzve tanë për zgjidhjen me sukses të detyrave që shtrojnë zhvillimi i vendit dhe situatat në të cilat jetojmë. Kongresi i 5-të i Frontit Demokratik të Shqipërisë ishte një manifestim i shkëlqyer i unitetit të çeliktë të popullit rreth Partisë, i vendosmërisë së punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, të të gjithë punonjësve tanë, për ta çuar kurdoherë përpara çështjen e socializmit në Shqipëri.

Problemet që u diskutuan, mendimet që u shfaqën dhe propozimet që u bënë këtu kanë rëndësi shumë të madhe, sepse ato do të ndihmojnë për të ngritur në një nivel më të lartë punën e organizatës së Frontit, entuziazmin e popullit, mobilizimin e gjithanshëm të tij në punë. Detyra jonë, shokë delegatë, është që frymën revolucionare e luftarake, optimizmin dhe besimin që u shprehën këtu t'i çojmë në masat e gjera të popullit, në të katër anët e Atdheut, në qytete, në fshatra, në lagje e në çdo familje, që të gjitha punët, në bujqësi, në industri, në arsim, në kulturë, në mbrojtje, të marrin një hov të ri, që detyrat kudo të plotësohen e të tejkalohen.

Realizimi me sukses i detyrave, plotësimi i planit të gjashtë pesëvjeçar në të gjithë sektorët e në të gjithë treguesit, do të jetë një bazë e fuqishme për planin e ardhshëm pesëvjeçar, të cilin Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria janë duke e hartuar. Ky plan, që do të jetë më i madh se planet e deritanishme, do t'i hapë vendit tonë perspektiva të reja akoma më madhështore. Do të zhvillohet më tej industria jonë e rëndë dhe e lehtë, do të zgjerohet më tej baza energjetike, do të rriten nxjerrja dhe përpunimi i naftës e i mineraleve, do të shtohet prodhimi i pajisjeve dhe i makinerive në vend, do të ecë edhe më përpara bujqësia, një hov të ri do të marrin arsimi e kultura, do të ngrihet më tej mirëqënia e popullit. Plani i ri pesëvjeçar do të jetë i pari plan që do të mbështetet krejtësisht në burimet tona të brendshme dhe do të realizohet vetëm me forcat tona, pa asnjë kredi e ndihmë ekonomike nga jashtë.

Populli shqiptar, ashtu si deri më sot, edhe me këtë plan pesëvjeçar do t'i tregojë gjithë botës, kujtdo qoftë, edhe skeptikëve, sesi mund të ndërtohet e të zhvillohet një vend me forcat e veta kur udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi dhe ka në krye një parti besnike ndaj çështjes së socializmit, interesave të Atdheut e të popullit.

Realiteti i mrekullueshëm që ekziston në vendin tonë dhe perspektivat e ndritura që na hapen i detyrohen popullit tonë heroik e patriot, klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies popullore, grave dhe rinisë. Ato i detyrohen vijës së drejtë të Partisë, që na ka udhëhequr dhe na udhëheq me urtësi nga fitorja në fitore.

Ky realitet e këto perspektiva janë një provë e gjallë e vitalitetit

të marksizëm-leninizmit, e fuqisë së pashtershme dhe e epërsisë së padiskutueshme të rendit të vërtetë socialist mbi sistemin kapitalist, borgjez e revizionist.

Imperializmi, revizionizmi dhe ideologët e tyre e sulmojnë rendin tonë socialist, demokracinë tonë proletare, sepse duan të fshehin kalbëzimin e sistemit dhe karakterin reaksionar të regjimeve të tyre, sepse duan t'i mbajnë punonjësit në errësirë, në shtypje e në shfrytëzim.

Për të qëndruar në fuqi imperializmi dëshiron e punon për skllavërimin dhe shkatërrimin fizik e shpirtëror të njerëzve, kurse socializmi lufton për të kundërtën, për emancipimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të tyre. Kapitalizmi përhap e zhvillon korrupsionin, fenë, krimin, drogat, degjenerimin, kurse socializmi të gjitha këto plagë të shoqërisë borgjeze i lufton dhe nuk i lejon të përhapen. Kapitalizmi kërkon të mbajë në fuqi klasën shfrytëzuese dhe të shtypë masat e gjera të punonjësve, kurse socializmi e përmbys këtë klasë dhe i jep liri të plotë popullit punonjës. Socializmi lufton për lumturinë e njerëzve, kurse kapitalizmi shkakton mjerimin e tyre. Socializmi është kundër luftërave grabitqare, kurse imperializmi i ka në gjak ato. Nëpërmjet luftës e agresionit ai kërkon t'i zgjatë jetën vetes, t'u pijë gjakun popujve, t'i pengojë këta të fitojnë lirinë, pavarësinë dhe të ndërtojnë jetën e tyre të re. Socializmi krijon unitetin e popullit e dashurinë midis njerëzve, kurse kapitalizmi krijon përçarjen, mëritë e grindjet midis masave. Këto përçarje e këto grindje i shfrytëzon borgjezia kapitaliste e revizioniste për të shtypur klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse.

Kapitalizmi botëror, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik e ai kinez po zhyten gjithnjë e më thellë në krizën ekonomike, politike, ideologjike e morale që i ka përfshirë dhe që acaron më tej të gjitha kontradiktat e antagonizmat e brendshme e të jashtme të tyre. Ata kanë filluar të kenë frikë e të tronditen sepse situatat po zhvillohen në disfavor të tyre. Popujt tani jo vetëm që lëvizin, por edhe po ngrihen në një luftë revolucionare e çlirimtare, që rrezikon sundimin kapitalist e revizionist. Shembulli i gjallë për këtë është revolucioni që përmbysi shahun e Iranit. Problemi i naftës, të cilin e bëri edhe më të mprehtë ky revolucion, po e trondit edhe më shumë botën kapitaliste e revizioniste.

Lufta e klasës punëtore në të katër anët e botës, me të cilën bashkohen çdo ditë e më shumë forcat demokratike e përparimtare, po i jep goditje të fuqishme sistemit të shtypjes e të shfrytëzimit kapitalist. Përballë dekompozimit e kalbëzimit të pandërprerë të rendit kapitalist po ngrihet një rrebesh i tmerrshëm, lufta çlirimtare e popujve. Ky zgjim i madh i popujve duket kudo, në të gjitha kontinentet. Ai vihet re edhe në Afrikë, popujt e së cilës kanë vuajtur shtypjen më të rëndë koloniaiste. Çdo ditë e më shumë popujt e këtij kontinenti, proletariati dhe inteligjencia e re, që tregohet mjaft revolucionare, po shohin me sy gjithnjë e më realisht si shtypjen e të huajve ashtu edhe atë të armiqve të tyre të brendshëm. Ata po ngrihen me vendosmëri kundër kësaj shtypjeje të dyfishtë.

Revolta kundër imperializmit e politikës së tij skllavëruese, kundër imperializmit amerikan e veglës së tij sioniste, kundër ndërhyrjeve të so-

cialimperialistëve sovjetikë e intrigave të socialimperialistëve kinezë, po rritet e zgjerohet në Lindjen e Mesme. Për liri e pavarësi, kundër shtypjes së huaj imperialiste dhe reaksionit, luftojnë edhe popujt e Amerikës Latine e të Azisë.

Bota sot rron në epokën e kalbëzimit të kapitalizmit, në kohën kur ziejnë grevat e demonstratat e proletariatit botëror dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve, kur sasia do të shndërrohet në cilësi, kur do të rrëzohen nga fronet shahër, mbretër e tiranë dhe imperializmi do të shembet. Ky është ligj objektiv i zhvillimit të shoqërisë. Rrugë tjetër s'ka. Revolucoini është çështje kohe dhe koha punon për socializmin e jo për imperializmin.

Në epokën e sotme asnjë demagogji revizioniste, asnjë formulë politike borgjeze, asnjë kërbaç e asnjë plumb policësh nuk mund të ndalojë marshimin triumfues të revolucionit.

Populli shqiptar ka qenë dhe do të jetë kurdoherë solidar dhe përkrah popujve, ai ka mbështetur e do të mbështetë fuqimisht luftërat revolucionare e çlirimtare të tyre.

Shqipëria dhe populli i saj duan të rrojnë në miqësi me të gjitha shtetet që nuk ndjekin qëllime armiqësore ndaj vendit tonë. Ne jemi për bashkekzistencën paqësore leniniste, por jo për bashkekzistencë ala hrushoviane e revizioniste. Ne nuk duam as shtypje, as grabitje, as ekspansion; ne duam të rrojmë në liri, në pavarësi dhe në miqësi të ndershme me të tjerët. Ata që kërkojnë të shkelin parimet e barazisë, të mosndëshyrjes në punët e brendshme dhe të respektimit të sovranitetit, populli shqiptar i urren dhe i lufton.

Ne nuk i biem në qafë kurrkujt, por kërkojmë që të tjerët t'i mbajnë larg duart nga Shqipëria socialiste. Në rast se ndokush e prek Atdheun tonë, ai do ta pësojë keq. Kohët kanë ndryshuar. Shqipëria e sotme ka zot, populli shqiptar është bashkuar si një grusht i fortë e i çeliktë. Ai di të mbrohet politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht.

Shokë e shoqe,

Tani ju do të ktheheni në rrethet tuaja, në krye të punëve e të detyrave të mëdha që ju presin. Kongresi i Frontit na armatosi, na frymëzoi e na dha fuqi të reja që të luftojmë më me vendosmëri e më me entuziazëm për Shqipërinë tonë të dashur, për popullin tonë të mrekullueshëm, për socializmin e komunizmin.

Rroftë populli heroik shqiptar!
Rroftë uniteti i popullit në Frontin Demokratik!
Rroftë Partia jonë e lavdishme!
Lavdi marksizëm-leninizmit!

Më parë se të mbyllim Kongresin, në emër të të gjithë juve, shoqe dhe shokë delegatë, më lejoni që t'i dërgojmë falenderimet më të përzemërta dhe mirënjohjen tonë popullit heroik të Vlorës, që na priti me kaq bujari, dashuri e patriotizëm të madh dhe na krijoi kushte shumë të mira për t'i përfunduar me sukses punimet e këtij kongresi.

Kongresin e 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë e deklaroj të mbyllur.

Më tepër vëmendje problemeve të përqendrimit e të specializimit në industrinë mekanike

LLAZAR XHAJANKA

Industria jonë mekanike, nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë e të shokut Enver Hoxha, është zhvilluar me ritme të shpejta. Sot ajo është e pajisur me një bazë tekniko-materiale të fuqishme dhe luan një rol të madh në zhvillimin e ekonomisë popullore. Ajo është bërë një mbështetje e fuqishme për thellimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor në të gjithë degët e sektorët e ekonomisë.

Në zbatim të detyrave të Kongresit të 7-të të PPSH, punonjësit e industrisë mekanike, krahas punës për mirëmbajtjen e teknikës që disponon ekonomia, janë angazhuar gjerësisht edhe me prodhimin e makinerive dhe të pajisjeve për ngritjen plotësisht me forcat tona të uzinave dhe të fabrikave, si dhe për përfundimin e objekteve që u lanë pa u përfunduar nga revizionistët kinezë.

Nëpërmjet thellimit të revolucionit tekniko-shkencor edhe në industrinë mekanike janë arritur suksese në drejtim të vendosjes së teknologjisë së përparuar, veçanërisht në uzinat e ofiçinat që kanë prodhime të përqendruara. Grupet e punës, byrotë teknologjike, specialistët dhe punëtorët pararojë kanë studiuar dhe përcaktuar më mirë teknologjinë e prodhimit dhe luftojnë për zbatimin e disiplinës teknike në proceset e punës. Kjo ka bërë të mundur që të prodhohen detale të komplikuara, si blloqe cilindrash, çifte elikoidalë, kushineta, të prodhohen makineri të komplikuara, si traktorët dhe automjetet e parë të markës shqiptare, makina të ndryshme bujqësore, sonda, anije metalike, të prodhohen makineri e pajisje për ngritjen e objekteve të plota, si fabrika e sheqerit, fabrikat për pasurimin e mineraleve dhe shumë të tjera.

Këto rezultate nuk janë arritur lehtë, por me përpjekje e me punë këmbëngulëse, në radhë të parë në luftë kundër koncepteve frenuese, prirjeve artizanale, prirjeve për të «mos prodhuar detale në seri të vogla, me pretekstin se kërkojnë përgatitje të madhe dhe se rendimenti

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Nëntor 1979
Viti XXVI i botimit

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH — Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Përmbajtja:

ENVER HOXHA — Dëshmi e fuqishme e vijës së drejtë të Partisë, e forcës së pathyeshme të popullit, e vitalitetit të rendit socialist (Fjala e mbajtur në mitingun e madh në Bahçellëk të Shkodrës më 19 tetor 1979) 5

35 VJET SHQIPËRI SOCIALISTE

F. ISLAMI — N. HOXHA — Industrializimi socialist — domosdoshmëri për zhvillimin e pandërprerë e të pavarur në rrugën e socializmit 14

A. BACKA — Politikë klasore revolucionare për ngushtimin e dallimeve thelbësore ndërmjet fshatit e qytetit 26

H. BANJA — Arritje dhe perspektiva të shkencave ekonomike 38

L. ZHAMO — Garanci për arritje të reja të shkollës sonë të revolucionarizuar 40

L. LEKA — Ta çojmë më tej revolucionin e realizuar në jetën e gruas shqiptare 58

A. KAZANXHI — Monumentet e kulturës — thesar i madh me vlera aktuale 68

MATERIALE NGA PUNA E KOMITETEVE TË PARTISË

— Të jetojmë me situatat dhe të përmbushim detyrat lidhur ngushtë me to 77

ENVER HOXHA

DËSHMI E FUQISHME E VIJËS SË DREJTË TË PARTISË, E FORCËS SË PATHYESHME TË POPULLIT, E VITALITETIT TË RENDIT SOCIALIST

– Fjala e mbajtur në mitingun e madh në Bahçellëk të Shkodrës më 19 tetor 1979 –

Të dashur shokë e shoqe, motra e vëllezër të rrethit të Shkodrës e të gjithë Shqipërisë,

Përfundimi me sukses të plotë i të gjitha ndërtimeve në rrethet e Shkodrës, Lezhës, Mirditës, Dibrës, Krujës, Matit, Pukës e Tropojës, që u dëmtuan rëndë nga tërmeti i fortë i 15 prillit të këtij viti, është për të gjithë popullin, për Partinë dhe për mua një gëzim i papërshkruar. Në asnjë vend të botës nuk ka ndodhur që pasojat e një fatkeqësie të madhe si kjo të zhduken brenda një kohe rekord siç ndodhi në vendin tonë socialist.

Tërmetet janë një fenomen natyror që njihen shkencërisht, por pasojat e tyre nuk mund të parandalohen. Një numër zonash të globit tokësor, për shkaqe që dihen, preken nga lëkundje të mëdha ose të vogla.

Vendi ynë nuk përfshihet në zonat e veçanta të tërmeteve, por kjo nuk e përjashton atë nga lëkundjet e tyre. Faktet historike tregojnë se në çdo kohë kanë ndodhur tërmete që janë ndierë dhe kanë shkaktuar dëme në vendin tonë, si edhe në vende të tjera. Historia e lashtë flet sidomos për tërmetet e forta të Dyrrahiumit të vjetër, të Tepelenës, të Gjirokastrës etj.

Para Çlirimit të Shqipërisë, në kohën e sundimit të pushtuesve të huaj dhe të feudo-borgjezisë vendëse, tërmetet përbënin një nga fatkeqësitë më të mëdha për popullin tonë, sepse ai ishte i varfër, i rraskapitur dhe i shfrytëzuar në kulm nga pushtuesit e nga klasat sunduese dhe, si i tillë, nuk gjente as mundësinë më të vogël për të për-

balluar sado pak fatkeqësinë që i binte në kokë. Kur ndonjërit i rrëzohej shtëpia në të kaluarën, kjo përbënte një gjëmë të madhe për të dhe për familjen e tij. Me vështirësi të mëdha dhe duke kursyer nga goja e vet dhe e fëmijëve kafshatën e bukës, atij do t'i duheshin me dhjetëra vjet që të rindërtonte çatinë sa për të mbuluar kokën. Megjithatë, edhe në ato kohë aq të rënda e fatkeqe, kur sundimtarët nuk i jepnin as ndihmën më të vogël të dëmtuarit, nuk ka munguar ndihma e njerëzve tanë të thjeshtë për shoku-shokun, e vëllait për vëllanë, e mikut për mikun, e shokut për shokun. Përkrahja në fatkeqësi, me gjithë fukarallëkun e mjerimin e madh që ekzistonte në vend, ka qënë një nga vetitë karakteristike të popullit tonë. Dikush jepte një velenxë, dikush një jorgan, i treti një sahan a një lugë, tjetri ndihmonte me punën e tij për të ngritur një kasolle me baltë a një haur sa për t'u futur brenda.

Pas Çlirimit, me fitoren e madhe historike të Luftës Nacionalçlirimtare, me marrjen e fuqisë nga populli, me vendosjen e shtetit të diktaturës së proletariatit, nën udhëheqjen e Partisë së lavdishme të Punës, si në çdo drejtim tjetër, edhe në drejtim të fatkeqësive natyrore, siç janë tërmetet, gjëndja ndryshoi krejtësisht. Rrënimet nga tërmeti që preknin krahina të tëra dhe ishin nga më të rëndat, filluan të zhduken me vendosmëri të madhe pa shumë dhembje dhe brenda një kohe shumë të shkurtër. Tani për t'i ndihmuar të prekurit nga ndonjë fatkeqësi e për të zhdukur pasojat që sjell ajo, ngrihet në këmbë menjëherë gjithë populli, të cilit i bën thirrje Partia, ashtu sikurse edhe dje në Luftën Nacionalçlirimtare. Kur Partia i bëri thirrje popullit për çlirimin e Atdheut, ai u ngrit i tëri dhe iu përgjigj flakë për flakë kushtrimit të saj. Kështu ka ndodhur te ne edhe pas Çlirimit kur kanë rënë tërmete, si ato në Dibër e Librazhd, në Tepelenë e në fshatrat e Mallakastrës, në Sarandë e gjetkë dhe tani së fundi, në rrethet e Shkodrës, Lezhës dhe në qytete e në shumë fshatra të disa rretheve të Shqipërisë së Veriut. Mbarë populli ynë, me thirrjen e Partisë dhe me besim të pakufishëm tek ajo, u ngrit menjëherë dhe, si një trup i vetëm, u mobilizua për të përballuar dëmet e shkaktuara, për të lehtësuar e ndarë dhembjen e madhe së toku me vëllezërit e motrat e dëmtuar.

Më 15 prill të këtij viti tërmeti na vrau dhe na plagosi shumë vëllezër e motra, na preku 500 fshatra e disa qytete, ku dolën jashtë përdorimit më tepër se 17 mijë shtëpi, objekte ekonomike e socialkulturore dhe, si pasojë, rreth 100 mijë banorë mbetën pa strehë. Për një çast u lëkund fort toka, u lëkundën kodrat, u lëkundën malet tona, shtëpi e fshatra të tëra na u rrafshuan përtokë, por nuk u lëkund shqiptari. Ai qëndroi fort në këmbë, ashtu siç ka qëndruar kurdoherë përpara rrebesheve që e kanë kërcënuar, ashtu siç ka qëndruar kur armiqtë janë përpjekur t'i prekin lirinë dhe kufijtë e Atdheut.

Shqiptari asnjëherë, në asnjë rrethanë, nuk është ligështuar, por me syrin në thepin e pushkës e ka mbajtur drejt shtatin, ka përveshur krahët, ka ngritur lart zemrën, ka vënë të gjitha forcat e tij fizike dhe mendore për të përballuar rreziqet. Mbi hirin, mbi rrënimet nga luftërat barbare të pushtuesve të ndryshëm, ai ka ditur të qëndrojë

i paepur e të rindërtojë Atdheun. Edhe në kohët tona, me Luftën vigane Nacionalçlirimtare kundër fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë, populli ynë e çliroi vendin dhe, pas kësaj lufte, e rindërtoi Atdheun e zhuritur nga armiqtë. E rindërtoi atë shpejt dhe ashtu siç dëshironte. Më vonë ndërtoi e po ndërton një shoqëri të vërtetë socialiste, ku rron i lirë, në demokraci dhe në sovranitet të plotë. Të bashkuar dhe në dashuri të papërshkruar jetojnë njerëzit tanë me njëri-tjetrin dhe me Partinë e pushtetin e tyre.

Ne jemi një vend i vogël dhe një popull i vogël. Por popullin shqiptar e karakterizojnë një forcë dhe një qëndrueshmëri e madhe, të pashembullta, për mbrojtjen e Atdheut dhe për mbrojtjen e jetës së tij. Këtë forcë dhe qëndrueshmëri të popullit shqiptar i vërteton historia.

Ne jemi pasardhësit e fiseve ilire. Në këto troje të lashta të të parëve tanë kanë vërshuar grekët, romakët, normandët, sllavët, anzhuinët, bizantinët, venedikasit, osmanët e shumë e shumë pushtues të tjerë, por ata nuk i zhdukën dot as popullin shqiptar, as kulturën e vjetër ilire, as vazhdimësinë e saj shqiptare. Kjo tregon dashurinë e madhe të popullit tonë për jetën, tregon vendosmërinë shembullore të tij për të mbrojtur vatrën, kulturën, bashkimin dhe çdo gjë të shenjtë të kombit shqiptar.

Edhe në kohët e reja populli shqiptar ka pësuar shumë fatkeqësi. Atë u përpoqën ta zhduknin si popull e si komb dhe ta shpartallonin si një unitet të gjallë e veprues. Të huajt u përpoqën dhe e copëtuan vendin, ata u përpoqën t'ia zhduknin edhe zakonet, t'ia bastardonin edhe kulturën, edhe gjuhën, por më kot.

Në kohët moderne, më 7 prill të vitit 1939, populli dhe vendi ynë, i qeverisur nga një mbret xhelat feudal, armik e tradhtar, që e kishte shitur Shqipërinë tek Italia, u sulmua nga ushtria fashiste e Musolinit dhe më pas edhe nga ushtria e Hitlerit. Por populli dhe klasa punëtore e Shqipërisë nxorrën nga gjiri i tyre Partinë e lavdishme Komuniste, sot Partia e Punës e Shqipërisë, e cila, që në ditët e para të themelimit të saj, lëshoi kushtrimin: Në këmbë, o burra e gra të Shqipërisë, në këmbë i madh dhe i vogël, për të përballuar rrebeshet që na kanosen e për të dalë fitimtarë mbi armiqtë! Dhe ne dolëm fitimtarë në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, në sajë të luftës së lavdishme të popullit shqiptar, në sajë të patriotizmit të flaktë të bijve të këtij trualli bujar, në sajë të ideologjisë së pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Lufta na shkatërroi, ajo rrënoi çdo gjë, mijëra vëllezër dhe motra na u vranë, por ne asnjëherë s'e humbëm kurajon. Nuk ishte populli ynë nga ata që qanin mbi fatkeqësitë, por ishte një popull trim, që diti të luftojë e të fitojë dhe, pas fitores, të vazhdojë luftën për ndërtimin e një shoqërie të re, të shoqërisë socialiste. Dhe ja, këtë shoqëri socialiste populli tani e gëzon, e jeton, e mbron dhe e zhvillon gjithnjë e më përpara.

Sot, në sajë të vijës së drejtë të Partisë dhe të shtetit të diktaturës së proletariatit, Shqipëria është e popullit punonjës dhe askush nuk guxon ta prekë. Edhe një fatkeqësi kaq e madhe natyrore me pa-

soja të rënda si kjo e tërmetit të 15 prillit të këtij viti, që na rrafshoi përtokë krahina të tëra, nuk e ligështoi popullin tonë.

Motra dhe vëllezër,

Kurrë ndonjëherë në asnjë vend të botës, ku kanë rënë e bien tërmete, nuk është parë që, brenda pesë muajve, të ndërtohen aq shtëpi banimi sa të futet brenda një popullatë e barabartë me atë të dy qyteteve të mëdha siç janë Durrësi dhe Vlora të marra së bashku, pra të ristrehohen në shtëpi moderne, më të mira se ç'i kishin, afro 100 mijë banorë.

Në vende të tjera, ku sundojnë borgjezia dhe kapitali, tërmetet, për fat të keq, përbëjnë, siç mund ta keni dëgjuar, një fatkeqësi të tmerrshme, që u shkaktojnë të dëmtuarve plagë të rënda që nuk i shërojnë dot as për shumë kohë.

Ka vende të prekura nga tërmetet ku njerëzit e dëmtuar kalojnë me dhjetëra e dhjetëra vjet në pritje për të siguruar të paktën një kasolle, por as këtë nuk e sigurojnë dot. Ata rrojnë në kushte të rënda, në çadra, në llucë, në shi e në borë. Për ndërtimin e shtëpive të këtyre të mjeruarve bëhet gjithë ajo bujë, caktohen edhe shuma të mëdha të hollash, gjoja për t'i ndihmuar, por në fakt nuk bëhet gjë, sepse këto shuma në botën e kalbur kapitalisto-revizioniste vidhen e grabiten nga të gjithë ata që ngarkohen gjoja t'i drejtojnë e t'i administrojnë këto fonde dhe nga gjithfarë matrapazësh e spekulatorësh.

Në vendet kapitaliste dhe revizioniste, kur ngjasin të tilla fatekqësi, qeveritë në fuqi zgjatin duart e lypin nga të katër anët, ku të mundin e sa të mundin, për të marrë ndihma në të holla, shtresa e mbulesa, veshmbathje, ilaçe e çdo gjë tjetër të nevojshme e, megjithëkëtë, të dëmtuarit e gjorë prapë mbeten në mjerim, në mes të katër rrugëve. Kurse vendi ynë socialist, ashtu siç i ka përballuar tërmetet e mëparshme, edhe pasojat e këtij tërmeti kaq shkatërrues i zhduku me forcat e veta, pa i nderur dorën kurrkujt, pa pranuar asnjë ndihmë, nga cilado anë që mund të vinte.

Shteti i diktaturës së proletariatit, shoqëria jonë socialiste, me Partinë e Punës të Shqipërisë në krye, me mundësitë dhe me rezervat e tyre ekonomike të pashtershme, me forcat e shpirtit bujar të njerëzve të papërkulur, e mundën shpejt tërmetin, ndërtuan çdo gjë që u shkatërrua, shkolla, shtëpi kulture, çerdhe e kopshte fëmijësh, shtëpi lindjeje, rrugë, ujësjellës e shumë objekte të tjera të domosdoshme dhe ua dhuruan vëllezërve e motrave të zonave që pësuan këtë fatkeqësi.

Familjet që u futën në shtëpitë e reja moderne janë sot në festë, janë të gëzuara e të lumtura, janë krenare për Partinë e tyre të dashur, për pushtetin e tyre të fuqishëm.

Gjithë këto shtëpi të bukura janë prona personale të familjeve që u strehuan në to, të cilave u urojmë që t'i gëzojnë për mot e jetë. Shteti i proletarëve nuk do të marrë nga ata asnjë shpërblim, asnjë taksë dhe asnjë qira. Ja, vëllezër dhe motra, shokë dhe miq, ç'do të thotë socializëm, ç'do të thotë diktaturë e proletariatit, ç'do të thotë fitore e revolucionit socialist mbi armiqtë kapitalistë, të jashtëm dhe të

brendshëm. Kjo është vija e Partisë sonë, që shpreh vullnetin dhe interesat e popullit e të Atdheut socialist. Këtë vijë të drejtë, që udhëhiqet nga doktrina kurdoherë fitimtare e marksizëm-leninizmit, komunistët shqiptarë, populli ynë, e pasurojnë, e zhvillojnë, e mbrojnë dhe e ruajnë të pastër si qelibari. Ja, ky është vitaliteti i rendit tonë shoqëror socialist, i forcës së madhe dhe i qëndrueshmërisë së ekonomisë sonë socialiste.

Borgjezia dhe revizionistët janë përpjekur për shumë e shumë vjet me radhë të gënjejnë botën duke i thënë të kundërtën e asaj që ka ndodhur në Shqipëri, ata janë orvatur ta bëjnë të bardhën të zezë dhe të mohojnë të gjitha ato që po realizohen në vendin tonë, të shpifin se gjithë këto realizime nuk po arrihen nga populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij e lavdishme e Punës, por nga të huajt. Qeveritë borgjeze dhe revizioniste janë përpjekur dhe vazhdojnë të përpiqen që t'i mbushin mëndjen botës se gjoja Shqipëria nuk mund të ndërtohet, të rrojë e lirë dhe e pavarur me forcat, me punën dhe me vullnetin e heroit të popullit të saj. Por gjithë këto gënjeshtra janë demaskuar dhe po demaskohen njëra pas tjetrës nga vetë jeta. Popujt e botës po i shohin gjithnjë e më tepër me sytë e tyre fitoret që arrin populli ynë, ata po dëgjojnë me veshët e tyre zërin e fuqishëm të këtij populli kurdoherë në mbrojtje të së drejtës, në mbrojtje të socializmit, në mbrojtje të interesave të tij dhe të popujve të tjerë të botës. Ata po dëgjojnë me kënaqësi zërin e fuqishëm të revolucionit proletar, që do ta përmbysë një ditë këtë themelet shoqërinë e vjetër borgjeze, kapitaliste, imperialiste, revizioniste.

Kapitalistët dhe revizionistët po gërthasin për «ndjenja humanitare» dhe «për të drejtat e njeriut», por faktet tregojnë se në vendet ku sundojnë ata s'ka as humanizëm, as liri, atje mbretëron mjerimi për popullin, për klasën punëtore, për fshatarësinë. Me miliona janë atje të papunët që vdesin nga sëmundjet e nga uria. Kudo ka greva, anarki, inflacion, kriminalitet, demonstrata, kudo ka përleshje me gjakpirësit e popullit, kudo ka probleme e shqetësime të panumërta për punonjësit, që regjimet në fuqi nuk janë në gjëndje t'i zgjidhin. Në këto vende jeta e njeriut nuk është asnjëherë e sigurt.

Në vendin tonë socialist është e kundërta, populli lufton, punon dhe rron i gëzuar. Çdo ditë e çdo vit jeta e tij përmirësohet. Këtu nuk ka papunësi, nuk ekzistojnë më taksat, nuk ngrihen çmimet, nuk ka inflacion, dhe të tilla nevoja jetësore si shërbimi shëndetësor e arsimi janë të siguruara falas. Qiratë e shtëpive te ne janë aq të vogla saqë gjetkë është e vështirë ta besojnë këtë të vërtetë. Por faktet dhe realiteti ynë flasin vetë.

Këtë Shqipëri të bukur e të lulëzuar socialiste e ka ndërtuar populli i saj dhe jo të huajt, atë nuk e kanë ndërtuar as titistët jugosllavë, as revizionistët sovjetikë dhe as revizionistët kinezë. Imperializmi amerikan, vendet kapitaliste të botës, revizonistët sovjetikë, revizionistët kinezë dhe gjithë revizionistët e tjerë e kanë pasur vazhdimisht halë në sy vendin dhe regjimin tonë socialist. Të gjithë këta armiq janë përpjekur me një mijë mënyra të na dëmtonin, të na skllavëronin.

Por nuk sklavërohet aq lehtë një popull si yni, që e ka treguar trimërinë e tij në shekuj, që po e tregon atë edhe sot e do ta tregojë vazhdimisht në çdo moment të jetës së vet me luftën e ashpër parimore, që bën bashkë me Partinë dhe pushtetin, për të demaksuar të gjithë ata që përpiqeshin e përpiqen ta dëmtojnë.

Le të dalë ai shtet kapitalisto-revizionisto-imperialist që të mohojë këtë realitet të madh, ndërtimin e socializmit në vendin tonë, jetën e lumtur e të gëzuar që po zhvillohet te ne, politikën e drejtë e të pavarur të shtetit shqiptar, miqësinë e madhe që ka shteti ynë i diktaturës së proletariatit me popujt e botës, dhe në mënyrë të veçantë me të gjithë ata popuj që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar dhe shoqëror.

Le të përpiqen, në qoftë se do të mundin, shtetet kapitalisto-revizioniste ta errësojnë këtë fakt madhështor dhe të pamohueshëm që brenda disa muajve u rindërtuan në tërë Shqipërinë e Veriut të gjitha ato ndërtesa që u shkatërruan nga tërmeti. Kjo është një punë kolosale, një realitet i dukshëm, që armiqtë nuk mund ta mohojnë dhe ta errësojnë dot.

Bota kapitalisto-revizioniste është shprehur se politika jonë do t'i nënshtrohej ndonjë fuqie të madhe dhe vendi ynë do të bëhej prej a e tyre. Por kjo as nuk ngjau dhe as nuk do të ngjasë kurrë. Një predikim i tillë dritëshkurtër nxorri kokë që kur ne filluam luftën kundër revizionistëve jugosllavë. E njëjta histori u përsërit kur demaskuam me ashpërsinë më të madhe dhe me drejtësi revolucionare tradhtarët revizionistë sovjetikë. Po kjo gjë ngjau edhe kur ne gjithashtu demaskuam revizionistët kinezë dhe teorinë famëkeqe të maocedunidesë. Pritnin kapitalistët e ndryshëm ose revizionistët sovjetikë që, pas prishjes me kinezët, ne të lidheshim me ta, pritnin ata që Shqipëria t'u nderte dorën dhe pastaj zverkun e të bëhej një koloni e tyre. Por kot kanë pritur, kjo kurrë nuk do të ngjiste dhe kurrë nuk do të ngjasë as në të ardhmen. Populli shqiptar nuk pranon zgjedhë e zinxhirë të çfarëdo lloji.

Popujt, njerëzit revolucionarë e përparimtarë, shokët tanë marksistë-leninistë, le të kenë besim të patundur se Shqipëria socialiste do ta mbajë kurdoherë lart e të papërlyer flamurin e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Josif Stalinit, këtij marksist-leninisti të lavdishëm, këtij revolucionari të madh proletar, që me përjashtim të armiqve të socializmit gjithë popujt dhe bota e përparuar e nderojnë dhe e respektojnë, ne këtë vit do t'i festojmë me madhështi 100-vjetorin e lindjes.

Ne kemi mbajtur e do të mbajmë marrëdhënie normale shtetërore, tregtare dhe kulturore me të gjitha ato shtete me të cilat kemi marrëdhënie të tilla, si dhe me të tjera që do të dëshirojnë të kenë marrëdhënie të drejta me ne, me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Sovjetik revizionist dhe të disa shteteve të tjera, të cilat i kanë bërë dhe sot e kësaj dite vazhdojnë t'i bëjnë padrejtësira Shqipërisë socialiste. Ne nuk do të kemi marrëdhënie as me ato shtete që, pa asnjë të drejtë, vazhdojnë të mos ia kthejnë

pasuritë e grabitura popullit shqiptar dhe të mos i paguajnë shpërblimet për dëmet e shkaktuara nga Lufta e Dytë Botërore. Ky ka qenë kurdoherë vullneti i popullit tonë, i tillë është dhe i tillë do të jetë ky vullnet edhe në të ardhmen. Asnjë shpresë të mos ketë reaksioni botëror për ndryshimin e qëndrimit tonë lidhur me këto kërkesa të ligjshme.

Populli ynë edhe kësaj radhe e tregoi qartë forcën e karakterit të tij luftarak e të pamposhtur, shpirtin e tij të paepur revolucionar, vendosmërinë e guximin e tij të pashembullt. Ai tregoi edhe një herë se ç'mundësi kolosale fsheh në gjirin e tij, ç'vepra madhështore është në gjendje të realizojë, nën udhëheqjen e Partisë, me forcat e me vullnetin e tij të çeliktë, me mendjen e kthjelltë dhe me duart e tij të arta. I madh e i vogël u ngritën në këmbë, u hodhën në sulm klasa jonë punëtore, fshatarësia kooperativiste, rinia, inteligjencia, ushtarakët, të cilët, me shpejtësi të rrufeshme, dërguan vullnetarë dhe ndihma materiale në zonat e dëmtuara nga tërmeti. Të gjithë u gjendën menjëherë pranë vëllezërve e motrave të tyre në këto momente fatkeqësie. Në këtë gatishmëri e mobilizim të lartë spikati edhe një herë ai solidaritet i mrekullueshëm socialist që ka kalitur Partia te njerëzit tanë, ai besim i patundur luftarak i popullit rreth Partisë. Dihet botërisht nga të gjithë se të tëra këto nuk i ndërtuan as papa i Vatikanit, as fryma e shenjtë, as e ashtuquajtura zonja e papërlyeme, por i ndërtuan krahët e fortë dhe mendja e mprehtë e klasës punëtore dhe e punonjësve të tjerë të Shqipërisë. Popujt dhe njerëzit e varfër nuk i shpëtojnë nga vuajtjet dhe nga mjerimet as lutjet e papës së Vatikanit, as gënjeshtrat e Uashingtonit dhe të Moskës dhe as ndërtimi i kambanareve të kishave e i minareve të xhamive. Është vetëm puna e njerëzve të çliruar nga skllavëria kapitaliste që mund të bëjnë çudira. Vetëm lufta kundër reaksionit, kapitalizmit e revizionizmit është ajo që e shpëton njerëzimin. Vetëm socializmi, i ndërtuar sipas mësimeve të Marksit e të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, është ai rend ekonomiko-shoqëror që, në çdo rast, çdo fatkeqësi e shndërron në forcë të madhe revolucionare që mposht çdo dhembje, që përballon çdo vështirësi dhe i bën njerëzit të lumtur.

Ne, shqiptarët, rrojmë dhe do të rrojmë në miqësi me popujt e gjithë botës, dhe në mënyrë të veçantë me popujt fqinj. Na erdhi shumë keq që popullit fqinj të Malit të Zi dhe popullatës shqiptare që banon në këtë republikë u ngjau e njëjta fatkeqësi e rëndë natyrore sikurse edhe neve. Dëshirojmë e shpresojmë që edhe në këtë vend ku ne, tok me partizanët jugosllavë, kemi derdhur gjakun në luftën çlirimtare nga pushtuesit nazi-fashistë, më parë nga çdo gjë të ndërtohen shtëpitë e rrënuara dhe kjo fatkeqësi të mos shkaktojë asnjë emigrim të njerëzve në vende të huaja.

Vëllezër dhe motra,

Në emër të Komitetit Qëndror të Partisë dhe në emrin tim, përshëndes dhe përgëzoj nga zemra popullsinë e rretheve të dëmtuara nga tërmeti dhe vullnetarët nga të gjitha anët e Shqipërisë që, pa u kursyer

dhe pa ndierë ç'është lodhja, derdhën djersën e tyre për të realizuar këtë vepër monumentale të Partisë; përshëndes dhe përgëzoj gjithë punonjësit e vendit tonë që, me një frymë të lartë revolucionare dhe me një disiplinë të çeliktë proletare, duke qenë të ndërgjegjshëm për vështirësitë e krijuara dhe të frymëzuar nga ndjenja e lartë e patriotizmit socialist, përballuan me sukses detyrat e planit, duke zëvendësuar punën e mijëra shokëve të tyre vullnetarë që shkuan në ndihmë të zonave të dëmtuara nga tërmeti; përshëndes dhe përgëzoj gjithashtu organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe ato të ekonomisë, shtabet për zhdukjen e pasojave të tërmetit, projektuesit e gjithë specialistët e tjerë për organizimin dhe drejtimin e mirë, për kurorëzimin me sukses të plotë të këtij aksioni të madh, që u bë një shkollë e vërtetë edukimi, kalitjeje revolucionare dhe përvoje të pasur.

Punëtorë e kooperativistë, të rinj, të reja e punonjës të tjerë në të gjithë Shqipërinë,

Sivjet do të festojmë jubileun e lavdishëm të 35-vjetorit të çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor, prandaj për nder të këtij jubileu, na vihet si detyrë e madhe dhe e vazhdueshme që të përveshim llërët, të derdhim djersë, të vëmë të gjitha forcat e zemrës e të mendjes për të realizuar detyrat që na janë ngarkuar, qofshin këto detyra në fushën ekonomike, politike a të mbrojtjes. Të punojmë që ekonomia jonë popullore vazhdimisht të përparojë e të fuqizohet, që fuqia jonë mbrojtëse të rritet dhe Atdheu ynë socialist të bëhet i paprekshëm nga çdo armik. Asnjë shqiptar dhe shqiptare të mos harrojë se me punë e me luftë u krijuan këto mundësi për përmirësimin e jetës. Duhet të mendojmë për sot, por edhe për nesër, prandaj t'i tejkalojmë planet, të shtojmë rezervat dhe mbi çdo gjë të vëmë interesat e popullit, interesat e Atdheut socialist. Populli shqiptar me këtë synim duhet ta gjykojë çdo punë që bën dhe çdo qëndrim politik që mban. Partia, populli dhe Atdheu socialist mbi të gjitha!

Këto fatkeqësi, që janë bërë për ne prova të mëdha të unitetit, të guximit, të trimërisë dhe të kalitjes revolucionare, ashtu si kurdoherë edhe në të ardhmen, poqe se na ngjasin, le t'i kthejmë në forca të pashtershme, t'i kthejmë në fitore. Dhembjet e mëdha që na shkaktuan humbja e njerëzve tanë nga tërmeti i 15 prillit dhe humbja e parakohshme e shokut tonë të lavdishëm, udhëheqësit të shquar të Partisë e të popullit tonë, luftëtarit trim e heroik të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit, Hysni Kapos, që deri në çastin e fundit të jetës së tij foli dhe mendoi për Partinë dhe popullin e që pikërisht këtu në Bahçellëk, pak javë përpara se të vdiste, vuri gurin e parë në themelet e këtij fshati socialist që po shfaqet përpara syve tanë, t'i kthejmë në një forcë të madhe për ndërtimin e plotë të socializmit e për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së Atdheut.

Të pavdekshme dhe të përjetshme qofshin për Partinë dhe për popullin tonë figura dhe puna e ndritur e militantit të madh Hysni Kapo!

Sukseset që kemi arritur le të na shërbejnë, të na nxitin e të na frymëzojnë që ta shtojmë gjithnjë e më shumë dashurinë për njëri-tjetrin, që të shtojmë dashurinë për Partinë tonë të madhe, që na udhëheq me aq urtësi, me aq guxim e me aq trimëri nga fitorja në fitore në të gjitha fushat. Të vëmë plotësisht në jetë amanetet e mijëra shokëve tanë të rënë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe të shumë të tjerëve që ranë në punë e në luftë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e Atdheut; të ruajmë kujtimin e dëshmorëve të kombit, të cilët luftuan për këto ditë kaq të lumtura që po kalon Atdheu ynë i fortë socialist, Atdheu ynë i lumtur dhe i lulëzuar.

Me këtë rast, gjithashtu, në emër të Komitetit Qendror dhe në emrin tim, dëshiroj të uroj nga zemra popullin e rrethit të Shkodrës, të cilit Presidiumi i Kuvendit Popullor, me propozimin e Byrosë Politike, i dha urdhrin më të lartë: «Hero i Punës Socialiste». Shkodra historike, Shkodra e luftëtarëve të shquar të pushkës e të penës, të Rilindjes e të Pavarësisë Kombëtare, Shkodra e Luftës Nacionalçlirimtare, Shkodra e punës së palodhur për ndërtimin e socializmit, për realizimin e planeve ekonomike, kulturore dhe e veprave të mbrojtjes, e meriton plotësisht nderin e madh që i bën sot mbarë Atdheu ynë, Shqipëria.

Edhe një herë, vëllezër dhe motra të Shkodrës dhe të të gjitha qyteteve e fshatrave që u rrënuan nga tërmeti i fortë i 15 Prillit, ju uroj t'i gëzoni shtëpitë e reja, të kaloni në to një jetë të lumtur e të bukur me fëmijët tuaj, të cilët t'i rritim luftëtarë trima e besnikë të Partisë, t'i kalitim e t'i bëjmë njerëz të vendosur, punëtorë dhe të thjeshtë, ashtu siç është vetë populli ynë. Të ndezim në zemrat e brezit të ri, me shembullin e popullit tonë të pavdekshëm, në shekuj, ndjenjat më të pastra të lirisë, të pavarësisë, të dashurisë për shoku-shokun dhe, në radhë të parë, të dashurisë së pakufishme për Partinë e Punës të Shqipërisë, për shtetin e diktaturës së proletariatit. T'i bëjmë fëmijët tanë internacionalistë të flaktë, që kur ta dojë nevoja të hidhen në zjarr për të mbrojtur kurdoherë kufijtë e Atdheut, revolucionin proletar dhe luftërat nacionalçlirimtare antiimperialiste.

Rroftë Partia!

Rroftë populli!

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Korrik 1980
Viti XXVII i botimit

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

966588

Përmbajtja:

— Komunikatë mbi mbledhjen e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të PPSH 5

ENVER HOXHA — Përparimi i vendit është i pandarë nga zhvillimi i shkencës dhe i teknikës (Fjala në mbledhjen e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të PPSH) 6

RAMIZ ALIA — Të ngremë nivelin e punës kërkimore-shkencore dhe të rritim efektivitetin e saj për zhvillimin aktual e perspektiv të vendit (Raport i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, mbajtur në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH) 26

PROBLEME TË PLENUMEVE TË FUNDIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

O. MURATI — Forcimi i kontrollit shtetëror — faktor i rëndësishëm për përsosjen e drejtimit e të organizimit të ekonomisë 63

M. BUSHATI — Masiviteti dhe cilësia e lartë — dy kërkesa themelore për lëvizjen fizkulturore-sportive 72

L. ÇUÇI — G. PASHKO — Çfarëdo forme që të marrin monopolet — thelbi i pronës kapitaliste nuk ndryshon 80

BIBLIOGRAFI

S. MANUSHI — Vepër me rëndësi historike në luftë kundër revizionizmit modern 90

ENVER HOXHA

PËRPARIMI I VENDIT ËSHTË I PANDARË NGA ZHVILLIMI I SHKENCËS DHE I TEKNIKËS

Fjala në mbledhjen e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të PPSH

Analiza dhe diskutimi i problemeve të shkencës në këtë Plenum të Komitetit Qendror të Partisë ishin të domosdoshme dhe të dobishme.

Vendi ynë ka arritur tani në një stad të përparuar zhvillimi ekonomiko-shoqëror, në të cilin veprimtaria kërkimore-shkencore, krijuese e transformuese ka patur dhe ka rolin e vendin e vet mjaft të rëndësishëm, por që duhet punuar për ta ngritur në një nivel edhe më të lartë sasior e cilësor, me qëllim që të kontribuojë më shumë e më efektivisht në tërë këtë zhvillim.

Atdheu ynë është i vetmi vend që po ndërton me sukses shoqërinë e vërtetë socialiste në kushte të veçanta historike, i rrethuar nga bota kapitalisto-revizioniste dhe pa marrë asnjë ndihmë ekonomike apo kredi nga jashtë. Kjo nuk ndodh jo vetëm me shtete të vegjël, por as me shtete të mëdhenj, të cilët, si kapitalistë e revizionistë që janë, edhe shkencën e teknikën i përdorin për të shtypur e shfrytëzuar masat e gjera punonjëse, për të realizuar synimet e tyre grabitqare imperialiste.

Vendi ynë sot ndodhet, gjithashtu, përpara detyrave madhështore që shtron plani i shtatë pesëvjeçar që jemi duke hartuar dhe që do ta zbatojmë tërësisht me forcat tona. Janë pikërisht këto rrethana kryesore që e bënë Byronë Politike të vendoste për t'i diskutuar posaçërisht në këtë mbledhje të Komitetit Qendror problemet e shkencës e të punës kërkimore-shkencore, me synim **që shkencën dhe përparimin teknik t'i vëmë më mirë në shërbim të zhvillimit aktual e perspektiv të vendit, për zhvillimin e ekonomisë, edukimin e njeriut të ri dhe forcimin e mbrojtjes së atdheut.**

Në raportin e Byrosë Politike për punën kërkimore-shkencore, paraqitur nga shoku Ramiz, çështjet janë shtruar drejt e në mënyrë të sintetizuar. Në të jepen vijat e drejtimet kryesore të programit të punës shkencore. Çdo çështje që trajton raporti shtron një problem, jep një orientim, ose përcakton një objektiv që duhet arritur. Kjo është e rëndësishme

për të drejtuar më mirë e për ta çuar më përpara tërë veprimtarinë kërkimore-shkencore. Diskutimet e shokëve që morën fjalën e plotësuan më tej kuadrin e problemit, duke na vënë më mirë në dijeni mbi stadin e zhvillimit të shkencave te ne deri në ditët e sotme. Kjo është e domosdoshme të dihet saktë nga ne, por edhe nga të gjithë punonjësit, që me punën e tyre kontribuojnë për përparimin shkencor e teknik.

Si në çdo punë, përpara se të thuash ku do të arrish dhe ç'detyrë do të caktosh, duhet të dish e të njohësh mirë gjendjen ekzistuese nga nisesh, duke e parë atë nga të gjithë anët. Kështu qëndron çështja edhe në shkencë. Në rast se themi që duam të arrijmë këto ose ato objektiva, të bëjmë këtë ose atë hap në shkenca të ndryshme e në prodhim, duhet të dimë mirë gjendjen ekzistuese të nivelit të shkencës e të zbatimit të saj në prodhim. Gjithashtu, në qoftë se themi që studimet dhe kërkimet shkencore duhet të paraprijnë çdo punë dhe t'i hapin rrugën e perspektivën prodhimit, atëherë duhet të dimë deri në çfarë shkalle është realizuar kjo në praktikë.

Këtu e kam fjalën që, ashtu siç u veprua në këtë Plenum, por më shumë kur këto materiale të punohen në organet e institucionet qendrore, në rrethe e në bazë, është e kështillueshme të bëhet një analizë e thellë e sukseseve, e të metave dhe e boshllëqeve, të shikohet si janë zhvilluar te ne disiplinat e ndryshme shkencore, në ç'nivel ka arritur puna kërkimore-shkencore e novatore, ç'ka penguar e çfarë pengon për të ecur edhe më përpara, ç'masa konkrete duhet të merren e të zbatohen për këtë qëllim në të ardhmen.

Partia jonë i ka kushtuar dhe do t'i kushtojë një rëndësi të madhe shkencës dhe përparimit shkencor e teknik në vendin tonë, sepse zhvillimi i tyre ka qenë dhe është i pandarë nga nevojat e jetës sonë shoqërore socialiste. Për Partinë dhe shtetin tonë shkenca dhe përparimi teknik-shkencor nuk kanë qenë dhe nuk janë asnjëherë qëllim në vetvete. **Shkenca dhe teknika kanë ecur përpara dhe janë zhvilluar në shërbim të drejtpërdrejtë të nevojave të prodhimit e të jetës shoqërore, ashtu sikurse këto nga ana e tyre kanë qenë dhe janë faktorë nxitës të përhershëm edhe për vetë zhvillimin e shkencës dhe të teknikës.**

Shkencat, qofshin këto edhe teknike e natyrore, janë një formë e ndërgjegjes shoqërore, siç janë të tilla literatura, arti etj. Shkenca vepron mbi zhvillimin e përgjithshëm të qytetërimit, të shoqërisë, sikundër bëjnë gjithashtu artet, literatura, teknika etj. Ajo nuk është një epifenomen i izoluar, përkundrazi është e lidhur me rrënjë të forta e të thella me terrenin shoqëror, ideologjik, ekonomik, politik. Shkenca lidhet dhe zhvillohet me epoka dhe në epoka të ndryshme. Shkenca, ose mendimi shkencor, nuk mund dhe nuk duhet shkëputur nga kuadri shoqëror ku evoluon. Në këtë mënyrë ajo është e pandarë nga historia e përgjithshme e njerëzimit, nga progresi i shoqërisë.

Praktika e shoqërisë është burimi i zhvillimit të shkencave dhe kriteri që vërteton drejtësinë e tezave të tyre. Sot lidhja midis zhvillimit të shkencës, të teknikës dhe të forcave prodhuese është bërë më e ngushtë. Nën ndikimin e shkencës e të përparimit teknik e shkencor rritet edhe potenciali material e intelektual i shoqërisë, i cili nga ana

e tij i jep një shtytje të re përpara zhvillimit të shkencës. Zhvillimi i saj ndjek kurdoherë një rrugë dialektike materialiste. Përparimi i kimisë, siç na mësojnë klasikët tanë të mëdhenj, çoi në materializëm, zhvillimi i matematikës në determinizëm dhe në ateizëm. Arkimedi me futjen e gjeometrisë rrëzoi teoritë e Aristotelit mbi kozmosin dhe vetitë e trupave e kështu me radhë.

Natyrisht, njohja si duhet e shkencave, dhe nga vetë specialistët, sot nuk është aq e thjeshtë, përkundrazi është shumë e ndërlikuar. Shkencat tani janë zgjeruar aq shumë sa edhe shkencëtari më i zoti humbet torruan, si i thonë, dhe e ka të vështirë që me një përmbledhje të shkurtër të të japë idenë e gjerësisë së kësaj apo të asaj shkence. **Çdo shkencë ndahet në degë të veçanta dhe çdo degëzim është një specializim. Zhvillimi dhe shumëzimi i njohurive nxjerr specializimin dhe specializimi kërkon bashkëpunimin sa më të ngushtë në mes disiplinave të ndryshme shkencore, të kërkimeve dhe të teknikave të ndryshme e të shumëllojta.** Nga specializimi dhe nga bashkëpunimi i madh në mes tyre është bërë dhe po bëhet gjithnjë e më e zorshme të dallosh kufijtë e disiplinave shkencore dhe t'i kuptosh ato njërën pa tjetrën.

Ç'janë, për shembull, fizika dhe kimia? Këto janë dy shkenca, që afërsia ndërmjet tyre i bën, si me thënë, «kushërira». Objektet dhe metodat e tyre janë shumë afër njëra-tjetrës, bile mund të themi të pleksura. Por që të dyja i shërbejnë studimit të universit dhe u diferencuan ashtu si edhe shkencat e tjera të natyrës.

Shkenca, në shpjegimin harmonik të botës, do të linte në errësirë shumë gjëra dhe fenomene të ngjashme në rast se nuk do të zbuloheshin lidhjet në mes tyre. Prandaj asnjë shkencë nuk mund të mësohet, të aplikohet dhe të zhvillohet më tej pa i lidhur problemet dhe metodat e saj me ato të shkencave të tjera. Nuk mund të ecin përpara fizika apo kimia, elektronika ose studimet mbi atomin pa përdorur, si me thënë, gjuhën e matematikës. Një lidhje e ngushtë dialektike ekziston gjithashtu midis shkencave teknike e natyrore dhe atyre ekonomike e shoqërore.

Kjo rrjedh edhe nga vetë natyra komplekse e problemeve dhe e fenomeneve të ndryshme në jetë, ku anët materiale, teknike e teknologjike nuk janë të ndara nga anët politike, ekonomike e shoqërore. Kjo kërkon që në praktikën tonë të kapërcehen shfaqjet jo të drejta që vihen re në të dy drejtimet. Në mjaft raste problemet në shkencat teknike e natyrore konsiderohen të përfunduara sapo zgjidhen anët tekniko-teknologjike, pa përfillur sa duhet aspektin ekonomiko-shoqëror të tyre. Në anën tjetër, shkencat ekonomike e shoqërore duhet ta thonë më mirë e në mënyrë më komplekse fjalën për drejtimet e përdorimit të arritjeve të shkencave teknike e natyrore për mundësitë, radhën dhe leverdinë e zbatimit të tyre në jetë.

Po ta shohim çështjen në këtë mënyrë do të kuptojmë se sa të lidhura janë shkencat me njëra-tjetrën, qoftë në aspektin e kërkimeve fondamentale dhe aq më tepër të kërkimeve për aplikim. Këtej del se nuk duhet të zhduket dhe as të dobësohet kujdesi për bashkëpunimin, kooperimin dhe sintezat midis punonjësve të disiplinave të ndryshme

shkencore. Ndryshe shkenca nuk përparon, qëndron në vend, përparim ngel në format artizanale, nuk hapet perspektiva për më tutje.

Zhvillimi i shkencave të aplikuara mbështetet në një masë të madh në shkencat fondamentale. Shumë herë përfitimi nga një zbulim i shken cës nuk shihet imediatisht, por ajo që duket aktualisht si një rezulta shkencor «i kulluar», por i papërdorshëm, nesër brezat e ardhshëm do t çmojnë dhe do ta zbatojnë për punë të mëdha. Historia e zhvillimit t shkencave na jep shembulla të tilla të panumërta. Le të marrim, pë shembull, shpikjen e Niutonit dhe të Leibnicit mbi analizën matema tike. Bashkëkohësit e tyre e çmuan, por a mund të merrej atëherë m mend se inxhinieri i ardhshëm do ta përdorte atë kaq gjerë për ndërti min e urave, gratacieleve dhe të hidhte predha më larg se 120 kilometra Jo, nuk e merrte me mend. Kjo ka ngjarë edhe me teoritë shkencore t astronomëve të shquar si Tiho Brahe, Kepler, me teoritë e shkencëta rëve e fizikantëve të mëdhenj si Ainshtajni etj.

Për kushtet e vendit tonë ne duhet të ngulim këmbë shumë në apli kim, ku duhet të përqendrojmë edhe forcat kryesore për punë kërkimore -shkencore. Kjo nuk do të thotë të mos bëhen edhe studime të mirëfill ta në fushat e shkencave fondamentale. Në këtë drejtim ne duhet t luftojmë më shumë për të përvetësuar teorinë e shkencave natyrore teknike, **me synim që të kuptojmë e të zbatojmë me sukses e në shkall të gjerë arritjet aplikative të këtyre shkencave dhe t'i vëmë ato në jetë** Kështu bëhet kalimi nga teoria në praktikë, kështu luftohen edhe empi rizmi e akademizmi në veprimtarinë shkencore. Njerëzit tanë të shkencë duhet ta konsiderojnë rutinën të dënueshme dhe jo krijuese në studimi e shkencës dhe në zbatimin e saj në praktikë, ta konsiderojnë si një pen gesë serioze, që duhet luftuar me vendosmëri. Por ata duhet të luftojn po ashtu edhe spekulimet sofistike në çfarëdo shkencë, pse këto jo vetën e shterpëzojnë dijen, por degjenerojnë edhe shkencën.

Në këtë kuadër, gjithashtu, kërkohet të zhvillohet logjika e lidhjes s teorisë me praktikën, si në njerëzit e shkencës, edhe në ata të prodhimit si nga Universiteti, edhe nga baza; si nga specialisti që punon në bazë edhe nga ai që punon në institucionet qendrore. Njerëzit e shkencës du het të shkojnë nga parimi se të dhënat teorike dhe eksperimentale mun të ngrihen në shkencë atëherë kur janë të lidhura së toku në mënyr logjike.

Edhe vetëm nga një vështrim kaq i përgjithshëm i këtyre proble meve të mëdha të shkencës mund të dalim me konkluzionin se sa punë përpjekje na duhet të bëjmë tani dhe në të ardhmen për të zotëruar dh aplikuar arritjet e përparimet e shkencës.

Shoqëria influencon në zhvillimin e shkencës, por edhe kjo influencon në zhvillimin e shoqërisë. Një hov të madh i jep shkencës veçanërish revolucioni socialist. Dihet se çfarë zhvillimi mori shkenca në revolucionin demokratiko-borgjez francez, por Revolucioni i madh Socialist i Tetorit, udhëhequr nga Lenini dhe Stalini, i dha një shtytje kolosale shkencës.

Me fitoren e revolucionit popullor dhe ndërtimin e socializmit në vendin tonë shkenca ka marrë një hov të madh. Është fakt i pamohue shëm se shkencat tona shoqërore, duke zbatuar vijën dhe politikën

Partisë, kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar për sqarimin dhe argumentimin shkencor të ligjësive të zhvillimit të shoqërisë socialiste, për mbrojtjen e doktrinës së marksizëm-leninizmit dhe për demaskimin e pikëpamjeve e të praktikave borgjeze e revizioniste, për përpunimin shkencor të historisë së lashtë e të lavdishme të popullit tonë. Një rol të madh kanë luajtur e luajnë ato për edukimin komunist të punonjësve, për përsosjen e marrëdhënieve në prodhim e të superstrukturës të shoqërisë sonë socialiste.

Studime dhe punime të rëndësishme janë kryer për zhvillimin me ritme të shpejta të forcave prodhuese, për ngritjen e një ekonomie komplekse e të pavarur dhe për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit. Punëtorët, kooperativistët e specialistët po çajnë përpara me mendimet e tyre, bëjnë propozime për përmirësime, për të zëvendësuar të vjetrën me të renë.

Por, megjithë punën e madhe që bëhet kudo, nuk mund të themi se është arritur ai kuptim dhe vlerësim i drejtë për punën kërkimore e studimore. Forca të shumta teknike e shkencore nuk mobilizohen dhe nuk japin si duhet kontributin e tyre në punë të kualifikuar. Ka mjaft raste që puna operative e përditshme komandon dhe drejton punën shkencore, në vend që të ndodhë e kundërta. Gjithashtu, frenuese janë edhe konceptet e ngushta e artizanale. Përvoja e përparuar, që bazohet në mjaft elemente shkencore, nuk përgjithësohet e zbatohet në shkallën e duhur. Është fakt, gjithashtu, se niveli i punëtorëve është ngritur, po jo sa duhet për këtë stad që jemi dhe aq më tepër për stadin e mëtejshëm.

Planet që hartojmë bazohen në shkencë, prandaj ato janë shkencore. Por zbatimi i shkencës në çdo sektor dhe degë, në funksion të zbatimit të planit, është akoma i dobët, pse edhe niveli i punës shkencore, pavarësisht nga përparimet që kemi bërë, është ende i ulët. Duhet ngritur niveli i punës shkencore në luftë për zbatimin e planit. Disa nuk i futen thellë këtij problemi. Të tjerë, burokratë, gjoja «besnikë dhe të përpiktë» në atë që është në plan, frenojnë përparimet tekniko-shkencore. Këta janë konservatorët, burokratët, që nuk janë të dispozuar drejt hapjes së shkencës. Kjo vjen nga mungesa e përgatitjes së tyre shkencore, nga një nivel përgatitjeje artizanale, e pamjaftueshme dhe frenuese. Ka gjithashtu edhe pengesa administrative që i ushqejnë këto prirje.

Në këto çështje duhet të bëhet kthesë e madhe nga udhëheqjet e të gjitha rangjeve, nga punëtorët, kooperativistët e specialistët, nga kuadrot e larta e të mesme, kudo që punojnë dhe drejtojnë. Duhet të bëhen përpjekje e të çahet më me guxim, më me siguri e në mënyrë metodike në përvetësimin dhe aplikimin e shkencës. Ndryshe, jo se nuk do të ecet përpara, por përparimet do të jenë të vogla dhe jo në përputhje me detyrat dhe me nevojat e mëdha e në rritje të vendit.

Njerëzit tanë, qofshin këta në aparate drejtuese apo në prodhim, në qendër apo në bazë, lipset të mbajnë kurdoherë parasysh mësimin për të cilin ngulte këmbë Lenini.

> «...të mësojmë dhe pastaj të kujdesemi që shkenca të mos mbetet te ne një fjalë e vdekur ose një frazë e modës (gjë që, s'kemi pse e fshehim, ndodh te ne shpesh herë), që shkenca të bëhet pjesë e pandarë e jetës sonë të përditshme, në mënyrë të plotë dhe me të vërtetë. Me një fjalë, vazhdonte Lenini, nga ne duhet të kërkohen jo ato që kërkon borgjezia e Evropës Perëndimore, por ato që është e denjë dhe e udhës t'i kërkohen një vendi që i ka caktuar vetes si detyrë të bëhet një vend socialist» (V. I. Lenin, Veprat, vëll. 33, f. 550).

Detyrat që përmban raporti mbi zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, që iu paraqit Plenumit, mendoj se duhet të konsiderohen si pjesë integrante e planit pesëvjeçar që po përgatisim. Shkenca duhet të ndihmojë planifikimin e prodhimit, të paraprijë prodhimin dhe t'i hapë perspektiva zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës. Projektplani po hartohet, po diskutohet në bazë dhe po vjen në organet qendrore. Por vendimet e këtij Plenumi nuk duhet të kuptohen të shkëputur nga plani i shtatë pesëvjeçar dhe të mos shkohet me idenë e gabuar «u bë ç'u bë» dhe studimet e punimet shkencore, që kanë të bëjnë me hartimin e përmirësimin e pesëvjeçarit, t'i lihen spontaneitetit. Kjo nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë.

Natyrisht ky Plenum për ndonjë çështje shtron edhe detyra për një perspektivë diçka më tej se objektivat e pesëvjeçarit të shtatë. Por, duke i përfshirë në kuadrin e pesëvjeçarit detyrat kryesore për zhvillimin e shkencës dhe të teknikës, ato duhet të na ndihmojnë për të saktësuar nevojat për kuadro, për fonde, për bazë materiale, për përmirësimin e organizimit të punës shkencore nga baza deri në qendër dhe për detyra të tjera.

Synimi i tërë kësaj pune duhet të jetë që zhvillimi i shkencës dhe përparimi teknik të bëhen një mbështetje e fuqishme për realizimin e objektivave e të detyrave të mëdha që na presin. Lidhur me këtë duhet mbajtur mirë parasysh ajo që theksoi Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror që **përpara shkencës shtrohet detyra për t'i vënë mirë mendjen dhe shpatullat pesëvjeçarit të ri që po hartojmë.** Çdo gjë që do të parashikohet gjatë pesëvjeçarit për zhvillimin e forcave prodhuese dhe përsosjen e marrëdhënieve në prodhim, të cilat lidhen edhe me shkencën e me studimet shkencore, të jetë medoemos e garantuar nga të gjitha pikëpamjet.

Këtu problemi lipset të shikohet në dy aspekte: për hartimin sa më shkencor të këtij plani, sidomos për zbatimin në jetë të tij, si dhe për çeljen e perspektivave për më tutje. Natyrisht, kjo presupozon edhe saktësime e argumentime më të plota në procesin e zbatimit të detyrave të planit. Përparimi shkencor e teknik është një rezervë e madhe, që duhet të përdoret për të përmirësuar e tejkaluar planet tona.

Hallkat dhe drejtimet kryesore të punës kërkimore-shkencore dhe të përparimit teknik janë përcaktuar në orientimet themelore që Komiteti Qendror ka dhënë për zhvillimin perspektiv të ekonomisë e të kul-

turës. Për planin e shtatë pesëvjeçar ato konsistojnë në zhvillimin në gjerësi e në thellësi të industrisë së rëndë nxjerrëse, të pasurimit e të përpunimit të mineraleve; në zhvillimin e fuqizimin e bazës energjetike të vendit, kryesisht në industrinë e naftës; në përfundimin dhe vënien me aftësi të plotë shfrytëzimi të veprave që revizionistët kinezë na i sabotuan dhe na i lanë në mes të rrugës, ku një rol të veçantë ka industria mekanike; në zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë; në plotësimin e nevojave të mbrojtjes së vendit, si dhe për zhvillimin e degëve dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë dhe të kulturës.

Realizimi me sukses i këtyre objektivave, në situatat që janë krijuar dhe në stadin aktual, kërkon **një konceptim sa më të drejtë të punës shkencore dhe në tërësi të zhvillimit e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor.** Racionalizimet e novacionet që bëhen nga punëtorët e specialistët dhe që sjellin përparime në teknikë mbështeten patjetër në një element empirik të përparuar. Në to ka edhe nocione e elemente të shkëputur të njohurive shkencore. Këto racionalizime e novacione duhet të bëhen, bile të shtohen, në mënyrë sasiore dhe cilësore. Kjo është një punë e gjerë masive, që zgjidh probleme të rëndësishme të prodhimit dhe duhet inkurajuar e organizuar më mirë, që t'u përgjigjet si duhet kushteve të krijuara dhe detyrave të mëdha që kemi përpara.

Por ne duhet të mos konfondojmë punën, si të thuash, të vogël shkencore për përmirësim të një procesi, për kryerjen e një racionalizimi në fabrikë, apo të një përmirësimi në bujqësi, të cilat janë shumë të dobishme dhe patjetër që duhet të inkurajohen me të gjitha mënyrat, me punën shkencore në një kuptim më të gjerë e të mirëfilltë të fjalës. **Nga puna shkencore kërkohet një përgjithësim, përmirësim e transformim i tërë pozitiv në praktikë dhe në teori, një shpërthim cilësor, si të thuash një revolucion në prodhim, në teknikë, në teknologji apo në organizim, në të gjithë fabrikën, në të gjitha fabrikat e njëllojta e të përafërta me të, në fusha të ndryshme të zhvillimit tonë, duke u dhënë zgjidhje problemeve aktuale që nxjerr jeta, si dhe të hapë perspektiva.** Këto kërkesa për punën kërkimore-shkencore lipset të shihen në unitet si nga punonjësit dhe studiuesit në bazë e në qendër. Ato kanë të bëjnë me rolin aktiv të vetë shkencës, me cilësinë dhe me efektivitetin e punës kërkimore-shkencore. Largimi prej tyre është me pasoja negative për të tanishmen dhe të ardhmen e zhvillimit të vendit dhe të vetë shkencës.

Me këtë sy le të shohim fushën e teknologjisë e të konstruksioneve. Janë suksese ngritja e një varg linjave, reparteve e uzinave me forcat tona. Po kështu prodhimi i traktorëve, sondave, anijeve e mjeteve të tjera të transportit. Një pjesë e mirë e tyre janë ngritur e prodhuar kryesisht në nivelin e teknologjisë ekzistuese e të modeleve të njohura e të mundshme.

Ne kemi një ekonomi të planifikuar e kursimtare, që buron nga natyra e rendit tonë ekonomiko-shoqëror, por jemi edhe vend i vogël. Këto na bëjnë që të përdorim e do të përdorim për një kohë sa më të gjatë bazën materiale e teknike që kemi krijuar, duke u kujdesur shumë për mirëmbajtjen e saj. Ne do të vazhdojmë gjithashtu të prodhojmë makineri e pajisje edhe mbi bazën e nivelit ekzistues. Por tani ka ardhur koha, janë krijuar edhe mundësitë, që të mendojmë e të punojmë më me perspektivë për të projektuar e prodhuar makineri e pajisje të tipeve të rinj, me tregues e parametra tekniko-ekonomikë që t'i përgjigjen nivelit të teknikës e të teknologjisë së sotme dhe të mos nisemi vetëm nga ajo që të prodhojmë atë tip që realizohet e ndërtohet më lehtë, por që nuk është kurdoherë më i miri e më i përshtatshmi. Kështu i zhvillojmë ne forcat prodhuese në rrugë ekstensive dhe intensive.

Por, në këtë fushë shkencëtarët, specialistët, novatorët dhe punonjësit e tjerë, që merren me punë krijuese e shkencore, duhet të thonë fjalën e tyre të fuqishme dhe të bëjnë vazhdimisht pyetjen: kjo që bëjmë është më e mira, më efektivja dhe u përshtatet nevojave e mundësive ekonomike e shoqërore të vendit tonë? Pa bërë këtë në praktikë nuk do të ecim me kohën, do të flasim për domosdoshmërinë e thellimit të intensifikimit të ekonomisë, por realisht nuk do të bëjmë sa duhet në krahasim me mundësitë që ekzistojnë e që do të na shtohen në të ardhmen. Këtë e kam edhe si sugjerim për grupet e punës që janë ngritur për projektimin e teknologjive dhe për prodhimin e makinerive, për rikonstruksionet dhe veprat e reja të pesëvjeçarit të shtatë.

Natyrisht, këto nuk janë probleme të thjeshta e të lehta. Ato duan shumë studime, krahasime e eksperimentime, sepse këtu kemi të bëjmë, në radhë të parë, me teknologjinë, e cila, siç dihet, është një tërësi metodash e procesesh të ndërlikuara që përdoren në përpunimin e lëndëve të para e të materialeve të ndryshme gjatë procesit të prodhimit për t'i shndërruar ato në produkte të gatshme. Këtu ndeshemi ne edhe me monopolin e teknologjisë, të cilën kapitalistët e revizionistët mundohen ta përdorin si mjet presionesh e nënshtrimi për popujt, gjë që duhet ta mbajmë mirë parasysh në punën tonë.

Kujdes duhet pasur jo vetëm për prodhimet e vendit, por edhe për makineritë e pajisjet që vazhdojmë të importojmë, duke synuar që të ketë një harmonizim të drejtë midis nivelit të përparuar teknik të tyre me burimet e energjisë e të lëndëve të para që disponon vendi dhe të mos nisemi vetëm nga ajo që të blejmë më të lirën, sepse mund të na dalë më shtrenjt. Po ashtu kërkohet të jemi të matur për të mos synuar që të sjellim pajisje superautomatike, që janë shumë të kushtueshme dhe nuk i vëmë dot në përdorim.

Përmirësimet e mëdha që kërkohet të bëhen në teknologji, në të gjitha degët e sektorët e ekonomisë, si dhe detyrat që kemi e do të rriten në të ardhmen për të projektuar e ndërtuar me forcat tona mjaft vepra të reja, shtrojnë me forcë dhe në mënyrë imperative nevojën e përgatitjes së kuadrit në këtë fushë. Në shkollat tona, të mesme e të larta, lipset të rishikohen programet dhe niveli i mësimdhënies dhe i përgatitjes së kuadrit për anët teknologjike të prodhimit, ashtu sikurse mund të studiohet edhe plotësimi i boshllëqeve që ndihen për disa specialitete, duke i përgatitur në vend ose, po të jetë e nevojshme, mund të dërgohen disa kuadro për specializim edhe jashtë.

Aktualisht vendi ynë po futet më gjerësisht në një stad të ri të

industrisë mekanike, në atë të industrisë makinandërtuese. Sipas paraprojektplanit të pesëvjeçarit të shtatë prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve do të rritet afro 80 për qind, në krahasim me pesëvjeçarin e gjashtë, gjë që nuk ka ndodhur në asnjë pesëvjeçar tjetër. Vetëm për objektet e Ministrisë së Industrisë e të Minierave, gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, do të duhet të prodhohen për herë të parë mbi 15 mijë tonë makineri e pajisje nga afro një mijë tonë që prodhohen gjithashtu për herë të parë këtë vit. Do të duhet të bëhen mbi 600 mijë formate e vizatime për uzinat e pasurimit të mineraleve, për rikonstruktimin e ndërtimin e mjaft ndërmarrjeve e uzinave të shkrirjes së mineraleve, të industrisë kimike, të industrisë së drurit etj. Kjo është ana sasiore e problemit dhe vetëm për një dikaster, që ka kërkesat dhe vështirësitë e veta, por ana cilësore e këtij problemi është akoma më e ndërlikuar.

Një përvojë të tillë në këtë shkallë ne nuk e kemi, por duhet dhe me siguri që do ta fitojmë. Nevojat do të na bëjnë të çajmë përpara siç kemi çarë deri tani në të gjitha fushat e jetës dhe të shkencës. Ne e dimë mirë atë ç'ka shkruajtur Engelsi, duke analizuar lidhjen dialektike midis shkencës dhe nevojave të praktikës:

> «Në qoftë se teknika varet në një shkallë të konsiderueshme nga gjendja e shkencës, në një shkallë akoma më të madhe shkenca varet nga gjendja dhe nga nevojat e teknikës. Kur shoqërisë i paraqitet një nevojë teknike, ajo e çon shkencën shumë më përpara se sa dhjetë universitete» (K. Marks — F. Engels, Vepra të zgjedhura, vëll. 2, f. 480).

Si u janë futur shkencat teknike e natyrore problemeve që kemi përpara për ndërtimin dhe rikonstruksionin? Sa janë të angazhuar njerëzit e shkencës me këto dhe si po i zgjidhin detyrat e caktuara qysh dy-tre vjet më parë? Nga sa jam informuar, për dy vjetët e kaluar, nga 59 studime të parashikuara, që duhej të kryheshin nga institutet dhe grupet e punës të Ministrisë së Industrisë e të Minierave, të Industrisë së Lehtë, të Bujqësisë e të Ndërtimit, një e treta e tyre nuk ishin realizuar dhe një pjesë që është përfunduar akoma nuk është diskutuar e miratuar. Ndërsa brenda vitit 1980 duhet të përfundojnë rreth 160 studime e projektime të llojeve të ndryshme, nga vetëm 39 që janë kryer gjatë dy vjetëve të fundit.

Kjo gjendje nuk është aspak e kënaqshme dhe mungon angazhimi serioz, kooperimi dhe kontrolli. Po zbatimi i këtyre studimeve sa probleme e vështirësi do të na nxjerrë dhe sa kohë do të kërkojë? Për disa nga veprat që janë në planin e këtij viti, dhe për të tjera që parashikohet të fillojnë në vitin 1981, detyrat për makineritë uzinave mekanike u kanë shkuar në global, në vleftë. Por të çfarë lloji do të jenë këto makineri, kush do t'i projektojë dhe ç'destinacion kanë, ende nuk dihet si duhet. Në këtë rast ne mund të flasim sa të duam për plane shkencore dhe për shkencë në industrinë mekanike, por objektivat nuk janë të garantuara. Për këto çështje duhet ulur këmbëkryq dhe të bëhet kthesë sa më parë, të vihen njerëzit në mënyrë të qartë para detyrave dhe nevojave që ka vendi.

Në raport nuk flitet sa duhet për problemet shkencore të elektro e termoenergjetikës. Mirëpo këtu mendoj se marrin shumë rëndësi studimet prognozë për burime të reja të energjisë, për shtrirjen e fuqizimin e sistemit unik energjetik dhe për shfrytëzimin me nivel më të lartë shkencor të tij, me qëllim që të rritet shkalla e sigurisë së furnizimit të përdoruesve të energjisë elektrike, si dhe treguesit ekonomikë, për futjen më të gjerë të energjisë elektrike në prodhim dhe për automatizimin e proceseve të ndryshme të punës.

Studimet, projektimet dhe eksperimentimet për problemet e termoenergjetikës duhen ngritur në një nivel më të lartë shkencor dhe organizativ. Ato duhet të rrokin probleme të rëndësishme, siç janë studimi shkencor i bilanceve energjetike të veprave me konsum të madh, të rajoneve industriale e deri në shkallë kombëtare. Duhet të bëhen studime për djegien më të mirë të lëndës djegëse të ngurtë, duke i përshtatur pajisjet termogjeneruese për qymyret e llojeve të ndryshme dhe me energji elektrike, për rritjen e shkallës së përqendrimit të burimeve gjeneruese të energjisë termike, me qëllim që kjo energji të përdoret në mënyrë komplekse në industri, bujqësi, për ngrohje etj.

Në bazë të politikës agrare marksiste-leniniste të Partisë bujqësia jonë ka ecur dhe po ecën përpara në rrugë origjinale, të drejtë dhe me perspektiva të qarta. Ne mbajmë sot afro 2/3 e popullsisë me banim në fshat dhe do të vazhdojmë ta mbajmë kështu pjesën më të madhe të saj. Këtë e bëjmë duke zhvilluar bujqësinë në rrugë intensive dhe ekstensive, si dhe duke futur në territorin e fshatit më gjerësisht edhe industrinë e veprimtari të degëve e sektorëve të tjerë të ekonomisë. Megjithatë, gjithmonë vendin kryesor në fshat do ta zërë bujqësia. Ne ecim në rrugën e intensifikimit të prodhimit bujqësor, në kushtet kur vazhdojmë të shtojmë krahët e punës në bujqësi nga popullsia e fshatit dhe pjesërisht edhe nga qyteti. Po kështu ne po zbatojmë me sukses politikën e ngushtimit të vazhdueshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit.

Ecja në këtë rrugë është një sukses i madh, në interes të të gjithë shoqërisë, gjë që nuk ndodh asgjëkundi në botë, ku fshati po boshatiset dhe bujqësia po degradohet. Nga njëra anë, kapitalistët e revizionistët flasin për kthimin e vendeve të tyre në industriale e superindustriale, por, nga ana tjetër, ata ndodhen përpara fakteve të pamohueshme të mbetjes në vend dhe të rënies së prodhimit bujqësor, të krizave të thella agrare, të perspektivave të zymta dhe të panikut që i ka kapur. Ku me gojë të plotë e ku me gjysëm zëri ata janë të detyruar t'i pohojnë këto fenomene nga pozitat e neomaltuzianizmit.

Çuarja më përpara e arritjeve në fushën e politikës agrare, përparimi i fshatit dhe zhvillimi i bujqësisë, afrimi i tij dhe ecja krah për krah me qytetin shtrojnë detyra të mëdha para shkencave bujqësore, ekonomike e shoqërore, për të studiuar thellë problemet e zhvillimit ekstensiv dhe intensiv të bujqësisë, ato të harmonizimit të degëve të prodhimit bujqësor e të efektivitetit, të përsosjes së marrëdhënieve të shpërndarjes e të këmbimit, të përparimit arsimor, kulturor e shoqëror të fshatit tonë socialist.

Partia jonë luan një rol luftarak dhe pararojë në mbrojtjen e marksi-

zëm-leninizmit. Jeta e solli që ne të ndërtojmë socializmin në vendin tonë në kushte e rrethana të veçanta, të rrethuar nga armiq të egër imperialistë e revizionistë, të ecim me sukses përpara dhe në rrugë të paçara. Duke e parë kështu çështjen, përpara shkencave shoqërore dalin detyra e probleme të mëdha, si për përgjithësimin e përvojës së revolucionit e të ndërtimit tonë socialist, ashtu edhe për të argumentuar në mënyrë sa më shkencore perspektivat e zhvillimit tonë.

Borgjezia dhe revizionistët, gjithë kalemxhinjtë e kapitalit: filozofë, politikanë, ekonomistë, sociologë, historianë e lakenj të tjerë të tyre janë në ethe dhe bëjnë përpjekje për të zbukuruar e mbrojtur rendin e kalbur e shtypës kapitalist, për të penguar revolucionin dhe luftën çlirimtare të popujve, për të luftuar e revizionuar teorinë marksiste-leniniste për revolucionin, për partinë e klasës punëtore e diktaturën e proletariatit, për ndërtimin e socializmit, luftën e klasave dhe probleme të tjera kardinale të saj. Në këtë llum që ka gatuar borgjezia ndërkombëtare, në kuadrin e synimeve globale kundërrevolucionare të strategjisë imperialiste, është detyrë imperative që shkencat shoqërore, nën udhëheqjen e Partisë, të lozin një rol më të madh për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të hapur perspektivat dhe për të nxjerrë më mirë në dritë përvojën e revolucionit tonë socialist.

Revolucioni i madh Socialist i Tetorit, i udhëhequr nga Lenini dhe Stalini në bazë të doktrinës së Marksit e të Engelsit, është i njohur në të gjithë botën, prandaj të tërë flasin për të, për të mirë e për të keq, kurse revolucioni ynë relativisht njihet më pak. Shumica dërrmuese e njerëzve në botë e dinë se ekziston një Shqipëri socialiste, që qëndron e patundur dhe që ka një vijë të sajën, por ata habiten dhe thonë: «Si ngjet kjo, si qëndron kështu kjo Shqipëri?». Është detyrë e shkencave tona shoqërore, që, me përgjithësimet dhe studimet shkencore, të shpjegojnë faktorët objektivë e subjektivë të revolucionit e të ndërtimit tonë socialist, të shpjegojnë se situata që u krijua te ne u shfrytëzua nga Partia, duke ndjekur me besnikëri teorinë marksiste-leniniste në kushtet konkrete të vendit tonë. Kjo teori na mëson rrugën revolucionare nëpër të cilën absolutisht do të kalojnë edhe të tjerët, duke shkatërruar imperializmin dhe revizionizmin.

Në epokën e sotme, pavarësisht nga presionet, shantazhet, mashtrimet e korrupsionet, po ndodh ajo që kanë parashikuar shkencërisht klasikët tanë të mëdhenj, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, që kontradikta antagoniste midis forcave prodhuese dhe marrëdhënieve kapitaliste shfrytëzuese e shtypëse në prodhim ka hyrë në rrugën e zgjidhjes. Proletariati, që shtypet e shfrytëzohet, milionat e të uriturve në Azi, në Afrikë, në Amerikën Latine e kudo në botë do të durojnë gjer në njëfarë pike kur s'mban më dhe, me siguri, do të shpërthejnë në revolucion.

Vendi ynë socialist është dhe duhet të bëhet akoma më shumë një shembull frymëzimi e inkurajimi për proletariatin dhe për popujt e shtypur të botës. Këtej del edhe një herë domosdoshmëria që shkencat tona shoqërore: politiko-filozofike, ekonomike, historike, të gjuhësisë, të etnografisë e të tjera, të bëjnë studime e përgjithësime komplekse për historinë e lashtë të popullit shqiptar, për të kaluarën heroike dhe gjenezën

e tij, për historinë e gjuhës dhe formimin e kombit tonë, për epopenë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, për rrugën nëpër të cilën kemi ecur ne për vendosjen e diktaturës së proletariatit, për krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës socialiste dhe për një varg problemesh të tjera që nxjerr jeta dhe zhvillimi ynë revolucionar. Shkencat shoqërore të orientohen, para së gjithash, nga tematika aktuale dhe nga ato probleme që kërkojnë zgjidhje, sepse nuk është normale që akoma nuk kemi në duart e popullit historinë e periudhës së ndërtimit socialist, ashtu sikurse nuk kemi studime të thelluara për mendimin filozofik, politik dhe ekonomik të Partisë sonë, për problemet e ndërtimit të plotë të shoqërisë sonë socialiste, për përgjithësime në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjithashtu duhen bërë studime për të demaskuar mbi baza shkencore pikëpamjet reaksionare në shkencë. Studime më të gjera e më të thella pritet të bëhen në fushën e artit tonë ushtarak popullor etj.

Shkencat shoqërore, shkolla, arti dhe kultura jonë kërkohet të milojnë më mirë për kalitjen revolucionare dhe edukimin e njeriut tonë të ri, të brumosur me botëkuptimin marksist-leninist, për të kuptuar dhe zbatuar me konsekuencë vijën dhe politikën e drejtë të Partisë sonë.

Një vend i përparuar, që ndërton socializmin e vërtetë, duhet të dallohet edhe nga kultura materiale e shpirtërore e popullit, nga mënyra socialiste e jetesës, duke filluar nga njeriu ynë i ri e ngritja kulturore e njerëzve tanë, nga zhvillimi e kujdesi që tregohet për shëndetin e popullit, për problemet e urbanistikës e të arkitekturës dhe deri në tregtinë e shërbimin e kulturuar, ai duhet të dallohet në çdo fushë të jetës. Këto kërkojnë një punë studimore-shkencore me horizont e perspektiva më të gjera, ashtu sikurse kërkohet të merren masa më të mira nga ana e organeve shtetërore dhe gjithë levat e tjera të Partisë.

Gjithashtu, organizatat e masave, që janë për ditë në kontakte me masat e gjera punonjëse, të qytetit e të fshatit, për ta vënë punën e tyre mbi baza më shkencore, mund dhe duhet të ndërmarrin me forcat e tyre të brendshme dhe me aktivistët më shumë studime në fushën politike, ideologjike, sociologjike etj. Kjo aq më tepër është e domosdoshme në mungesë të ndonjë organi apo instituti të posaçëm, i cili do të studjonte këto probleme.

Shkenca dhe puna kërkimore-shkencore kanë arritur në një stad zhvillimi dhe sot ballafaqohen me detyra e kërkesa të atilla që diktojnë nevojën e një drejtimi e organizimi më të përsosur nga qendra deri në bazë. Deri sa themi që revolucionin në shkencë dhe në teknikë e bëjnë masat, gjë që në vendin tonë është një realitet i padiskutueshëm, atëherë ngritjes në shkallë të reja të këtij revolucioni ne duhet t'i përgjigjemi edhe me një drejtim e organizim më efikas. Kjo bëhet më imperative po të mbajmë parasysh natyrën, vështirësitë dhe kompleksitetin e veprimtarisë e të punës kërkimore-shkencore, nga puna më e thjeshtë novatore e krijuese, deri te veprimtaria më e ndërlikuar shkencore.

Këtu dalin një varg çështjesh, të cilat, për kohën e vet, i kemi gjykuar se kanë qenë të drejta, por, në kushtet e detyrat e reja, duhen rivlerësuar e zgjidhur më mirë. Të gjithë këta njerëz e hallka të shkencës, të

veprimtarisë shkencore e novatore, sa janë në vendin që u takon, ky organizim që kemi sa ndihmon për çuarjen përpara të punëve dhe si mund të përmirësohet më tej? Forcat njerëzore, materiale, financiare e valutore sa i mbështesin objektivat që shtrojmë, sepse ato mund të na duken të mjaftueshme e të mirëqena, kur nuk janë dhe mund të mos jenë të tilla. Mirëpo kjo mund t'i verë në pikëpyetje mjaft nga ato detyra që caktojmë në fushën e zhvillimit të shkencës dhe të teknikës.

Në unitetin drejtues të çdo institucioni shtetëror, në qendër e në bazë, duhet të ekzistojë drejtimi politik dhe ai ekonomik, që zënë vendin e parë. Në radhë të dytë, dhe si ndihmës i të parit, vijnë organizmat shkencore dhe më pas administrata, e cila ka rolin dhe funksionet e saj në shërbim të çdo institucioni. S'ka dyshim që gjithë veprimtaria shtetërore udhëhiqet nga një punë shkencore e veçantë, specifike dhe e harmonizuar së toku. Karakteri frenues dhe burokratik, që shfaqet disa herë në drejtim e në organizim, të luftohet dhe jo të pranohet nga udhëheqja politike dhe ekonomike. Shfaqjet e burokratizmit e të liberalizmit është e domosdoshme të luftohen me vendosmëri, sepse pengojnë me një mijë lloj mënyrash aplikimin e shkencës dhe të të rejave të saj.

Udhëheqja politike dhe ajo operative të mos ngelet në cikërima, por të ketë iniciativë dhe të mos u ruhet telasheve dhe kokëçarjeve. Mendimi shkencor e novator duhet të dëgjohen dhe të nxiten për propozimet e dobishme, për t'i dhënë hov prodhimit dhe gjithë veprimtarive të tjera, qoftë me afat të afërt, qoftë në perspektivë. Ato duhet të aplikohen dhe jo t'i mbulojë pluhuri. Në një veprim të tillë duket si hapi shkencor që bëhet, ashtu edhe rezultati që ai sjell në zhvillimin e prodhimit dhe në fushën shoqërore.

Imediate është gjithashtu të shikohet sa efektive janë puna dhe vartësia e **instituteve dhe e organizmave të ndryshme shkencore të dikastereve qendrore dhe të Akademisë së Shkencave.** Institutet dikasteriale duhet të merren me probleme shkencore dhe teknike që lidhen ngushtë me çuarjen përpara të prodhimit, të arsimit e të kulturës dhe jo të kthehen në organe veprimi administrativ, siç përdoren shpesh sot. Në hapat e mëtejshme që do të bëhen mund të lindë nevoja e krijimit të disa organizmave të reja shkencore të specializuara, por kjo punë është e domosdoshme të bëhet me shumë kujdes, e matur e me dorë të shtrënguar, sepse edhe shkencën duam ta çojmë përpara, por duhet të luftojmë edhe frymën e «institutomanisë».

Institutet i kemi konsideruar bërthama që duhet të bëjnë vetë punë shkencore, por kërkohet që ato të mbështeten fuqimisht në ata mijëra e mijëra kuadro të lartë, të mesëm dhe punëtorë e kooperativistë të pararojës, **ku është edhe rezerva më e madhe.** Vetëm kështu mund t'i jepet një shtytje e re e mëtejshme punës novatore dhe kërkimore shkencore.

Në kuadrin e hallkave të punës shkencore një rol të posaçëm kanë **byrotë teknike e teknologjike, si dhe këshillat shkencore në ndërmarrje e kooperativa.** Në këtë drejtim kërkohet të luftohen shfaqjet e thjeshtimit të punës së tyre, të cilat, në mjaft raste, janë kthyer më shumë në grupe që zgjidhin probleme të proceseve korente të prodhimit, bëjnë ndonjë përmirësim të vogël teknologjik, punë kjo që, në fakt, i përket punë-

torit që ndjek dhe kontrollon prodhimin. Në ndonjë rast ato do të bëjnë edhe të tilla, por kjo të mos bëhet rrugë. Byrove teknike e teknologjike dhe këshillave shkencore t'u përcaktohen më mirë detyrat dhe të shëndoshet puna e tyre, duke aktivizuar rreth tyre dhjetëra specialistë të lartë e qindra punëtorë e kooperativistë me përvojë pune e të arsimuar që ka çdo ndërmarrje e kooperativë.

Puna novatore dhe ajo kërkimore-shkencore nëpër ndërmarrje e në kooperativa bujqësore është dhe lipset të jetë shumë më e gjerë se sa puna e drejtpërdrejtë që bëjnë byrotë teknike e teknologjike dhe këshillat shkencore. Kjo veprimtari e përditshme duhet të orientohet më mirë, të përkrahet e të nxitet me të gjitha mënyrat. Prej saj lindin e do të lindin vazhdimisht iniciativa të vlefshme, të planifikuara e të paplanifikuara. Detyra është që ato të vlerësohen, të shoshiten, si i thonë fjalës, pastaj të merren masa që të zbatohen. Dora-dorës të kalohet më tej, në masivizimin, specializimin e përqendrimin e tyre dhe të mos nxirren pengesa burokratike, siç ndodh disa herë në praktikë, me pretekst se «themelore është realizimi i planit», se «ky ose ai novacion nuk ka të bëjë me profilin e ndërmarrjes» etj., etj.

Si në çdo veprimtari tjetër, edhe në punën kërkimore-shkencore njeriu, i edukuar politikisht e ideologjikisht dhe i përgatitur shkencërisht, është faktori vendimtar për çuarjen e punëve përpara. Partia ka përgatitur tani një armatë të tërë kuadrosh, të lartë e të mesëm, që çdo vit shtohen. Këta i kanë dhënë një zhvillim të madh shkencës, diturisë dhe rezultatet si kudo, edhe në këtë fushë, duken, preken. **Megjithatë, mendoj se duhej dhe duhet të bëjnë akoma më shumë.** Atje ku kemi krijuar kushtet më me guxim, por qiten edhe shumë pengesa, objektive dhe subjektive, në dhënien e maksimumit nga ana e njerëzve të shkencës. Ka nga këta që u mungon vullneti për punë krijuese shkencore, harrojnë se çdo disiplinë shkencore ka dhe kërkon metodën e vet të kërkimit, të zhvillimit, të aplikimit, të konceptimit, **bazën ku zbatohet ajo shkencë.**

Kërkesa është me vend, po edhe udhëheqja e bazës nuk e kupton e nuk bën sa duhet përpjekje që ta kuptojë shkencën dhe atë nevojë të madhe që ka prodhimi për zbatimin e saj. Ka drejtues që mendojnë se dinë gjithçka, prandaj nuk e përfillin mendimin e specialistëve që ka përgatitur Partia për fusha e sektorë nga më të ndryshmit. Mund të jesh drejtues, po kjo nuk do të thotë se i di të gjitha, bile nuk kërkohet t'i dish. Por që të mësosh e të dëgjosh nga ata që dinë këtë drejtuesi duhet ta bëjë medomosdo. Në të njëjtën kohë, specialistët, që Partia dhe populli i kanë përgatitur me aq mund e sakrifica, mendimet e veprimet, problemet shkencore e teknike, kërkesat që shtrojnë prodhimi, arsimi, kultura, mbrojtja etj. duhet edhe ata t'i gjykojnë mbi bazën e teorisë sonë marksiste-leniniste. Kështu shmangen si rreziqet e nënvleftësimit të shkencës e të teknikës, ashtu dhe rreziqet e teknokratizmit.

Edhe një çështje tjetër duhet të bëhet mirë e qartë. Në rast se në prodhim apo në sektorë të tjerë shtohet numri i kuadrove të lartë, atëhere Partia pret dhe kërkon nga ana e tyre që, në bashkëpunim me kolektivat punonjëse, të bëhen përmirësime e ndryshime progresive, ndryshe puna e tyre nuk do të japë efektin e dëshiruar. Natyrisht, kuadrot e pro-

dhimit përgjigjen dhe duhet të përgjigjen, në radhë të parë, për hartimin e zbatimin e planit mbi bazën e kërkesave të shkencës e të teknikës, por kërkohet që ata të japin kontributin e tyre të vlefshëm edhe në punët kërkimore, shkencore e teknike.

Prandaj inxhinierët, agronomët, ekonomistët dhe gjithë specialistët e tjerë duhet të ngarkohen me detyra e me plane konkrete, duke kërkuar, për shembull, që brenda këtij ose atij afati parametrat teknologjikë, mekanizimi, kursimi, rendimenti i kulturave bujqësore etj. të arrijnë në këto ose në ato nivele. Kjo do të ndihmojë edhe për masivizimin e shkencës. Partia kërkon efektivitet të prodhimit, por kjo nuk mund të arrihet pa efektivitet të punës kërkimore-shkencore.

Fidanishte e përgatitjes së kuadrove të zotë, të shkencëtarëve tanë, janë Universiteti dhe shkollat e tjera të larta. Detyra kryesore e tyre është të nxjerrin kuadro, shkencëtarë të zotë në çdo drejtim, në çdo lëndë e disiplinë.

Për t'i arritur këtij qëllimi cilësia duhet kërkuar në radhë të parë te pedagogu. Prandaj është e domosdoshme të bëhet zgjedhje e saktë e tyre. Ata duhet të jenë jo vetëm të zotë në lëndët përkatëse, por edhe kërkues si ndaj vetes, ashtu edhe ndaj studentëve, zhvillues të teorisë dhe njohës të mirë të zbatimit të shkencës. Ata duhet të shquhen për metodë, stil dhe disiplinë shkencore. Shkencën dhe zhvillimin e saj ta kenë pasion, kjo t'u bëhet një jetë e dytë dhe funksionin e pedagogut të mos e konsiderojnë si diçka sa për të fituar mjetet e jetesës. Nëse në shkollat tona të larta ka të tillë pedagogë që janë të pazotë, ashtu si edhe në institutet kërkimore-shkencore, këta të zëvendësohen menjëherë me kuadro më të aftë.

Për një punë frytdhënëse shkencore, në çdo disiplinë të shkencës, duhet të maten me shumë kujdes koha e studimeve, ngarkesa e pedagogëve dhe e studentëve, puna teorike dhe ajo laboratorike, puna mësimore, dhe, nga ana tjetër, puna praktike dhe ushtarake, si dhe pushimet e domosdoshme.

Duhet studiuar gjithashtu ç'na ka dhënë përvoja e deritashme. A është e mjaftueshme koha e studimeve që kemi caktuar në disiplinat e ndryshme shkencore? Për këtë qëllim **kërkohet të praktikohet një bashkëpunim i ngushtë në mes fakulteteve të Universitetit e shkollave të tjera të larta për disiplinat e tyre të ndryshme,** pikërisht për studimin e veçantë dhe në tërësi të tyre dhe, në bazë të analizave konkrete e të orientimeve të reja, të bëhen ndryshime dhe përmirësime.

Universiteti dhe shkollat e larta s'ka dyshim që duhet të pajisen me laboratorë, me biblioteka dhe me të gjitha mjetet e tjera të domosdoshme, por, natyrisht, jo përnjëherë nga më të sofistikuarat, sa të mos dinë pastaj si t'i përdorin.

Vartësia e Universitetit dhe e instituteve të larta arsimore nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës nuk mund t'i bëjë dikasteret e tjera që të lajnë duart nga kujdesi dhe ndihma që lipset t'u japin këtyre institucioneve. Në të kundërtën, ato duhet ta koordinojnë mirë punën me Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës ose me organin shtetëror që propozohet të studiohet për drejtimin e shkollave të larta.

Gjithashtu duhet të forcohet më tej edhe lidhja e Universitetit dhe e

shkollave të larta me bazën, ashtu siç duhet ta forcojnë e ta thellojnë këtë lidhje edhe Akademia e Shkencave e institucionet e tjera kërkimore-shkencore. Kjo nuk duhet kuptuar si një lidhje midis dekanatit e dikasterit, por sidomos e specialistit të lartë me bazën dhe me udhëheqjen e saj. Por edhe udhëheqja duhet të ketë mirësinë dhe logjikën që t'i dëgjojë me vëmendje specialistët. **Ajo duhet ta ndjekë shkencën, ta mësojë dhe ta aplikojë atë. Kështu duhet kuptuar kjo punë.**

E shtrojmë këtë detyrë sepse nuk e shohim ende atë integrim të nevojshëm e të mundshëm midis pedagogëve e punonjësve shkencorë të Universitetit, të shkollave të larta dhe të institucioneve shkencore me prodhimin, në mënyrë që punonjësit e gjithë këtyre institucioneve, që janë edhe me grada shkencore, ta thonë më me kompetencë dhe me përgjegjësi shtetërore fjalën e tyre për problemet e ndryshme që shqetësojnë prodhimin. Neve nuk na duhen, si me thënë, vetëm «këshilltarë fakultativë» që hedhin ndonjë mendim kur u kërkohet, ose që studiojnë ndonjë problem atëherë kur u duhet për vete, sa për të marrë një gradë apo titull shkencor, por mendimet e studimet e tyre duhet t'i shërbejnë kryesisht rritjes së prodhimit apo çuarjes përpara të shkencës.

Në këtë fushë mbase do studiuar përvoja e organizimit të punës në fakultetin e mjekësisë, ku pedagogët janë edhe mjekë në klinikat përkatëse, ndërsa shefat e katedrave, që janë punonjësit më të kualifikuar të mjekësisë, drejtojnë e udhëheqin edhe klinikat. Këta përgjigjen jo vetëm për përgatitjen e mirë të kuadrit, por edhe për kurimin me baza shkencore të pacientëve në klinikat që drejtojnë.

Shembuj të tillë, por të rrallë, ka edhe në shkencat teknike e natyrore, siç është rasti i profesor Petrit Radovickës, i cili drejton katedrën e centraleve elektrike në Universitet dhe seksionin e shkencave teknike në Akademi, është në të njëjtën kohë edhe kryeinxhinier në Institutin e projektimit të hidrocentraleve, ku gjithashtu përgjigjet njëlloj si për detyrat e tjera dhe ndjek hap pas hapi zbatimin e projekteve që drejton.

Shkenca mësohet në shkolla, por, duke kaluar këtej, mësohet edhe jashtë shkollës. Prandaj Partia duhet të zhvillojë, të organizojë dhe të drejtojë në masat një etje të madhe për njohuritë shkencore, jo vetëm në institucione, por dhe jashtë tyre. Një dëshirë, një interesim i tillë, sidomos nga ana e të rinjve, por edhe e të moshuarve, nuk duket në atë masë që nevojitet. Ka kënaqësi për bagazhin, qoftë edhe të mirë, që merret në shkollë dhe shkohet me mendimin se mjafton diploma që futet në xhep, pse me të mund të hapet çdo portë. Diploma, që përfaqëson përpjekjet e një pjese studimore të konsiderueshme të jetës, është e vërtetë që të hap portën, por ka shumë kthina, shumë rrugë, të ndritura dhe të errëta, që kërkohet të sqarohen, të zbulohen e të ndriçohen. Kjo s'mund të bëhet pa dituri të gjera, pa nxënë vazhdimisht, pa nxjerrë konkluzione të atilla që të shtyjnë përpara mendimin krijues.

Kuadrot e lartë do t'i futen më mirë punës shkencore kur tërë sistemi i kualifikimit pasuniversitar të vihet mbi baza më të shëndosha. Përgatitja e tyre në Universitet apo në shkollat e tjera të larta zgjat 4–5 vjet. Mirëpo jeta e atyre që përfundojnë studimet është përpara, po edhe detyrat që u ngarkohen rriten dhe dijenitë shtohen e zgjerohen. Në këto kushte

kualifikimi i vazhdueshëm është i domosdoshëm për të gjithë kuadrot e specialistët, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha rrugët e praktikat e mundshme, individuale dhe në mënyrë të organizuar, duke gjallëruar debatet e kritikën shkencore. Këtej del që edhe kualifikimi pasuniversitar duhet të vihet mbi baza më të shëndosha shkencore, sepse sot ai përfshin një pjesë të vogël kuadrosh dhe vetëm në disa specialitete. Ai është e nevojshme të lidhet ngushtë me jetën dhe t'i shërbejnë zgjidhjes së problemeve.

Kuadrot dhe punonjësit, në përgjithësi, duan të mësojnë dhe të njihen edhe me shpikjet e mëdha në shkenca të veçanta, sidomos në aplikimin e tyre. Por, të jemi realistë, nuk është edhe aq i lehtë kuptimi dhe thellimi në shkenca. Sa më tepër zhvillohet kjo, aq më e ndërlikuar bëhet. Me metodat e derisotme nuk mund ta ndjekësh dot zhvillimin dhe ecjen përpara të shkencës dhe të përvetësosh tërë atë bagazh të madh njohurish, as të mënjanosh punën paralele. Kjo kërkon nga studiuesit tanë thellim dhe pasion për shkencat, kurse nga ana e Partisë dhe e organeve të pushtetit mbështetje serioze në hapjen e perspektivave, konkretizim dhe zbatim të tyre.

Në të njëjtën kohë kjo kërkon organizimin e një informacioni shkencor sa më të përsosur. Për këtë ne duhet të shfrytëzojmë format ekzistuese, të përpiqemi t'i përsosim ato më tej, por të studiojmë e të mendojmë, ashtu siç theksohet në raport, edhe për organizimin mbi baza më të shëndosha të këtij informacioni, duke krijuar edhe një sektor apo qendër të informacionit dhe të dokumentacionit tekniko-shkencor. Kërkesat dhe detyrat që shtrohen përpara kësaj qendre diktojnë nevojën që ajo vetë të jetë në një nivel të lartë tekniko-shkencor. Kjo është e nevojshme si për njerëzit që do të angazhohen atje, ashtu dhe për aparaturat teknike me të cilat ajo do të pajiset. Në këtë drejtim më mirë duhet të luajnë rolin e tyre edhe bibliotekat, sidomos ato qendrorët. Që specialistët të rritin njohuritë e tyre e të njihen me të rejat e shkencës e të teknikës, atyre lipset t'u sigurohen më shumë libra e revista teknike e shkencore.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh rolin që luajnë shkencat në vendin tonë në stadin aktual, nuk duhet lënë pasdore edhe vulgarizimi i tyre, sepse ky i lejon pak a shumë një publiku të kulturuar që të kuptojë dometḧenien shkencore dhe aplikimin e tyre në jetë. Ky vulgarizim shkencor duhet të mos jetë për sensacione, por të ketë për objektiv shtruarjen sa më reale dhe koherente teorike dhe eksperimentale të problemeve që trajton.

Drejtimi dhe organizimi i mirë i punës shkencore e ka fillimin te planifikimi i shëndoshë dhe i plotë i saj. Themi se plani i punës kërkimore-shkencore, dhe në tërësi i revolucionit tekniko-shkencor, është pjesë e planit unik shtetëror. Po e kemi në fakt kështu nga baza deri në qendër? Plani i punës shkencore nuk është vetëm tematika e studimeve e ndarë sipas nomenklaturave dhe me njerëzit që do të aktivizohen e me afatet e përfundimit të tyre. Plani duhet të përmbajë pikësynimet e punimeve e të studimeve shkencore, rezultatet që pritet të arrihen, çfarë artikujsh të rinj do të përvetësohen e do të prodhohen, ku do të bëhet mekanizim dhe automatizim, ku do të futen procese të reja teknologjike e do të përmirësohen ato ekzistueset, si do të zhvillohet përqendrimi, specializimi e kooperimi, ku do të synojë dhe çfarë duhet të arrijë lëvizja novatore etj.

Në plan duhet të parashikohen mirë edhe fondet buxhetore shtetërore për zhvillimin e shkencave dhe të përdoren ato vetëm për këtë qëllim. Dikasteret, ashtu si dhe Akademia e Shkencave, duhet të kenë buxhetin e tyre, investimet dhe fondet e nevojshme jo vetëm për plotësimin e detyrave të parashikuara në plan për studime, kërkime shkencore e përparime teknike, por edhe ndonjë rezervë të domosdoshme për t'u hapur rrugën të rejave të shkencës të paparashikuara që u nxjerr puna dhe jeta.

Planifikimi i punës kërkimore-shkencore kërkohet t'i paraprijë zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës. Këtej rrjedh edhe nevoja e studimeve prognozë dhe me afate më të gjata për zhvillimin e disiplinave e të degëve të ndryshme të shkencës e të teknikës.

Po ta kuptojmë drejt këtë zhvillim të domosdoshëm do të ketë zhvillime pozitive. Gjatë zbatimit do të na duhen fonde, materiale, njerëz etj. që nuk janë parashikuar dot. Këtij zhvillimi o do t'i hapim rrugë, o do t'ia mbyllim. **Rruga duhet të jetë e hapët.** Plani nuk mund të jetë i ngurtë.

Preokupimi dhe serioziteti për planifikimin dhe për zbatimin e organizuar të punës kërkimore-shkencore kërkohet të rritet, sepse **nga kjo varet në një shkallë të ndjeshme vetë realizimi i planeve të prodhimit, të kulturës e të mbrojtjes.**

Me hovin që ka marrë e po merr puna kërkimore-shkencore, nga baza deri në qendër, kërkohet edhe një drejtim më i mirë, i orientuar më drejt dhe i centralizuar i saj. Kjo shtron nevojën që dikasteret qendrore, Akademia e Shkencave dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve t'i rrinë më mirë mbi kokë punës kërkimore-shkencore, ta orientojnë e ta drejtojnë atë më nga afër.

Ashtu siç propozohet në raportin e Byrosë Politike, përparimit të shkencës sonë do t'i shërbente edhe **krijimi i një Komiteti të lartë të Shkencave në rang ministrie,** por jo i ndërtuar si ministritë e tjera. Mendoj se ky komitet i lartë i shkencave nuk do të ketë as administratë në kuptimin e asaj të ministrive dhe as laboratorë dhe institute në vartësi të drejtpërdrejtë, siç i kanë dikasteret qendrore ose Akademia e Shkencave. Ky komitet, që do të drejtojë shkencat në vendin tonë, duhet të përbëhet vetëm nga shkencëtarët më të mirë të disiplinave të ndryshme. Laborator ai të ketë gjithë vendin, kudo ku studiohet, punohet e prodhohet. Komiteti i lartë i Shkencave duhet të jetë në dijeni se në këto kategori e procese pune shkenca dhe zbatimi i saj ndodhet në këtë apo në atë stad, të gjykojë nëse duhet shtyrë më tej ky ose ai studim, çfarë studimesh mund të bëjnë ndërmarrja apo dikasteret. Ai mund dhe duhet të bëjë edhe vetë studime të ndryshme mbi perspektivën e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë në fushat dhe në drejtimet më themelore, për të tashmen dhe për perspektivën; cilave degë duhet t'u jepet përparësi; të përcaktojë raportet e zhvillimit të degëve të ndryshme të shkencës, nevojat për përgatitjen e kuadrit etj., etj.

Komiteti i lartë i Shkencave do të duhet të bashkërendojë në shkallë kombëtare punën shkencore më të rëndësishme dhe të ndihmojë në problemet kryesore të kooperimit ndërdikasterial, të kontrollojë vënien në jetë të punimeve shkencore më të rëndësishme, të vejë më mirë në rrugë punën për kualifikimin dhe specializimin e kuadrit etj. Me një fjalë do të jetë një organ që do të vendosë e do të veprojë nën drejtimin e Këshillit të Ministrave dhe do të përgjigjet para tij. Ky komitet, ashtu si dhe organet e tjera shtetërore, do t'i paraqitë Qeverisë dhe udhëheqjes së Partisë materiale, studime e propozime të ndryshme në fushën e zhvillimit të shkencës e të teknikës.

Asnjë dikasteri, asnjë institucioni, as Akademisë, as Universitetit dhe shkollave e institucioneve të tjera të larta, komiteti nuk duhet t'u marrë kompetencat. Përkundrazi ai do t'i ndihmojë dhe do të kontrollojë ata për zbatimin e kryerjes së studimeve, si dhe për vënien e vendimeve në jetë. Komiteti do të disponojë fondin shtetëror të caktuar për zhvillimin e shkencës në vendin tonë dhe, duke kontrolluar punën shkencore të dikastereve, të institucioneve e të bazës, do të shohë edhe përdorimin e mirë ose të keq të fondeve, do të kontrollojë edhe natyrën e «punës shkencore», nëse është me të vërtetë në atë lartësi që kërkohet (gjë që duhet të japë fryte), apo është vetëm një novacion, një përmirësim i thjeshtë e i përditshëm i punës.

Komiteti do të analizojë jo vetëm probleme të mëdha shkencore, por mund të studiojë e të analizojë edhe novacione që kanë rëndësi e mund të përgjithësohen për të gjithë vendin. **Kush do t'ia bëjë Qeverisë dhe Komitetit Qendror studime të tilla? Komiteti që përmenda dhe që duhet të krijohet,** i cili, sipas rasteve, aktivizon, ngarkon e drejton grupe pune, komisione studimi e specialistë të ndryshëm. Studime shkencore duhet të bëjnë dhe t'i zbatojnë edhe dikasteret, ndërsa Qeveria nga ana e vet lypset të bëjë studime më të thella mbi dikasteret, pa tërhequr kërraba nga ato dhe këtë t'ua diktojë atyre.

I gjithë zhvillimi ynë në rrugën e revolucionit, procesi i gjithanshëm i ndërtimit të socializmit në vendin tonë, mbështeten fuqimisht në shkencën marksiste-leniniste, në politikën dhe ideologjinë e Partisë, e cila ndërtohet në bazë të njohjes së thellë të ligjeve objektive që përcaktojnë zhvillimin politik, ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit. Punimet e këtij Plenumi duhet të shërbejnë që **organet dhe organizatat e Partisë, kudo ku punojnë e militojnë, të kujdesen vazhdimisht që tërë punën e tyre drejtuese, organizuese dhe edukuese ta vënë në baza më të shëndosha shkencore.** Kjo shtron detyrën që Partia, në qendër, në rrethe e në bazë, të tregojë një kujdes më të madh për shkencën dhe për punën kërkimore-shkencore, për zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor. Në të njëjtën kohë, edhe vetë organet e Partisë duhet të angazhohen më tepër në punën studimore shkencore, të bëjnë studime e përgjithësime për veprimtarinë e tyre drejtuese, organizuese, edukuese dhe zbatuese.

Krahas kësaj, Partia duhet të kujdeset dhe të kërkojë që edhe organet e pushtetit, të ekonomisë dhe të gjitha levat e tjera të ngrejnë nivelin shkencor të punës së tyre në të gjitha fushat, në bazë dhe në superstrukturë.

Punimet e këtij Plenumi është e domosdoshme të pasohen me analiza serioze e të thelluara të arritjeve të derisotme, të boshllëqeve e të detyrave që dalin në çdo hallkë të veprimtarisë prodhuese, arsimore, kulturore e të mbrojtjes, në çdo institucion e qelizë të punës kërkimore, shkencore e novatore, duke u shoqëruar me masa e aksione konkrete në dobi të ndërtimit të socializmit, të mbrojtjes së atdheut, për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullit dhe për kalitjen e mëtejshme të njeriut tonë të ri.

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Nëntor 1981
Viti XXVIII i botimit

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Përmbajtja:

RAMIZ ALIA – FJALA E HAPJES SË KONGRESIT TË 8-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË 7

ENVER HOXHA – RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË, MBAJTUR NË KONGRESIN E 8-TË TË PPSH 11

Në Kongresin e 8-të të PPSH

SHOKU ENVER HOXHA

duke mbajtur raportin «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH»

21) IZET DĀSHI
22) JORGO SULJOTI
23) KADRI HAZBIU
24) KRISTAQ RAMA
25) LENKA ÇUKO
26) LUMTURI REXHA
27) LLAMBI GEGPRIFTI
28) MANUSH MYFTIU
29) MEHMET SHEHU
30) MIHALLAQ QIRJAKO
31) MINE GURI
32) MUHO ASLLANI
33) MYSLIM PEZA
34) NAUNKA BOZO
35) NEXHMIJE HOXHA
36) OSMAN KRAJA
37) PALI MISKA
38) PETRIT GAÇE
39) PETRIT RADOVICKA
40) PETRO DODE
41) PILO PERISTERI
42) PRENDA DODA
43) PROKOP MURRA
44) QIRJAKO MIHALI
45) RAHMAN KUMBARO
46) RAMIZ ALIA
47) RAQI IFTICA
48) RITA MARKO
49) RESMI SHAMETI
50) SALIE KŪKLI
51) SIMON BALLABANI
52) SIMON STEFANI
53) SKËNDER GOZHITA
54) SOFOKLI LAZRI
55) SPIRO KOLEKA
56) SULEJMAN BUSHATI
57) SHEME MARA
58) SHUAIP ROSHAJ
59) TIMO MUÇI
60) THOMA DINE
61) VASIL ANAGNOSTI
62) VITO KAPO
63) XHANFISE KEKO
64) XHEMAL DAUTI
65) XHEVAIR LILA
66) XHEVDET KUÇI

(Me vota të njëzëshme miratohet përbërja e presidiumit të kongresit. Pasi shokët e presidiumit zënë vend, kalohet në zgjedhjen e sekretarisë së kongresit).

Propozohet që sekretaria e kongresit të përbëhet nga 15 shokë, dhe konkretisht të jenë:

1) SIMON STEFANI
2) BEHAR SHTYLLA
3) DED GJERGJI
4) DRINI NUSHI
5) FOTO ÇAMI
6) GAFUR ÇUÇI
7) HAXHIRE SHEHU
8) HASAN BANJA
9) HATIKA HAJNAJ
10) MIHALLAQ GJINIKASI
11) MITI NITO
12) PELIVAN MANGA,
13) PIPI MITROJORGJI
14) QEMAL BREGASI
15) XHELIL GJONI

(Miratohet njëzëri përbërja e sekretarisë së kongresit.

Gjithashtu, njëzëri u miratua edhe rendi i ditës dhe rregullorja e punimeve të kongresit).

Tani fillojmë nga pika e parë e rendit të ditës:

Për të mbajtur raportin «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë» fjalën e ka Sekretari i Parë i Komitetit Qendror shoku Enver Hoxha.

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH, SHOKU ENVER HOXHA, NË KONGRESIN E 8-TË TË PARTISË

Të dashur shokë e shoqe,

Partia dhe mbarë populli ynë vijnë në këtë Kongres me suksese të mëdha e fitore të shënuara. Shqipëria socialiste u ngjit një shkallë më lart në zhvillimin e saj ekonomik e kulturor, bëri një hap të ri përpara në rritjen e mirëqenies së masave dhe në forcimin e mbrojtjes së Atdheut.

Pesë vjetët që kanë kaluar nga koha kur u mbajt Kongresi i 7-të, janë një periudhë lufte heroike e masave tona punonjëse në të gjitha frontet për të çuar edhe më përpara ndërtimin socialist, për ta begatuar e lulëzuar edhe më shumë jetën tonë të re. Nën udhëheqjen e Partisë dhe me besim të patundur në vijën e saj të drejtë, klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, rinia dhe inteligjencia i shkrinë pa kursim forcat e tyre fizike e mendore për të përballuar e kapërcyer me sukses vështirësitë e rritjes socialiste, si dhe ato që na krijuan armiqtë e jashtëm.

Ashtu si në kongreset e mëparshme, edhe në të tanishmin Partia jonë vjen ballëlart e faqebardhë, pse detyrat e mëdha që mori përsipër i plotësoi me sukses, pse besimin e patundur që ka populli tek ajo e justifikoi plotësisht. Populli ynë mund të jetë i kënaqur nga puna dhe mundi i tij. Kjo ka qenë një punë krijuese dhe e frytshme, që i solli atij gëzime e përparime të reja, që e bëri atë më optimist e më të lumtur.

Industrializimi i vendit edhe gjatë planit të gjashtë pesëvjeçar eci përpara pa u ndalur. Vlerësimi i pasurive tona minerare dhe i lëndëve të tjera të para të vendit arriti një shkallë më të lartë. Me ngritjen e objekteve të reja, siç qenë kombinati metalurgjik «Çeliku i

Partisë», Uzina e Ferrokromit, ajo e Pirometalurgjisë, Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës etj., një pjesë e konsiderueshme e tyre tani transformohet dhe përpunohet në vend, duke krijuar kështu një bazë të shëndoshë e të sigurt për zhvillimin e tërë ekonomisë. Ky është një sukses i vijës së drejtë të Partisë, siç është edhe sigurimi i bazës së fuqishme energjetike, që u zgjerua akoma më shumë me vënien e plotë në funksionim të turbinave të hidrocentralit «Drita e Partisë».

Bujqësia jonë bëri hapa të rinj e të mëdhenj në të gjitha drejtimet. Orientimi i Partisë për ta shndërruar atë në një bujqësi socialiste të prodhimit të madh modern, mbi një bazë gjithnjë e më të fuqishme teknike e duke u mbështetur në dijet më të reja agroteknike, u provua në praktikë se ishte një orientim i drejtë e plotësisht i realizueshëm. Shtimi nga viti në vit i produkteve bujqësore e blegtorale, plotësimi gjithnjë e më mirë i nevojave të popullsisë e të industrisë me këto produkte e vërtetojnë plotësisht këtë gjë.

Përparime të dukshme janë bërë në fushën e kulturës e të arsimit. Kultura jonë e zhvilloi dhe e thelloi më tej përmbajtjen socialiste, fizionominë e saj kombëtare dhe frymën popullore. Kultura dhe të gjitha vlerat e saj po hyjnë më shumë në masat. Është meritë e kulturës sonë të re që ajo ka përballuar presionet e ndikimet e ndryshme të kulturës borgjeze e revizioniste duke ruajtur origjinalitetin dhe tiparet e saj socialiste. Arsimi popullor eci përpara duke plotësuar e zbatuar porositë e Partisë për të siguruar shkollimin e gjerë të brezit të ri dhe për t'i dhënë vendit specialistë në nivelin që kërkon zhvillimi ynë në etapën e tanishme dhe në të ardhmen.

Në këtë periudhë të rëndë krizash që kanë përfshirë botën kapitaliste e revizioniste, ku ka tronditje të shumta politike, stanjacion e rënie të prodhimit, ulje të nivelit të jetesës dhe dekadencë të vlerave morale, te ne ka stabilitet të plotë ekonomik e politik, shoqëria është e shëndoshë, njerëzit janë të sigurt për të sotmen e për të ardhmen. Gjatë pesëvjeçarit që kaloi, një kontingjent i madh njerëzish, të edukuar dhe të arsimuar nga Partia e pushteti ynë popullor, janë futur për herë të parë në punë, duke e shtuar e fuqizuar edhe më shumë armatën e madhe të punonjësve të qytetit e të fshatit. Rëndësia e këtij fakti bëhet edhe më e madhe po të kemi parasysh se sot në botë jo vetëm që nuk i sigurohet punë brezit të ri, por mbeten pa punë edhe nga brezi i vjetër.

Pushteti ynë popullor është forcuar e demokratizuar më tej. Pjesëmarrja e masave në qeverisjen e vendit është bërë më aktive dhe është ngritur në një nivel më të lartë. Është zgjeruar më tej demokracia jonë socialiste dhe janë krijuar kushte më të mira që njerëzit t'i gëzojnë sa më të plota të drejtat e garantuara dhe të realizojnë më mirë detyrat e tyre ndaj shoqërisë.

Situata e brendshme s'ka qenë kurrë më e fortë se sot. Kompaktësia e uniteti i popullit, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste, bashkëpunimi dhe solidariteti midis shtresave të ndryshme të shoqërisë sonë janë forcuar e konsoliduar më tej. Lidhjet e Partisë me popullin janë çelikosur, besimi reciprok është kalitur akoma më shumë.

Shprehje e shkëlqyer e këtij uniteti të madh është ajo vendosmëri, ai hov dhe ai heroizëm me të cilin populli ynë lufton për realizimin e detyrave që shtron Partia, për kapërcimin e vështirësive të ndryshme që kanë dalë në rrugën tonë, për përballimin me sukses të bllokadës dhe të rrethimit imperialisto-revizionist.

Shqipëria socialiste, në sajë të vijës së drejtë dhe të kujdesit të veçantë të Partisë, ka sot një mbrojtje të sigurt e të pathyeshme. Populli dhe ushtria jonë e mbajnë kurdoherë lart vigjilencën, qëndrojnë sypatrembur e të gatshëm për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së Atdheut, të fitoreve të socializmit.

Vendin tonë e nderojnë dhe e respektojnë popujt dhe shtetet përparimtare e paqedashëse, kudo në botë. Pozita e tij ndërkombëtare është e fortë. Miqtë e dashamirët e tij shtohen e shumohen nga dita në ditë. Lufta e vendosur parimore kundër imperializmit e revizionizmit modern e ka rritur simpatinë e dashurinë e marksistë-leninistëve, të revolucionarëve, të njerëzve të ndershëm e demokratë për Partinë e Punës dhe Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Partia dhe populli ynë i bënë ballë me sukses provës së rëndë në të cilën e vuri vendin tonë prerja e menjëhershme dhe brutale e marrëdhënieve ekonomike nga ana e Kinës. Revizionistët kinezë menduan se me veprimin e tyre armiqësor do të çoroditnin ekonominë tonë dhe do të ndalonin për një kohë të gjatë zhvillimin e saj, do ta detyronin Shqipërinë të bënte lëshime politike e ideologjike, t'u nderte dorën të huajve dhe të kërkonte përkrahje e ndihmë nga jashtë. Por ata, e pas tyre edhe reaksioni ndërkombëtar, që shpresoi se Shqipëria do të detyrohej të ndërronte rrugë, dështuan plotësisht. Vështirësitë e krijuara populli ynë i kapërceu me një pjekuri të madhe politike e me frymë të lartë patriotike, me një mobilizim të ri të forcave dhe me bindje të thellë në fitoren e luftës së tij.

Në Kongresin e saj të 8-të Partia jonë vjen e kalitur në beteja të reja dhe me një përvojë më të pasur. Ajo vjen si një armatë e madhe dhe e edukuar me ideologjinë proletare, marksiste-leniniste, me një unitet të fortë të brendshëm dhe e lidhur ngushtë me popullin, me aftësi të rritura organizuese, mobilizuese e drejtuese, e gatshme të marrë përsipër, si gjithnjë, detyra të reja e më të mëdha dhe t'i realizojë ato, si gjithmonë, me sukses.

Mbajtja e këtij Kongresi koincidon me një përvjetor të lavdishëm, me përvjetorin e themelimit të Partisë sonë heroike të Punës. Dyzet vjet më parë populli ynë u besoi komunistëve shqiptarë fatet e tij, jetën dhe të ardhmen e Atdheut. Partia jonë e justifikoi këtë besim me veprën e saj të lavdishme, me fitoren e revolucionit dhe me krijimin e Shqipërisë së re socialiste. E frymëzuar nga besimi i popullit dhe e ndërgjegjshme për përgjegjësinë historike e për misionin e lartë që mori përsipër, ajo e udhëhoqi popullin shqiptar me mendje të mprehtë e dorë të sigurt nga njëra betejë në tjetrën, nga njëra fitore në tjetrën.

Realizimet madhështore të arritura në vitet e jetës sonë të lirë, nën udhëheqjen e Partisë, treguan se socializmin në Shqipëri, lirinë e pavarësinë e Atdheut tonë, perspektivën tonë të ndritur s'ka forcë që

t'i tronditë e t'i errësojë. Ndjekja me konsekuencë e parimit marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta, politika e krijimit të një industrie moderne të mbështetur në lëndët e para të vendit dhe të një bujqësie që garanton ushqimin e popullit me produktet e veta, përgatitja e kuadrove të mjaftueshëm, teknikë e shkencorë, të aftë për të punuar e për të drejtuar në çdo sektor, kanë qenë shpëtimtare në të gjitha drejtimet. Është kjo politikë e urtë e largpamëse e Partisë që ka krijuar atë bazë të sigurt mbi të cilën mbështetet zhvillimi ynë i pandalshëm ekonomik e kulturor, garantohet rruga jonë socialiste.

Arritja e pavarësisë ekonomike krahas asaj politike, sigurimi i mbrojtjes së vendit nga vetë populli ynë, edukimi dhe armatosja e masave punonjëse me ideologjinë marksiste-leniniste janë ato shtylla të forta e të palëkundshme mbi të cilat qëndron kalaja jonë socialiste, janë tiparet themelore që karakterizojnë një shtet me të vërtetë socialist. Këto realizime, të marra në tërësi, përbëjnë edhe përvojën historike të socializmit në Shqipëri. Përvoja e Shqipërisë tregon se edhe një vend i vogël e me një bazë materialo-teknike të prapambetur mund të arrijë një zhvillim ekonomik e kulturor shumë të shpejtë e të gjithanshëm, mund të sigurojë pavarësinë e tij e të përballojë sulmet e kapitalizmit e të imperializmit botëror, kur udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste, kur është i vendosur të luftojë deri në fund për idealet e tij dhe kur ka besim se mund t'i realizojë ato.

Në rrugën e ndritur nëpër të cilën ka ecur gjatë dyzet vjetëve të jetës së saj, Partia e Punës e Shqipërisë do të ecë me vendosmëri e pa u lëkundur edhe në të ardhmen. E lidhur si mishi me kockën me popullin, në krye të tij dhe bashkë me të, ajo do të luftojë me devotshmëri e pa marrë parasysh asnjë sakrificë, për t'u siguruar njerëzve tanë, Atdheut tonë socialist përparime e fitore të reja.

I

ZHVILLIMI I EKONOMISË DHE DETYRAT E PARTISË

Ekonomia jonë socialiste hyn në pesëvjeçarin e ri të zhvillimit të saj e stabilizuar, plot dinamizëm dhe me mundësi të mëdha për të zhvilluar e zgjeruar më tej prodhimin shoqëror, për të rritur efektivitetin e saj në të gjitha drejtimet.

Detyrat kryesore të planit të gjashtë pesëvjeçar u plotësuan në përgjithësi me sukses. Kjo e ka fuqizuar edhe më shumë bazën materialo-teknike të vendit, ka shtuar më tej burimet e lëndëve të para e të energjisë, ka siguruar kushte më të mira për një zhvillim të harmonishëm, të vrullshëm e të pandalshëm të ekonomisë. Gjatë pesëvjeçarit të kaluar vazhdoi zhvillimi me ritme të shpejta i forcave prodhuese, u thellua më tej zhvillimi intensiv i ekonomisë dhe revolucioni teknikoshkencor njohu përparime të reja të rëndësishme. Industria, bujqësia dhe degët e tjera të ekonomisë ecën më përpara. Në vitin 1980, kundrejt vitit 1975, prodhimi shoqëror u rrit afro 25 për qind dhe prodhimi industrial mbi 34 për qind, me një ritëm 2 deri 3 herë më të shpejtë se ritmi i shtimit të popullsisë.

Duke zbatuar me konsekuencë politikën ekonomike të Partisë u bënë përmirësime të ndjeshme në strukturën e prodhimit industrial dhe u rrit pesha specifike e mjeteve të prodhimit. Industria plotësoi më mirë nevojat e popullit, u rrit roli i saj për zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë dhe për mbrojtjen e vendit.

Në krahasim me pesëvjeçarin e pestë, prodhimi bujqësor u rrit mbi 21 për qind. Bujqësia plotësoi nevojat e vendit për drithëra buke, për produkte ushqimore e për lëndët e para më të domosdoshme dhe rriti vëllimin e eksportit të produkteve bujqësore.

Për plotësimin e detyrave të planit të gjashtë pesëvjeçar Partia dhe shteti ynë shfrytëzuan në një shkallë më të lartë burimet dhe mundësitë e brendshme të vendit. U sigurua financimi i pandërprerë i zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, u ndërtuan dhe u vunë në shfrytëzim rreth 300 vepra të rëndësishme dhe eksporti i mallrave u rrit mbi 51 për qind.

Fuqia ekonomike në rritje dhe zbatimi i një vargu masash me karakter ekonomiko-shoqëror garantuan mirëqenien e arritur të popullit dhe çuan në ngritjen e mëtejshme të saj. Të ardhurat reale për frymë të popullsisë u rritën si në qytet edhe në fshat. Qarkullimi i mallrave me pakicë u shtua afro 20 për qind. U përmirësuan më tej kushtet e strehimit të popullit dhe u morën masa për zgjerimin e shërbimeve sociale. Shkollat e larta i mbaruan afro 20 mijë veta dhe ato të mesmet mbi 113 mijë ose 57 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e pestë.

Këto arritje në zhvillimin e përgjithshëm ekonomiko-shoqëror të vendit marrin një kuptim të veçantë po të kemi parasysh atë që po ndodh në botën kapitalisto-revizioniste, ku kriza ekonomike, me pasojat e saj të rënda për masat punonjëse dhe për tërë jetën e vendit, ka shkaktuar stanjacione e rënie të prodhimit. Këto arritje shënojnë një fitore të madhe për Partinë dhe popullin tonë.

Nga tribuna e këtij Kongresi, në emër të Partisë e të popullit, përshëndes dhe përgëzoj punëtorët, specialistët dhe kuadrot e ndërtimit e të industrisë, të cilët, edhe në rrethanat e vështira që na krijuan revizionistët kinezë, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, i dolën zot punës dhe ditën të ndërtojnë e të vënë në shfrytëzim veprat e mëdha të pesëvjeçarit të gjashtë, të cilat e fuqizuan më tej atdheun tonë socialist.

Me gjithë sukseset e arritura, ne jemi të ndërgjegjshëm edhe për mosplotësimin e disa detyrave të planit pesëvjeçar, si në investimet e në ndërtimet, në prodhimin bujqësor, në disa produkte industriale dhe në rendimentin e punës. Partia, organet e shtetit dhe kolektivat punonjës i kanë analizuar me vëmendje këto mosrealizime dhe kanë nxjerrë mësime për të mënjanuar dobësitë e të metat e punës organizuese e drejtuese në ekonomi.

Realizimet e mëdha me rëndësi historike që janë arritur deri sot në të gjitha fushat, si dhe përvoja e pasur e fituar në punën dhe në luftën e Partisë e të popullit për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit,

përbëjnë një mbështetje të fuqishme politike, ekonomike e shoqërore për të ecur me siguri dhe me guxim përpara.

Komiteti Qendror, në bazë të vijës së përgjithshme dhe të politikës ekonomike të Partisë për ndërtimin e socializmit, pas një pune dhe studimi të gjithanshëm, pas një konsultimi të gjerë popullor, përgatiti Projektdirektivat për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për periudhën 1981-1985, të cilat ia paraqet për shqyrtim e miratim Kongresit. Detyra themelore e këtij pesëvjeçari është: «**Zhvillimi i përgjithshëm i ekonomisë, duke u mbështetur tërësisht në forcat tona, mbi bazën e thellimit të industrializimit socialist të vendit, të fuqizimit e të intensifikimit të bujqësisë, të rritjes së efektivitetit të ekonomisë, të zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor dhe të përsosjes së marrëdhënieve socialiste në prodhim, me qëllim që të garantohen dhe të ngrihen gradualisht mirëqenia materiale dhe niveli kulturor i masave punonjëse, të forcohet më tej rendi socialist dhe fuqia mbrojtëse e atdheut**».

Në këtë detyrë sintetizohen drejtimet dhe objektivat kryesorë të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës gjatë pesëvjeçarit të shtatë, i cili dallohet nga një varg karakteristikash të veçanta.

Ky është i pari plan pesëvjeçar që do të realizohet duke u mbështetur plotësisht në forcat e në mundësitë tona. Shqipëria është sot i vetmi vend në botë që zhvillohet dhe ecën përpara në rrugën e socializmit pa asnjë lloj ndihme e kredie nga jashtë. Kjo është një provë e madhe, por e lavdishme për popullin e Partinë tonë dhe fitorja është e sigurt, sepse, duke ecur në bazë të marksizëm-leninizmit, jemi përgatitur me kohë për këtë hap vendimtar.

Plani i ri pesëvjeçar përmban objektiva e detyra më të mëdha se çdo plan tjetër, të cilat janë të bazuara shkencërisht dhe plotësisht të realizueshme. Për të pesë vjetët, 1981-1985, vëllimi i prodhimit shoqëror dhe i investimeve do të jetë më i madh se vëllimi i realizuar gjatë katër pesëvjeçarëve të parë të marrë së bashku, ndërsa vëllimi i eksportit do të jetë akoma më i madh. Në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, prodhimi shoqëror parashikohet të rritet 34 deri 36 për qind, me një ritëm mesatar vjetor prej 6,4 për qind. Fondet për investime dhe ndërtime do të përdoren për ngritjen e afro 750 veprave të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës.

Me mundësitë që krijohen nga rritja e prodhimit dhe e të ardhurave kombëtare, në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, fondi i konsumit të popullit parashikohet të rritet 21 për qind dhe qarkullimi i mallrave me pakicë 22 deri 24 për qind. Detyra të rëndësishme parashikohen për zhvillimin e arsimit e të kulturës, për shëndetësinë, strehimin dhe shërbimet e tjera jetësore.

Në caktimin e këtyre detyrave e ritmeve janë pasur parasysh si mundësitë që ka dhe që do të krijojë ekonomia, ashtu edhe nevojat për zhvillimin e ekonomisë, për zënien me punë të forcave të reja aktive, për fuqizimin e mbrojtjes së vendit, për shtimin e rezervave, për zhvillimin e sektorëve social-kulturorë, si dhe për plotësimin gjithnjë e më mirë të kërkesave në rritje të popullsisë. Mjaft nga detyrat e këtij pesëvjeçari, sidomos ato që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e

rezervave të naftës e të mineraleve, me caktimin e investimeve etj., janë parë në lidhje të ngushtë edhe me zhvillimin e ekonomisë në pesëvjeçarët e ardhshëm, kur do të ballafaqohemi me nevoja e kërkesa akoma më të mëdha.

Gjatë pesëvjeçarit të shtatë do të bëhen disa përmirësime të rëndësishme strukturore në fushën e prodhimit, të qarkullimit të mallrave e të konsumit të popullit. Këto përmirësime do të përfshijnë burimet energjetike, metalurgjinë e zezë, industrinë mekanike, bujqësinë, transportet, financat dhe mallrat e konsumit të gjerë etj. Përmirësimet e parashikuara do të çojnë përpara intensifikimin e ekonomisë, do të rritin efektivitetin e saj, do ta bëjnë atë më të aftë për të plotësuar nevojat e vendit dhe për t'i bërë ballë më mirë rrethimit e bllokadës, si dhe presionit të krizës ekonomike të botës kapitaliste e revizioniste.

Zhvillimi dhe fuqizimi i bazës materialo-teknike të vendit, si **kurdoherë, do të bëhet në lidhje të ngushtë me përsosjen e anëve të ndryshme të marrëdhënieve ekonomike** në qytet e sidomos në fshat. Masa të rëndësishme janë zbatuar e po zbatohen për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kooperativist dhe për ngushtimin e oborrit, për zgjerimin e specializimit e të kooperimit, për forcimin e organizimit e të drejtimit të prodhimit, për një lidhje më të mirë të shpërblimit të punës me sasinë, cilësinë, kursimin dhe me plotësimin e detyrave të planit. Këto masa do të çohen akoma më përpara, me synim që të forcohet pareshtur rendi ynë socialist.

Për detyrat e planit të shtatë pesëvjeçar do të flitet më hollësisht në raportin e Komitetit Qendror për Projektdirektivat e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për periudhën 1981-1985, që do ta mbajë shoku Mehmet Shehu. Prandaj në këtë raport do të parashtrojmë vetëm disa probleme themelore të politikës së Partisë, që kanë të bëjnë me zhvillimin e sotëm dhe të ardhshëm ekonomik e shoqëror të vendit.

I. Fuqizimi i mëtejshëm i industrisë – faktor vendimtar për përparimin e përgjithshëm të vendit

Në politikën ekonomike të Partisë vendin kryesor e ka zënë dhe e zë industrializimi socialist i vendit, i cili, nga njëri pesëvjeçar në tjetrin është zhvilluar si një proces i madh dhe i pandalshëm. Ai ka qenë dhe është një faktor vendimtar për përparimin e përgjithshëm të vendit në rrugën e socializmit. Krijimi dhe fuqizimi i industrisë sonë shumëdegëshe, të rëndë e të lehtë, të mbështetur fuqimisht në burimet e në pasuritë tona dhe me perspektiva të qarta zhvillimi, është vepër monumentale e Partisë dhe e popullit tonë, e arritur me shumë punë, sakrifica dhe me një heroizëm të pashoq, është vepër me rëndësi historike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Në pesëvjeçarin e shtatë industria jonë do të ecë akoma më përpara dhe do të zhvillohet në front të gjerë. Për këtë degë do të përdoren afro 46 për qind e të gjitha investimeve të pesëvjeçarit. Politika e

Partisë për zhvillimin e industrisë synon: të konsolidohet struktura shumëdegëshe e industrisë, duke i dhënë si gjithnjë përparësi industrisë së rëndë; të ruhet dhe të përmirësohet më tej bilanci pozitiv i burimeve energjetike, duke i kushtuar rëndësi të veçantë industrisë së naftës; të zhvillohet më tej industria nxjerrëse minerare dhe ajo përpunuese, duke u futur edhe në shfrytëzimin e mineraleve të reja; të bëhen përmirësime të ndjeshme në strukturën e mjeteve të prodhimit e të mallrave të konsumit; industria të vihet akoma më shumë në shërbim të intensifikimit të bujqësisë; të rriten aftësitë prodhuese ekzistuese nëpërmjet rikonstruksionit dhe modernizimit të tyre.

Duke ecur me vendosmëri në këtë rrugë, prodhimi industrial do të vazhdojë të rritet me ritme të shpejta. Në vitin 1985 kundrejt vitit 1980 ai do të rritet 36 deri 38 për qind. Ky zhvillim material, i lidhur ngushtë edhe me një varg faktorësh të tjerë ekonomikë e shoqërorë, do të bëjë të mundur që vendi ynë të ecë përpara si një vend me industri dhe bujqësi të përparuar.

Një vëmendje të posaçme Partia u kushton industrisë energjetike, nxjerrjes së naftës, të gazit e të qymyrgurit, prodhimit të energjisë elektrike. Ne kemi krijuar një sistem të fuqishëm e të pavarur energjetik, që plotëson nevojat në rritje të vendit për energji dhe siguron nga eksporti i saj të ardhura të rëndësishme valutore. Kjo është një fitore e madhe e politikës së drejtë të Partisë, është një mbështetje e sigurt për zhvillimin e tërë ekonomisë kombëtare.

Kjo fitore duhet konsoliduar dhe çuar më tej, në radhë të parë duke bërë investime e duke shtuar prodhimin, por edhe duke përdorur me kursim maksimal, me kontroll të rreptë e me nikoqirllëk të gjitha burimet tona energjetike. Zgjidhja e këtyre problemeve kërkon një punë të organizuar mirë, të disiplinuar, sistematike, me baza të shëndosha shkencore e metodike. Zhvillimi i kësaj dege nevralgjike me rëndësi kapitale e strategjike shtrohet si një detyrë imperative, sidomos në kushtet e krizës energjetike botërore.

Nxjerrja dhe përpunimi i naftës e i gazit do të zënë vendin kryesor në burimet tona energjetike. Në vitin 1985 kundrejt vitit 1980 nxjerrja e naftës do të rritet 58 deri 60 për qind. Kjo është një detyrë e madhe dhe plotësisht e realizueshme, sepse mbështetet në vendburimet ekzistuese dhe në rezervat e njohura e të përvetësuara.

Realizimi i detyrave për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, si dhe rritja e efektivitetit të shpenzimeve të mëdha që bëhen në këtë degë të industrisë, kërkojnë që naftëtarët, specialistët e kuadrot t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përsosjes së metodave të kërkimit dhe të nxjerrjes së tyre, duke u mbështetur plotësisht në arritjet e shkencës, në zbatimin e një disipline të fortë teknike dhe të punës.

Shpenzimet për nxjerrjen e naftës e të gazit të bëhen mbi bazën e studimeve të thelluara e me përgjegjësi. Të merren masa të plota teknike, organizative dhe materiale për të shtuar nxjerrjen e naftës jo vetëm nga vendburimet e reja, por edhe nga ato të vjetrat, duke përdorur shumë më mirë se deri tani metodat intensifikuese e të dyta. Në këtë sektor jetik të ecim me ekonomi, me rezerva të sigurta e të njohura dhe të shfrytëzojmë naftën e gazin me nikoqirllëk, duke menduar për sot e për nesër. Forcat shkencore e teknike të angazhohen më shumë për të shpejtuar vënien në shfrytëzim dhe me efektivitet të lartë të rërave bituminoze, të kësaj pasurie të madhe të vendit që duhet futur sa më parë në qarkullim ekonomik.

Një vend të rëndësishëm në burimet energjetike të vendit zë qymyrguri, që është një lëndë djegëse masive dhe me leverdi të madhe ekonomike. Në vitin 1985 nxjerrja e qymyrgurit do të rritet 48 për qind më shumë se në vitin 1980. Kjo është një detyrë e madhe për realizimin e së cilës kërkohet një punë këmbëngulëse nga punonjësit e këtij sektori.

Vëmendja të përqendrohet jo vetëm në shfrytëzimin racional të minierave qymyrgurore ekzistuese, por edhe në hapjen me rentabilitet të minierave të reja. Të zgjerohen kërkimet për qymyre me fuqi kalorifike më të lartë dhe të koksifikueshme. Të punohet kudo për zëvendësimin e karburanteve të lëngëta me qymyr dhe për kursimin e tij. Gjithashtu është e nevojshme të merren masa edhe për pasurimin e briketimin e qymyreve, për të rritur leverdinë e përdorimit të tyre.

Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, do të rritet 16 për qind. Për t'u dalë përpara nevojave në rritje për energji elektrike, si dhe për të shfrytëzuar intensivisht burimet hidrike me të cilat vendi ynë është mjaft i pasur, gjatë këtij pesëvjeçari do të zhvillohen në përmasa të mëdha punimet për përfundimin e hidrocentralit të Komanit, që do të jetë më i fuqishëm nga çdo hidrocentral i ndërtuar deri tani, dhe do të bëhen përgatitjet për ndërtimin e hidrocentraleve të tjera, të mëdha e të vogla, për të përballuar jo vetëm nevojat për sot e në perspektivë, por edhe për të rritur eksportimin e energjisë elektrike.

Prodhimi dhe përdorimi i energjisë elektrike duhet të shikohen në unitet. Partia, organet shtetërore dhe ekonomike të punojnë që të ndryshojnë konceptet e njerëzve, me qëllim që energjia elektrike të vlerësohet si një pasuri e madhe kombëtare, të përdoret me kursim e me kontroll të rreptë në çdo fushë, veçanërisht në atë të prodhimit material, ku duhet të vendosen normativa të studiuara shkencërisht për çdo kilovat të harxhuar.

Perspektiva të gjera i hap pesëvjeçari i shtatë industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve të dobishme. Nxjerrja e mineraleve të njohura të kromit, të bakrit, të hekur-nikelit do të vazhdojë të rritet në përmasa të mëdha, nga 30 për qind deri mbi 2 herë më shumë. Tani janë krijuar kushtet që të rritet edhe nxjerrja e mineraleve të tjera të dobishme, siç janë fosforitet, kuarcitet, kripa e gurit, dolomitet, olivinitet, boksitet etj.

Nevojat e sotme dhe të perspektivës shtrojnë detyrën e zgjerimit të nxjerrjes e të pasurimit të mineraleve të varfra dhe të rritjes së shkallës së përfitimit të elementeve të dobishme, për të ngritur vlerën e pasurive tona minerale, për të shfrytëzuar edhe ato vendburime, të vjetra ose të reja, që janë të varfra nga cilësia, por të pasura nga rezervat.

Gjeologëve dhe gjithë kërkuesve të tjerë të mineraleve u vihet detyra që, mbi bazën e përgjithësimeve e të ligjësive shkencore, duke

përdorur me guxim metoda të reja e komplekse, si dhe duke përsosur organizimin e punës, të rritin efektivitetin e shpimeve dhe rezervat e këtyre mineraleve, sidomos në minierat ekzistuese, të zbulojnë minerale e vendburime të reja në masivet me perspektivë e të pashkelura.

Punëtorët dhe specialistët e minierave t'u kushtojnë rëndësi të veçantë përsosjes së teknikës dhe të teknologjisë së nxjerrjes, rritjes së shkallës së mekanizimit dhe të kualifikimit në punë, për të arritur një kthesë të dukshme në cilësinë e prodhimit, për të ulur shpenzimet dhe për të pakësuar varfërimet e humbjet e mineralit.

Metalurgjisë në përgjithësi dhe siderurgjisë në veçanti do t'u kushtohet vëmendje e posaçme jo vetëm për të thelluar përpunimin me cikël të plotë të mineraleve tona kryesore, por edhe për të forcuar pavarësinë e ekonomisë sonë nga importi. Prandaj metalurgët tanë të mobilizojnë të gjitha forcat dhe aftësitë e tyre për të njohur e përvetësuar me disiplinë të rreptë e në baza shkencore teknologjinë e shkrirjes së mineraleve dhe të përpunimit të shumëllojshëm të metaleve, për të shfrytëzuar në kompleks gjithë përmbajtjen e dobishme kryesore e shoqëruese që ato kanë, për të ulur shpenzimet materiale dhe të energjisë, të cilat ende janë të larta. Studime të thelluara dhe punë intensive kërkojnë zgjerimet e mëdha që do të vazhdojnë të bëhen në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» për ngritjen e uzinave të tubave të llojeve të ndryshme, të llamarinës së petëzuar dhe të prodhimeve karbonike.

Tani që kemi çelikun tonë dhe kemi ngritur një **industri të fuqishme mekanike**, janë krijuar kushte që para kësaj dege të vihen detyra më të mëdha. Prodhimi i industrisë mekanike në vitin 1985 do të jetë 43 deri 45 për qind më i madh se në vitin 1980.

Industria mekanike e realizoi mirë detyrën që i caktoi Kongresi i 7-të i Partisë për prodhimin e pjesëve të ndërrimit, duke plotësuar 95 për qind të nevojave që ka ekonomia për to. Në këtë pesëvjeçar do të duhet të konsolidohet kjo arritje, duke përmirësuar rrënjësisht cilësinë dhe duke rritur shumë ripërtëritjen e pjesëve të ndërrimit.

Në vitet e këtij pesëvjeçari industria mekanike do të futet në një shkallë më të gjerë në prodhimin e pajisjeve dhe të makinerive për ndërtimin e linjave e të fabrikave të reja, për rikonstruksione e zgjerime të ndryshme të aftësive prodhuese. Realizimi i një detyre të tillë kërkon që të përmirësohet organizimi e drejtimi i kësaj dege të industrisë, të vihen mbi baza sa më shkencore teknologjia e përpunimit, planifikimi, kooperimi dhe standardizimi i prodhimit.

Masa urgjente e të plota të merren sidomos për përgatitjen e projekteve teknologjike e konstruktive të pajisjeve e të makinerive për objektet e reja e për rikonstruksionet që do të kryhen gjatë pesëvjeçarit. Shumë nga këto pajisje e makineri do të prodhohen për herë të parë. Projektimi dhe prodhimi në kohë e me cilësi i tyre është një ndër detyrat më të vështira që duhet të përballojë industria jonë mekanike.

Futja e industrisë mekanike në rrugën e gjerë të prodhimit të makinerive shtron me forcë nevojën e kualifikimit të njerëzve e të zhvillimit të mendimit të tyre krijues, nevojën e përgatitjes së kuadrove të lartë e të mesëm edhe për profile të ngushta e specialitete të veçanta,

duke bërë për këtë qëllim ndryshimet përkatëse në programet e shkollave profesionale e të Universitetit.

Zhvillim e zgjerim të madh do të marrë në këtë pesëvjeçar industria kimike. Prodhimi i saj në vitin 1985 kundrejt vitit 1980 do të rritet 63 deri 65 për qind. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet shtimit të prodhimit të plehrave fosfatike dhe kimikateve për mbrojtjen e bimëve. Duke pasur tani mjaft prodhime bazë dhe një varg mbetjesh industriale e komponimesh shoqëruese të mineraleve, kimistët dhe specialistët e tjerë duhet të studiojnë e të realizojnë një gamë shumë më të gjerë prodhimesh e reagentësh kimikë, për të ulur sa më parë importin e tyre. Fillimet e sintezës kimike gjithashtu duhen çuar përpara, duke u mbështetur kryesisht në lëndët e para të vendit dhe të synohet që në një të ardhme jo të largët prodhimet e saj të bëhen një burim i mirë edhe për eksport.

Partia kurdoherë ka mbajtur parasysh që në zhvillimin e industrisë në tërësi **në përputhje me nevojat e popullit, të rritet edhe prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë, duke siguruar një stabilitet e një përmirësim të vazhdueshëm të nivelit material e kulturor të masave punonjëse.** Për këtë qëllim prodhimi i industrisë së lehtë e ushqimore gjatë pesëvjeçarit do të shtohet me ritme mbi 2 herë më të larta se ritmi i shtimit të popullsisë.

Në prodhimet e industrisë së lehtë e ushqimore është e nevojshme të bëhet një kthesë e vërtetë, të arrihet një përmirësim rrënjësor në strukturën e mallrave, në asortimentet, në cilësinë, në ambalazhimin e në uljen e kostos së tyre. Kjo kthesë mund të bëhet vetëm me masa të plota dhe efektive në fushën e organizimit e të drejtimit, të planifikimit e të teknologjisë së prodhimit. Mbi të gjitha duhet të ndryshohen plotësisht konceptet artizanale, të zhvillohet fantazia dhe mendimi krijues, të veprohet me shkathtësi e shpejtësi për të bërë ndryshimet pozitive, për t'i hapur kudo rrugë të gjerë së resë.

Për ngritjen dhe zhvillimin e industrisë janë bërë investime të mëdha dhe është përgatitur një armatë e tërë punonjësish të kualifikuar e të devotshëm, të cilët janë një mbështetje e fuqishme për zhvillimin e këtij sektori jetik të ekonomisë.

Realizimi i detyrave të mëdha që shtron Partia, kërkon që punonjësit e industrisë të rritin efektivitetin e prodhimit dhe rendimentin e punës, të ngrenë në një shkallë më të lartë krijimtarinë e tyre. Ata duhet të shfrytëzojnë gjerësisht aftësitë e shumta prodhuese që kanë në duar dhe të përvetësojnë sa më mirë objektet dhe linjat e reja që do të përfundojnë e do të vihen në shfrytëzim, si edhe ato që do të rikonstruktohen në vitet e pesëvjeçarit. Me guxim e vendosmëri dhe duke u mbështetur në të dhënat studimore e shkencore, të çojnë përpara e të modernizojnë teknologjinë e prodhimit, të përmirësojnë treguesit cilësorë e ata financiarë të tij.

Populli dhe Partia kanë besim të plotë se punonjësit e të gjitha degëve të industrisë, të ndërgjegjshëm për situatat që kalojmë, do të shumëfishojnë përpjekjet dhe luftën e tyre për arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të mëdha që po cakton ky Kongres për zhvillimin dhe fuqizimin e industrisë sonë socialiste.

2. Të intensifikohet më tej prodhimi bujqësor dhe të përsosen marrëdhëniet socialiste në fshat

Partia jonë ka përpunuar dhe ka zbatuar një politikë agrare marksiste-leniniste, duke mbajtur parasysh kushtet historike dhe rrethanat konkrete në të cilat fitoi revolucioni ynë popullor dhe vendi hyri në rrugën e socializmit. Në kushtet e një vendi agrar mjaft të prapambetur, Partia duhej të zgjidhte njëkohësisht dy detyra: edhe transformimin socialist të fshatit, edhe zhvillimin e gjithanshëm të bujqësisë. Bujqësia duhej të krijonte mundësinë që të ushqente popullsinë e fshatit dhe të jepte kontributin e saj të madh për industrializimin e vendit dhe zhvillimin e ekonomisë kombëtare. **Realizimi i këtyre detyrave themelore kërkonte jo çfarëdolloj zhvillimi të bujqësisë, por vetëm zhvillimin socialist të saj, mbi bazën e prodhimit të madh e modern, të lidhur ngushtë me të gjitha degët dhe me sektorët e tjerë të ekonomisë.**

Shndërrimet revolucionare dhe përparimet që janë arritur në bujqësi, përfaqësojnë një nga fitoret më të mëdha të vijës e të politikës së Partisë për ndërtimin e socializmit. Për drejtësinë e kësaj politike flet fakti që gjatë afro katër dekadave të pushtetit popullor prodhimi bujqësor në vendin tonë është shtuar dhe shtohet përgjithësisht rreth 2 herë më shpejt se popullsia, që të ardhurat reale për frymë të fshatarësisë nga njëri pesëvjeçar në tjetrin janë rritur 10 deri 20 për qind, që prodhimi bujqësor për njësi të sipërfaqes së punueshme, kundrejt vitit 1960, është shtuar 1,7 herë dhe për një punonjës të bujqësisë 1.6 herë. Edhe në pesëvjeçarin e gjashtë, megjithëse detyrat nuk u realizuan plotësisht sipas planit, prodhimi mesatar vjetor, në krahasim me pesëvjeçarin e pestë, ishte 21,4 për qind më i madh.

Në pesëvjeçarin e shtatë, duke ndjekur me konsekuencë politikën e vet agrare, Partia ka caktuar objektiva të rinj e më të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe përparimin e fshatit tonë socialist. Në planin e ri pesëvjeçar detyrat që ka caktuar Komiteti Qendror i Partisë për sektorin e bujqësisë, synojnë: rritjen e prodhimit për të siguruar gjithnjë e më mirë tërë ushqimin e popullit dhe përmirësimin e strukturës së tij; shtimin në një masë më të madhe të lëndëve të para për industrinë e lehtë dhe ushqimore; heqjen gradualisht nga importi edhe të asaj pjese të produkteve ushqimore e të lëndëve të para bujqësore që akoma e sjellim nga jashtë; rritjen e vëllimit të eksportit të produkteve bujqësore të përpunuara e të papërpunuara; shtimin dhe fuqizimin e rezervave të nevojshme. Mbi bazën e këtyre objektivave, si dhe të masave të tjera ekonomike e shoqërore, do të ngrihet mirëqenia e fshatarësisë dhe do të ngushtohen më tej dallimet ndërmjet fshatit e qytetit.

Këto probleme të mëdha për zhvillimin e bujqësisë kanë të bëjnë me të sotmen dhe të ardhmen e vendit. Për të gjitha këto arsye bujqësia në këtë pesëvjeçar do të zërë një vend të posaçëm dhe më të rëndësishëm se deri më sot. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarin

e shtatë kundrejt pesëvjeçarit të gjashtë parashikohet të rritet 30 deri 32 për qind. Afro 29 për qind e gjithë investimeve të pesëvjeçarit do të përdoren në bujqësi. Në këtë degë do të drejtohen rreth 60 për qind e forcave të reja aktive të punës dhe asaj do t'i vihet në dispozicion një bazë më e gjerë materialo-teknike. Prandaj punonjësit e bujqësisë dhe të të gjithë sektorëve që lidhen me bujqësinë, janë para detyrash të mëdha e luftarake.

Detyrë e parë e bujqësisë, si kurdoherë, mbetet prodhimi i drithërave. Ne çdo vit duhet të përballojmë nevojat për bukë për një popullsi në rritje të pandërprerë, të plotësojmë kërkesat më të mëdha me koncentrate e ushqime të industrializuara për blegtorinë, si dhe nevoja të tjera të domosdoshme për drithëra. Këto probleme nuk mund të zgjidhen duke shtuar vazhdimisht sipërfaqet e mbjella me drithëra. Përkundrazi, theksi duhet vënë gjithnjë e më shumë në rritjen e rendimenteve dhe në përmirësimin e strukturës së drithërave. Kjo bëhet më e domosdoshme në kushtet kur popullsia vazhdon të shtohet me ritme të larta e, si rrjedhim, edhe sipërfaqja e tokës së punueshme për frymë të popullsisë ka prirje të ulet. Prandaj e gjithë shtesa e prodhimit të drithërave prej rreth 20 për qind, në pesëvjeçarin e shtatë kundrejt pesëvjeçarit të gjashtë, duhet të sigurohet tërësisht nga rritja e rendimenteve. Detyrat në këtë fushë janë shumë serioze dhe kërkojnë një kujdes të jashtëzakonshëm nga organet e Partisë, të pushtetit, të ekonomisë dhe nga të gjithë punonjësit e bujqësisë.

Krahas shtimit të prodhimit të drithërave duhet të forcohen edhe masat në të gjitha hallkat e grumbullimit, të përpunimit, të ruajtjes e të përdorimit të drithërave për të mënjanuar çdo humbje e dëmtim të tyre. Gjithashtu ne duhet të ecim drejt pakësimit të konsumit të bukës për frymë të popullsisë si në qytet, ashtu dhe në fshat. Në këtë rrugë të ecim me program të menduar shkencërisht për të përmirësuar strukturën e ushqimit të popullit, duke shtuar prodhimin dhe përdorimin e perimeve, të patateve, të frutave, të produkteve blegtorale etj. Çështja është që, pa ulur nivelin e jetesës, bile duke e ngritur atë, t'i jepen popullit më shumë qumësht, mish, perime etj. dhe të pakësohet kështu konsumi i bukës.

Prandaj, krahas shtimit të prodhimit të perimeve, të patates e të fasules për frymë të popullsisë dhe uljes së shpenzimeve të tij, një punë më e organizuar duhet bërë për studimin e kërkesave e të shijes së njerëzve dhe për të ndryshuar mentalitetin e sotëm gati artizanal lidhur me prodhimin, transportimin, industrializimin dhe shitjen e këtyre produkteve. Detyrat e ngjeshura që parashikon ky pesëvjeçar për perimet, patatet dhe fasulet, kërkojnë zbatimin e masave të gjithanshme agroteknike, si dhe përqendrimin e specializimin e prodhimit, sidomos rreth qyteteve të mëdha, me synim që të plotësohen planet në sasi, në lloje dhe në kohë gjatë gjithë vitit.

Investime të rëndësishme kanë bërë shteti dhe kooperativat për zhvillimin e frutikulturës. Por investimet e derisotme, sidomos në kooperativa, kanë pasur efektivitet të ulët dhe pesha e këtij sektori në prodhimin bujqësor është akoma relativisht e ulët. Prandaj, për realizimin e detyrave në rritje për zhvillimin e frutikulturës, del e nevojshme, në

radhë të parë, që kjo degë të vlerësohet më drejt, të luftohen koncepte nënvleftësuese dhe shfaqjet e mosinteresimit për këtë pasuri të madhe dhe me perspektivë për vendin tonë. Është e nevojshme që të kryhen plotësisht shërbimet në pemët e në ullinjtë dhe të krijohen kushtet e përshtatshme për një ujitje në shkallë të gjerë.

Investimet e reja të përqendrohen kryesisht në plotësimin e blloqeve ekzistuese dhe të bëhet rikonstruksioni i vreshtave që janë ngritur. Për frutikulturën të ndërmerren studime dhe të bëhet një punë e madhe për shtimin dhe përmirësimin e varieteteve të reja, të ecet drejt ngritjes së kurorave me pemë të ndryshme rreth qyteteve, dhe brenda mundësisë, të praktikohen edhe investimet e përbashkëta shtet-kooperativë.

Nevojat e popullit dhe zhvillimi i një bujqësie shumëdegëshe kërkojnë që të përmirësohet struktura e mbjelljeve të bimëve industriale, të bëhen përqendrime e specializime në rrethet e në ekonomitë që kanë pasur rezultate më të mira, të sigurohen farëra me prodhimtari e rreze të lartë, si edhe të zbatohet teknologjia e përparuar në prodhim. Për bimët industriale t'i përmbahemi orientimit që me prodhimin e vendit të plotësojmë gjithnjë e më mirë nevojat e popullit e të ekonomisë.

Për sa i përket ekonomisë pyjore, krahas masave për të ecur më shpejt drejt balancimit të prerjeve të drurëve pyjorë, me rritjen natyrore vjetore të tyre, të synohet që pyjet të kthehen në ekonomi komplekse, ku, përveç nxjerrjes të lëndës drusore, të kultivohen e të merren edhe prodhime të dyta të pyllit, bimë etero-vajore e mjekësore si dhe të zhvillohet më shumë zookultura.

Objektivat që shtron pesëvjeçari i ri për blegtorinë kërkojnë të rritet shumë më tepër kujdesi i organeve të Partisë, të shtetit e të ekonomisë dhe i të gjithë punonjësve të bujqësisë për këtë degë të rëndësishme. Me gjithë përparimet që janë arritur, shkalla e prodhimit dhe e modernizimit të sektorit të blegtorisë nuk u përgjigjet investimeve të mëdha që janë bërë dhe nevojave në rritje për produkte blegtorale. Projektdirektivat parashikojnë që prodhimi, në vitin 1985 kundrejt vitit 1980, të rritet: për qumështin 30 deri 32 për qind, për mishin 53 deri 55 për qind, për vezët 50 deri 52 për qind etj. Këta objektiva mbështeten në një rritje të mëtejshme të numrit të krerëve, por në mënyrë të veçantë ata mbështeten në rritjen e prodhimtarisë së të gjitha llojeve të kafshëve. Shtrohet detyra që nga lopët e racës dhe nga kafshët e tjera të përmirësuara të merren prodhime dy deri tri herë më të larta se mesataret e rendimenteve të derisotme në shkallë vendi. Për këtë është e nevojshme të ndryshojnë rrënjësisht konceptet dhe qëndrimet ndaj nevojave e kërkesave që paraqet zhvillimi i një blegtorie me përmasa të mëdha, me shumëllojshmëri të kafshëve dhe të ndërtuar mbi baza shkencore.

Problemi numër një në fushën e blegtorisë është zbatimi i një sistemi të plotë dhe të përshtatshëm masash për të dy e trefishuar rendimentet e kulturave foragjere dhe aftësinë prodhuese të kullotave natyrore, për të grumbulluar e shfrytëzuar të gjitha rezervat dhe nënproduktet e bujqësisë, si dhe për të zbatuar një teknologji më të përparuar në përpunimin e ushqimeve të koncentruara e të produkteve të tjera bujqësore e industriale për bagëtinë.

Ne kemi bërë dhe do të vazhdojmë të bëjmë investime e të marrim masa për ngritjen e komplekseve moderne për fuqizimin e blegtorisë, për prodhimin e mishit e të vezëve, për përpunimin industrial dhe silazhimin e ushqimeve për bagëtinë. Por duhet të tregohet kujdes që këto investime të kryhen me kohë dhe të japin efektin e duhur. Nga ana tjetër, duhet mbajtur mirë parasysh se pjesa dërrmuese e blegtorisë, e kësaj pasurie të madhe kombëtare, është në kooperativat bujqësore dhe në tufat e krijuara me bagëtitë e anëtarëve të këtyre kooperativave. Prandaj kujdes shumë i madh të tregohet për mbarështimin e rregullt të këtyre bagëtive, për shtimin e prodhimit dhe për uljen e kostos së produkteve blegtorale në të gjitha zonat e vendit.

Realizimi i detyrave për bujqësinë që parashikon plani i shtatë pesëvjeçar, do të arrihet si asnjëherë tjetër nëpërmjet rrugës intensive. Nga rritja e rendimenteve të bimëve dhe e prodhimtarisë së blegtorisë parashikohet të sigurohet 90 për qind e shtesës së prodhimit të përgjithshëm bujqësor, kundrejt 45 deri 70 për qind që ka qenë shtesa nga rritja e rendimenteve në pesëvjeçarët e kaluar. Detyra shtrohet që toka dhe e gjithë baza materialo-teknike relativisht e fuqishme dhe e shumëllojtë që është krijuar, të shfrytëzohet me efektivitet sa më të lartë, me qëllim që të merren sa më shumë prodhime bujqësore e blegtorale me shpenzime sa më të pakta.

Duke caktuar detyra të mëdha për shpejtimin e intensifikimit të bujqësisë, edhe në të ardhmen duhet të vazhdojnë me këmbëngulje përpjekjet për zgjerimin e sipërfaqeve të tokës së punueshme, sepse vendi ynë ka akoma toka për të hapur në zonën kodrinore e malore, si edhe për të përfituar sipërfaqe të reja toke nga shkripëzimet etj.

Një problem i madh që ka të bëjë me intensifikimin e bujqësisë, është harmonizimi më i mirë e me kritere shkencore i tërësisë së faktorëve njerëzorë, materialë, agroteknikë e natyrorë, që kushtëzojnë prodhimin bujqësor. Kjo është një çështje e përgjithshme, që i takon çdo ekonomie, rrethi e zone. Specialistët, kuadrot dhe punonjësit e pararojës në bazë, organet ekonomike e të planifikimit, por edhe institucionet kërkimore-shkencore kanë këtu një fushë të gjerë studimi e veprimi krijues e novator.

Investimet dhe kujdesi për tokën duhet të përbëjnë edhe në të ardhmen drejtimin kryesor të punës për intensifikimin dhe shtimin e prodhimit bujqësor. Kjo kërkon zbatimin e masave të gjithanshme për rritjen e pjellorisë së tokës dhe mbrojtjen nga erozioni, pasurimin dhe përmirësimin e tokave nëpërmjet plehërimit të kombinuar dhe të plotë, kërkon prodhimin dhe përdorimin e farërave me aftësi të lartë prodhuese, të qëndrueshme ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe ndaj faktorëve të disfavorshëm natyrorë.

Problemet e shumta që kanë të bëjnë me intensifikimin e bujqësisë, mund të zgjidhen me sukses vetëm duke e vënë tërë prodhimin bujqësor mbi baza rreptësisht shkencore. Plenumi i 8-të i KQ të Partisë dha orientime e direktiva me shumë rëndësi për të gjitha organizmat shkencore në bujqësi, nga baza deri në qendër. Është detyrë e dorës së parë e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe ekonomike

që ky program të vihet me këmbëngulje në jetë. Për këtë është e domosdoshme të formohet një kuptim i drejtë për rëndësinë dhe rolin e madh të kërkimeve e të eksperimentimeve shkencore në bujqësi dhe të merren të gjitha masat organizative që përfundimet e këtyre studimeve të gjejnë sa më shpejt zbatim në prodhimin e gjerë.

Në kuadrin e punës që do të bëhet në bujqësi gjatë këtij pesëvjeçari, Komiteti Qendror i Partisë i propozon Kongresit që **të zbatohen një varg masash të rëndësishme për intensifikimin me përparësi të prodhimit në fushat më pjellore të vendit brenda një periudhe 10-vjeçare.** Etapa e parë e këtij programi, që parashikohet të zbatohet në pesëvjeçarin e shtatë të shtrihet në më shumë se 100 mijë hektarë tokë të zonës fushore bregdetare. Qëllimi i këtij aksioni është që të shtohen prodhimet bujqësore e blegtorale në zonat ku puna dhe investimet japin më shpejt e më shumë efekt. Kjo do të krijojë kushte të favorshme edhe për një zhvillim më të shpejtë të kooperativave dhe për kalimin gradual të pronës së grupit në pronë të të gjithë popullit. Duke ndërmarrë këtë aksion, nuk do të preken investimet dhe burimet materiale të domosdoshme për zhvillimin e bujqësisë në zonat e tjera të vendit, përkundrazi, do të vazhdojë puna për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të të gjitha kooperativave bujqësore.

Realizimi me sukses i kësaj detyre të madhe kërkon punë të kujdesshme, të programuar e të organizuar mirë nga Ministria e Bujqësisë, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe institucionet e tjera qendrore dhe nga organet e Partisë e të pushtetit të rretheve që përfshihen në zonën ku do të zbatohet intensifikimi më i lartë i bujqësisë.

Niveli i arritur në zhvillimin e forcave prodhuese dhe hapat e rinj që do të bëhen në pesëvjeçarin e shtatë e në të ardhmen, do të shoqërohen dhe do të mbështeten me përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve socialiste në fshat. Komiteti Qendror i Partisë ka studiuar me kujdes dhe ka miratuar iniciativat revolucionare të fshatarësisë për kufizimin e mëtejshëm të oborrit kooperativist dhe tufëzimin e bagëtive të anëtarëve dhe ka marrë e po merr masa të gjithanshme për ta mbështetur si duhet këtë proces progresiv në fshat. Partia çmon lart frymën revolucionare dhe patriotizmin e flaktë të fshatarësisë kooperativiste për këtë hap me rëndësi të veçantë për forcimin e sistemit kooperativist në vendin tonë.

Ajo ka besim të plotë se kufizimi i oborrit dhe tufëzimi i bagëtive do të çojnë me siguri në shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, në garantimin dhe në ngritjen e mëtejshme të mirëqenies së fshatarësisë, në forcimin e mëtejshëm të ndjenjës së kolektivizmit socialist. Kështu, mbi bazën e shtimit të prodhimit dhe të ngritjes së mirëqenies së përgjithshme të fshatarësisë, oborri, si një ekonomi ndihmëse e përkohshme, ecën hap pas hapi drejt venitjes, drejt shuarjes së tij.

Edhe zbatimi i programit për shpejtimin e intensifikimit të prodhimit bujqësor në zonën fushore të vendit do të sjellë, në këtë zonë, ndryshime të rëndësishme në marrëdhëniet socialiste në prodhim. Me investimet e mëdha që shteti do të bëjë në kooperativat e kësaj zone,

do të rritet pesha e mjeteve të prodhimit pronë shtetërore. Kjo do të sjellë ngushtimin, dora-dorës, të sferës së marrëdhënieve të pronës kooperativiste, derisa kjo e fundit në një periudhë të mëvonshme të kthehet në pronë të të gjithë popullit. Derisa të arrihet në këtë fazë, kooperativistët në zonën ku do të shpejtohet intensifikimi i bujqësisë, do të vazhdojnë të shpërblehen me format e sotme, me norma e ditë-pune. Ndërkohë do të punohet që niveli i shpërblimit të tyre të arrijë gradualisht deri në nivelin e pagës së punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore.

Krahas kësaj do të vazhdojë puna për forcimin e kooperativave të tipit të lartë, disa prej të cilave do të shndërrohen në ndërmarrje bujqësore. Kjo do të shërbejë edhe si përvojë për të ardhmen. Në zonën fushore do të ngrihen kooperativa të tjera të tipit të lartë. Të tilla mund të bëhen edhe disa kooperativa të zonës kodrinore e malore, në varësi nga zhvillimi i tyre dhe nga mundësitë e shtetit.

Duke programuar këta hapa të rinj, Partia do t'i kushtojë edhe në të ardhmen vëmendje të madhe zhvillimit dhe fuqizimit të kooperativave të zonës kodrinore e malore. Këtu jeton një pjesë e madhe e popullsisë së vendit dhe ndodhet një sipërfaqe e konsiderueshme e tokës së punueshme. Shpejtimi i intensifikimit të bujqësisë në fushë do të krijojë mundësi më të mëdha materiale e financiare në duart e shtetit për të bërë investime dhe për ta ndihmuar më shumë edhe këtë zonë.

Vëmendje e kujdes i posaçëm duhet të tregohet për zhvillimin dhe fuqizimin e të gjitha ndërmarrjeve bujqësore, duke luftuar të metat e dobësitë që ekzistojnë sot në një pjesë të tyre. Detyra që ka shtruar prej kohësh Partia, që ndërmarrjet bujqësore të jenë në pararojë, duhet zbatuar me këmbëngulje.

Objektivat madhështore të planit të ri pesëvjeçar çelin perspektiva të gjithanshme zhvillimi e përparimi për bujqësinë dhe fshatin tonë socialist. Arritja e tyre kërkon mobilizimin dhe punën këmbëngulëse të të gjithë punonjësve të bujqësisë, përsosjen e planifikimit, të organizimit e të drejtimit në prodhimin bujqësor dhe në të gjitha hallkat që e pasojnë atë, në organet e grumbullimit, të industrisë së lehtë e ushqimore, të tregtisë së brendshme e të jashtme. Veçanërisht detyra të rëndësishme dalin para Ministrisë së Bujqësisë, organeve dhe institucioneve të saj vartëse, që ato të ngrihen në lartësinë e problemeve të mëdha që po shtron ky Kongres për zhvillimin e bujqësisë.

Realizimi me sukses i detyrave në fushën e bujqësisë do të jetë një fitore e madhe e politikës agrare të Partisë, që është diametralisht e kundërt me politikën që ndiqet në vendet revizioniste, ku bujqësia është futur në rrugë pa krye. Në këto vende, siç dihet, është braktisur prej kohësh rruga leniniste e kolektivizimit. Forma e kapitalizmit kolektiv që ekziston në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, po shoqërohet tani në një shkallë të madhe edhe me forma direkte të pronës private. Ekonomitë individuale private shihen nga revizionistët si një burim kryesor për prodhimin e mishit, të qumështit dhe të produkteve të tjera bujqësore, bile atyre po u jepen për t'i ushqyer e rritur edhe bagëtitë e kolkozeve e të sovkozeve, duke likuiduar kështu çdo gjurmë të sistemit socialist në fshat. Kjo është rruga që e ka futur në një krizë të the-

llë bujqësinë e shumë prej këtyre vendeve, ku mungesa e ushqimeve dhe e lëndëve të para bujqësore është bërë sot një nga problemet më serioze për jetën e masave punonjëse.

3. Investimet e ndërtimet – bazë e rëndësishme për fuqizimin e pandërprerë të ekonomisë

Gjatë pesëvjeçarit të kaluar janë bërë përpjekje të mëdha për realizimin e investimeve e të ndërtimeve themelore që caktoi Kongresi i 7-të i Partisë. Në këtë fushë veprimtaria armiqësore e revizionistëve kinezë na dëmtoi rëndë dhe pengoi më shumë se në çdo fushë tjetër arritjen e objektivave të caktuar. Megjithëkëtë, në sajë të masave të gjithanshme që morën Partia dhe shteti, në pesëvjeçarin e gjashtë u realizua një vëllim investimesh 15 për qind më i madh se në pesëvjeçarin e pestë.

Potenciali prodhues që kemi krijuar dhe burimet në rritje të akumulimeve tona të brendshme, bëjnë të mundur që në pesëvjeçarin e ri të ndërmerret një program investimesh e ndërtimesh si asnjëherë tjetër, me një vëllim të përgjithshëm prej mbi 25 miliardë lekësh, ose 22 deri 24 për qind më shumë se në pesëvjeçarin e kaluar. Kjo është një shprehje kuptimplote e epërsive dhe e vitalitetit të rendit tonë ekonomiko-shoqëror, e aftësive krijuese dhe e energjive të pashtershme të masave të gjera punonjëse, e drejtësisë së parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Në caktimin e investimeve, të strukturës së tyre dhe të veprave konkrete është mbajtur parasysh perspektiva e zhvillimit të degëve të ndryshme të ekonomisë e të kulturës, forcimi i pavarësisë dhe i mbrojtjes së atdheut, garantimi dhe ngritja graduale e mirëqenies së popullit.

Si kurdoherë, në politikën e investimeve përparësia i jepet prodhimit material. Nga 77 për qind që zinin investimet e sferës prodhuese në pesëvjeçarin e kaluar, në pesëvjeçarin e ri ato do të zënë 83 për qind. Një shpërndarje e tillë e investimeve bëhet sepse prodhimi është baza e mirëqenies së popullit dhe e fuqisë së atdheut.

Investimet më të mëdha edhe në këtë pesëvjeçar do të drejtohen për zhvillimin e industrisë e të bujqësisë, ku do të përdoren mbi 74 për qind e të gjitha investimeve, me një rritje prej afro 37 për qind kundrejt pesëvjeçarit të kaluar. Investime të rëndësishme do të bëhen edhe për transportin, për sektorët social-kulturorë, për ndërtimin e banesave. Gjatë pesëvjeçarit do të punohet për ndërtimin e më shumë se 350 veprave të rëndësishme vetëm të sferës prodhuese.

Për realizimin e objektivave të mësipërm është e nevojshme të merren masa praktike për rritjen e efektivitetit në përdorimin e mjeteve financiare, valutore, teknike e materiale që do të investohen. Për këtë, puna nis qysh në planifikim. Prandaj është e nevojshme që ai të vihet mbi baza shkencore që nga ndërmarrjet deri në qendër. Vëmendje më

e madhe u duhet kushtuar studimeve të plota për domosdoshmërinë, leverdinë dhe për fondet e çdo vepre. Gjithashtu të përcaktohen sa më parë kriteret shkencore dhe treguesit ekonomikë e teknikë të llogaritjes së efektivitetit, si dhe të ushtrohet kontrolli që ata të zbatohen në mënyrë të detyrueshme si në ndërtimin, ashtu edhe në shfrytëzimin e veprave. Rëndësi të veçantë ka kryerja e studimeve prognozë për zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, por edhe për ndërmarrjet e kooperativat. Këto studime të shërbejnë si pikënisje për hartimin e planeve pesëvjeçare dhe për përdorimin racional e me kursim të investimeve themelore.

Në pesëvjeçarin e shtatë do të përmirësohet më tej struktura e investimeve, duke rritur peshën që zënë makineritë e pajisjet dhe duke zvogëluar atë të ndërtim-montimeve. Këtu do të ndikojë mjaft fakti që rreth 40 për qind e investimeve në industri dhe në degët e tjera do të përdoren për zgjerime, rikonstruksione dhe modernizime të ndërmarrjeve ekzistuese. Kjo është një rrugë e leverdishme që kursen fonde të mëdha për ndërtimet dhe shpejton zgjerimin e aftësive prodhuese mbi një bazë teknike e teknologjike më të lartë. Përpara organeve të planifikimit, të ndërtimit, të financës shtrohet detyra që të punojnë me kujdes dhe të luftojnë me këmbëngulje për arritjen e këtij objektivi.

Si në çdo fushë tjetër, aq më tepër në investimet e në ndërtimet, kursimi i kohës është një ndër faktorët vendimtarë për të pakësuar investimet e ndërtimet e papërfunduara, për të siguruar plotësimin e detyrave të planit të prodhimit, të të ardhurave kombëtare, të akumulimit, për forcimin e stabilitetit të tregut dhe të qarkullimit monetar etj. Caktimi i afateve normative për kohëzgjatjen e ndërtimit të veprave të ndryshme dhe i kufijve normativë për gjendjen e investimeve e të ndërtimeve të papërfunduara duhet të shërbejnë si një mjet efikas për forcimin e kontrollit në planifikimin dhe në zbatimin e investimeve.

Një kujdes më i madh duhet të tregohet për investimet që kryejnë kooperativat bujqësore me mjetet e tyre, të cilat, gjatë këtij pesëvjeçari, janë parashikuar të arrijnë 2 miliardë e 750 milionë lekë. Këto investime të përfshihen më mirë në planin e zhvillimit ekonomik dhe realizimi i tyre të ndiqet me kujdes nga vetë kooperativat, nga organet shtetërore e ato ekonomike dhe në të ardhmen të mos lejohet më që të mbeten fonde të rëndësishme të papërdorura.

Një problem i madh për ndërtimin mbetet ulja e mëtejshme e kostos, sepse kjo, me gjithë përparimet e bëra, është akoma e lartë. Këtej del nevoja që projektuesit, teknologët e zbatuesit, si edhe prodhuesit e materialeve të ndërtimit, duke bashkëpunuar ngushtë me ekonomistët, të hartojnë e të zbatojnë projekte të përshtatshme, të përdorin konstruksione standarde e të lehta, të prodhojnë një gamë të gjerë materialesh ndërtimi me cilësi e rezistencë të lartë, duke zbatuar përvojën e përparuar të vendit dhe atë botërore.

Ministria e Ndërtimit, dikasteret e tjera dhe ndërmarrjet e tyre, që kanë një park të madh të makinerive, duhet të kujdesen e të luftojnë për shfrytëzimin racional e të plotë të kësaj baze të fuqishme. Me ritmet që kanë marrë e po marrin ndërtimet, nuk mund të ecet pa bërë kthesë

nin e ri pesëvjeçar arsimit, kulturës e shkencës do t'u jepet një zhvillim i mëtejshëm.

Numri i nxënësve në shkollat e mesme do të rritet në mënyrë të ndjeshme. Përveç fëmijëve të qyteteve, arsimi i mesëm do të përfshijë gjithnjë e më shumë edhe fëmijët e fshatit. Për t'iu përgjigjur më mirë zhvillimit të vrullshëm të ekonomisë, krijimit të degëve dhe futjes së teknologjive të reja në prodhim, do të zgjerohen e do të profilizohen shkollat e mesme profesionale. Në të gjitha kategoritë e shkollave të mesme gjatë pesë vjetëve të ardhshëm do të marrin dëftesën e pjekurisë rreth 160 mijë veta nga 113 mijë që i mbaruan këto shkolla në pesëvjeçarin e kaluar.

Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të arsimit të lartë, ku do të hyjnë 45 për qind studentë më shumë se në pesëvjeçarin e gjashtë. Do të krijohen profile të reja dhe do të zgjerohet kualifikimi dhe specializimi pasuniversitar.

Krahas arsimit, hapa të rinj përpara do të bëhen edhe në sektorët e ndryshëm të kulturës, me qëllim që puna e tyre të shtrihet thellë në masat dhe t'i shërbejë më mirë edukimit të tyre. Do të zgjerohet botimi i librave politikë, shkencorë, teknikë e artistikë. Tirazhi i tyre i përgjithshëm do të jetë 1 milion copë më shumë se në pesëvjeçarin e kaluar. Zhvillim të mëtejshëm do të marrë kinematografia. Do të zgjerohet rrjeti radio-televiziv nëpërmjet ngritjes së stacioneve të ritransmetimit e të përsëritësve, me qëllim që të mbulohen të gjitha zonat e vendit. Gjatë pesëvjeçarit të shtatë do të fillojë transmetimi i emisioneve televizive me ngjyra. Për edukimin revolucionar e patriotik të punonjësve do të ngrihen muze të rinj në qytete e fshatra dhe do të pasurohen më tej ata ekzistuesit. Vepra me rëndësi në këtë fushë janë: Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, Muzeu i Skënderbeut në Krujë, Muzeu i Kulturës Materiale Popullore në Shkodër etj.

Më tepër fonde në këtë pesëvjeçar janë caktuar edhe për zhvillimin e kulturës fizike e të sporteve. Do të zgjerohen terrenet sportive, do të ngrihen pallate sporti e stadiume të reja. Këto do t'i shërbejnë kalitjes fizike dhe argëtimit të rinisë, përgatitjes së saj më të mirë për punë e mbrojtje. Këtij kujdesi të Partisë sportistët e fizkulturistët duhet t'i përgjigjen me arritjen e rezultateve sa më të larta.

Në mbrojtjen e shëndetit të popullit gjatë viteve të pushtetit popullor është bërë një revolucion i vërtetë. Është zgjeruar shumë rrjeti i institucioneve të ndryshme shëndetësore, është përmirësuar vazhdimisht shërbimi mjekësor dhe janë zgjeruar gjithë masat e tjera për mbrojtjen e forcimin e shëndetit të njerëzve. Në këtë rrugë të suksesshme do të ecet edhe në planin e shtatë pesëvjeçar. Një zgjerim e përmirësim cilësor do të marrin masat e gjithanshme profilaktike si në qytet e veçanërisht në fshat. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të shërbimit shëndetësor për të rritur cilësinë e mjekimit e të ndihmës mjekësore dhe për të forcuar masat për mbrojtjen e shëndetit të nënës e të fëmijës, me qëllim që të ulet më tej vdekshmëria në fëmijët nën një vjeç. Për këtë qëllim do të ndihmojë edhe vendimi për zgjatjen e lejes së lindjes në afro gjashtë muaj.

Vendi ynë ka një shtim dinamik të popullsisë, një strukturë me mbizotërim të moshave të reja dhe një popullsi gjithmonë aktive e të freskët. Partia ka punuar e punon që proceset demografike të studiohen e të drejtohen në baza më shkencore, që popullsia të vazhdojë të shtohet me ritme të përshtatshme.

Vendi ynë jo vetëm nuk ka papunësi dhe emigracion ekonomik, por zhvillimi dinamik i forcave prodhuese dhe i veprimtarive shoqërore e kulturore kërkojnë gjithnjë forca të reja pune. Të gjitha forcat e reja që do të dalin gjatë pesëvjeçarit dhe që arrijnë në afro 210 mijë veta, do të futen në punë, në radhë të parë, në prodhim. Zënia me punë e forcave të reja kërkon studime të thelluara nga Komisioni i Planit të Shtetit, nga Komiteti Shtetëror i Punës e i Pagave, nga dikasteret e tjera, nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe nga vetë ndërmarrjet e kooperativat bujqësore.

Natyrisht, Partia dhe shteti do të përpiqen që të hapin fronte pune atje ku janë njerëzit, por kjo varet shumë edhe nga shpërndarja e burimeve dhe e pasurive natyrore. Prandaj një pjesë e forcave të reja të punës do të duhet të punojë atje ku ka nevojë vendi dhe atje ku hapen më shumë fronte pune. Ky proces duhet të mbështetet më mirë me zhvillimin e qendrave urbanistike, me zhvillimin e transportit, me përmirësimin e kushteve të punës, me rregullime në sistemin e pagave për të nxitur zënien me punë edhe në zonat e largëta ose në kushte të vështira pune.

6. Të përsosim drejtimin e ekonomisë dhe të rritim efektivitetin e saj

Drejtimi dhe organizimi janë një hallkë nga më të rëndësishmet pas së cilës duhet të kapemi fort për t'i çuar përpara punët kudo, në ekonomi, në arsim, në shkencë, në kulturë, në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore.

Në kushtet aktuale, kur ekonomia jonë është bërë një ekonomi e madhe e komplekse, ajo nuk mund të drejtohet e të ecë përpara me koncepte e praktika të cilave u ka kaluar koha. Sot nuk mund të punohet me empirizëm e prakticizëm të ngushtë. Drejtimi dhe organizimi duhet të mbështeten në njohuri e dije të thella, në parime dhe kritere të shëndosha shkencore, që burojnë nga ligjet e zhvillimit ekonomik e shoqëror.

Drejtimi i ekonomisë në bazë të këtyre ligjeve kërkon që problemet e zhvillimit të forcave prodhuese të shikohen kurdoherë të lidhura ngushtë me anët shoqërore të tyre, me të gjithë komponentët që përbëjnë jetën tonë socialiste. Kjo ka të bëjë me zbatimin në jetë, në mënyrë të planifikuar e të drejtuar mirë, të atij bashkëveprimi reciprok midis forcave prodhuese dhe marrëdhënieve ekonomike e të superstrukturës, që e pohojmë, por që në praktikë disa herë e harrojmë ose e kalojmë shkarazi. Këto shfaqje të dëmshme duhet të mënjanohen e të

luftohen, sepse bartin rrezikun e një drejtimi nga pozitat e ekonomizmit e të teknokratizmit.

Ekonomia popullore, si një ekonomi unike socialiste, drejtohet në bazë të parimit të centralizmit demokratik dhe të planit të përgjithshëm shtetëror. Në qoftë se cenohet sadopak ky parim, duke u nisur nga interesa të veçanta e të ngushta, kjo tregon se nuk kuptohen thellë e nuk zbatohen drejt direktivat e Partisë, ligjet e ekonomisë dhe rregullat e shtetit tonë socialist. Prandaj të luftohen shfaqjet e dikastelizmit e të punës së mbyllur brenda rretheve ose institucioneve. Të forcohet bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës për problemet e ndryshme mbi bazën e vijës e të politikës së Partisë, për t'u dhënë rrugëzgjidhje të shpejtë problemeve në bazë të kompetencave që i janë dhënë secilit.

Kryesorja është që secili, duke u udhëhequr nga vija, nga politika dhe ideologjia e Partisë, të realizojë detyrat e ngarkuara, t'i dalë zot punës, të tregojë iniciativë e këmbëngulje dhe të mbajë përgjegjësi të plotë për punën që kryen dhe sektorin ku drejton e punon. Kërkimi dhe dhënia llogari për kompetencat dhe funksionet e caktuara, për realizimin e detyrave të planit, është një normë që buron nga rendi ynë shoqëror, nga parimi i centralizmit demokratik. Kjo normë duhet zbatuar pa asnjë lëshim në të gjitha instancat, pa lejuar kurrfarë liberalizmi e sentimentalizmi mikroborgjez.

Partia ka theksuar vazhdimisht se socializmi është vepër e masave të gjera punonjëse të udhëhequra prej saj. Këtej rrjedh domosdoshmëria objektive që masat punonjëse të marrin pjesë gjallërisht në drejtimin e jetës së vendit, të përvetësojnë artin e të drejtuarit të ekonomisë. Kjo çështje parimore duhet të ngulitet thellë në mendjen dhe në ndërgjegjen e të gjithëve. Të arrihet kudo që të gjithë punonjësit ta thonë fjalën e tyre ashtu siç mendojnë e gjykojnë vetë, të kritikojnë të metat dhe të gjithë ata që shkelin rregullat dhe disiplinën shtetërore, me qëllim që punët të ecin përpara.

Për organizimin dhe drejtimin shkencor të ekonomisë një rëndësi të veçantë ka hartimi i planeve reale dhe mobilizuese, të mbështetura në studime të gjithanshme për problemet aktuale e të perspektivës, në përgjithësime dhe analiza të thelluara. Një punë më e kujdesshme duhet bërë edhe gjatë zbatimit të planit, duke zgjidhur drejt e shpejt problemet që dalin. Plani vërtet është ligj dhe zbatimi i tij është detyrë shtetërore, por kjo nuk duhet të pengojë marrjen e masave për të bërë ndryshime eventuale për përmirësimin e treguesve të tij sa herë që kjo është e domosdoshme dhe kur është e mundur.

Më shumë vëmendje t'i kushtohet kontrollit për zbatimin e planit. Ai duhet të jetë një kontroll i gjallë, veprues dhe i përditshëm, që jo vetëm të konstatojë të metat ose dobësitë, por t'u japë rrugëzgjidhje problemeve në vend. Sidomos duhet të forcohet kontrolli i brendshëm ekonomik, financiar dhe teknik në ndërmarrjet ekonomike dhe në kooperativat bujqësore. Organet e financës e të bankës duhet ta vënë kontrollin me anë të lekut në vendin që i takon dhe të rritin më shumë rolin aktiv të tyre në prodhim, në qarkullim e në shërbime, duke përdo-

rur më me efikasitet e në rrugë të drejtë edhe levat e tjera të mekanizmit tonë ekonomik.

Forcimi i drejtimit dhe i organizimit kërkon që të bëhen edhe përmirësimet e duhura në strukturat ekzistuese të organeve shtetërore dhe në organizma të ndryshëm të ekonomisë sa herë që kjo është e domosdoshme. Ashtu siç luftojmë që të shtojmë prodhimin dhe të përsosim teknologjinë e tij, po ashtu duhet të veprojmë për të ndryshuar format e metodat e vjetruara të drejtimit, duke vënë në zbatim struktura e forma të reja më efikase, më të gjalla dhe më pak të kushtueshme.

Puna drejtuese e organizuese duhet të shprehet në shtimin e prodhimit dhe në rritjen e efektivitetit të shpenzimeve në të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike. Gjatë pesëvjeçarit të shtatë të ardhurat kombëtare do të rriten më shpejt se prodhimi shoqëror; shtesa e tyre do të sigurohet në masën mbi 46 për qind nga rritja e rendimentit të punës; në industri e në ndërtim rendimenti i punës do të rritet 2 deri 3 herë më shpejt se në pesëvjeçarin e kaluar; rritja e së ardhurës neto në ndërmarrje do të realizohet në pjesën më të madhe nga ulja e kostos në prodhim, në ndërtim, në shërbime.

Nga plotësimi i këtyre objektivave varet në një shkallë të madhe zhvillimi i drejtë përpjesëtimor i gjithë ekonomisë, realizimi i ritmeve të parashikuara dhe i të gjitha detyrave të planit me forcat tona. Rrugët për arritjen e tyre duhen kërkuar në prodhim, në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, në zgjerimin e mekanizimit, në forcimin e disiplinës dhe në shfrytëzimin e kohës së punës, në uljen e kostos, në përdorimin racional të bazës materiale e teknike, pra, në zbulimin e shfrytëzimin e të gjitha rezervave të brendshme të ekonomisë, duke u mbështetur fuqimisht në përvojën e përparuar dhe në arritjet e shkencës e të teknikës.

Puna e njerëzve, me cilësi e me rendiment të lartë, është faktori vendimtar për të siguruar rritjen e efektivitetit të prodhimit e për të çuar përpara tërë ekonominë. Kjo kërkon të ngrihet kualifikimi i punonjësve, të zhvillohet iniciativa dhe krijimtaria e tyre, të bëhen ata të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe mundësinë e realizimit të detyrave të planit.

Një problem tjetër i madh që lidhet drejtpërdrejt me drejtimin, me organizimin e ekonomisë dhe me rritjen e efektivitetit të saj është zgjerimi dhe forcimi i kooperimit në të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike e shoqërore. Kjo diktohet nga thellimi i ndarjes shoqërore të punës dhe i lidhjeve ekonomike. Prodhimi është pasuruar me degë e aktivitete të shumta, forcat prodhuese janë shtrirë në të gjithë vendin. Është thelluar specializimi i veprimtarive prodhuese dhe kanë ecur përpara shkenca e teknika. Në këto kushte mungesa e kooperimit dhe e bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme jo vetëm nuk lejon të shfrytëzohen epërsitë e ekonomisë socialiste si një ekonomi unike, por pengon edhe zhvillimin e saj me ritme të shpejta.

Në këtë kuadër kërkohet një kuptim dhe zbatim më i thellë dhe më i plotë i parimit të mbështetjes në forcat e veta në fushën e ekonomisë dhe në çdo fushë tjetër. Në raport me botën e jashtme vendi ynë e zbaton këtë parim si një trup i vetëm, domethënë të gjithë së bashku, të gjitha

degët dhe sektorët e ekonomisë sigurojnë dhe duhet të sigurojnë me çdo kusht pavarësinë dhe zhvillimin e pandalshëm të vendit. Mbështetja në forcat e veta në planin e brendshëm, të degëve ekonomike, të rretheve, të ndërmarrjeve, të kooperativave, duhet kuptuar si një luftë krah për krah, në solidaritet të fortë socialist, në kooperim dhe në bashkëpunim të ngushtë e të gjithanshëm me njëri-tjetrin për plotësimin e detyrave të planit unik e të përgjithshëm shtetëror.

Rruga nëpër të cilën ka ecur dhe ecën ekonomia jonë është një rrugë e drejtë marksiste-leniniste. Dëshmi e qartë dhe konkrete për këtë janë qëndrueshmëria, vitaliteti dhe dinamizmi i saj. Këto tipare themelore të ekonomisë sonë socialiste do të konsolidohen e do të çohen akoma më përpara me luftën dhe përpjekjet e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore, nën udhëheqjen e Partisë, për të vënë në jetë objektivat e planit të shtatë pesëvjeçar, që po miratojmë në këtë Kongres.

II

TË FORCOJMË PARESHTUR PARTINË, TË RRITIM MË TEJ EFEKTIVITETIN E PUNËS SË SAJ

Partia jonë e Punës, besnike e patundur ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit, luftëtare e vendosur kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, me rrënjë të thella në popullin që e lindi dhe e rriti, në çdo etapë të revolucionit e të ndërtimit socialist të vendit e ka udhëhequr me urtësi e largpamësi popullin shqiptar nga fitorja në fitore.

Edhe detyrat e mëdha, të vështira e komplekse që caktoi Kongresi i 7-të i saj, Partia i ka kryer me nder. Lufta dhe puna për zbatimin e këtyre detyrave e ka forcuar dhe çelikosur më tej vetë Partinë, ka rritur rolin udhëheqës dhe frymën luftarake të saj, ka revolucionarizuar jetën dhe veprimtarinë e organizatave-bazë, të forumeve e të komunistëve, ka kalitur unitetin e çeliktë të radhëve të Partisë dhe lidhjet e ngushta me masat e gjera të popullit.

Shprehje e qartë e këtij uniteti monolit të Partisë dhe të popullit rreth saj është mobilizimi i përgjithshëm i komunistëve dhe i mbarë popullit për zbatimin e detyrave që ka shtruar e shtron Partia, janë aksionet e lëvizjet e mëdha revolucionare, si dhe solidariteti i mrekullueshëm popullor i njerëzve tanë. Ky unitet ka qenë dhe mbetet faktori vendimtar, kyçi i të gjitha fitoreve tona në ndërtimin socialist dhe në mbrojtjen e atdheut.

Forcimit të Partisë dhe të rolit të saj udhëheqës i ka shërbyer lufta e vazhdueshme që ajo ka bërë e bën për revolucionarizimin e radhëve të saj nëpërmjet punës për ngritjen e nivelit ideologjik, politik e kulturor të komunistëve, rritjes së veprimtarisë së tyre si militantë politikë e shoqërorë, si dhe forcimit të përbërjes proletare të saj. Në ra-

dhët e Partisë militon një armatë e tërë komunistësh, që kanë treguar besnikëri të patundur ndaj vijës së drejtë të Partisë në të gjitha situatat që kemi kaluar. Komunistët shqiptarë, si gjithnjë, kanë luftuar e kanë punuar me guxim dhe optimizëm revolucionar, ata janë treguar organizatorë, edukues e drejtues të aftë të masave.

Thellimi i luftës kundër shfaqjeve të liberalizmit e të burokratizmit në jetën e organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë, zhdukja e pasojave të punës armiqësore në disa sektorë të ekonomisë, në art, në kulturë dhe në ushtri, që synonte spostimin e rolit udhëheqës të Partisë, respektimi dhe zbatimi kudo i parimeve e i normave të Partisë, kanë rritur më tej frymën luftarake të saj, e kanë bërë Partinë më të pjekur, më të aftë dhe më të vendosur për të zbatuar detyrat e reja e të mëdha që na dalin në rrugën e ndërtimit socialist të vendit.

1. Të rritim e të përsosim më tej rolin udhëheqës të Partisë

Përvoja 40-vjeçare e Partisë sonë vërteton se vetëm një parti që bazohet fort në shkencën marksiste-leniniste mund të bëhet udhëheqësja e vërtetë e klasës punëtore, të realizojë hegjemoninë e saj dhe të sigurojë fitoren e revolucionit dhe ndërtimin e shoqërisë socialiste. Partia jonë ka qëndruar dhe qëndron kurdoherë në ballë të luftës e të punës së masave, ajo udhëheq kudo: në politikë e ideologji, në pushtet dhe në ekonomi, në arsim, kulturë e shkencë, në ushtri e në të gjithë sektorët e tjerë të vendit. Asnjë problem, i thjeshtë ose i ndërlikuar, aktual ose perspektiv nuk mund të gjejë zgjidhje pa udhëheqjen e Partisë. Ky ka qenë dhe mbetet për ne ligj. Tek udhëheqja e vetme dhe e pandarë e Partisë qëndron burimi i të gjitha fitoreve në ndërtimin socialist dhe garancia më e sigurt për të ardhmen e ndritur që po ndërtojmë.

Partia nuk vihet e as mund të qëndrojë rastësisht në udhëheqje. Rolin e vet udhëheqës ajo e siguron me vijën e saj të drejtë dhe me luftën e punën këmbëngulëse për zbatimin e kësaj vije në jetë. Duke u mbështetur në teorinë e klasës më të përparuar të shoqërisë, të proletariatit, në doktrinën marksiste-leniniste, në ligjet e zhvillimit materialist të shoqërisë, Partia ka një vizion të gjerë, një mendim të përpunuar e shkencor. Ajo sheh qartë në çdo situatë, kupton të tashmen, parashikon të ardhmen dhe di t'u dalë përpara punëve, duke përcaktuar e zbatuar kurdoherë një strategji e një taktikë revolucionare, që u përgjigjen interesave të klasës punëtore e të masave punonjëse.

Rolin udhëheqës Partia e realizon kudo e për çdo gjë nëpërmjet organizatave-bazë dhe komunistëve. Sa më mirë të përvetësohen e të zbatohen ideologjia dhe vija politike e Partisë në përgjithësi, çdo vendim e direktivë e saj në veçanti nga çdo organizatë e komunist, aq më shumë forcohet Partia dhe lidhjet e saj me masat, aq më lart ngrihet roli udhëheqës i Partisë në çdo hallkë të ndërtimit socialist. Kjo përbën një kusht vendimtar për plotësimin e detyrave të mëdha që shtrohen në stadin e sotëm të zhvillimit të vendit dhe në situatat konkrete në të cilat ne

ndërtojmë socializmin. Me Partinë në ballë, të fortë si çeliku, vigjilentë e sypatrembur, çështja e revolucionit dhe e socializmit është e pathyeshme.

Rëndësi të veçantë ka formimi i një koncepti më të qartë e më të plotë për realizimin e rolit udhëheqës të Partisë në të gjitha hallkat dhe në çdo fushë. Në praktikë disa komitete, byro dhe organizata-bazë partie e kuptojnë ngushtë këtë çështje. Disa mendojnë gabim se «Partia janë vetëm aparatet dhe organet udhëheqëse» dhe jo masa e madhe dhe e organizuar e tërë komunistëve. Disa të tjerë nuk e kuptojnë dhe nuk e realizojnë plotësisht rolin udhëheqës të Partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit dhe, nën parullën «Partia udhëheq çdo gjë», i angazhojnë organizatat, komitetet e Partisë dhe drejtuesit e tyre me zgjidhjen konkrete të çështjeve të vogla të prodhimit, të administrimit, të teknikës etj. Me sa duket, nuk kuptohet e nuk realizohet mirë e nga të gjithë se çështjet e Partisë i drejtojnë tërë komunistët, kudo që punojnë, se Partia drejton në bllok, në mënyrë të organizuar dhe të centralizuar me të gjitha levat e saj, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e masave.

Është kjo arsyeja që disa organe dhe organizata partie në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme u kushtojnë më shumë vëmendje anëve teknike e administrative dhe lënë pas dore aspektin politik e ideologjik, problemet e politikës ekonomike, kulturore ose ushtarake të Partisë, punën me njerëzit, që është edhe detyra e tyre kryesore. Gjykime dhe veprime të tilla çojnë në monopolizimin e punëve, ndryshin iniciativën e kuadrove e të masave, dublojnë e spostojnë levat e Partisë dhe dobësojnë e vyshkin vetë rolin udhëheqës të Partisë.

Partia jonë e ka konceptuar dhe e ka kryer gjithnjë drejt rolin e saj në sistemin e diktaturës së proletariatit. Prandaj ka rëndësi të madhe të kuptohet e të zbatohet gjithnjë e më mirë në jetë se puna e Partisë nuk është punë vetëm e organeve dhe e organizatave-bazë, aq më pak e aparateve të tyre. Punë partie bëjnë edhe organet shtetërore, ekonomike, komandat e shtabet në ushtri, organizatat e masave, gjithë kuadrot e punonjësit, qofshin ose jo komunistë, sepse të gjithë udhëhiqen nga ideologjia dhe nga vija e Partisë, zbatojnë ligjet dhe rregullat e shtetit, planet e tij, në të cilat mishërohet kjo vijë.

Kjo nuk e ul aspak, nuk e dobëson përgjegjësinë e plotë të organizatave të Partisë, rolin e tyre udhëheqës për të gjitha problemet. Por ato nuk mund t'i kryejnë vetë të gjitha punët. Prandaj organizatat e Partisë u ngarkojnë detyra levave, i mobilizojnë, u çelin perspektiva, i udhëheqin në punën e tyre, i kontrollojnë dhe u kërkojnë llogari për zbatimin me përpikëri të detyrave. Forumet dhe organizatat-bazë të Partisë, nëpërmjet komunistëve që veprojnë në to, punojnë që t'i bëjnë të ndërgjegjshme e t'i vënë në lëvizje këto leva, me qëllim që funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara t'i zbatojnë në mënyrë revolucionare dhe me iniciativë.

Këto çështje duhen kuptuar mirë jo vetëm nga organizatat e Partisë, por edhe nga levat e saj e nga çdo kuadër. Partia secilit i ka caktuar detyrat, kompetencat e përgjegjësitë. Ajo të gjithë i orienton e i kontrollon, të gjithëve u kërkon llogari. Por secili duhet t'i dalë zot punës

së vet, të veprojë me iniciativë e këmbëngulje dhe, sipas kompetencave që i janë dhënë, brenda vijës së Partisë, të mbajë përgjegjësi të plotë për detyrat e ngarkuara në sektorin që drejton. Nga kjo pikëpamje nuk janë të drejta ato pirrje që vihen re në praktikë kur disa organe shtetërore dhe ekonomike, në emër gjoja të sigurimit të rolit udhëheqës të Partisë, për çdo gjë pyesin dhe kërkojnë lejen e organizatave dhe të forumeve të Partisë, përpiqen të ligjësojnë veprimet e tyre, duke bërë kështu ortakllëk me to. Ky nuk është sigurim i rolit udhëheqës të Partisë, por pirrje për të ndarë përgjegjësinë me organizatën e Partisë.

Organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e masave dhe kuadrot e tyre nuk janë apolitikë, që merren vetëm me çështje teknike, agroteknike, ushtarake etj. Edhe këta punojnë e luftojnë duke u mbështetur në vijën e Partisë e për zbatimin e saj. Natyrisht organizata e Partisë ka përgjegjësinë e vet kur i lejon disa drejtues e administratorë të mos kryejnë detyrën e ngarkuar. Ajo duhet t'i ndihmojë, t'i orientojë, t'i edukojë, t'i korrigjojë, t'i vërë ata edhe para përgjegjësisë, e, kur është rasti, t'u tregojë vendin të gjithë atyre që kërkojnë të veprojnë sipas mendjes së vet, qoftë nën hijen e organizatës-bazë ose nën emrin e komunistit. Kështu zvogëlohen rreziqet për të bërë gabime, rritet kuadri dhe përgjegjësia e tij për punën.

Organizatat e Partisë merren e do të merren me të gjitha çështjet: me problemet e ekonomisë, të kulturës, të mbrojtjes, të të gjithë jetës së vendit. Ndryshe ato nuk mund të qëndrojnë në krye e të udhëheqin. Aftësia e tyre qëndron në atë që në momentin e dhënë të dinë të kapin çështjet më kryesore, t'u japin atyre zgjidhje të drejta, të justifikuara e të argumentuara, të shohin si kuptohen e si zbatohen vija dhe direktivat e Partisë nga komunistët, nga kuadrot, nga organet ekonomike e shtetërore, nga organizatat e masave dhe t'u kërkojnë llogari kur këto nuk e kryejnë detyrën e tyre. Për këtë mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë organizata e Partisë, që duhet ta përqendrojë vëmendjen kryesore në këto çështje dhe të mos merret ajo me zgjidhjen e problemeve të vogla e konkrete, për të cilat Partia ka krijuar organe e organizma të veçantë.

Puna e Partisë është në radhë të parë punë me njerëzit, punë për edukimin, sqarimin, mobilizimin e organizimin e tyre. Kjo nuk duhet harruar kurrë, ndryshe Partia largohet nga detyra dhe nga funksioni i saj kryesor udhëheqës, shndërrohet në një organizëm operativ dhe merr përsipër funksione shtetërore. Ky është një rrezik i madh për një parti që është në fuqi. Këtë rrezik e kemi bërë të njohur me kohë, që të mos e lejojmë kurrë të shfaqet.

Forca e pathyeshme e revolucionit tonë, e rendit shoqëror socialist qëndron në masat e popullit, në ndërgjegjen e tyre të lartë politike, në gatishmërinë dhe vendosmërinë e tyre për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit. Kjo është vepër e lavdishme e Partisë dhe këtë vepër Partia duhet ta konsolidojë e ta çojë vazhdimisht përpara me punën e saj ideologjike, politike e organizative.

Për këtë është e nevojshme që organizatat e Partisë, gjithë komunistët të shkrihen me masat e të punojnë pa u lodhur në gjirin e tyre, të njohin mirë gjendjen moralo-politike, të jenë kurdoherë në dijeni të problemeve që shqetësojnë masat, t'i sqarojnë ato për situatat, t'i

bindin për rëndësinë e detyrave që shtrohen, t'u bëjnë të qarta direktivat e Partisë dhe ligjet e shtetit. Nga ata kërkohet t'i edukojnë masat me botëkuptimin e moralin komunist, të luftojnë çdo mbeturinë e shfaqje të huaj, të kujdesen për jetën e tyre, të nxitin e të mbështetin krijimtarinë dhe iniciativat e masave, t'i mobilizojnë e t'i hedhin ato në aksione, për të forcuar ekonominë, kulturën dhe mbrojtjen e atdheut.

2. Të rritet efektiviteti i punës së Partisë dhe ndjenja e përgjegjësisë së organeve dhe organizatave të Partisë

Stadi aktual i zhvillimit të vrullshëm e të gjithanshëm, detyrat e mëdha e të guximshme që na shtrohen për të zgjidhur, kërkojnë të ngrihet në një shkallë më të lartë niveli dhe efektiviteti i punës së Partisë në të gjitha hallkat e drejtimet. Puna e Partisë është e gjerë dhe e gjithanshme: politike, ideologjike, organizative, administrative, ekonomike, psikologjike; ajo është punë e harmonizuar dhe e sintetizuar, që duhet zbatuar si e tillë. Efektiviteti i saj matet me rezultatet konkrete në realizimin e detyrave në çdo sektor të veprimtarisë shoqërore.

Në praktikë ka raste që puna e Partisë konceptohet ngushtë. Disa organe e organizata-bazë partie harrojnë perspektivën, mbeten në sipërfaqe të problemeve, mbështeten vetëm në njohuritë praktike, pa u ballafaquar me përvojën dhe mendimin e përparuar, me ndryshimet që kanë ndodhur në jetën e vendit e të njerëzve. Të tilla shfaqje në shumicën e rasteve janë shkaku i mosplotësimit të planeve ekonomike ose i dobësive që vihen re në punën e disa ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore, si dhe në ndonjë rreth.

Tani kërkohet të punohet me kulturë, me dije, me kompetencë e njohuri shkencore. Shpesh përsëritim se jemi të detyruar të ecim nëpër rrugë të pashkelura, se jemi të detyruar të kërkojmë e të krijojmë. Por kjo nuk mund të arrihet pa njohuri të thella të teorisë marksiste-leniniste dhe pa studim e përgjithësim shkencor të praktikës revolucionare të komunistëve e të masave punonjëse. Sot problemet e prodhimit, të organizimit të punës, të arsimit e të kulturës, të shkencës dhe të mbrojtjes nuk mund të zgjidhen drejt e me sukses pa studime serioze. Të tilla studime janë të nevojshme të bëhen edhe për vetë punën drejtuese, organizuese dhe edukuese të Partisë. Studimet e përgjithësimet u zgjerojnë horizontin, u hapin perspektiva të qarta organizatave të Partisë, komunistëve e punonjësve, ndihmojnë për të luftuar shfaqjet e rutinës, të formalizmit e të cektësisë, për të krijuar bindje të shëndosha e për të përcaktuar drejt masat dhe rrugët për kryerjen e detyrave aktuale e të perspektivës.

Më mirë duhet të përdorin organet dhe organizatat e Partisë mendimin e kualifikuar të specialistëve, të aktivistëve e të njerëzve të tjerë kompetentë, që Partia ka përgatitur në çdo sektor. Nga ata kërkohet

që të mbështetin e të frymëzojnë mendimin e përparuar shkencor dhe ta vënë këtë në shërbim të zgjidhjes së detyrave. Ata duhet të luftojnë shfaqjet e sektarizmit e të nënvleftësimit të përvojës e të mendimit të përparuar. Shembullin në këtë drejtim duhet ta japin, në radhë të parë, vetë komunistët. Komunist i mirë është ai që thellohet në dijet shkencore, që mëson vazhdimisht vetë e nga të tjerët, ndjek zhvillimin e shoqërisë, përkrah të renë përparimtare, mendon për perspektivën.

Puna e Partisë nuk është një punë vetëm agjitative propagandistike për sqarimin dhe bindjen e njerëzve, por është edhe një punë organizuese e mobilizuese për të zbatuar vijën dhe direktivat e Partisë. Puna e Partisë udhëheq, edukon e mobilizon komunistët dhe masat për veprime revolucionare, që ata të mendojnë, të punojnë e të luftojnë si revolucionarë.

Partia ka luftuar shfaqjet e njëanshmërisë në punën e disa organeve dhe të organizatave-bazë, që u japin më shumë përparësi mbledhjeve, raporteve e diskutimeve të shumta e të gjata sesa përcaktimit të qartë të detyrave dhe të masave konkrete për zbatimin e tyre. Me këtë shpjegohen rastet kur, me gjithë mbledhjet e shumta që bëhen për të analizuar gjendjen e punëve në këtë ose në atë sektor, prapë problemet nuk zgjidhen e gjendja nuk ndryshon.

Përvoja ka treguar se problemet zgjidhen dhe detyrat realizohen jo vetëm duke i bërë thirrje ndërgjegjes së komunistëve e të punonjësve, por edhe duke e shoqëruar zbatimin e detyrave dhe punën për bindjen e njerëzve me masa të gjithanshme, me organizim e drejtim konkret, me kontroll e kërkesë llogarie. Masat ideopolitike dhe tekniko-organizative përbëjnë një unitet dialektik; ato i edukojnë, i mobilizojnë dhe i hedhin njerëzit në veprime revolucionare.

Përsosja e rolit pararojë të komunistëve ka qenë dhe mbetet edhe në të ardhmen detyrë kryesore e organeve dhe e organizatave-bazë të Partisë. Veçanërisht në kushtet aktuale komunistët kanë për detyrë të rritin kërkesat ndaj vetes për ta mbajtur lart këtë emër, të luftojnë çdo shfaqje të huaj te vetja e tyre e te të tjerët, të jenë njerëz të përparuar në çdo drejtim. Komunistët duhet të dallohen për vendosmërinë revolucionare dhe pjesëmarrjen aktive në luftën e përditshme për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, të jenë kurdoherë në frontin më të vështirë e më të rëndësishëm të punës e të luftës, organizatorë e drejtues të talentuar që veprojnë me përgjegjësi për zbatimin e vijës së Partisë.

Masat i zbatojnë vendimet e organizatës së Partisë, i ndjekin komunistët, kur këta nuk i ndajnë fjalët nga veprat, kur mendojnë, punojnë e sakrifikojnë për interesat e punonjësve, të socializmit e të atdheut. Të jesh komunist e revolucionar do të thotë të marrësh përsipër dhe të realizosh detyra të mëdha, të mos mbetesh në vend, të mos kënaqesh me ritmet e zakonshme, të luftosh për zhvillime të shpejta në të gjitha frontet, të marrësh kurdoherë anën e së resë dhe ta mbrosh atë.

Puna e Partisë jep rezultate kur organizatat e Partisë, gjithë komunistët, zhvillojnë gjerësisht vetëveprimin, shpirtin krijues e novator.

Në këtë drejtim ka shembuj të shumtë e përvojë pozitive kudo. Megjithëkëtë është e nevojshme që në disa organizata partie, te disa kuadro e komunistë në ndërmarrje, në kooperativa bujqësore, në dikastere e institucione qendrore të luftohen shfaqjet e pritshmërisë, zvarritjet e ngu-rrimet, mungesa e iniciativës për t'u dhënë rrugëzgjidhje problemeve që janë në kompetencën e tyre.

Metodat e punës, të drejtimit e të organizimit nuk janë të dhëna një herë e përgjithmonë e të paprekshme. Jeta shkon përpara, shoqëria jonë socialiste zhvillohet pa pushim, kushtet ndryshojnë. Ky zhvillim kërkon të jemi krijues e novatorë, të gjejmë forma të reja pune më të zhdërvjellëta e të larmishme, t'i ripërtërijmë e t'i pasurojmë vazhdimisht ato, që t'u përgjigjen më mirë kërkesave të kohës.

Një punë më e kualifikuar dhe efektive kërkohet për zbërthimin e direktivave të Partisë. Kjo është detyrë themelore e organizatave-bazë, e të gjithë komunistëve. Në direktivat e Partisë shprehet vija e saj, përcaktohen detyrat që u dalin komunistëve e masave për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Në punën për zbërthimin e direktivave të Partisë është fituar një përvojë e mirë. Megjithëkëtë duhen luftuar më me forcë shfaqjet e formalizmit e të shabllonizmit që vihen re akoma në disa organe e organizata-bazë partie. Disa herë ndodh që direktivat dhe vendimet e Partisë nuk shkojnë në bazë, te njerëzit, me po atë seriozitet e forcë që i shtron Komiteti Qendror ose komitetet e Partisë të rretheve. Ato transmetohen mekanikisht poshtë, pa mbajtur parasysh kushtet konkrete ku vepron organizata e Partisë, gjendjen dhe detyrat që ajo ka për të zgjidhur.

Të zbërthesh direktivën e Partisë, do të thotë të sqarosh nevojën dhe rëndësinë e saj nga pikëpamja politike, ideologjike dhe ekonomike, të nxjerrësh detyrat që dalin për organizatat e Partisë, organizatat e masave, organet e pushtetit, të ekonomisë, të kulturës etj. në përshtatje me kushtet konkrete të çdo rrethi, zone, sektori e kolektivi, të përcaktosh rrugët dhe masat e nevojshme për realizimin e këtyre detyrave.

Rëndësi vendimtare ka hedhja e masave në aksione revolucionare për zbatimin e plotë e me krijimtari të direktivës. Këtu, në zjarrin e kësaj lufte, provohet edhe drejtësia e direktivës së Partisë, bëhen edhe plotësimet e korrigjimet e nevojshme të saj. Në aksion e nëpërmjet tij komunistët dhe masat forcojnë bindjet për direktivat e Partisë, edukohen e kaliten, shfaqin iniciativat e tyre revolucionare, realizojnë unitetin e fjalës me vepra, sigurojnë ritme të larta pune për kryerjen në kohë e me cilësi të detyrave. Aksioni shërben, gjithashtu, për të luftuar metodat burokratike e teknokratike, zvarritjet, rehatinë e vetëkënaqësinë, shërben për të gjallëruar kudo jetën, punën, njerëzit.

Puna e Partisë bëhet efektive kur organet dhe organizatat e Partisë mbajnë e ndiejnë përgjegjësi të plotë për zbatimin e vijës së Partisë, për plotësimin e detyrave të planit të shtetit. Pa ndjenjë përgjegjësie nuk ka luftë e përpjekje, nuk ka aksion revolucionar për zgjidhjen e problemeve. Detyrat përballohen duke luftuar e punuar me devotshmëri e shpirt sakrifice, duke i vënë shpatullat punës, duke kryer deri në një detyrat, me cilësi dhe efektivitet të lartë.

Është fakt se shumica dërrmuese e organeve dhe e organizatave të Partisë, e komunistëve dhe e kuadrove punojnë me ndjenjë të lartë përgjegjësie. Por gjenden edhe organizata, komunistë e kuadro që nuk luftojnë me këmbëngulje për kapërcimin e vështirësive e të pengesave dhe për zbatimin e detyrave. Shfaqjet e indiferentizmit e të justifikimit, rrumbullakosja e të metave dhe e dobësive nuk janë veçse mungesë e ndjenjës së përgjegjësisë.

Partia duhet të luftojë për të rritur ndjenjën e përgjegjësisë jo vetëm në radhët e veta, por edhe në organet e organizmat që ajo drejton, te të gjithë punonjësit e kuadrot. Duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë kolektive të çdo organi, organizate-bazë partie, të levave të tyre dhe të përgjegjësisë individuale të çdo komunisti e kuadri, krijohet një garanci e madhe për zbatimin e detyrave në çdo kohë e në të gjitha fushat.

Ndjenja e përgjegjësisë forcohet kur rritet kërkesa e llogarisë ndaj cilitdo, kur ushtrohet kontroll i rreptë për zbatimin e detyrave. Me gjithë përmirësimet që janë arritur në këtë drejtim, ka akoma shfaqje liberale e qëndrime sentimentale, frymë justifikimi, ka shfaqje nënvleftësimi për kontrollin dhe formalizëm e cektësi në ushtrimin e tij. Disa herë kontrolli dhe kërkesa e llogarisë janë të dobëta, sepse detyrat dhe vendimet janë të përgjithshme e, si rrjedhim, edhe të pakontrollueshme.

Çdo komunist dhe anëtar forumi, pavarësisht nga posti që mban dhe nga funksioni që kryen, duhet të japë dhe të kërkojë llogari deri në një për zbatimin e vijës dhe të direktivave të Partisë, të vendimeve të organizatës-bazë e të detyrave shtetërore. Kjo arrihet kur komunistët zhvillojnë me guxim e pa druajtje autokritikën, si dhe kritikën ndaj kujtdo që nuk realizon detyrat, kur bëjnë një luftë të vendosur kundër frikës, hakmarrjes e indiferentizmit mikroborgjez. Qëndrimi autokritik ndaj të metave, guximi i komunistëve për të kritikuar e për të kërkuar llogari janë një shembull dhe burim i madh frymëzimi për të gjitha masat punonjëse.

Stalini na mëson se kontrolli

> *«... i organizuar mirë, është ai projektor që ndihmon për të ndriçuar gjendjen e punës së aparatit në çdo kohë dhe për të nxjerrë në shesh burokratët dhe formalistët»*[1].

Këtë mësim duhet ta kemi kurdoherë parasysh e ta vëmë në jetë me konsekuencë. Detyra e organeve dhe e organizatave të Partisë është të gjallërojnë e të forcojnë kontrollin e Partisë dhe kontrollin shtetëror, kontrollin punëtor dhe atë të masave, t'i zhvillojnë ato në mënyrë të vazhdueshme e të ndërthurur me njëri-tjetrin. Kontrolli nga lart, ai paralel ose kontrolli nga poshtë të jenë medoemos më veprues, të shoqërohen me ndihmë konkrete, të hapin perspektivë, t'i mësojnë njerëzit si ta organizojnë punën, si të mobilizohen e të luftojnë me vështirësitë për realizimin e detyrave.

1 J. V. Stalin. Vepra të zgjedhura, f. 418-419. Tiranë, 1979.

3. Të zbatojmë drejt kriteret e vendosura për shtimin e radhëve të Partisë

Partia jonë kurdoherë ka zbatuar me vendosmëri e në mënyrë revolucionare kritere të drejta për shtimin e radhëve të saj. Këto e kanë forcuar e shëndoshur Partinë dhe kanë rritur efektivitetin e punës së saj.

Në këtë Kongres Partia vjen me radhë të shtuara, me komunistë luftëtarë të vendosur për çështjen e popullit, të revolucionit e të komunizmit, proletarë nga mendimi e nga veprimi. Tani në efektivin e saj militojnë 122 600 komunistë, nga të cilët afro 38 për qind janë punëtorë, 29,4 për qind kooperativistë dhe 32,6 për qind nëpunës. Gratë përfaqësojnë 30 për qind ose 2,5 për qind më shumë se në Kongresin e mëparshëm. Komunistët përfaqësojnë 4,5 për qind të popullsisë. Në vitet pas Kongresit të 7-të janë pranuar 24 363 kandidatë partie, nga të cilët 42,40 për qind punëtorë, 40,43 për qind kooperativistë dhe 17,17 për qind nëpunës. Shoqet zënë 40,70 për qind të tyre.

Shumica dërrmuese e të pranuarve, anëtarë e kandidatë partie, vijnë nga prodhimi, sidomos nga frontet më kryesore të tij. Ata janë nga punonjësit më të mirë, më të formuarit politikisht e ideologjikisht, me cilësi e virtyte të larta morale, me nivel të ngritur arsimor, luftëtarë pararojë, pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e socializmit.

Komiteti Qendror, në bazë të përvojës dhe të situatës, mendon se është me vend që, edhe në të ardhmen, për shtimin e radhëve të Partisë, të zbatohen, përafërsisht, të njëjtat ritme e kritere që janë ndjekur edhe në pesë vjetët e kaluar:

Të pranohen me përparësi aktivistë nga radhët e klasës punëtore, sidomos nga ata që punojnë në degët kryesore të prodhimit, në industrinë e rëndë, nxjerrëse e përpunuese, në veprat e mëdha që ndërtohen.

Të punohet më mirë për të shpejtuar realizimin e pikësynimit të caktuar nga Kongresi i 7-të që komunistët kooperativistë, në perspektivë, të dalin në vëndin e dytë, pas punëtorëve, në efektivin e Partisë.

Të pranohen nga nëpunësit dhe inteligjencia ata që kanë nivel të lartë ideopolitik e kulturor, teknik e shkencor dhe që punojnë në sektorët më të rëndësishëm të ndërtimit socialist e të mbrojtjes.

Të rritet më tej kujdesi dhe puna për shtimin e radhëve të Partisë me gra.

Zbatimi i këtyre orientimeve kërkon që organet dhe organizatat-bazë të Partisë të bëjnë një punë më të kualifikuar e më të menduar për shtimin e radhëve të Partisë. Të luftohen me vendosmëri shfaqjet formale e burokratike, çdo prirje për të qenë në rregull me shifrat e përqindjet.

Vendimtare në politikën e Partisë për shtimin e radhëve të saj ka qenë dhe mbetet cilësia e pranimeve. Kandidatët duhet të jenë të ngritur politikisht e ideologjikisht, të aftë e të zotë, të përparuar në mendime e veprime, me horizont të gjerë kulturor, arsimor e tekniko-profesional, të gëzojnë besimin e respektin e masës, të jenë me iniciativë e revolucionarë konsekuentë. Asnjë nuk duhet pranuar në Parti thjesht

pse është bir punëtori, fshatari ose komunisti, për meritat e nënës e të babait, por për meritat e veta personale, për cilësitë dhe aftësitë e tij. Këto cilësi e veti duhet të kaliten më tej nga organizatat-bazë të Partisë dhe nga vetë çdo komunist në luftën dhe veprimtarinë e përditshme.

Në formimin komunist të të pranuarve rishtas në Parti rol të madh luan stazhi i kandidatit. Përvoja e grumbulluar duhet të shërbejë që të rritet roli dhe përgjegjësia e organizatave-bazë për edukimin e vazhdueshëm ideopolitik të kandidatëve dhe për kalitjen e tyre revolucionare. Të luftohen shfaqjet që vihen re në disa raste, kur stazhi i kandidatit nënvleftësohet ose kur nuk zbatohen me rreptësi rregullat e vendosura për kryerjen e tij.

4. Të përsosim punën e Partisë me kuadrin

Në gjithë veprimtarinë e saj 40-vjeçare Partia i ka kushtuar kurdoherë një kujdes të veçantë punës me kuadrin dhe ka ndjekur në këtë çështje me rëndësi jetike një politikë të drejtë e me perspektiva të qarta. Gjatë këtyre vjetëve ajo ka përgatitur një armatë të tërë kuadrosh të të gjitha specialiteteve, për të gjitha fushat e sektorët e jetës, që shquhen për cilësitë e virtytet e larta morale, për pjekurinë politike e ideologjike, për besnikërinë e devotshmërinë ndaj çështjes së popullit e të socializmit, për aftësitë e zotësitë e tyre në kryerjen e detyrave.

Ashtu si në të gjitha fushat e tjera, edhe në punën me kuadrin Partia ka politikën e vet, ka përcaktuar orientime, kritere e norma të qarta marksiste-leniniste. Politika e kuadrit është monopol i Partisë, ajo përpunohet nga Komiteti Qendror i saj dhe zbatohet kudo nën udhëheqjen e Partisë. Kjo është një çështje parimore që duhet kuptuar drejt e nga të gjithë. Por, lidhur me këtë problem, Komiteti Qendror i Partisë ka kritikuar disa kuptime të ngushta e ka korrigjuar disa praktika të gabuara që ishin vënë re në punën me kuadrin. Monopoli i Partisë në politikën e kuadrit nuk do të thotë që problemet e kuadrit të trajtohen vetëm nga komitetet e Partisë. Konfondimi i këtyre çështjeve nuk mund të mos çojë, ashtu siç kishte çuar, në një përqendrim të madh të punës me kuadrin në organet dhe organizatat e Partisë. Partia jep orientimet, cakton kriteret, vendos normat për përgatitjen, edukimin, zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrove, por këto zbatohen jo vetëm dhe drejtpërdrejt nga komitetet e Partisë, por edhe nga të gjitha levat e saj, nga organet e pushtetit, të ekonomisë, të ushtrisë e të organizatave të masave. Edhe në punën me kuadrin secilit organ Partia i ka dhënë kompetenca dhe i ka vënë detyra të përcaktuara, të cilat duhen zbatuar me përgjegjësi, me partishmëri e me përpikëri. Kjo nuk i ul aspak rolin dhe përgjegjësinë e organeve dhe të organizatave të Partisë, përkundrazi, i forcon ato. Ashtu siç udhëheq e kontrollon punën në çdo sektor, po kështu Partia udhëheq e kontrollon edhe zbatimin e politikës së saj në punën me kuadrin.

Vëmendje e kujdes të madh duhet të tregojë Partia për t'i përdorur drejt kuadrot, për të shfrytëzuar më mirë aftësitë e tyre intelektuale e krijuese dhe për t'i vënë ato plotësisht në shërbim të prodhimit, të edukimit e të mbrojtjes. Kuadrot e specialistët e ndryshëm të ngarkohen me detyra e të vendosen në funksione që përputhen me profilin, specia-

litetin e përvojën e tyre, duke mbajtur kurdoherë parasysh cilësitë moralo-politike dhe aftësitë profesionale. Sidomos në shkollat e larta, në institucionet kërkimore-shkencore, projektuese e krijuese të zgjidhen e të vendosen, aq sa është e domosdoshme e pa dobësuar punën në bazë e prodhimin, specialistë nga më të mirët, më të talentuarit, më të zotët dhe që kanë dhënë prova.

Në ngritjen e kuadrove të mbahen mirë parasysh kërkesat e kohës. Në të gjitha funksionet, si në organet e zgjedhura, ashtu edhe në ato që emërohen, të ngrihen kuadro të aftë, që t'u dalin zot punëve e t'i drejtojnë ato me kompetencë. Ndryshe u hapet rruga burokratizmit, rutinës, mediokritetit. Edhe ata specialistë që ngrihen në përgjegjësi në funksione të ndryshme të Partisë, të pushtetit, të ekonomisë e të sektorëve të tjerë, duhet të mbeten kurdoherë krijues dhe të mos shndërrohen në administratorë të thjeshtë, në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Një punë të veçantë ka bërë Partia për ngritjen e kuadrove nga radhët e njerëzve që punojnë drejtpërdrejt në prodhim, si edhe nga radhët e grave. Në organet e zgjedhura të Partisë, të pushtetit dhe të organizatave të masave vendin e parë e zënë njerëzit që punojnë në prodhim. Në kuadrot e emëruar ata me origjinë e prejardhje punëtore zënë 33 për qind. Ndër kuadrot me arsim të lartë e të mesëm 44 për qind e tyre janë gra e të reja. Për të zbatuar drejt orientimet e dhëna nga Kongresi i 7-të i Partisë, Komiteti Qendror ka tërhequr vëmendjen e organeve e të organizatave të Partisë që, krahas luftës kundër konservatorizmit, sektarizmit e teknokratizmit, të luftojnë edhe kundër zbatimit formal të këtyre orientimeve sa për të ruajtur mekanikisht disa përpjesëtime orientuese në dëm të cilësisë. Edhe në të ardhmen ne do të ngremë në përgjegjësi punëtorë dhe gra, sepse ky është një orientim i drejtë, por do t'i ngremë këta jo vetëm se janë të tillë, por sepse e meritojnë. Tani ne kemi me qindra e mijëra njerëz të zotë, të aftë e me përvojë nga radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste e të grave, që i kanë të gjitha kushtet të marrin përsipër detyra më të mëdha. Në punë e sipër dhe me ndihmën e shoqeve e të shokëve më të vjetër e më me përvojë ata do të rriten e do të bëhen kuadro të kualifikuar, ashtu siç janë bërë shumë prej tyre.

Me këtë masë të madhe njerëzish të mësuar që kemi duhet hedhur poshtë si krejt pa baza mendimi se nuk ka kuadro dhe as duhet lejuar që të paaftët të qëndrojnë në ato detyra që nuk i kryejnë dot ose të kufizohemi vetëm te disa njerëz e të bëhen lëvizje pa kriter, siç ndodh disa herë. Ashtu si deri sot, edhe në të ardhmen, Partia duhet të ecë me guxim në ngritjen e kuadrove të rinj. Në numrin e përgjithshëm të kuadrove 38 për qind janë të moshave deri 30 vjeç; rreth 34 për qind janë 31 deri 40 vjeç dhe 28 për qind janë mbi 41 vjeç. Kjo tregon se rritja dhe përtëritja e kuadrove ecin në rrugë normale. Megjithëkëtë duhen luftuar ato shfaqje të konservatorizmit që ende vihen re dhe që pengojnë ngritjen e kuadrove të rinj në vende me përgjegjësi. T'u besohet më shumë kuadrove të rinj, të zgjedhur e të emëruar, dhe ata me siguri do ta ngrenë edhe më lart punën dhe veprën e Partisë. Besimi te të rinjtë duhet shoqëruar edhe me ndihmën për ta, por edhe vetë këta nga ana e tyre duhet të rritin përpjekjet, të punojnë, të mësojnë e të krijojnë. Partia dhe populli gëzohen e krenohen kur shikojnë se si njerëzit e rinj që ka edukuar Partia, drejtojnë e punojnë me zotësi në sektorë të ndryshëm të jetës së vendit.

Partia punon që jeta aktive e kuadrove të jetë sa më e gjatë. Megjithatë jeta e njeriut ka ligjet e saj. Ka kuadro që duhet të dalin në pension, ka të tjerë që fizikisht nuk i përballojnë dot detyrat, ashtu siç ka edhe nga ata që për fajin e tyre, nuk kanë ecur me kërkesat e kohës. Prandaj është absolutisht e domosdoshme që çdo kuadër të mendojë e të punojë seriozisht, me pasion e përgjegjësi për të përgatitur zëvendësit e tij, të cilët Partia t'i përdorë ku e kur t'i duhen.

Një detyrë e dorës së parë në punën e Partisë me kuadrot është formimi dhe kalitja e tyre si revolucionarë konsekuentë. Këtë detyrë Partia jonë e ka pasur kurdoherë në qendër të vëmendjes së saj. Ajo ka zhvilluar një veprimtari të gjithanshme edukative dhe ka marrë masa për t'i vënë kuadrot në kushte të atilla, që ata të militojnë kurdoherë për vijën e Partisë e të jenë shërbëtorë besnikë të popullit. Kjo ka qenë një ndër garancitë që çështja e revolucionit dhe e socializmit në Shqipëri ka ecur gjithnjë përpara.

Për të ecur me siguri në këtë rrugë të drejtë edhe në të ardhmen, kuadrot duhet të armatosen vazhdimisht me ideologjinë e Partisë, të zbatojnë vijën e saj dhe ligjet e shtetit, të marrin pjesë aktive në luftën e klasave dhe të mbajnë lidhje të ngushta me masat. Vetëm kështu luftohen me sukses shfaqjet e burokratizmit e të liberalizmit, të intelektualizmit e të teknokratizmit, forcohet botëkuptimi dhe karakteri komunist i kuadrove.

Vendi ka nevojë për kuadro me horizont të gjerë kulturor, me njohuri të thella shkencore, për kuadro që dinë të përdorin me efektivitet mendimin e përparuar, rezultatet e shkencës, që njohin ligjet e zhvillimit të ekonomisë, që dinë të planifikojnë saktë e të zbatojnë drejt, të punojnë me llogari. Është detyrë e të gjithëve, të zgjedhur e të emëruar, që të ngrihen në nivelin e kërkesave të kohës dhe të funksioneve që u janë besuar.

Për këtë do të na duhet ta përmirësojmë akoma më tej e ta vëmë në baza më shkencore punën për përgatitjen, kualifikimin e specializimin e kuadrove. Kjo përgatitje duhet bërë shkencërisht dhe e planifikuar me rigorozitet në bazë të nevojave të tanishme e të ardhshme. Detyra të mëdha kanë në këtë drejtim shkollat tona, veçse duhet pasur parasysh që kualifikimi e specializimi nuk bëhen vetëm në shkolla, por edhe në jetë e në punë. Në praktikën e përditshme njerëzit duhet të mësohen të ecin me llogari, të jenë metodikë e këmbëngulës në punë, prodhues të zotë e krijues me imagjinatë.

5. Të forcojmë më tej sistemin politik të diktaturës së proletariatit

Pas Kongresit të 7-të, me miratimin e Kushtetutës së re dhe të kodeve e ligjeve të tjera që burojnë prej saj, është forcuar më tej drejtimi, organizimi dhe veprimtaria e tërë sistemit të diktaturës së proleta-

riatit, të vetë Partisë, të shtetit, të forcave të armatosura, të organizatave të masave etj.

Punën me levat e saj Partia e ka trajtuar gjithnjë si një domosdoshmëri absolute për të realizuar qëllimin dhe programin e saj. Sa më të mëdha e më të rëndësishme janë detyrat që kryen Partia, aq më shumë rritet kujdesi dhe puna e saj me organet e pushtetit dhe me organizatat e masave. Por, me gjithë sukseset e arritura, në disa organizata, komitete partie e komunistë të veçantë nuk ka një kuptim të plotë e të saktë për rolin e Partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit. Ka organe dhe organizata partie që nuk sigurojnë gjithnjë një udhëheqje konkrete e të kualifikuar të organeve të pushtetit e të organizatave të masave, ka paralelizëm, spostime e zëvendësime të roleve, ka komunistë që nuk militojnë aktivisht në organizatat e masave, ashtu siç ka edhe shfaqje të formalizmit në punën me masat. Këto janë të meta që dobësojnë forcën dhe efektivitetin e punës së Partisë.

Dihet se sistemi i diktaturës së proletariatit përfshin një kompleks të tërë organesh e organizmash, me funksione, kompetenca e përgjegjësi të ndryshme, të ndërtuara në bazë të centralizmit demokratik e që funksionojnë nën udhëheqjen e Partisë. Problemi shtrohet që gjithë ky sistem të forcohet në mënyrë të vazhdueshme e të veprojë në mënyrë të sinkronizuar, duke kryer secili me përpikëri detyrat që i takojnë e, të gjithë së bashku, qëllimin dhe programin e Partisë.

Këtë sistem të organizuar Partia e udhëheq në tërë piramidën, nga baza në qendër, me politikën dhe ideologjinë e saj, me veprimtarinë e organizatave dhe organeve të Partisë e të çdo komunisti. Anëtarët e Partisë dhe kuadrot e saj, të zgjedhur e të emëruar në funksione të ndryshme të Partisë, të pushtetit, të ushtrisë, të ekonomisë, të organizatave të masave etj., i kuptojnë përgjegjësitë që u ngarkohen si një ndarje pune që bën Partia ndërmjet anëtarëve e kuadrove të saj.

Të gjitha levat e Partisë, edhe pse kanë organet e tyre drejtuese, udhëhiqen nga Partia jo vetëm në përgjithësi, por edhe nga çdo organ e organizatë-bazë partie. Dobësimi sadopak i rolit udhëheqës të Partisë në çdo hallkë, do të ishte me pasoja të këqija. Pikërisht këtë përpiqen të arrijnë borgjezia dhe revizionistët modernë, të cilët, në orvatjet e tyre për të minuar sistemin e diktaturës së proletariatit, synojnë t'i shkëputin levat nga udhëheqja e Partisë, t'i shndërrojnë ato në organizata të pavarura, t'i vënë përbri e kundër Partisë.

Udhëheqja e Partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit nuk e kufizon dhe nuk e cungon aspak veprimtarinë e organeve të pushtetit ose të organizatave të masave. Përkundrazi, Partia punon e lufton që të rriten roli dhe përgjegjësia e tyre, të zhvillohet iniciativa, të forcohen ato politikisht e organizativisht, të aftësohen për t'i kryer sa më mirë detyrat e tyre. Për këtë qëllim Partia ka kritikuar e kritikon si të huaja e të dëmshme ato praktika kur ndonjë organ ose organizatë partie përpiqet të vendosë mbi levat e Partisë një tutelë burokratike, t'u diktojë e t'u imponojë atyre çdo gjë, të ndrydhë e të mbytë vetëveprimin e tyre.

Si forca udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë, Partia e ka për detyrë të bashkërendojë punën e të gjitha organeve të pushtetit e të organizatave të masave. Edhe vetë këto të fundit, krahas kryerjes së funksioneve e të

detyrave të tyre, duhet të forcojnë bashkëpunimin me njëra-tjetrën si një kusht i domosdoshëm për suksesin e veprimtarisë së tyre. Natyrisht, çdo organ e organizatë ka profilin dhe specifikën e punës së vet, por këto veçori nuk duhen absolutizuar, sepse të gjithë punojnë e luftojnë për një qëllim. Duke bashkëpunuar, ato nuk dublojnë e nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën, as vihen në varësi të njëra-tjetrës, sepse të gjitha udhëhiqen nga Partia dhe secila në linjën e vet punon e lufton për zbatimin e detyrave që shtron ajo.

Një kujdes të veçantë tregon Partia **për forcimin e vazhdueshëm të organeve të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore**, nga gjendra në bazë. Pushteti popullor është fitorja më e madhe dhe arma më e fuqishme e klasës punëtore dhe e masave punonjëse për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut. Prandaj këtë pushtet e ruajmë si sytë e ballit dhe e forcojmë vazhdimisht në luftë me rreziqet që i kanosen, me liberalizmin e burokratizmin.

Kujdesi i Partisë për forcimin dhe rritjen e rolit të organeve të pushtetit, e veçanërisht të këshillave popullorë, ka qenë dhe duhet të jetë i vazhdueshëm. Partia ka luftuar çdo shfaqje të formalizmit në veprimtarinë e këshillave dhe ka kërkuar që të zbatohen me përpikëri të drejtat dhe kompetencat e tyre, të cilat nuk duhet lejuar kurrë që t'u merren nga organet ekzekutive. Respektimi me rreptësi i normave të Kushtetutës për organet e pushtetit shtetëror dhe për raportet ndërmjet tyre dhe organeve ekzekutive urdhërdhënëse ka të bëjë me ruajtjen e karakterit demokratik të pushtetit tonë, që i ka rrënjët në popull dhe që i përket popullit.

Organet e pushtetit shtetëror te ne e kryejnë veprimtarinë e tyre në lidhje të ngushtë me masat punonjëse. Në këto lidhje të ngushta me popullin qëndron forca e pathyeshme e pushtetit tonë popullor, prandaj t'i ruajmë, t'i forcojmë e t'i përsosim ato vazhdimisht. Duke ecur si gjithnjë me konsekuencë në këtë rrugë, do të rritet edhe vetë roli i masave, pjesëmarrja e tyre në punët e shtetit, do të zgjerohet demokracia jonë socialiste, pa të cilën nuk mund të kuptohet e të forcohet diktatura e proletariatit.

Gjithë veprimtaria e shtetit tonë mbështetet në Kushtetutën e në ligjet që burojnë prej saj, në të cilat shprehet në formë të sintetizuar përmbajtja e vijës dhe e politikës së Partisë. Partia nuk i ka lejuar e nuk do t'i lejojë shfaqjet e arbitraritetit dhe të shkeljes së ligjeve që do të cenonin interesat e shoqërisë ose të shtetasve të veçantë, prandaj ka ngulur këmbë vazhdimisht që ligjet e shtetit të njihen mirë e të zbatohen me përpikëri nga të gjitha organet shtetërore e punonjësit e tyre. Nëpërmjet një pune të gjerë propagandistike këto ligje u duhen bërë të njohura gjithnjë e më mirë edhe masave punonjëse, që ato të dinë të kryejnë detyrat e të mbrojnë të drejtat e tyre, të luftojnë kundër çdo shtrembërimi të ligjit nga çdo anë që të vijë. Njohja dhe zbatimi i ligjeve është një kusht vendimtar që veprimtaria e organeve shtetërore dhe e masave të popullit të zhvillohet në rrugë të drejtë dhe të ketë suksese. Kjo ndihmon që të forcohet kudo disiplina, rregulli e ndërgjegjja socialiste dhe t'i pritet rruga shumë të këqijave.

Partia punon që organet e zgjedhura të pushtetit, që nga këshillat

popullorë të fshatrave, të rretheve e deri në Kuvendin Popullor, komisionet e ndryshme pranë tyre dhe organet ekzekutive, të ndjekin frontalisht detyrat e të ushtrojnë kompetencat që u përkasin në të gjitha fushat e jetës: politike, ekonomike, social-kulturore, arsimore, shkencore etj. Ajo punon që të shmangen shfaqjet e njëanshmërisë që vihen re në disa organe të pushtetit në rrethe, të cilat merren kryesisht me problemet ekonomike dhe tregojnë pak kujdes për fushat e tjera të veprimtarisë shtetërore. Partia ka kritikuar gjithashtu praktikën e disa këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara, të cilët, duke u nisur nga fakti se me problemet e drejtimit e të zhvillimit të ekonomisë merren kryesitë e kooperativave bujqësore, nuk i kanë ndjekur ato, nuk kanë ushtruar kontroll dhe nuk kanë kërkuar llogari për kryerjen e detyrave të planit të shtetit në ekonomi.

Detyrat e mëdha që kemi përpara kërkojnë që të përsoset më tej metoda dhe stili i të gjitha organeve shtetërore, organizimi dhe drejtimi i punëve nga ana e tyre. Kjo përsosje nuk duhet kuptuar në mënyrë të thjeshtë e burokratike, sikur mund të arrihet duke shtuar organikat. Përkundrazi, organizimi dhe drejtimi i punëve përmirësohen e përsosen duke luftuar shfaqjet e burokratizmit, sidomos në konceptet, metodat e format e vjetruara të punës, që në mjaft raste nuk u përgjigjen stadit të zhvillimit e kompleksitetit të problemeve që i dalin vendit.

Në organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore, në qendër e në bazë, duhet bërë një luftë më këmbëngulëse nga organizatat e Partisë, kuadrot e punonjësit e tyre kundër çdo mungese të ndjenjës së përgjegjësisë, zvarritjeve të ndryshme, rendjes pas çikërrimave të ditës, mungesës së iniciativës e të vetëveprimit, shfaqjeve të servilizmit, konformizmit ose të prepotencës, qëndrimeve të ngushta sektoriale e lokale, koncepteve e praktikave artizanale etj. Që kjo luftë të ketë sukses, duhet bërë edhe me edukim, por edhe me organizim, disiplinë e kontroll të rreptë.

Gjatë periudhës midis dy kongreseve, Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Mbrojtjes **kanë marrë masa të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të aftësisë mbrojtëse të vendit.** Partia dhe pushteti, kuadrot ushtarakë, aktivë e rezervistë, kanë zhvilluar një punë të madhe në ushtri dhe kanë luftuar me sukses për zhdukjen e pasojave të veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut me shokë. Kjo ka bërë që të ngrihet në një shkallë më të lartë organizimi, stërvitja, edukimi dhe gatishmëria luftarake e forcave tona të armatosura.

Mbrojtjen e atdheut Partia jonë asnjëherë nuk e ka mbështetur në ndihmën e jashtme ose në koniunkturat e ndryshme ndërkombëtare, por kryesisht në faktorin e brendshëm, në forcën, në patriotizmin, në trimërinë e popullit tonë, si dhe në përgatitjen e gjithanshme e në gatishmërinë e përhershme luftarake të të gjithë vendit për mbrojtjen. Direktiva e Partisë «Mbrojtja e Atdheut është detyrë mbi detyrat» po bëhet gjithnjë e më shumë një realitet i madh te ne. Nga kuptimi i plotë e i drejtë i kësaj direktive dhe nga lufta konkrete për zbatimin e saj varet shumë rritja e aftësisë mbrojtëse të vendit.

Partia kërkon që edhe në të ardhmen Ushtria Popullore, të gjitha strukturat e saj, si forca kryesore për mbrojtjen e atdheut, të fuqizo-

het, të modernizohet e të revolucionarizohet vazhdimisht. Për këtë është e nevojshme të rriten përpjekjet e organizatave të Partisë, të komunistëve dhe të gjithë efektivave për përgatitjen e lartë politiko-luftarake, për përvetësimin e zbatimin krijues të kërkesave të Artit tonë Ushtarak mbi Luftën Popullore, për zotërimin e përsosur të të gjitha llojeve të armëve e të teknikës luftarake, për forcimin e rregullit e të disiplinës ushtarake mbi bazën e rregulloreve përkatëse.

Te ne ushtri e popull janë një e të pandarë, Forcimit të këtij uniteti e të këtyre lidhjeve i shërben edhe ngritja e shkollave të lira ushtarake sipas mësimeve të Leninit të madh. Konsolidimi i tyre po e bën përgatitjen ushtarake pjesë të pandarë të jetës e të veprimtarisë së çdo punonjësi.

Mbrojtja e atdheut forcohet dhe bëhet e pathyeshme kur detyrat në fushën politike, ideologjike, ekonomike e ushtarake kuptohen e zbatohen të lidhura ngushtë e të pandara nga njëra-tjetra. Një kuptim dhe zbatim i tillë i detyrave do ta konsolidojë më tej frontin tonë të brendshëm në të gjitha drejtimet, do ta bëjë atë edhe më të aftë për të përballuar me sukses çdo situatë, një mur të hekurt ku do të thyente kokën çdo agresor që do të guxonte të ngrinte dorën kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Në luftën kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm për mbrojtjen e pushtetit popullor dhe të fitoreve të ndërtimit socialist një kontribut veçanërisht të madh e të rëndësishëm kanë dhënë e japin **organet e punëve të brendshme, Sigurimi i Shtetit, Policia Popullore dhe Forcat e Kufirit.** Të udhëhequra e të edukuara nga Partia, këto organe të dashura të popullit, besnike ndaj interesave të tij, i kanë plotësuar kurdoherë me ndërgjegje e përgjegjësi të lartë detyrat e tyre.

Nga organizatat e Partisë në organet e punëve të brendshme kërkohet që të zgjerojnë e të përmirësojnë punën për edukimin politik, ideologjik, kulturor e profesional të efektivave, të mprehin më shumë vigjilencën revolucionare, të forcojnë disiplinën dhe gatishmërinë luftarake. Kuadrot dhe efektivat e sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të shtojnë përpjekjet për të njohur gjithnjë e më mirë format, taktikat dhe metodat që përdor armiku, për t'u aftësuar vazhdimisht në artin e punës së tyre e për të zbuluar, parandaluar e goditur me forcë e në kohën e duhur çdo veprimtari armiqësore e keqbërëse.

Njohja gjithnjë e më mirë, në thellësi e gjerësi, e vijës së Partisë, e politikës dhe e normave të saj, e ligjeve të shtetit dhe zbatimi me një disiplinë të lartë i tyre, janë kushte të domosdoshme për të rritur veprimtarinë e këtyre organeve, për të forcuar më tej frymën klasore, partishmërinë dhe objektivitetin në ushtrimin e funksioneve.

Forcimi i vazhdueshëm i udhëheqjes së Partisë, mbështetja e fuqishme te populli, janë garanci për të ruajtur e forcuar më tej karakterin popullor të organeve të punëve të brendshme, për të mbrojtur me vigjilencë interesat e atdheut e të socializmit.

Organet gjyqësore e të prokurorisë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e rendit tonë socialist, në mbrojtjen e në zbatimin e ligjshmërisë socialiste, në luftën parandaluese kundër veprim-

tarisë keqbërëse e në zbatimin e një politike të drejtë penale, sipas mësimeve të Partisë. Legjislacioni ynë ka karakter të theksuar klasor, politik, ideologjik, edukativ dhe administrativ. Ky karakter i legjislacionit tonë duhet mbajtur mirë parasysh edhe në të ardhmen në punën për njohjen, popullarizimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjeve. Asnjë çështje që bie në kundërshtim me ligjet dhe që është në juridiksionin e këtyre organeve nuk duhet të kalojë pa u hetuar e gjykuar me pjekuri, drejtësi, partishmëri e kompetencë të lartë. Një punë e veçantë dhe më e kualifikuar duhet bërë për edukimin dhe aktivizimin e ndihmësgjyqtarëve dhe prokurorëve popullorë, që përbëjnë një forcë të madhe për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjeve.

Partia jonë, si një parti e vërtetë marksiste-leniniste, ka vlerësuar gjithnjë drejt **organizatat e masave, të cilat kanë luajtur e luajnë një rol me rëndësi të veçantë për edukimin dhe mobilizimin e punonjësve për realizimin e programit të Partisë.** Si leva të saj, organizatat shoqërore jo vetëm orientimet e përgjithshme, por edhe veprimtarinë e përditshme të tyre e bazojnë në politikën e ideologjinë, në vendimet dhe direktivat e Partisë. Specifikat e punës së tyre janë të lidhura kryesisht me ato kërkesa të veçanta që ka Partia ndaj shtresave të popullsisë që përfshihen në këto organizata, me format dhe metodat e punës që duhen përdorur nga secila prej tyre për realizimin e detyrave.

Bashkimet Profesionale kanë një rol të veçantë në edukimin dhe në mobilizimin e klasës punëtore e të punonjësve të tjerë. Nën udhëheqjen e Partisë, ato i kanë kryer me sukses detyrat e tyre me shumë përgjegjësi.

Partia u ka ngarkuar Bashkimeve Profesionale detyra të mëdha për edukimin ideopolitik e tekniko-profesional të klasës punëtore për ta bërë atë të aftë të kryejë me sukses jo vetëm detyrat në fushën e prodhimit, por në të gjitha fushat e tjera të jetës së vendit, të marrë pjesë aktivisht në drejtimin e punëve shtetërore e shoqërore, të ushtrojë kudo e mbi këdo kontrollin e saj të klasës në fuqi. Për këtë është e nevojshme që Bashkimet Profesionale të përmirësojnë punën e tyre edukative, ta bëjnë atë konkrete e të lidhur ngushtë me jetën, me problemet që shqetësojnë kategoritë e ndryshme të punëtorëve, siç janë punëtorët e rinj, ata me banim në fshat, punonjësit e shërbimeve e të ndërmarrjeve bujqësore etj. duke rrënjosur kudo tiparet e klasës punëtore; të luftojnë kundër rutinës, globalizmit e formalizmit në punën edukative dhe të përdorin forma pune të gjalla, të shkathëta e të larmishme, që t'u përgjigjen nivelit, interesave e kërkesave të klasës, situatave dhe detyrave të reja.

Klasa punëtore, si klasa udhëheqëse e shoqërisë socialiste, do të mbajë si kurdoherë edhe në këtë pesëvjeçar një peshë të madhe. Detyrat që shtrohen kërkojnë nga ajo që të punojë me hov e emulacion të madh, me ndjenjë të lartë përgjegjësie e me disiplinë të fortë proletare, me rendiment, cilësi e frymë kursimi. Është detyrë e Bashkimeve Profesionale që ta bëjnë klasën punëtore plotësisht të ndërgjegjshme për këto detyra dhe ta mobilizojnë atë për zbatimin e tyre, të nxitin e të përkrahin iniciativat, aksionet dhe mendimin krijues të klasës, të zhvillojnë kudo sedrën revolucionare për arritjen dhe tejkalimin e objektivave të planit të shtetit.

Punëtori duhet të njohë mirë ligjet e shtetit të tij, sidomos ato ligje që e mësojnë atë si ta kryejë detyrën e tij në rregull, që plani të realizohet në të gjithë treguesit, si ta mbrojë e ta administrojë pronën e përbashkët socialiste, si të forcojë rregullin dhe disiplinën në punë etj. Këto ligje punëtori duhet t'i mësojë tok me zanatin. Këtu Bashkimet Profesionale kanë një fushë të gjerë veprimi, ashtu siç duhet të punojnë e të luftojnë që të zbatohen me rreptësi edhe ligjet e shtetit që mbrojnë të drejtat e punëtorëve e të mos pajtohen me asnjë shkelje të tyre nga kushdo qoftë. Detyrat dhe të drejtat te ne janë në unitet dhe të pandara.

Në ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste **rinia ka qenë kurdoherë në ballë të punës e të luftës, ndihmëse luftarake e Partisë.** Është një kënaqësi e madhe për të gjithë kur shikojmë se në vendin tonë brezi i ri rritet i gëzuar, i mësuar, i ngritur politikisht e ideologjikisht, i fortë fizikisht e me moral të lartë. Megjithatë, kujdesi i Partisë, i shtetit, i shoqërisë, i shkollës dhe i familjes për brezin e ri duhet të jetë i madh dhe i vazhdueshëm, sepse rinia është e ardhmja e vendit, shpresa e popullit dhe e socializmit. Partia dhe vetë organizata e Bashkimit të Rinisë, duhet të punojnë pareshtur që të rritet gjithnjë e më shumë interesimi i rinisë për të gjitha problemet e vendit, për ato politike e ideologjike, të ekonomisë e të mbrojtjes, të arsimit e të kulturës, të shkencës e të teknikës, me qëllim që ajo, si forca më e gjallë e popullit, të marrë pjesë aktive në ndërtimin socialist dhe të futet në jetë gjithnjë e më e përgatitur.

Rinia është fidanishte e pashtershme jo vetëm për përtëritjen e radhëve të Partisë e të kuadrove, por edhe për arsye se ajo do të zëvendësojë brezat, do të mbushë radhët e klasës punëtore, të kooperativistëve e të inteligjencies, do ta çojë përpara veprën e pavdekshme të Partisë e të popullit tonë. Që kjo fidanishte të nxjerrë gjithnjë fidanë të shëndoshë, Partia kërkon nga anëtarët e saj, nga organizata e rinisë dhe nga kuadrot që janë ngarkuar të punojnë në këtë organizatë, që të përmirësojnë punën për edukimin politik, ideologjik, kulturor e profesional të të rinjve e të rejave të vendit tonë, për të mbajtur gjallë e për të zhvilluar traditat patriotike e revolucionare të popullit, për të kultivuar e nxitur shpirtin praktik e krijues, për t'i kalitur ata në kudhrën e madhe të ndërtimit socialist, të luftës klasore e të aksioneve revolucionare.

Partia ka besim se rinia jonë, ashtu si kurdoherë, do të mësojë me pasion në shkollë e në jetë, do të përvetësojë shkencën dhe teknikën, do të punojë me entuziazmin që e karakterizon në të gjitha frontet, në të katër anët e Shqipërisë, do të mësojë e do të stërvitet për të mbrojtur atdheun, do të luftojë me këmbëngulje për të përvetësuar ideologjinë fitimtare të Partisë.

Detyrat që shtrohen përpara brezit të ri, kërkojnë të forcohet e të gjallërohet vetë organizata e rinisë, të ngrihet në një nivel më të lartë veprimtaria e saj edukuese, organizuese e mobilizuese, të luftohen shfaqjet e liberalizmit, të sektarizmit e të formalizmit, të bëhet një punë në forma sa më të larmishme e interesante që t'u përgjigjet nivelit e kërkesave në rritje të të rinjve e të rejave, duke shfrytëzuar më mirë

të gjitha kushtet dhe mjetet që Partia dhe shteti kanë krijuar për edukimin, arsimin dhe kalitjen e rinisë.

Partia ka luftuar e do të luftojë me konsekuencë për zbatimin e programit të saj **për emancipimin e plotë të gruas shqiptare, pa të cilën nuk mund të kuptohet socializmi dhe nuk mund të ecë përpara ndërtimi i tij.** Në jetën e gruas shqiptare janë bërë ndryshime kolosale, por ka edhe mjaft probleme që mbeten për t'u zgjidhur, sidomos në fushën e realizimit të barazisë së plotë të gruas me burrin në jetën shoqërore e familjare, në nivelin arsimor, kulturor e tekniko-profesional.

Gratë e vendit tonë kanë dhënë një kontribut me vlerë për realizimin e detyrave që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë. Ato dhe organizata e tyre, Bashkimi i Grave të Shqipërisë, duhet të luftojnë që të mbahet lart e të zhvillohet më tej fryma e emancipimit në vetë masën e grave dhe në tërë shoqërinë, që roli i gruas si ndërtuese aktive e socializmit, si mbrojtëse sypatrembur e atdheut, si nënë e kujdesshme dhe edukatore e brezit të ri të rritet vazhdimisht. Vëmendje të veçantë të tregojë organizata e gruas për forcimin e familjes e të kompleksit të marrëdhënieve familjare, për problemet e nënës e të fëmijës, të mëmyrës së jetesës etj., duke luftuar me forcë kundër të gjitha shfaqjeve të huaja e zakoneve prapanike që ende vazhdojnë të manifestohen në raste e forma të ndryshme dhe që cenojnë dinjitetin e personalitetin e gruas.

Fronti Demokratik i Shqipërisë ka bërë një punë të madhe për forcimin e unitetit të popullit rreth Partisë, për edukimin patriotik e mobilizimin e punonjësve për plotësimin e detyrave të planit të shtetit, sidomos në fshat. Edhe në të ardhmen kjo organizatë masive, me tradita dhe autoritet, të luftojë që uniteti politik, ideologjik e moral i popullit të çelikoset vazhdimisht, që të rritet roli aktiv i masave në ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit, në qeverisjen e vendit, në forcimin e kontrollit shoqëror dhe në zhvillimin e demokracisë socialiste.

Veteranët e luftës e të punës, pensionistët që shtohen nga viti në vit, janë një forcë tjetër e madhe, për të cilën Partia dhe shteti ynë kanë treguar e tregojnë një kujdes të veçantë. Ata gëzojnë respektin e tërë shoqërisë për luftën e punën që kanë bërë dhe për kontributin e çmuar që kanë dhënë. Por shumë prej tyre kanë ende forca dhe energji që mund e duhet t'i vënë në punë të dobishme shoqërore, sidomos për edukimin e brezit të ri me traditat e pasura të luftës e të punës heroike të Partisë e të popullit, si edhe për ruajtjen, zhvillimin dhe përjetësimin e këtyre traditave.

III

DETYRAT E PARTISË PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË PUNONJËSVE

Edukimi i gjithanshëm i njeriut të ri ka qenë dhe mbetet çështje themelore e veprimtarisë së Partisë për të çuar kurdoherë përpara ndërtimin e shoqërisë socialiste. Ky edukim është bërë në front të gjerë, i lidhur ngushtë me detyrat e çdo etape të zhvillimit, me problemet që ka nxjerrë jeta dhe me situatat konkrete. Kjo ka siguruar e siguron karakterin aktiv, forcën e madhe mobilizuese e transformuese të punës edukative të Partisë dhe të levave të saj.

Kushtet në të cilat ne punojmë e luftojmë për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit, si edhe detyrat që shtrojmë në këtë Kongres për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit, kërkojnë **që puna edukative e Partisë të ngrihet në një nivel më të lartë, të përqendrohet më mirë në disa probleme kryesore aktuale e të perspektivës**, për të krijuar te njerëzit bindje të thella marksiste-leniniste, për t'i bërë ata të aftë nga ana profesionale, për t'i pajisur me kulturë të gjerë dhe me virtyte të pastra morale.

1. Edukimi komunist i punonjësve – bazë e sukseseve tona

Shqipëria është vendi ku socializmi ndërtohet me sukses dhe qëndron në binarët e shëndoshë të marksizëm-leninizmit, ku zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës, organizimi dhe drejtimi i Partisë dhe i shtetit, formimi dhe kalitja e njeriut të ri bëhen mbi bazën e parimeve të socializmit shkencor. Rruga nëpër të cilën ka kaluar vendi ynë, nuk ka qenë e lehtë. Partisë dhe popullit u është dashur të përballojnë vështirësi të shumta, të çajnë në rrugë të njohura e të panjohura, në shtigje të reja e të pashkelura.

Besnikëria e pafund e Partisë sonë ndaj doktrinës së pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, aftësia e saj për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, në përshtatje me kushtet e vendit e në rrethana të ndërlikuara ndërkombëtare, vendosmëria për të mbrojtur pastërtinë e parimeve të saj nga sulmet e shtrembërimet e armiqve të shumtë, të brendshëm e të jashtëm, kanë qenë dhe mbeten baza e bazave të të gjitha sukseseve dhe fitoreve të popullit tonë.

Gjithë preokupimi i Partisë ka qenë që çdo hap në rrugën e revolucionit dhe në ndërtimin e socializmit të bëhej i menduar mirë, që themelet e shoqërisë së re socialiste të ishin të tilla që të siguronin zhvillimin e pandërprerë të saj drejt progresit dhe t'u bënin ballë dallgëve e furtunave të rrethimit armiqësor imperialisto-revizionist. Kjo është arsyeja që revolucioni dhe ndërtimi i socializmit në vendin tonë nuk kanë njohur zigzage dhe kthime prapa, por kanë ecur kurdoherë përpara dhe kanë shënuar gjithnjë fitore.

Shembulli i Shqipërisë është një përvojë e re në historinë e diktaturës së proletariatit dhe përbën një kontribut me vlerë në teorinë e praktikën e socializmit dhe të marksizëm-leninizmit.

Zhvillimin e vendit tonë në rrugën e socializmit komunistët, kuadrot, punonjësit, veçanërisht brezi i ri, duhet ta njohin mirë, ta kenë sa më të qartë nga jemi nisur e ç'rrugë kemi bërë, ç'vështirësi janë kapërcyer, ç'vijë ka ndjekur e ka zbatuar Partia, cilat janë themelet e kësaj shoqërie që është ndërtuar me gjakun, mundin dhe djersën e popullit tonë heroik.

Duke e njohur këtë rrugë të lavdishme e përvojë të pasur, njerëzit tanë do të kenë një shikim më të gjerë për shoqërinë socialiste, për stadin e sotëm e të ardhmen e saj dhe do të punojnë me ndërgjegje më të lartë e bindje të patundur për t'i çimentuar gjithnjë e më shumë fitoret e socializmit, për t'i çuar ato kurdoherë përpara. Partia duhet ta shikojë këtë si një çështje kapitale, sepse, sa më të forta të jenë themelet e të sotmes, aq më e siguruar do të jetë e ardhmja socialiste e komuniste e vendit tonë.

Forcimi i bindjeve për socializmin, për vitalitetin dhe epërsitë e tij merr një rëndësi të veçantë në kushtet e sotme, kur socializmi është minuar në shumë vende dhe kur imperialistët, borgjezia e revizionistët kanë ndërmarrë një fushatë të tërbuar kundër socializmit për të zhvleftësuar idealet revolucionare, për të mbjellë farën e dyshimit e të pasigurisë në të ardhmen socialiste të njerëzimit. Tehu i gjithë kësaj lufte jo rastësisht është drejtuar kundër doktrinës sonë fitimtare, marksizëm-leninizmit, pa të cilën nuk ka e nuk mund të ketë socializëm të vërtetë.

Gjithashtu, duhet të kemi kurdoherë parasysh se kushtet në të cilat ndërtohet socializmi në Shqipëri janë tepër komplekse. Partia, shteti, populli ynë luftojnë ballë për ballë dhe vetëm për vetëm kundër një force kolosale armike, kundër botës kapitaliste e revizioniste që na rrethon. Njerëzit tanë kurrë nuk duhet t'i nënvleftësojnë e t'i harrojnë rreziqet që i kërcënohen shoqërisë sonë socialiste nga presioni i madh e i gjithanshëm politik, ekonomik, ideologjik e ushtarak i kësaj bote.

Detyra jonë historike, kombëtare e ndërkombëtare, është të jemi të gjithë në këmbë, vigjilentë e të gatshëm për të përballuar çdo situatë, për të mbrojtur fitoret e arritura e për të çuar përpara revolucionin dhe ndërtimin tonë socialist. Diversionit të rrezikshëm të armiqve të socializmit t'i kundërvëmë vendosmërinë dhe guximin tonë, unitetin e çeliktë të Partisë e të popullit, punën e palodhur për zhvillimin dhe fuqizimin e ekonomisë e të mbrojtjes së vendit. Mbi të gjitha, për të mbrojtur socializmin e për ta çuar atë me siguri dhe gjithnjë përpara, është e domosdoshme të forcohen vazhdimisht bindjet e shëndosha e të thella për socializmin, si rendi shoqëror më i lartë, të cilit, në mënyrë të pashmangshme, i përket e ardhmja.

Njerëzit tanë duke jetuar e punuar në një shoqëri socialiste edukohen me normat e parimet e saj, të cilat mishërohen në marrëdhëniet ekonomike e shoqërore, në organizimin e drejtimin e shtetit e të tërë jetës së vendit, në legjislacionin e në mënyrën e jetesës, në sistemin e arsimit e të kulturës etj. Vetë realiteti socialist, si dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e njerëzve në veprën e ndërtimit socialist të vendit, i edukon dhe i ndihmon ata t'i kuptojnë e t'i përvetësojnë parimet bazë të marksizëm-leninizmit e të socializmit.

Por bindjet dhe ndërgjegjja socialiste që krijohen në praktikën e jetës, janë të pamjaftueshme për t'u orientuar drejt në çdo situatë, për të kuptuar thellë politikën e Partisë, për të vepruar kurdoherë me pikësynime të qarta. Ato edhe mund të lëkunden përballë vështirësive të ndryshme të ndërtimit socialist ose përballë presionit të madh

të botës kapitalisto-revizioniste, po qe se nuk mbështeten në një bazë të fortë teorike. Bindjet e thella të qëndrueshme i krijon vetëm marksizëm-leninizmi, që është baza teorike e socializmit shkencor dhe e edukimit komunist të punonjësve. Ato i rrënjos në masat Partia me punën e saj edukative.

Partia jonë ka bërë dhe bën një punë të madhe për edukimin marksist-leninist të komunistëve e të masave. Këtij qëllimi i shërbejnë Shkolla e Partisë, kurset e ndryshme dhe format e edukimit në Parti e në organizatat e masave, botimet, shtypi dhe të gjitha mjetet e tjera të propagandës. Marksizëm-leninizmi mësohet në mënyrë sistematike në shkollat e kategorive të ndryshme të arsimit shtetëror. Në dispozicion të komunistëve, kuadrove e punonjësve janë vënë veprat e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, si edhe dokumente e materiale të shumta të Partisë sonë.

Detyra që shtrohet tani, është që gjithë kjo punë të bëhet me një nivel më të lartë, më e kualifikuar, me qëllim që të përvetësohen sa më mirë e sa më thellë parimet e marksizëm-leninizmit dhe mësimet e Partisë sonë. Kryesorja është që njerëzit tanë të armatosen si duhet ideologjikisht me botëkuptimin dhe metodologjinë marksiste, të formohen si duhet nga pikëpamja teorike, që të qëndrojnë e të veprojnë në çdo kohë e në çdo rrethanë, në mënyrë të vetëdijshme, si revolucionarë konsekuentë, si luftëtarë të vendosur për çështjen e socializmit e të komunizmit dhe jo t'u mësohen atyre thjesht vetëm disa teza e konkluzione marksiste.

Partisë dhe popullit tonë u duhet të ecin gjithnjë përpara, të zgjidhin probleme të reja. Përpunimi teorik dhe zgjidhja praktike e këtyre problemeve kërkon që të zhvillohet vazhdimisht mendimi krijues, duke u mbështetur në parimet bazë dhe në metodologjinë marksiste, si dhe në përgjithësimin e përvojës së fituar. Për këtë arsye është e nevojshme që në shkolla e në sistemin e edukimit marksist-leninist të komunistëve e të masave, në tërë propagandën e Partisë marksizëm-leninizmi të studiohet, të propagandohet e të përvetësohet si një doktrinë e gjallë e krijuese, si një shkencë që zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Kudo të zhvillohet fryma kritike e revolucionare, të gjallërohen debatet e diskutimet e frytshme, të luftohet çdo shfaqje e ngurtësisë dhe e dogmatizmit, t'i hapet rrugë e gjerë mendimit të përparuar e të partishëm, gjithçka t'i nënshtrohet analizës së thellë, logjikës së shëndoshë marksiste.

Ngritja teorike është një kusht i domosdoshëm për të luftuar shfaqjet e empirizmit dhe të prakticizmit. Fakt është se ka komunistë e kuadro që pak bëjnë përpjekje për përvetësimin e teorisë, që problemet e detyrat që shtrohen dhe direktivat e orientimet që jepen, i kuptojnë ngushtë, i shohin në mënyrë të thjeshtësuar dhe nuk thellohen në përmbajtjen e tyre ideopolitike, në aspektin e tyre teorik. Në këtë çështje mbetet gjithnjë aktuale ajo që thoshte Stalini se

«... sa më të lartë të jenë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove të çdo sektori të punës së shtetit dhe të Partisë, aq më e mirë dhe më frytdhënëse është vetë puna,

aq më të efektshme janë rezultatet e punës, dhe anasjelltas, sa më të ulët që të jenë niveli politik dhe vetëdija marksiste-leniniste e kuadrove, aq më të mundshme janë gabimet dhe dështimet në punë, aq më tepër ka mundësi që vetë këta kuadro të bien poshtë dhe të shndërrohen në prakticienë që merren me vogëlima, aq më tepër ka mundësi që ata të degjenerohen»[1].

Mangësitë në formimin e përgjithshëm teorik çojnë në mënyrë të pashmangshme edhe në konceptime e veprime subjektiviste e voluntariste, që bien në kundërshtim me kërkesat e ligjeve objektive, cenojnë drejtimin shkencor të punëve, frenojnë e deformojnë proceset e zhvillimit ekonomiko-shoqëror, dëmtojnë edhe vetë edukimin e njerëzve. Me shfaqje të tilla ndeshemi në mjaft raste, por sidomos në planifikimin, organizimin dhe drejtimin e ekonomisë ato janë më të dukshme e më të dëmshme.

Shoqëria socialiste vërtet është një shoqëri që ndërtohet në mënyrë të ndërgjegjshme, por kjo bëhet jo sipas vullnetit e dëshirave subjektive të njerëzve. Edhe në socializëm zhvillimi kryhet sipas ligjesh që kanë karakter objektiv. Veçoria e socializmit qëndron në njohjen dhe përdorimin e ndërgjegjshëm të këtyre ligjeve në përputhje me pikësynimet e Partisë e të shtetit socialist. Këtu qëndron edhe një nga epërsitë e mëdha të rendit socialist, që siguron një zhvillim harmonik e me ritme të larta të ekonomisë e të kulturës në dobi të masave punonjëse.

Këtej del detyra që njohja e ligjeve ekonomike objektive të socializmit, të cilat qëndrojnë në themel të politikës ekonomike të Partisë, të jetë në qendër të vëmendjes së punës edukative të Partisë, të shtetit, të organizatave të masave, të të gjitha mjeteve të propagandës. Duke njohur thellë ligjet objektive e duke vepruar në përputhje me kërkesat e tyre, mund të mënjanohen shfaqjet e subjektivizmit, të shfrytëzohen epërsitë e mëdha të rendit socialist, të vihet mbi baza shkencore planifikimi e drejtimi i ekonomisë dhe vetë edukimi i njerëzve.

Është e njohur se njeriu, me ndërgjegjen, aftësitë dhe përvojën e tij, është faktori vendimtar në çdo punë, në realizimin e çdo detyre. Kjo është edhe arsyeja pse Partia i jep rëndësi të dorës së parë punës me njerëzit për edukimin, kalitjen, aftësimin e tyre të vazhdueshëm. Por veprimtaria e njerëzve ka sukses dhe mund të arrijë objektivat e caktuar, kur, përveç punës edukative, ajo mbështetet si duhet me masa ekonomike, organizative dhe administrative. Janë shfaqje të subjektivizmit ato raste kur problemet trajtohen në mënyrë të njëanshme, kur shkaqet e të metave dhe të dobësive kërkohen vetëm në punën ideopolitike ose në metodën e stilin e drejtimit, kur mendohet se gjendja mund të ndryshojë e të përmirësohet me fjalë e me mbledhje, pa veprime e masa konkrete.

Në ngritjen e nivelit të propagandës së Partisë, të të gjithë punës për edukimin e masave në frymën e socializmit, një rol i madh u

1 J. V. Stalin. Vepra të zgjedhura, f. 509-510. Tiranë, 1979.

takon shkencave shoqërore. Vetëm mbi bazën e studimeve e të përgjithësimeve shkencore të përvojës së Partisë e të masave, si dhe të problemeve që nxjerr jeta mund të bëhet një punë bindëse e thellë dhe e argumentuar me njerëzit.

Shkencat tona shoqërore kanë bërë hapa përpara dhe janë zhvilluar në rrugë të drejtë. Me punimet e botimet e tyre ato kanë dhënë kontribute të çmuara në fushën e studimit të historisë së popullit e të kulturës së tij, të përvojës së Luftës Nacionalçlirimtare e të transformimeve socialiste, të jetës politike, ekonomike e shoqërore të vendit. Një punë me vlerë të madhe ka bërë Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë Komitetit Qendror për përpunimin e Historisë së Partisë, për botimin e materialeve dhe të dokumenteve të shumta të Partisë, për studimin e problemeve të ndryshme të revolucionit e të ndërtimit socialist.

U takon institucioneve shkencore, katedrave të shkollave të larta, si edhe gjithë kuadrove të shkencave shoqërore që të ngrenë në një shkallë të re punën e tyre, të thellohen më shumë në çështjet themelore të përvojës dhe të perspektivës së zhvillimit të vendit tonë, t'i përpunojnë ato me nivel të lartë teorik e shkencor dhe të militojnë më aktivisht në luftën që bën Partia për edukimin e njeriut të ri.

Një çështje themelore e botëkuptimit komunist, e teorisë dhe e praktikës revolucionare është kuptimi i drejtë i rolit vendimtar të masave në ndërtimin e shoqërisë socialiste. Partia jonë nuk ka lejuar asnjë devijim nga ky parim dhe në këtë qëndron një ndër shkaqet e thella që në Shqipëri socializmi është ndërtuar në rrugë të drejtë dhe zhvillohet me sukses.

Pjesëmarrja aktive e masave në qeverisjen e vendit, në tërë jetën shoqërore përbën, siç e ka vërtetuar edhe përvoja e vendit tonë, një kusht të domosdoshëm e vendimtar për ruajtjen dhe forcimin e pushtetit popullor, për të çuar përpara pa ndërprerje revolucionin socialist, për të siguruar një mbrojtje të fortë e të pamposhtur të atdheut.

Roli vendimtar gjithnjë në rritje i masave popullore në shoqërinë tonë socialiste është shprehja më e thellë dhe drejtimi themelor i zhvillimit të demokracisë socialiste. Nga kjo pikëpamje, demokracia socialiste është jo vetëm një arritje historike e masave të popullit, e fituar në luftë e në revolucion, por njëkohësisht një nevojë, një kusht i domosdoshëm, një ligj i brendshëm i zhvillimit të shoqërisë socialiste, një forcë e madhe lëvizëse, që e çon atë përpara.

Socializmi i ka çliruar njerëzit tanë nga çdo formë e shfrytëzimit të njeriut nga njeriu. Një fitore e madhe historike është çlirimi i ndërgjegjes së punonjësve nga prangat shpirtërore të shoqërive shfrytëzuese, emancipimi i gruas, që është bërë pjesëtare e barabartë me burrin në jetën tonë shoqërore. Njerëzit tanë gëzojnë të drejta e liri demokratike të mëdha, siç janë e drejta për punë, për arsim, për të zgjedhur e për t'u zgjedhur në funksione shtetërore e shoqërore, liria e fjalës, e shtypit etj., të cilat në vendin tonë janë një realitet i shpallur jo vetëm me ligj, por edhe i zbatuar në praktikën e përditshme. Gjithë jeta e vendit tonë, organizimi e drejtimi i shtetit, i ekonomisë, i arsimit e i kulturës,

i mbrojtjes, është ndërtuar në mënyrë të tillë që siguron e kërkon pjesëmarrjen aktive të masave punonjëse.

Rreziqet që i vijnë socializmit nga shkëputja e organeve të pushtetit dhe e kuadrove nga masat, nga burokratizimi i aparateve etj., Partia i ka bërë të qarta me kohë. Ajo ka theksuar se lufta kundër shfaqjeve dhe shtrembërimeve të tilla duhet të bëhet vazhdimisht, pa lënë që ato të grumbullohen e të trashen. Por në praktikë ndeshen shfaqje të njëanshmërisë e të formalizmit në kuptimin e zbatimin e demokracisë së masave e të marrëdhënieve të kuadrove me masat. Ka raste që administratat dalin mbi organet e zgjedhura, që disa kuadro nuk mbajnë kontakte të ngushta me njerëzit ose konsultohen formalisht me ta. Ndodh që nuk llogariten e nuk vlerësohen si duhet asambletë e kooperativave bujqësore dhe organizatat e tjera të masave, që nuk respektohen kurdoherë normat e vendosura të dhënies llogari përpara masave etj. jo vetëm nga të zgjedhurit, por edhe nga kuadrot e emëruar.

Është detyrë e propagandës së Partisë që të shpjegojë e të argumentojë thellë se roli i masave nuk është një çështje abstrakte, se ai realizohet nëpërmjet veprimtarisë së përditshme të kolektivit, të Bashkimeve Profesionale, të organizatës së rinisë, të Frontit e të gruas, të këshillit popullor e të të gjitha organeve të zgjedhura. Propaganda e Partisë duhet të arrijë në mënyrë të veçantë që kuadrot ta kuptojnë politikisht e ideologjikisht nevojën e lidhjes së drejtpërdrejtë me masat, me punëtorët, me kooperativistët, me rininë, me gratë, me të gjitha shtresat e popullit. Ata duhet të këshillohen gjerësisht me njerëzit, të marrin mendimet e tyre, të shtrojnë para masave problemet që preokupojnë Partinë e shtetin dhe të gjejnë bashkë me to zgjidhjet më racionale.

Kur Partia shtron me forcë që të dëgjohet më shumë zëri i specialistëve, që të mbështetet dhe të përkrahet më mirë mendimi i tyre i kualifikuar për ta vënë prodhimin mbi baza shkencore, kjo nuk duhet të çojë në asnjë mënyrë në nënvleftësimin e mendimit të përparuar të masave dhe të përvojës së tyre të pasur revolucionare. Revolucioni teknik-shkencor te ne mund të zhvillohet me sukses vetëm kur potenciali intelektual e shkençor i kuadrove dhe i specialistëve të lidhet ngushtë e të shkrihet me luftën e përvojën e gjithanshme të masave.

Në zbatimin e vijës së masave duhet mënjanuar çdo thjeshtëzim e trajtim formal i saj. Është e palejueshme që, në emër gjoja të zbatimit të vijës së masave, të mbyten njerëzit me mbledhje pa bukë e për gjëra fare të vogla. Mbledhjet ku nuk zgjidhen problemet që shqetësojnë, ku nuk arrihet në konkluzione e masa konkrete për ndryshimin e gjendjes, nuk kanë asnjë vlerë. Nuk duhet lejuar, gjithashtu, që vija e masave të përdoret si një perde pas së cilës të fshihen mungesa e përgjegjësisë, të metat në organizimin e drejtimin e punëve, moszbatimi i kompetencave, i ligjeve e i rregullave të vendosura.

Objekt i një kujdesi të vazhdueshëm të Partisë dhe të organizatave të masave duhet të jetë gjallërimi e aktivizimi i kontrollit të masave nga poshtë, duke përfshirë edhe grupet e kontrollit të drejtpërdrejtë punëtor e fshatar, të cilat duhet të përqendrohen më mirë sidomos në kontrollin mbi administrimin e pronës socialiste, mbi veprimtarinë e administra-

tave, si edhe në fushën e shërbimeve për popullin e të plotësimit të nevojave të tij.

Rëndësi të veçantë ka të kuptohet drejt se kontrolli i masave nga poshtë nuk duhet kufizuar e nuk duhet reduktuar vetëm në një formë të tij, në atë të grupeve të kontrollit punëtor e fshatar; ai duhet ushtruar shumë më gjerë e në format më të ndryshme, duke ngritur në këmbë masat e gjera të punonjësve, duke i edukuar ato me idenë se ato vetë janë zotërit e vendit, që duhet të thonë për çdo gjë e për këdo fjalën e tyre. Në të njëjtën kohë, Partia ka theksuar se grupet e kontrollit punëtor e fshatar nuk mund e nuk duhet të zëvendësojnë kontrollin e organizatave të Partisë, të organeve shtetërore ose të organizatave të masave.

Demokracia socialiste dhe roli i masave është e nevojshme jo vetëm të kuptohen e të zbatohen mirë, por edhe të studiohen më thellë për t'u përsosur vazhdimisht. Qëllimi është që procesi i ndërtimit të socializmit të mos shndërrohet kurrë në një proces burokratiko-administrativ, por të jetë kurdoherë vepër e gjallë e krijuese e masave të gjera punonjëse, nën udhëheqjen e Partisë.

Edukimi i njeriut të ri është një ndër fitoret më të mëdha të socializmit dhe një ndër garancitë themelore për zhvillimin e pandërprerë të tij. Detyrat historike që shtrohen përpara Partisë e popullit tonë për ndërtimin socialist të vendit dhe për të përballuar me sukses rrethimin dhe presionin e botës kapitalisto-revizioniste kërkojnë njerëz të formuar e të kalitur si revolucionarë konsekuentë, të pajisur në një shkallë më të lartë me botëkuptim dhe etikë marksiste-leniniste, njerëz që të jenë në gjendje t'i bëjnë ballë presionit të ideologjive të klasave shfrytëzuese. Kjo kërkon të thellohet më tej lufta ideologjike kundër çdo mbeturine e shfaqjeje të huaj në ndërgjegjen e njerëzve tanë.

Një problem i madh ideologjik ka qenë dhe mbetet lufta kundër mentaliteteve e psikologjisë mikroborgjeze, që ka rrënjë të thella në vendin tonë. Është e vërtetë se transformimet e mëdha social-ekonomike që janë bërë, si dhe puna e gjithanshme e Partisë për edukimin komunist të punonjësve i kanë dhënë goditje të forta dhe e kanë tronditur nga themelet psikologjinë mikroborgjeze. Por, megjithëse sfera e veprimit të saj është ngushtuar shumë, në shtresa të ndryshme të popullsisë ndeshemi ende me mentalitete, qëndrime e veprime mikroborgjeze. Konceptet e prirjet mikroborgjeze janë një e keqe e madhe sepse ato jo vetëm pengojnë edukimin komunist të njerëzve, jo vetëm frenojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në ndërtimin socialist të vendit, por bëhen shkak për gjithfarëlloj lëkundjesh, shërbejnë si bazë për përhapjen e ideologjisë borgjeze dhe për minimin e vetë rendit socialist.

Psikologjia mikroborgjeze shfaqet në forma të ndryshme e në shumë fusha. Më të theksuara mbeturinat e saj shfaqen në qëndrimin ndaj punës e pronës, që zë edhe vendin kryesor e vendimtar në veprimtarinë e njerëzve.

Punonjësit tanë, në fshat e në qytet, i karakterizon një ndërgjegje e lartë në qëndrimin ndaj punës e pronës socialiste. Ky është një tipar dallues i njeriut tonë të ri, është një realitet që spikat kudo. Por socializmi, si fazë e parë e shoqërisë komuniste që del nga rendi shfrytëzues

kapitalist, ka kushtet dhe veçoritë e veta të zhvillimit, të cilat lënë gjurmët e tyre edhe në qëndrimin ndaj punës e pronës. Socializmi, thoshte Lenini,

> «. . . nuk *mund të jetë plotësisht i pjekur nga pikëpamja ekonomike, nuk mund të jetë fare i lirë nga traditat ose gjurmët e kapitalizmit*»[1].

Nga ana tjetër, ka rëndësi të mbahet parasysh edhe futja në prodhimin shoqëror e në sektorë të tjerë e masave të mëdha të të rinjve, të cilët, me gjithë gatishmërinë dhe entuziazmin që kanë për të punuar e krijuar në emër të socializmit, janë ende të paformuar me shprehitë e punës dhe të pakalitur me vështirësitë e jetës.

Këta faktorë, si dhe dobësitë në punën drejtuese, organizuese dhe edukuese të organizatave të Partisë dhe të atyre të masave, të organeve të pushtetit dhe të ekonomisë bëjnë që të vihen re qëndrime të huaja ndaj punës dhe pronës socialiste.

Në një kohë që kemi shumë shembuj të përparuar dhe arritje pozitive, nuk janë të pakta rastet e thyerjes së disiplinës në punë, të mungesave të paarsyeshme, të punës me rendiment të ulët e me cilësi të dobët, të mosshfrytëzimit të plotë të aftësive prodhuese, të dëmtimeve dhe të shpërdorimeve të pronës së përbashkët, të pakujdesive në administrimin dhe ruajtjen e saj.

Këto janë arsyet që Partia ngul këmbë për domosdoshmërinë e ngritjes së nivelit e të efektivitetit të punës propagandistike dhe ideologjike, me qëllim që të forcohet dhe të ngrihet në një shkallë më të lartë ndërgjegjja socialiste e punëtorëve, e kooperativistëve, e kuadrove në qëndrimin e tyre ndaj punës e pronës. Ky ka qenë dhe duhet të jetë një ndër frontet më të rëndësishme të punës së Partisë, të organeve shtetërore e të organizatave të masave, në mënyrë të veçantë të punës së Bashkimeve Profesionale.

Masat që kanë marrë Partia dhe shteti për përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim, për kufizimin e mëtejshëm të oborrit kooperativist, për përmirësimin e sistemit të pagave, të legjislacionit, të planifikimit e të drejtimit të ekonomisë etj., kanë krijuar mundësi e kushte të reja për të ndërmarrë një punë më të gjerë e më të thellë edukative me masat punonjëse, për të rrënjosur në to koncepte e qëndrime të drejta për punën dhe pronën, për të krijuar kudo një atmosferë optimizmi revolucionar e mobilizimi në punë.

Komunistët, kuadrot, punonjësit të bëhen të ndërgjegjshëm se jetojmë në situata të reja, të brendshme e të jashtme, të cilat shtrojnë edhe detyra e kërkesa të reja. Para nesh shtrohet me tërë forcën mobilizimi i gjithë punonjësve për të plotësuar deri në një detyrat e planit. Situatat që kalojmë dhe objektivat e mëdhenj të planit pesëvjeçar kërkojnë një ritëm e angazhim të ri në punë, një ndjenjë më të lartë përgjegjësie dhe një këmbëngulje më të madhe, kërkojnë të ecim me hap më të shpejtë, me hapin që kërkon koha.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 559.

Puna edukative e Partisë duhet të rrënjosë bindje të thella se puna e prona socialiste janë dy shtylla të mëdha në të cilat mbështetet zhvillimi i ekonomisë, i tërë jetës së vendit, e tashmja dhe e ardhmja e tij. Në këtë fushë duhet bërë një luftë frontale dhe e organizuar kundër shfaqjeve negative, kundër çdo koncepti e qëndrimi mikroborgjez e liberal, për të forcuar kudo frymën e organizimit, të rregullit e të disiplinës.

Detyrat për forcimin e ndërgjegjes dhe të psikologjisë socialiste kërkojnë që t'i kushtohet një vëmendje më e madhe njohjes së interesave të ndryshme që ekzistojnë e veprojnë në shoqërinë tonë dhe ruajtjes së raporteve të drejta midis tyre. Engelsi theksonte se marrëdhëniet ekonomike të çdo shoqërie paraqiten para së gjithash si interesa. Prandaj edhe zbatimi i kërkesave të ligjeve ekonomike, edhe forcimi i qëndrimit socialist ndaj punës e pronës nuk mund të kuptohen e të realizohen jashtë interesave të ndryshme dhe, para së gjithash, jashtë interesave ekonomike.

Vënia e interesit të përgjithshëm mbi interesat e grupit dhe ata vetjakë, e interesave të perspektivës mbi ata të çastit, e interesave themelorë të shtetit mbi ata dikasterialë e lokalë, ka përshkuar tejendanë veprimtarinë e Partisë e të shtetit tonë për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit. Kjo ka qenë dhe mbetet garanci për të ecur kurdoherë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste, për të mos lejuar shmangie nga teoria dhe praktika e ndërtimit të socializmit.

Por interesi vetjak në mjaft raste tërheq akoma shumë nga vetja dhe kjo shprehet në prirjet për të marrë nga shoqëria më shumë sesa i jepet asaj, për të rendur pas sasisë në dëm të cilësisë etj.

Nuk ka dyshim se ekzistenca e dallimeve të ndryshme, siç janë ato ndërmjet fshatit e qytetit, dallimet në të ardhurat ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë, si dhe mospërputhjet që lindin midis kërkesave në rritje të masave punonjëse dhe mundësive reale për plotësimin e tyre, ndikojnë në mbajtjen gjallë të fenomeneve të tilla. Por këta faktorë nuk mund të përligjin shfaqjet e ndryshme të vënies së interesit vetjak mbi interesin e përgjithshëm. Në shoqërinë tonë socialiste janë të gjitha mundësitë për t'i kufizuar gjithnjë e më shumë fenomenet e huaja nëpërmjet forcimit të edukimit të masave, zhvillimit të prodhimit dhe përsosjes së marrëdhënieve ekonomike, zbatimit me rreptësi të ligjeve të shtetit.

Kjo është e lidhur, para së gjithash, me faktin që në socializëm interesi i përgjithshëm nuk është në kundërshtim me interesat vetjakë të punonjësve. Kur ne flasim për përparësi të interesit të përgjithshëm, kjo nuk do të thotë aspak injorim i interesave vetjakë. Në socializëm interesi i përgjithshëm nuk realizohet si qëllim në vetvete, por për t'i shërbyer plotësimit të nevojave të ligjshme të punonjësve, mirëqenies së popullit, forcimit të aftësisë mbrojtëse të atdheut. Vija e Partisë zbatohet drejt e me konsekuencë kur ndjekja e problemeve ekonomike dhe kujdesi për interesin e përgjithshëm nuk shkëputen asnjëherë nga shqetësimi për njeriun, nga kujdesi për të plotësuar kërkesat materiale e shpirtërore të tij.

Një problem i madh jo vetëm ekonomik, por edhe ideologjik e shoqëror, është harmonizimi i drejtë i interesave të pronës kooperativiste

me interesin e përgjithshëm të shoqërisë. Partia duhet të luftojë si prirjet që vihen re në disa raste për t'u mbyllur në kuadrin e interesave të grupit dhe për t'i parë ata të shkëputur nga interesat e gjithë shoqërisë, ashtu edhe prirjet që, në emër gjoja të interesit të përgjithshëm, cenojnë interesat e kooperativës.

Ky problem ka të bëjë me marrëdhëniet midis shtetit dhe kooperativave bujqësore, por ai lidhet edhe me procesin e shndërrimit të pronës së grupit në pronë të të gjithë popullit. Prona kooperativiste është e një tipi me pronën shtetërore, të dyja janë socialiste, por megjithatë prona e grupit është një shkallë më e ulët e shoqërizimit të pronës. Nëpërmjet një pune edukative të gjerë e të menduar mirë Partia duhet t'ia bëjë të qartë fshatarësisë kooperativiste karakterin kalimtar të pronës së grupit, si edhe rrugët e shndërrimit të saj në pronë të të gjithë popullit. Procesi i shndërrimit të pronës së grupit në pronë të të gjithë shoqërisë te ne ka filluar dhe në të ardhmen ritmet e tij do të shpejtohen. Por në këtë rrugë duhet ecur gradualisht, në përputhje me krijimin e kushteve objektive e subjektive dhe duke mbajtur parasysh e duke respektuar edhe interesat e pronës së grupit.

Propaganda e Partisë duhet të trajtojë më gjerë dhe më thellë karakterin unik të ekonomisë sonë dhe problemet që e forcojnë më tej këtë karakter. Në këtë kuadër është e nevojshme të bëhet një luftë e vendosur kundër tërheqjes pas interesave të ngushtë dikasterialë, lokalë e të ndërmarrjeve. Pengesat që i sillen specializimit, përqendrimit e kooperimit të prodhimit, si dhe rastet e planifikimit me rezerva të prodhimit, të rendimentit e të uljes së kostos, ose kërkesat e fryra për investime, fuqi punëtore etj., janë shfaqje të interesave të ngushtë, që frenojnë zhvillimin e ekonomisë dhe cenojnë interesat e përgjithshëm të shtetit e të shoqërisë.

Në kushtet kur te ne sunduese është bërë e reja, dukuritë e psikologjisë mikroborgjeze, mbeturinat e së kaluarës, stonojnë gjithnjë e më shumë dhe përbëjnë një pengesë serioze në rrugën tonë socialiste.

Veçori e këtyre mbeturinave është se ato janë tepër rezistente, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pse kushtet që i kanë lindur, kanë ndryshuar rrënjësisht; ato marrin trajta «të reja», kamuflohen pas normave socialiste dhe ringjallen atje ku gjejnë terren të përshtatshëm. Veçanërisht duhet të tërheqin vëmendjen disa zakone e praktika të vjetruara, të cilat, me gjithë goditjet e forta që u janë dhënë, shfaqen akoma në mënyrën e jetesës, në marrëdhëniet familjare, në qëndrimet ndaj gruas etj. Partia dhe levat e saj duhet të punojnë që të forcohen e të konsolidohen parimet e konceptet socialiste, ideologjia e morali proletar, që të mbahet kurdoherë e ndezur fryma e aksioneve dhe e lëvizjeve të mëdha ideologjike të masave, të cilat kanë në themel luftën për çrrënjosjen e çdo mbeturine të vjetër dhe për afirmimin e normave e të zakoneve të reja socialiste. Kjo luftë duhet të zhvillohet me urtësi e zgjuarsi, me qëllim që normat e konceptet e reja të bëhen të pranueshme për ndërgjegjen e të gjithëve.

Për këtë është e nevojshme të njihet thellë psikologjia e masave, të bëhet një punë edukative e kualifikuar dhe e diferencuar sipas shtresave e krahinave, sipas llojit e vendit të punës, kolektivave e sektorëve,

moshave, seksit e deri në njerëz të veçantë. Gjendja shpirtërore e masave njihet mirë jo në mënyrë empirike, por në bazë të studimeve të thelluara e sistematike, duke e analizuar problemin në shumanshmërinë e tij, në gjendjen aktuale e në dinamikën e zhvillimit dhe duke i marrë në tërësinë e tyre faktorët e ndryshëm që ndikojnë në formimin e ndërgjegjes e të psikologjisë së masave, siç janë kushtet materiale, traditat e zakonet e vjetra, zhvillimi i arsimit e i kulturës, bota e jashtme kapitalisto-revizioniste etj.

Në luftën tonë në frontin ideologjik të mos harrojmë për asnjë çast se mbeturinat e së kaluarës pleksen me ndikimet degjeneruese të rrethimit imperialisto-revizionist, të cilat, megjithëse reklamohen si «moderne», «përparimtare», janë në thelb po aq, në mos më shumë, të vjetra e tepër të rrezikshme.

Kundër vendit tonë zhvillohet një agresion i gjerë ideologjik, që synon të denigrojë realitetin e Shqipërisë socialiste dhe të çoroditë mendjet e njerëzve. Partia dhe levat e saj duhet të bëhen barriera të fuqishme e të pakapërcyeshme kundër këtij agresioni dhe ndikimeve të tij mbi njerëzit tanë. Ato duhet të farkëtojnë unitetin ideologjik të popullit, të ngrenë vigjilencën dhe luftën e tij kundër liberalizmit e të gjitha shfaqjeve të huaja, që të mos lejohen të çara, situata qetësie e euforie, që komunistët, kuadrot e gjithë punonjësit t'u përmbahen kurdoherë parimeve e normave socialiste, ideologjisë e moralit proletar.

Lufta kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të ideologjive të huaja, të vjetra e të reja, për edukimin komunist të punonjësve përbën frontin më të gjerë e më kompleks të luftës së klasave që zhvillohet në vendin tonë. Kjo luftë merr një rëndësi e mprehtësi të veçantë në kushtet e sotme, kur vendi ynë ecën përpara në ndërtimin e socializmit duke u mbështetur tërësisht në forcat e veta, kur në arenën ndërkombëtare lufta midis socializmit e kapitalizmit, marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit është ashpërsuar së tepërmi dhe kur rrethimi imperialisto-revizionist dhe presioni i tij mbi vendin tonë janë bërë më të egër.

Partia duhet të punojë pa u lodhur që komunistët, populli dhe brezat e rinj të edukohen vazhdimisht me frymën e diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave, që të jenë kurdoherë vigjilentë e të gatshëm për të mbrojtur socializmin nga çdo armik e rrezik, të luftojnë në ndërgjegjen e tyre, në radhët e Partisë e të popullit kundër gjithçkaje që bie ndesh me frymën dhe parimet e socializmit.

Të zhvillosh drejt luftën e klasave, do të thotë të zbatosh drejt vijën marksiste-leniniste të Partisë, të pranosh me vetëdije e bindje të thellë parimet e socializmit, të punosh e të luftosh kurdoherë për të mirën e popullit e të atdheut, të ruash e të mbrosh socializmin. Kjo do të thotë, gjithashtu, që ta zhvillosh atë pa lejuar devijime nga e djathta ose nga e majta, oportuniste ose sektare, të cilat janë njëlloj të rrezikshme dhe me pasoja të rënda për Partinë, për unitetin e popullit, për shoqërinë socialiste.

Vetëm duke e zhvilluar drejt dhe pa devijime luftën e klasave, me pjesëmarrjen e gjerë të masave punonjëse, të udhëhequra nga Partia, e sotmja do të ndërtohet kurdoherë drejt, do të qëndrojë mbi themele

të shëndosha dhe e ardhmja e atdheut dhe e socializmit do të jetë e siguruar.

Në shërbim të edukimit të komunistëve, të kuadrove dhe të masave Partia ka krijuar një sistem të tërë të mjeteve të komunikimit masiv, siç janë shtypi, botimet, radiotelevizioni, filmi etj. Roli i tyre është i madh, prandaj ato duhet të ngrenë vazhdimisht nivelin e punës së tyre, në përmbajtje e në formë, për t'iu përgjigjur gjithnjë e më mirë kërkesave në rritje të masave punonjëse.

2. Socializmi kërkon njerëz me kulturë të gjerë e dije shkencore

Te ne është bërë një revolucion i vërtetë në nivelin kulturor e profesional të masave punonjëse. Në një vend ku para Çlirimit rreth 90 për qind e popullsisë ishte analfabete, sot më shumë se 67 për qind e punëtorëve kanë arsim 8-vjeçar e të mesëm dhe 32 për qind e tyre kanë kualifikim profesional të mesëm e të lartë; në fshat 52,3 për qind e kooperativistëve janë me arsim 8-vjeçar e të mesëm. Ne kemi tani rreth 47 500 kuadro me arsim të lartë dhe rreth 131 500 me arsim të mesëm e profesional. Megjithëkëtë ngritja e nivelit arsimor, kulturor e tekniko-profesional të punonjësve, si pjesë e pandarë e edukimit komunist, mbetet një nga drejtimet e rëndësishme të veprimtarisë së Partisë dhe të shtetit.

Zhvillimi intensiv i ekonomisë e i kulturës, futja gjithnjë e më gjerë e teknikës dhe e teknologjisë së përparuar, detyrat që shtrohen për rendiment e cilësi më të lartë, për rentabilitet dhe efektivitet më të madh në prodhim, përgjithësisht perspektivat e zhvillimit të vendit në të ardhmen kërkojnë ngritjen e mëtejshme të nivelit arsimor e kulturor, zotërimin e shkencës dhe të teknikës nga njerëzit tanë.

Detyra e Partisë është që të krijojë te të gjithë një kuptim të drejtë për nevojën që ka shoqëria jonë për njerëz të ditur, me horizont të gjerë kulturor, me përgatitje të lartë profesionale, teknike e shkencore, të edukojë te punonjësit ndjenjën e ekzigjencës së lartë ndaj vetes. Kuadrot e punonjësit tanë duhet t'i karakterizojë ndjenja e së resë përparimtare, fryma novatore, pasioni dhe vullneti për të studiuar dhe mësuar vazhdimisht.

Vatra kryesore e përvetësimit të kulturës, të dijeve dhe të shkencës është shkolla jonë e re. Gjatë 15 vjetëve të fundit është ndërmarrë dhe po përballohet me sukses aksioni i madh për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë socialiste. Tashmë janë stabilizuar të gjitha strukturat e reja themelore të këtij procesi. Një punë e gjerë me vlerë është bërë për përpilimin dhe vënien në jetë të programeve të reja mësimore e sidomos për hartimin e teksteve shkollore të të gjitha kategorive.

Përpjekje të mëdha janë bërë për forcimin e përmbajtjes ideologjike e shkencore të shkollës sonë në të tre komponentët e saj, për ndërtimin më racional të mënyrave të transmetimit të dijeve, për të nxitur qëndrimin aktiv e krijues të nxënësve ndaj mësimit etj. Të gjitha këto kanë

bërë që nga shkolla jonë të dalin kontingjente të tëra nxënësish e studentësh me formim më të mirë e më të gjithanshëm, më të brumosur ideologjikisht dhe më të aftë profesionalisht.

Suksese të mëdha janë arritur edhe në masivizimin e të gjitha hallkave të sistemit tonë arsimor. Në tërësi mund të konsiderohen të zgjidhura ose të vëna përfundimisht në rrugën e zgjidhjes shumica dërrmuese e nevojave urgjente të zhvillimit sasior të arsimit. Ne kemi tani një sistem arsimor të aftë për të përballuar kërkesat e sotme dhe të perspektivës në të gjitha fushat.

Tani ka ardhur koha që, pa lënë mënjanë kujdesin e vazhdueshëm për masivizimin e mëtejshëm të arsimit në tërësi e veçanërisht të disa hallkave të tij, të gjitha forcat e frontit tonë arsimor e pedagogjik të përqendrohen në mënyrë më serioze e më të kualifikuar në ngritjen e cilësisë së punës së shkollës. Kjo nevojë diktohet jo vetëm nga zhvillimet e brendshme specifike të arsimit, të shkollës e të pedagogjisë, por, në radhë të parë, nga zhvillimet e përgjithshme, ekonomike, shoqërore, shkencore e teknike të të gjithë jetës së vendit.

Shkolla jonë duhet të pajisë brezin e ri me dije të nivelit bashkëkohor. Në kohën tonë sistemi i dijeve ripërtërihet vazhdimisht e në përpjesëtime të mëdha. Një zhvillim me ritme shumë të shpejta kanë marrë matematika, fizika, kimia, biologjia etj., që përbëjnë themelin teorik të disiplinave të aplikuara të teknikës e të teknologjisë. Është shkurtuar së tepërmi koha që ndan një zbulim shkencor nga përdorimi i tij në veprimtarinë prodhuese. Prandaj është bërë shumë i mprehtë problemi i pasqyrimit më të shpejtë të arritjeve të reja në programet shkollore. Për t'i hapur vend informacionit të ri e të domosdoshëm shkencor, duhet bërë jo një shtim mekanik i vëllimit të njohurive, por ndryshime të aparatit konceptual dhe risistemime të këtij informacioni në struktura më kompakte dhe më universale, që e rritin mjaft peshën e tij specifike dhe e zgjerojnë në mënyrë të ndjeshme fushën e zbatimeve.

Para shkollës sonë, në të gjitha nivelet e saj, qëndron detyra e mënjanimit të njëfarë tradicionalizmi në parashtrimin e disiplinave shkencore bazë, të cilit tanimë i ka kaluar koha. Kjo është një detyrë serioze që nuk duhet të zgjidhet kurrsesi me shartime dhe arnime të së resë mbi të vjetrën, por mbi bazën e një konceptimi tërësor e unik, që të shtrihet në të gjitha vitet e shkollimit, sidomos në hallkat masive të sistemit tonë arsimor. Studimet për këto probleme duhen bërë me kujdes e të menduara mirë, me qëllim që të bëhet me kohë përgatitja për ndryshimet eventuale, që të shmanget çdo element improvizimi në vendimet që do të merren për to, që të përpunohen më imtësisht procedimet didaktike në përputhje me kriteret tona ideologjike, shkencore, pedagogjike.

Organet kompetente të studiojnë me përgjegjësi ngarkesën mësimore të nxënësve e të studentëve, sepse realisht ka mbingarkesë, e cila shkon në dëm të formimit të tyre. Burimet e saj janë koordinimi jo i mirë i ngarkesave të pjesshme të lëndëve të planit mësimor, prirja që shkolla të monopolizojë e të dublojë edhe dhënien e informacionit që sot merret nëpër kanale të tjera, kërkesat e papërligjura për të përvetësuar koncepte e ide jashtë fuqive perceptuese të moshës etj. Në mënyrë të veçantë të tregohet kujdes i posaçëm për përpunimin në nivele të ndry-

shme trajtimit të disiplinave me karakter të mirëfilltë ideologjik, sepse vërehet një shtjellim pak a shumë i njësuar dhe pa shkallëzimet e nevojshme sipas grup-moshave shkollore.

Ngritjes së gjithanshme të cilësisë e të rendimentit të punës mësimore-edukative të shkollës i shërben më mirë edhe forcimi i mëtejshëm i lidhjes së mësimit me jetën, me praktikën, me punën prodhuese jo vetëm në prizmin e edukimit e të kalitjes së brezit të ri, ku ne kemi arritje të konsiderueshme, por edhe në prizmin e integrimit të arsimit e të shkencës me prodhimin e sotëm modern, të vënies së tyre edhe më mirë në shërbim të zgjerimit e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor. Duhet mbajtur gjithmonë parasysh se rinia e sotme që merr një arsim gjithnjë e më solid, është, e në të ardhmen do të jetë edhe më shumë, një forcë pararojë në realizimin e këtij revolucioni.

Forcimi i gjithanshëm cilësor, ngritja e nivelit shkencor, e rendimentit dhe e efikasitetit të të gjithë procesit mësimor-edukativ kërkon të bëhen përpjekje më të mëdha për përmirësimin rrënjësor të metodave të mësimdhënies, në mënyrë që të rritet përvetësimi aktiv i dijeve dhe qëndrueshmëria e tyre, të nxitet mendimi krijues dhe të edukohen shprehitë e punës së pavarur te nxënësit e studentët qysh në bankat e shkollës. Në këtë kuadër është e nevojshme të merren masa konkrete për të fuqizuar bazën materiale laboratorike të shkollës.

Prodhimi ynë, që ka tani një shtrirje shumë të gjerë aktivitetesh, do të pasurohet në të ardhmen edhe me aktivitete të reja. Një ndër shtyllat e tij është armata e madhe e teknikëve të mesëm dhe e punëtorëve të kualifikuar. Prandaj rëndësi e veçantë u duhet kushtuar shkollave të mesme profesionale me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, të cilat përbëjnë 80 për qind të arsimit të mesëm të vendit. Këto shkolla, sidomos ato pa shkëputje nga puna e me profil bujqësor, duhet të konsolidohen plotësisht. Përpara tyre shtrohet detyra që rritjen e formimit teorik të nxënësve të mos e shohin vetëm si një synim që i lejon këta të fundit të ndjekin më lehtë shkollën e lartë, por ta harmonizojnë e ta vënë më mirë në funksion të aftësimit profesional në fushën përkatëse. Hallka që duhet kapur, është formimi i aftësive praktike dhe i intuitës teknike mbi bazën e një horizonti më të gjerë teorik.

Një kujdes i madh i duhet kushtuar përgatitjes së specialistëve të lartë. Ata të jenë të aftë të përballojnë me kompetencë të plotë detyrat e tyre dhe në të njëjtën kohë të jenë të pajisur me imagjinatë shkencore, pa të cilën nuk mund ta çojnë përpara revolucionin tekniko-shkencor në sektorin ku punojnë. Puna e rëndomtë duhet të zërë dhe do të zërë një pjesë gjithnjë e më të vogël të kohës, ndërsa veprimtaria e mirëfilltë studimore, novatore, shkencore të shndërrohet në një preokupim themelor të specialistit të lartë.

Është detyrë e Universitit dhe e shkollave të tjera të larta që këto cilësi t'i kultivojnë te studentët, duke vënë në lëvizje tërë potencialin intelektual të tyre, duke insistuar më fort në aspektin krijues të procesit mësimor-edukativ. Për të realizuar këtë, pedagogët e shkollave të larta duhet të futen thellë në veprimtarinë kërkimore, sepse vetëm një kërkues e ndjek me interes disiplinën që jep dhe është në gjendje ta zbulojë atë para auditorit me pasion të vërtetë.

Zgjerimi i punës shkencore në shkollën e lartë dhe trajtimi nëpërmjet saj jo i temave të vogla, por i problemeve të mëdha të ekonomisë, të prodhimit, të mbrojtjes, të kulturës bëhet i domosdoshëm edhe për zgjerimin e intensifikimin e kualifikimit shkencor pasuniversitar. Kualifikimi i kuadrove dhe i specialistëve të lartë është një çështje për të cilën është e interesuar tërë shoqëria. Ajo ka nevojë që kuadrot të rritin vazhdimisht dijet e tyre, të njohin të rejat e shkencës dhe të teknikës, të mësojnë e të kualifikohen në forma individuale, por dhe të organizuara e të kontrolluara. Ndërtimi i kësaj hallke të re të sistemit arsimor kërkon një punë të madhe e me përgjegjësi nga shkolla e lartë, nga Ministria e Arsimit, si dhe një ndihmë të gjithanshme e shumë të interesuar nga të gjitha dikasteret e tjera.

Arsimi ynë po kalon një proces konsolidimi të arritjeve të mëdha të revolucionarizimit të tij. Për ne mbetet detyrë e përhershme përsosja e vazhdueshme e tërë kompleksit të madh të masave që përbëjnë thelbin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës. Verifikimin e tyre e bën praktika revolucionare, e cila na mëson të korrigjojmë pasaktësitë, të zhdukim të metat, të plotësojmë zbrazëtitë. Shumë gjëra janë ndrequr në dinamikën e përparimit të shkollës sonë. Por zhvillimi i jetës së vendit dhe i vetë arsimit nxjerrin probleme të reja, të cilat duhen studiuar me kujdes në tërë kompleksitetin e tyre dhe pastaj të merren masat e nevojshme e të përshtatshme për t'i zgjidhur.

Një rol vendimtar në realizimin e gjithë këtyre detyrave që shtrohen përpara shkollës, kanë arsimtarët e pedagogët. Ata duhet të punojnë më shumë për ngritjen e tyre ideopolitike e profesionale, për zgjerimin e horizontit të përgjithshëm shkencor e kulturor, për të rritur mjeshtërinë pedagogjike. Të luftohet çdo formalizëm në vlerësimin e punës së tyre, të luftohet fryma e liberalizmit dhe e të kënaqurit me pak. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se shkolla kërkon mund e djersë, kërkon pasion e vullnet, ndërgjegje e disiplinë të lartë.

Në forcimin e punës së shkollës një peshë të madhe ka opinioni i shëndoshë shoqëror, i cili mund të ndihmojë shumë në veprimtarinë e përditshme të shkollës. Rëndësi të posaçme ka kultivimi te rinia e shkollave i motiveve të shëndosha të të mësuarit mbi bazën e idealeve revolucionare.

Përmirësimi i gjithanshëm i punës në arsimin popullor dikton edhe nevojën për përsosjen e për revolucionarizimin e mëtejshëm të metodës e të stilit të punës drejtuese të të gjitha organeve arsimore që nga drejtoritë e shkollave e deri në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës. Kjo kërkon ngritjen e nivelit shkencor të punës drejtuese, zgjidhjen mbi baza më të kualifikuara shkencore të problemeve komplekse të zhvillimit të mëtejshëm të arsimit popullor e të revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës.

Nga ana e tyre, edhe ministritë e institucionet e tjera duhet të merren më mirë me përgatitjen e kuadrove e të specialistëve të mesëm dhe të lartë, të përcaktojnë drejt kërkesat për numrin dhe profilet e tyre, të angazhohen seriozisht në hartimin e planeve, të programeve e të teksteve të shkollës, të kujdesen për organizimin më të mirë të punës prodhuese e të stazhit në punë të nxënësve e të studentëve.

Gjatë pesëvjeçarit të gjashtë artet dhe kultura jonë socialiste morën një zhvillim të mëtejshëm dhe u ngrit në një shkallë më të lartë roli i tyre në të gjithë punën që bën Partia për edukimin komunist të masave punonjëse. Përparime të dukshme u shënuan në forcimin e përmbajtjes dhe në rritjen e cilësisë së veprimtarisë kulturore e artistike. Karakteristika dalluese kryesore e tërë kësaj veprimtarie është partishmëria proletare dhe militantizmi revolucionar. Në këtë mënyrë ajo ndikoi edhe më shumë për forcimin botëkuptimor të njeriut tonë të ri, për edukimin e tij me shije proletare dhe me normat e mënyrës socialiste të jetesës.

Janë krijuar vepra të denja me vlera ideoartistike në letërsi, në artet figurative, në muzikë e kinematografi. Në themel të tyre kanë qenë kurdoherë parimet bazë të realizmit socialist. Është një meritë e veçantë e krijuesve tanë, të cilët kanë luftuar që krahas përmbajtjes socialiste të theksojnë me forcë origjinalitetin kombëtar dhe frymën popullore në veprat e tyre, duke u mbështetur fort në traditat tona më të shëndosha letrare e artistike, duke i pasuruar ato me kërkime e gjetje të reja novatore dhe duke luftuar kundër çdo qëndrimi konservator e liberal, kundër çdo presioni të kulturës së degjeneruar borgjeze e revizioniste.

Letërsia dhe artet tona kanë arritur suksese të rëndësishme edhe në afirmimin e tyre përpara publikut ndërkombëtar. Librat, filmat, ansamblet tona të këngëve e të valleve, si dhe ekspozitat e arteve figurative, gjithmonë e më tepër kanë tërhequr vëmendjen dhe janë çmuar nga njerëzit përparimtarë, të cilët kanë gjetur në to, krahas ideve të përparuara, një frymë të shëndoshë realiste, demokratike e humaniste në kundërshtim me frymën dekadente dhe reaksionare të artit të sotëm borgjez e revizionist.

Vendi ynë është shndërruar në një shkollë të madhe, ku të gjithë njerëzit mësojnë e punojnë, zbukurojnë dhe begatojnë atdheun. Kjo ka bërë që ata të jenë gjithnjë e më shumë në një raport aktiv me kulturën. Njerëzit tanë marrin pjesë gjallërisht në krijimin e vlerave të kulturës materiale e shpirtërore dhe në përdorimin e tyre të vazhdueshëm. Këtu qëndron një nga epërsitë e sistemit tonë socialist ndaj atij kapitalist.

Jeta jonë socialiste u jep kulturës, letërsisë dhe arteve tona më shumë gjallëri, më shumë dinamizëm e freski, i pasuron ato në përmbajtje dhe në formë. Lidhja me jetën e gjallë është i vetmi mjet dhe e vetmja mënyrë për të zbuluar e afirmuar virtytet dhe cilësitë e larta moralo-politike të njerëzve të punës, arritjet dhe veprimtarinë e tyre krijuese. Vetëm kështu vlerat kulturore kthehen në burim frymëzimi e mobilizimi të masave për realizimin e detyrave në fushën e ndërtimit e të mbrojtjes së vendit, krijojnë atmosferën e entuziazmit revolucionar për kapërcimin e vështirësive dhe për arritjen e fitoreve të reja.

Një detyrë e rëndësishme e gjithë krijuesve tanë të letërsisë, të kinematografisë, të arteve figurative, të muzikës etj. është të trajtojnë dhe të pasqyrojnë gjerësisht në veprat e tyre problemet e mëdha të kohës, proceset e zhvillimit dhe dukuritë e reja të jetës. Në artet dhe në letërsi duhet të shtjellohen dhe të propagandohen ato motive të fuqishme, ai heroizëm masiv dhe ata heronj që udhëheqin me shembullin e tyre në jetë, në punë, në shkencë, në shkollë e kudo. Është kërkesë e kohës zgjerimi i gamës së temave të letërsisë dhe të arteve, përfshirja në to përherë e më tepër e gjerësisë dhe e larmisë së jetës, në mënyrë që dalngadalë të kompletohet prej shkrimtarëve dhe artistëve tanë tabloja e madhe e epokës socialiste në Shqipëri. Krijimi i kësaj dëshmie artistike mbetet një detyrë bazë e letërsisë dhe e arteve tona.

Temat e nxjerra nga historia dhe nga periudhat e kaluara janë dhe do të jenë përherë të vlefshme e të domosdoshme për edukimin e njerëzve tanë me dashurinë për atdheun, për traditat e kulturën kombëtare, për të njohur më mirë luftërat e popullit tonë për liri, pavarësi e përparim. Por zhvillimi i letërsisë dhe i arteve nuk mund të kuptohet pa vërshimin sa më të gjerë të jetës dhe të aktualitetit në romanet, poemat, filmat dhe në veprat muzikore e figurative. Duke u mbështetur fort në realitetin ku jetojmë, duke e pasqyruar gjerësisht atë, letërsia dhe artet do të jenë në gjendje që edhe të kaluarën ta pasqyrojnë më mirë, më drejt dhe me nivel më të lartë ideoartistik.

Lufta për forcimin e karakterit dhe të origjinalitetit kombëtar të artit tonë, duhet të shoqërohet përherë me forcimin e frymës socialiste, që i jep tonin gjithë jetës sonë. Afirmimi i asaj që është socialiste, është një kërkesë objektive për konsolidimin e artit të realizmit socialist. Në pasqyrimin e realitetit socialist edhe karakteri kombëtar fiton tipare të reja cilësore, zhvillohet e ngrihet në një shkallë të re më të lartë.

Partia ka theksuar se mbështetja e arteve tona në artin popullor është një faktor i rëndësishëm për shëndoshjen dhe ruajtjen e frymës popullore e kombëtare të krijimtarisë së kultivuar. Por duhet të ruhet gjithmonë një raport i drejtë në marrëdhëniet midis artit të kultivuar dhe atij popullor, të mos abuzohet me dhënien e përparësisë njërit ndaj tjetrit, sepse ashtu siç është e dëmshme shkëputja e artit të kultivuar nga ai popullor, po ashtu është e dëmshme edhe vënia e barazisë midis tyre dhe kthimi i artit të kultivuar në një imitim të thjeshtë të artit popullor.

Pasqyrimi i realitetit socialist dhe trajtimi më i gjerë i kësaj teme, i problemeve tipike dhe themelore të shoqërisë sonë janë të lidhura ngushtë me rritjen e cilësisë. Përmbajtjes së shëndoshë, tematikës revolucionare duhet t'u përgjigjet një formë dhe një nivel i lartë realizimi artistik. Nuk mjafton të kapësh temën e ditës, të shkruash për heroin pozitiv, për realitetin socialist etj. Vetëm kjo, pa mjeshtërinë artistike, nuk mund të të emocionojë, të të edukojë dhe të të frymëzojë për të sotmen e për të ardhmen. Rritja e cilësisë në artet është një kërkesë që vjen nga rritja e niveleve kulturore dhe e shijeve estetike të masave të gjera punonjëse, nga kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë sonë.

Detyrat e mëdha që shtrohen për zhvillimin e letërsisë dhe të arteve kërkesat për formimin e vazhdueshëm botëkuptimor e kulturor të forcave krijuese, sidomos të talenteve të reja. Shkrimtarët dhe artistët krijojnë një art me vlera të larta kur njohin thellë jetën e popullit, historinë dhe psikologjinë e tij, kur përvetësojnë marksizëm-leninizmin dhe mësimet e Partisë, kur jetojnë intensivisht me problemet e kohës. Në këtë drejtim roli i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve është i madh. Ajo duhet të mbetet kurdoherë një qendër frymëzimi dhe edukimi për forcat krijuese. Objekt kryesor i kujdesit të saj të jetë krijimtaria e shkrimtarëve dhe e artistëve, rritja e përmbajtjes dhe e cilësisë së veprave të tyre.

Edhe institucionet e tjera kulturore e artistike, Radiotelevizioni, shtëpitë dhe institucionet botuese, teatrot dhe Kinostudioja kanë për detyrë të forcojnë kontrollin dhe të rritin kërkesat për cilësi, me qëllim që t'i japin popullit krijimtarinë më të mirë. Ato duhet të luftojnë për të mënjanuar pasqyrimin e cekët, pa forcë dhe pa mendim të thellë të realitetit, shfaqjet e skematizmit, të uniformitetit dhe të kuptimit të thjeshtësuar të dukurive dhe të problemeve të jetës së sotme.

Detyrat e institucioneve kulturore-artistike janë të shumta dhe të gjithanshme. Në punën e tyre për ngritjen e kulturës së masave ato duhet t'i kushtojnë një kujdes të veçantë edhe përhapjes më të gjerë të dijeve dhe të njohurive të ndryshme, organizimit më të mirë të informacionit tekniko-shkencor, zgjerimit të propagandës së prodhimit e të përvojës së përparuar, duke siguruar një bashkëveprim më të gjerë me organizatat e masave, me specialistët e kuadrot, me punonjësit pararojë të prodhimit. Krahas librit politik dhe atij artistik, më shumë kujdes t'u kushtohet botimit të librave teknikë e shkencorë, të manualeve dhe të enciklopedive, që mund të shfrytëzohen gjerësisht nga specialistët e ndryshëm, si dhe botimeve shkencore popullore për përdorim masiv.

Një vend i vërtetë socialist duhet të dallohet gjithnjë e më shumë edhe nga niveli i lartë kulturor i njerëzve, edhe nga bota e pasur shpirtërore e tyre, edhe nga shijet e shëndosha estetike, edhe nga mënyra e jetesës. Formimi i koncepteve të drejta për mënyrën socialiste të jetesës është një detyrë e rëndësishme e punës arsimore, kulturore e edukative që zhvillohet në vendin tonë.

E rëndësishme është të kuptohet gjerë e thellë se kultura e jetesës ka të bëjë me njeriun gjatë gjithë jetës së tij. Ajo ka të bëjë me mënyrën e të ushqyerit, të higjienës e të veshjes, me mjediset e banesës e të prodhimit. Kultura, letërsia e bashkë me to ambientet e prodhimit e të shërbimit publik ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e shijeve të masave. Ato rritin interesimin e tyre për të bukurën në punë, në jetë e në natyrë, forcojnë luftën si kundër shijeve borgjeze e revizioniste, ashtu edhe kundër atyre vulgare.

Detyra të reja të rëndësishme dalin sidomos për përhapjen e kulturës në fshat. Ngritja e mëtejshme e nivelit kulturor të fshatarësisë ndikon drejtpërdrejt në përparimin e gjithanshëm të vetë fshatit, në ngushtimin e dallimeve midis tij dhe qytetit. Për përhapjen e kulturës në fshat përveç shtrirjes, forcimit dhe shfrytëzimit më me efektivitet të rrjetit të institucioneve kulturore dhe përmirësimit të përbërjes së kuadrit të tyre, një rol të rëndësishëm luan ndihma e qytetit, aktivizimi i inteligjencies dhe kujdesi i organizatave të masave. Veçanërisht shkollat në fshat duhet të shndërrohen në vatra të vërteta për përhapjen e kulturës masive, të traditave patriotike-revolucionare, për gjallërimin e jetës artistike, për edukimin dhe përgatitjen e talenteve të reja.

Zhvillimi dhe përparimi i kulturës është zhvillim dhe përparim i kombit. Ndërmjet tyre ka një lidhje të ngushtë dialektike. Engelsi ka thënë se historia tregon që çdo hap i ri përpara në rrugën e kulturës ka qenë një hap drejt lirisë. Kjo ka rëndësi të kuptohet thellë nga organet e Partisë dhe të pushtetit në bazë, nga gjithë punonjësit e fron-

tit të kulturës. Sa më i lartë të jetë kuptimi për rëndësinë e punës kulturore, aq më shumë do të lidhen ata me problemet e kësaj veprimtarie. Organizimi i ndihmës dhe i kontrollit nga organet e Partisë e të pushtetit duhet të forcohet, në radhë të parë, për problemet e drejtimit dhe të planifikimit, të përmbajtjes, të efektivitetit dhe të vlerave edukative që sjell veprimtaria kulturore e artistike.

Në sukseset e mëdha që ka arritur populli ynë në ndërtimin socialist të vendit, një kontribut të veçantë ka dhënë edhe shkenca jonë e re. Kjo është shtrirë në fusha të reja të palëvruara më parë, ka ngritur nivelin e studimeve dhe tani është në gjendje të marrë përsipër detyra më të vështira e të zgjidhë probleme më të mëdha, t'u përgjigjet më mirë kërkesave që shtron para saj zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës.

Njerëzit tanë të shkencës e të teknikës sot studiojnë, projektojnë dhe zbatojnë tërësisht me forcat e veta të gjitha veprat për të cilat ka nevojë ekonomia dhe mbrojtja, siç janë veprat hidroenergjetike, hekurudhat, puset e shpimeve të thella, fabrikat e pasurimit të mineraleve dhe shumë objekte të tjera të rëndësishme industriale. Janë zbuluar dhe vënë në shfrytëzim pasuri të mëdha të nëntokës, të cilat tani përbëjnë bazën themelore për zhvillimin e industrisë e të tërë ekonomisë së vendit. Hapa të mirë janë bërë për zgjidhjen e problemeve të shumta teknike e teknologjike të prodhimit. Nga pjesët e ndërrimit tani është kaluar në prodhimin e makinerive të plota. Në fushën e bujqësisë studimet dhe eksperimentimet janë bërë faktorë të rëndësishëm për rritjen e rendimenteve dhe për përmirësimin e racave. Realizime me vlerë ka pasur edhe në shkencat shoqërore, historike, gjuhësore, ekonomike, politike etj.

Por stadi i arritur i zhvillimit të vendit dhe detyrat e mëdha që kemi përpara, shtrojnë si një nevojë të ngutshme zhvillimin e shkencës, vlerësimin e saj të drejtë dhe zbatimin e arritjeve të saj në prodhim. Kjo nevojë bëhet edhe më imperative në kushtet e sotme të zhvillimit të vendit vetëm me forcat tona, kur ekonomia dhe gjithë sektorët e veprimtarisë shoqërore janë futur në rrugën intensive dhe kur kudo kërkohet punë me cilësi, rendiment dhe efektivitet të lartë.

Këto ishin arsyet që Partia në një Plenum të posaçëm vitin e kaluar analizoi gjithë veprimtarinë shkencore në vendin tonë, duke nxjerrë konkluzione dhe duke përcaktuar detyra të veçanta jo vetëm për punonjësit e shkencës, por për gjithë organizatat e komitetet e Partisë, organet shtetërore e ekonomike të vendit. Detyrat që shtroi dhe orientimet që dha Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror përbëjnë një program të madh pune për sot e për të ardhmen. Tani tërë puna duhet përqendruar në luftën këmbëngulëse për vënien në jetë të këtij programi.

Objektivi kryesor i gjithë punës studimore shkencore është që të mbështesë si duhet pesëvjeçarin e shtatë për të siguruar realizimin e plotë të tij. Krahas kësaj, detyrë dhe objektiv me rëndësi i shkencës sonë është që qysh tani të fillojë nga kryerja e studimeve për pesëvjeçarin e ardhshëm. Shkenca, që të jetë shkencë, që ta luajë me të vërtetë rolin e saj dhe të kryejë funksionin e vet, duhet t'i paraprijë prodhimit, të tregojë qysh më përpara perspektivën e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës. Vetëm mbi këtë bazë ajo mund të ndihmojë si planifikimin, ashtu edhe prodhimin.

Duke pasur mirë parasysh detyrat aktuale e të perspektivës, kujdes i madh i duhet kushtuar përvetësimit të arritjeve bashkëkohore dhe lëvrimit të atyre shkencave të cilat zbatohen në fusha me rëndësi jetike për ne, që kushtëzojnë përparimin e vendit me ritme të shpejta dhe fuqizojnë pavarësinë e plotë të tij.

Forcat dhe mjetet kryesore duhet të përqendrohen në studimin e pasurive tona natyrore e në radhë të parë në kërkimin dhe zbulimin e mineraleve të dobishme. Shkenca jonë duhet të gjejë rrugët më të mira për të shtuar burimet energjetike dhe për përdorimin racional të tyre, për një shfrytëzim sa më kompleks dhe integral të të gjithë përbërësve të dobishëm të lëndëve të para, për kosto sa më të ulët dhe cilësi sa më të lartë të prodhimit.

Objektiv i rëndësishëm i punës shkencore duhet të jetë zgjerimi i studimeve në fushën e konstruksioneve mekanike dhe të përsosjes së teknologjive të prodhimit e të mekanizimit të proceseve të punës, në fushën e projektimit dhe të ndërtimit të veprave të ndryshme industriale, hidroteknike e civile etj.

Me rëndësi të veçantë janë studimet në lëmin e bujqësisë, sidomos ato që kanë të bëjnë me ruajtjen, shtimin dhe përmirësimin e tokës, me rritjen e aftësive gjenetike të farërave e të racave, me përmirësimin e agroteknikës, me mbrojtjen e bimëve e të kafshëve.

Për kushtet e vendit tonë ne duhet të ngulim këmbë në aplikim. Në këtë fushë të përqendrohet, në radhë të parë, puna kërkimore-shkencore. Këtu të angazhohen edhe forcat kryesore shkencore-teknike. Kjo nuk do të thotë që të lihen mënjanë shkencat fondamentale, të cilat përbëjnë themelin teorik të shkencave të aplikuara e të teknikës moderne. Detyra që shtrohet është të njihen e të përvetësohen rezultatet dhe metodat e përparuara të këtyre shkencave për t'i vënë sa më mirë në shërbim të prodhimit dhe për të siguruar një përgatitje të shëndoshë teorike të specialistëve tanë.

Në të gjitha fushat e shkencës, por sidomos në ato të aplikuarat duhet të ngremë cilësinë e punës studimore shkencore dhe efektivitetin e saj. Çdo studim që kryhet të jetë i plotë, fazat e ndryshme të tij të përbëjnë një tërësi të vetme, duke filluar nga studimi i përgjithshëm, eksperimentimi, projektimi dhe deri në zbatim. Studimet teknike e teknologjike duhet të shoqërohen edhe me studime ekonomiko-financiare, me qëllim që të evidentohet leverdia ekonomike dhe efektiviteti i shpenzimeve.

Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor në të gjitha fushat ka vënë në lëvizje masa të mëdha njerëzish, ka nxitur një interesim të vërtetë për të përvetësuar më thellë dijet shkencore e për të eksperimentuar. Mbi të gjitha ai ka forcuar besimin e kuadrove e të punonjësve tanë në aftësitë dhe në mendimin e tyre krijues. Tani janë krijuar mundësitë që, krahas rritjes sasiore e cilësore të racionalizimeve e novacioneve, të kalohet gradualisht në një front më të gjerë përmirësimesh e transformimesh më të mëdha, që të sjellin ndryshime më rrënjësore në dobi të prodhimit, të pajimit teknik, të konceptimeve teknologjike apo formave organizative jo vetëm në reparte e fabrika të veçanta, por edhe në degë të tëra. Për këtë duhet të rritet më tej roli aktiv

dhe efektiviteti i shkencës, e cila të zhvillohet jo vetëm në institucionet kërkimore-shkencore, por të zhvillohet e të zbatohet gjerësisht në terrenin konkret, në uzina, kombinate, në fusha, kudo ku prodhohen të mira materiale.

Përparimi i shkencës kushtëzohet shumë nga planifikimi më i saktë e më largpamës i saj në përputhje me nevojat e vendit në të gjitha hallkat e punës kërkimore-shkencore, nga organizimi dhe bashkërendimi i mirë i veprimtarisë së institucioneve të ndryshme, nga ngritja e një baze materialo-laboratorike të përshtatshme dhe të mundshme për vendin tonë, nga përgatitja, kualifikimi i vazhdueshëm dhe angazhimi me efektivitet të lartë i specialistëve të fushave të ndryshme.

Akademia e Shkencave mbetet qendra më e madhe e më e rëndësishme e kërkimeve shkencore në vendin tonë. Partia i ka vënë asaj detyrën që, krahas konsolidimit të institucioneve të saj shkencore ekzistuese, të zgjerojë veprimtarinë e saj edhe në fusha të tjera, sidomos në ato natyrore e teknike, që i shërbejnë më drejtpërdrejt zgjidhjes së problemeve të mëdha të prodhimit.

Krijimi i Komitetit të Shkencës dhe Teknikës këtë vit është një masë e rëndësishme që mori Partia për drejtimin dhe organizimin më të mirë të punës studimore-shkencore. Është detyrë e tij që të bashkërendojë më mirë gjithë veprimtarinë shkencore të vendit dhe të ndihmojë për vënien në zbatim të rezultateve të saj.

Një kujdes e interesim më të madh për zhvillimin e shkencës duhet të tregojnë të gjitha organet shtetërore nga baza deri në qendër. Veprimtarinë shkencore këto duhet ta konsiderojnë si pjesë përbërëse të pandarë të punës së tyre, për planifikimin, organizimin, drejtimin e ekonomisë, të kulturës e të gjithë jetës së vendit.

Zhvillimi dhe përparimi i shkencës ndihmohet kur jetohet më afër veprimtarisë shkencore dhe njerëzve që merren me të, kur tërhiqet mendimi i specialistëve dhe përkrahet e reja, kur luftohen pengesat dhe zvarritjet burokratike që vihen re disa herë në kryerjen e studimeve dhe sidomos në vënien e tyre në jetë.

Objekt themelor i punës së organizatave të Partisë duhet të jetë kujdesi për zbatimin e politikës së Partisë në fushën e shkencës, që veprimtaria kërkimore e studimore të përqendrohet në problemet e mëdha aktuale e të perspektivës, që kuadrot shkencorë të armatosen me botëkuptimin marksist-leninist e me mësimet e Partisë.

IV

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E RPSSH

Partia e Punës e Shqipërisë ka ndjekur dhe ndjek me vëmendje zhvillimin e situatave ndërkombëtare dhe ngjarjet që ndodhin në botë. Ajo i ka analizuar ato në mënyrë objektive e realiste, e bazuar si gjithnjë në parimet marksiste-leniniste, dhe ka nxjerrë konkluzione përkatëse. Në gjithë këtë punë Partia është nisur nga fakti se proceset e

sotme botërore, në këtë ose në atë masë, ushtrojnë ndikimin e tyre edhe mbi vendin tonë. Ne i ndjekim dhe i analizojmë me një interesim të veçantë situatat ndërkombëtare për të mos u zënë kurrë në befasi, për të qenë gjithmonë të përgatitur që të përballojmë me sukses çdo rrezik që mund të na vijë nga jashtë, për të ndërtuar me sukses socializmin. Nga ana tjetër, kjo përbën një kusht edhe për të zbatuar drejt e në mënyrë efektive detyrën tonë internacionaliste në përkrahje të luftës së popujve për liri e pavarësi kombëtare, për demokraci e përparim shoqëror, për të kontribuar në forcimin e paqes e të sigurisë ndërkombëtare.

Parë në tërësi, gjendja e sotme ndërkombëtare është e turbullt, e ndërlikuar dhe mjaft e nderë. Forca të mëdha politike e shoqërore qëndrojnë kundër njëra-tjetrës: nga njëra anë imperializmi, kapitalizmi dhe reaksioni, bartës të shtypjes, të shfrytëzimit e të luftës, dhe, nga ana tjetër, popujt, revolucionarët e demokratët, që luftojnë për çlirimin kombëtar e shoqëror, për emancipimin e njerëzimit. Ky konfrontim i gjerë, i thellë dhe i gjithanshëm, që është pasqyrim i ndeshjeve të ashpra klasore dhe që ka përfshirë tërë kontinentet pa përjashtim, ka acaruar më tej të gjitha kontradiktat dhe krizën e rëndë që ka mbuluar botën e sotme kapitaliste. **Çdo gjë tregon se situata e sotme në botë është e mbarsur me luftë të përgjithshme dhe me luftëra lokale, siç është e mbarsur me luftëra çlirimtare e me revolucion.** Zhvillimi i ngjarjeve do të tregojë nëse imperializmi do të mund ta çojë botën në një katastrofë të re, apo popujt do ta ndalojnë luftën dhe do ta shpëtojnë njerëzimin.

Në këtë situatë lufta e popujve dhe revolucioni qëndrojnë në rendin e ditës jo vetëm si aspiratë dhe detyrë imediate për çlirimin nga shtypja kapitaliste e zgjedha imperialiste, por edhe si domosdoshmëri historike për shkatërrimin e planeve luftënxitëse të imperializmit dhe për mënjanimin e një lufte të re të përgjithshme.

Imperializmi ka qenë dhe mbetet burimi i të gjitha agresioneve e luftërave grabitqare, shkaku i të gjitha fatkeqësive e mjerimeve që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në botë. Popujt e kanë paguar me gjakun dhe jetën e tyre etjen e pangopur të imperialistëve për pushtime e shfrytëzim, për sundim botëror. Këtë karakter të pandryshueshëm të imperializmit, të natyrës e të qëllimeve të tij e dëshmon edhe lufta që zhvillohet sot midis superfuqive imperialiste dhe fuqive të mëdha kapitaliste për tregje dhe zona influence.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik janë në ndeshje me njëri-tjetrin, janë në garë e në lëvizje për të kryer agresione e për të pushtuar vende të tjera. Në shumë rajone të botës lufta midis dy superfuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, pa përjashtuar edhe Kinën imperialiste dhe fuqitë e tjera kapitaliste, ka marrë përmasa të reja e të mëdha. Secila nga këto fuqi përpiqet të arrijë epërsi ekonomike, politike, ushtarake mbi tjetrën, të zërë pozita strategjike të reja. Megjithëse zjarri i luftës botërore akoma nuk është ndezur, zjarret lokale që kanë shpërthyer dhe vatrat e rrezikshme që tashmë janë krijuar mund të kthehen në një zjarr të madh të luftës botërore imperialiste. Lindja e Mesme e përsëri Indokina dëshmojnë fare qartë për këtë. Ky rivalitet, kjo politikë e superfuqive, i ndërlikon më tej situatat dhe bën që tërë raportet botërore të jenë të ndera dhe me pasoja të rrezikshme.

Sigurisht, kur konstatojmë se rivaliteti midis superfuqive dhe acarimi i kontradiktave midis tyre përbën burimin kryesor të konflikteve të sotme ndërkombëtare dhe të rrezikut të luftës, nuk mund të mos vëmë re edhe përpjekjet e tyre për të rënë në kompromise, ujdira e deri në aleanca të përkohshme. Tendencës për ndeshje e konflikte midis imperialistëve i është përgjigjur gjithnjë edhe përpjekja për t'u marrë vesh në kurriz të popujve.

Por midis shteteve imperialiste nuk mund të ekzistojë kurrë atmosfera e besimit reciprok. Për shkak të natyrës së tyre agresive ata do të veprojnë hapur dhe fshehur kundër njëri-tjetrit. Kjo është dialektika e marrëdhënieve midis imperialistëve.

Deri më sot superfuqitë janë përpjekur për ruajtjen e njëfarë ekuilibri ndërmjet tyre, për respektimin e zonave reciproke të influencës, për të ecur me një hap në garën e armatimeve. Ata kanë bërë përpjekje për mënjanimin e një lufte të drejtpërdrejtë ndërmjet tyre, por tani, si rezultat i krizës dhe i zhvillimit të pabarabartë, ky ekuilibër ka tendencë të prishet.

Ekspansioni i tyre nuk gjen më hapësira boshe ku të mund të shtrihet. Çdo hap i mëtejshëm ndesh në interesat e tjetrit me rrezikun e një reagimi që nuk mund të parashikohet. Këtej lindin disbalancimet, këtej lindin rreziqet për konfrontime të armatosura, që mund ta çojnë njerëzimin në një luftë të përgjithshme imperialiste.

Dikur u bë e mundur të nënshkruhej traktati për mospërhapjen e armëve atomike, që u siguronte Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik monopolin e këtyre armëve, bile të nënshkruhej edhe SALT-i, që vendoste ekuilibrin e dy superfuqive në këto armë. Tani të dy palët janë rrëmbyer nga ethet e armatimit të papërmbajtur, që ua kanë marrë mendjen dhe ua kanë humbur logjikën. Megalomania dhe arroganca e superfuqive, që mendojnë se mund të bëjnë ligjin në botë pa u ndëshkuar, është përzier me frikën ndaj njëra-tjetrës dhe me tmerrin që u kall revolucioni.

Interesat e superfuqive e të popujve nuk përputhen e nuk takohen në asnjë kohë dhe në asnjë rast. Që të jetojë imperializmi popujt duhet të jenë të skllavëruar, që të çlirohen popujt duhet të shkatërrohet imperializmi.

Është shumë e rrezikshme dhe duhet luftuar deri në fund ajo politikë e klasave reaksionare që, për të ruajtur pushtetin e vet e për të mashtruar masat, mbështeten te njëri ose te tjetri shtet imperialist, duke e paraqitur njërin të mirë e tjetrin të keq, njërin përkrahës të popujve e tjetrin armik të tyre, njërin mbrojtës të paqes e tjetrin nxitës të luftës. Superfuqitë, secila më vete dhe të gjitha së bashku, janë armiqtë më të egër të lirisë e të pavarësisë së popujve, mbrojtësit e garantët e regjimeve reaksionare, përkrahësit e zgjedhës së huaj kombëtare dhe të grindjeve e të konflikteve ndërmjet kombeve. Politika e tyre përbën rrezikun e drejtpërdrejtë për ta hedhur njerëzimin në një luftë të tretë botërore.

Prandaj, si në të kaluarën, ashtu edhe tani, lufta e të gjitha forcave revolucionare, përparimtare e demokratike për demaskimin e shkatërrimin e planeve grabitqare e skllavëruese të superfuqive imperialiste është një domosdoshmëri historike, është një kusht e detyrë për mbrojtjen e lirisë e të sovranitetit të popujve, për fitoren e revolucionit, për mënjanimin e luftës dhe sigurimin e paqes.

Në një mënyrë ose në një tjetër, në këtë ose në atë formë të gjithë popujt ndeshen me ndërhyrjen dhe kërcënohen nga politika agresive e imperializmit amerikan, që përfaqëson fuqinë më të madhe kapitaliste të kohës sonë dhe mburojën kryesore të sistemit borgjezo-imperialist. Që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, kur ai doli në krye të fuqive imperialiste dhe u bë pretendenti kryesor për sundimin botëror e deri më sot, imperializmi amerikan ka bërë të derdhet si lumë gjaku i popujve që ai ka sulmuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet veglave të tij të bindura. Në çdo proces kundërrevolucionar që ka ndodhur në botë, në çdo puç fashist e përmbysje të demokracisë, në çdo sulm kundër revolucionit e socializmit ka qenë kurdoherë e pranishme dora e imperializmit amerikan. Është ky imperializëm që ndërhyrjen në punët e brendshme të vendeve të tjera, arbitraritetin dhe diktatin i ka bërë një praktikë të zakonshme në jetën ndërkombëtare, që agresionin e kërcënimin për agresion i ka shndërruar në një politikë bazë, në një veprimtari të përhershme të tij.

Kapitali amerikan është grabitësi më i madh dhe më i pangopur i pasurive e i djersës së popujve që ka njohur ndonjëherë historia. Shoqëritë kapitaliste amerikane, që kanë shtrirë kthetrat e tyre në tërë globin, shkelin në mënyrën më barbare sovranitetin e kombeve dhe bëjnë ligjin në shumë vende. Bashkë me eksportimin e kapitaleve imperializmi amerikan ka eksportuar edhe mënyrën e tij të jetesës, korrupsionin e degjenerimin, frymën e kozmopolitizmit dekadent dhe të nënshtrimit servil ndaj të huajve.

Imperializmi amerikan e ka mbushur globin me baza ushtarake, të cilat janë pikat mbështetëse kryesore të luftës e të agresionit. Ai ndjek politikën e forcimit të blloqeve ekzistuese dhe ngritjen e blloqeve të reja ushtarake, nëpërmjet të cilave siguron sundimin amerikan mbi partnerët e tij, kërcënon të mbytë me hekur e me zjarr revolucionin dhe luftën e popujve, mbron me forcë sistemin e shtypjes e të dhunës kapitaliste.

Aktualisht imperializmi amerikan ka filluar të zbatojë një vijë më të ashpër, më agresive e më aventuriste në politikën e tij të jashtme. Ai po mbështetet gjithnjë e më shumë në forcën ushtarake. Për këtë dëshmon qartë politika e re e Reganit.

Imperializmi amerikan kërkon tani që tërë reaksioni e forcat kundërrevolucionare botërore të bashkohen në një kryqëzatë të vetme e nën egidën amerikane kundër revolucionit, socializmit, lirisë, pavarësisë e sovranitetit të popujve, kundër të drejtave demokratike të njerëzve. Duke i konsideruar si «zona të interesave amerikane» gati të gjitha zonat ku nxirren nafta dhe lëndët e para kryesore, të gjitha rrugët detare të oqeaneve, të gjitha pikat strategjike të globit dhe duke shpallur zyrtarisht se do të ndërhyjë me armë për t'i mbrojtur këto «interesa»,

imperializmi amerikan del hapur me një program konkret për shtrirjen e pushtetit të tij politik e ushtarak në të gjithë botën. Krijimi i «korpusit të ndërhyrjes së shpejtë», të kësaj armate të madhe agresive, të gatshme për të ndërhyrë kudo që do ta nisë Pentagoni për të vendosur me hekur e me zjarr sundimin e Shteteve të Bashkuara, është një provë e pakundërshtueshme e këtij kursi.

Kjo vijë shprehet edhe në «doktrinën» e re të Uashingtonit, të nisur nga Karteri e të zhvilluar më tej nga Regani, se gjoja paqja në botë dhe sigurimi i popujve mund të arrihen me anë «të rritjes së fuqisë dhe të epërsisë amerikane». Në të vërtetë kjo «doktrinë» e nxit dhe e afron më tepër luftën e përgjithshme imperialiste. Grumbullimi i pashembullt i armëve të ndryshme, që nga ato klasike e deri te bombat atomike prej qindra megatonësh, nxitja e frymës militariste, mobilizimi total për të arritur me çdo kusht epërsinë ushtarake mbi rivalin sovjetik po krijojnë në qarqet udhëheqëse amerikane konceptin se lufta është jo vetëm e pashmangshme, por edhe e domosdoshme.

Të gjitha këto tregojnë se bota do të ndeshet me një intensifikim të politikës agresive të imperializmit amerikan, me një shtim të ndërhyrjeve të tij në punët e brendshme të vendeve të tjera, sidomos të përdorimit të forcave të tij ushtarake.

Në këto kushte çdo lëshim e tërheqje përpara imperializmit amerikan, çdo iluzion se politika e tij mund të ndryshojë për të mirë përmban në vetvete rreziqe të mëdha për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e popujve.

Politika hegjemoniste e ekspansioniste për vendosjen e sundimit botëror, kursi aventurist i përgatitjes dhe i nxitjes së luftës karakterizon sot edhe socialimperializmin sovjetik, strategjia globale e të cilit, e sidomos mënyrat e zbatimit të saj, janë bërë, gjithashtu, më agresive.

Duke filluar me pushtimin e Çekosllovakisë e gradualisht, politika e Bashkimit Sovjetik ka ardhur duke marrë një karakter të theksuar militarist, që shprehet në përdorimin e forcës ushtarake për realizimin e qëllimeve të veta ekspansioniste. Ndërhyrjet ushtarake pasuan njëra-tjetrën. Pas Çekosllovakisë erdhën Angola, Jemeni, Etiopia, Eritrea, ku sovjetikët ndërhynë nëpërmjet të tretëve. Më së fundi erdhi Afganistani. Afganistani shënon fillimin e marshimit të madh të socialimperializmit drejt Jugut, ku gjenden burimet më të mëdha energjetike të botës, nyjet më të rëndësishme strategjike, fushat ku ndeshen e përplasen rivalitetet më të mprehta imperialiste.

Politika e Bashkimit Sovjetik ka marrë po ato tipare agresive, ekspansioniste, luftënxitëse si ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo duket qartë në objektivat e njëjtë që kanë zgjedhur dhe në rrugët paralele në të cilat ecin. Bashkimi Sovjetik po kërkon baza ushtarake në vendet e huaja, po krijon aleanca politiko-ushtarake me vende të tjera, për t'i pasur si pika mbështetëse të zgjerimit të sundimit të tij mbi popujt dhe të ndeshjes me imperializmin amerikan. Po ashtu ai nuk qëndron prapa as në garën e armatimeve. Sovjetikët disponojnë tashmë një arsenal të madh ushtarak, të cilin po e rritin dhe po e perfeksionojnë vazhdimisht në përgatitjet që bëjnë për shpërthimin e luftës. Ekonomia

sovjetike e militarizuar është vënë në shërbim të realizimit të planeve pushtuese të kësaj superfuqie të re imperialiste.

Të gjitha këto kanë bërë që Bashkimi Sovjetik të demaskohet në sytë e popujve si një fuqi e egër imperialiste, që kërcënon e rrezikon hapur lirinë dhe pavarësinë e tyre.

Megjithëkëtë, në njerëz e në disa forca politike në vende të ndryshme, ekzistojnë akoma iluzione ndaj Bashkimit Sovjetik, ekziston një përfytyrim i gabuar për rendin e tij dhe një mirëbesim naiv ndaj politikës së tij. Kjo vjen jo vetëm nga fakti se Bashkimi Sovjetik spekulon shumë me të kaluarën e tij socialiste dhe se politikën e rivalitetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shet si politikë antiimperialiste, por edhe për mjaft arsye të tjera. Kryesorja ndër to është se ekspansioni sovjetik kryhet përgjithësisht nëpërmjet depërtimit në lëvizjet antiimperialiste e çlirimtare, nëpërmjet instrumentalizimit dhe shfrytëzimit të tyre në dobi të vet. Faktet kanë treguar se viktima të këtij ekspansioni janë bërë jo vetëm ata që kanë besuar në «ndihmën internacionaliste» të Bashkimit Sovjetik, por edhe ata që kanë besuar se mund të mbështetesh te «ndihma» sovjetike e aleanca me të për të kundërshtuar ose për t'u çliruar nga imperializmi amerikan e nga imperializmat e tjerë.

Në mënyrë të veçantë duhet demaskuar demagogjia pacifiste e Bashkimit Sovjetik, parullat hrushoviane të «bashkekzistencës paqësore», propaganda mashtruese revizioniste, e cila përpiqet të bindë popujt se evitimi i luftës dhe sigurimi i paqes, bile edhe pavarësia kombëtare e transformimet shoqërore qëndrojnë tek e ashtuquajtura detantë midis superfuqive. Popujt nuk janë për rritjen e tensionit, për acarimin e konflikteve, për përdorimin e forcës në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare. Por e ashtuquajtura detantë, që predikojnë revizionistët sovjetikë, nuk ka të bëjë aspak me garantimin e paqes e të sigurisë ndërkombëtare, që kërcënohen pikërisht nga dy superfuqitë imperialiste.

Detanta, e trumbetuar nga revizionistët sovjetikë e të tjerë, nuk është gjë tjetër veçse teoria e vjetër imperialiste e ekuilibrit dhe e harmonisë midis fuqive të mëdha. Teoritë e «detantës», të «ekuilibrit» ose të «bipolarizmit», që janë të njëjta në përmbajtje, me gjithë ndonjë nuancë në formë, synojnë të garantojnë zonat reciproke të influencës, të ngrenë në ligj ndërkombëtar diktatin e superfuqive në punët botërore, nënshtrimin e plotë e të pakushtëzuar të vendeve të tjera ndaj dy super të mëdhenjve, braktisjen e interesave dhe të sovranitetit të tyre kombëtar.

Politika imperialisto-revizioniste e luftës, e shtypjes dhe e shfrytëzimit ka ndeshur në rezistencën e madhe të proletariatit dhe të popujve të botës. Popujt i kuptojnë intrigat, manovrat, strategjinë, taktikat e superfuqive të egra, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik revizionist dhe nuk rrinë duarlidhur.

Bota sot është dëshmitare se lufta e klasës punëtore dhe e popujve të shtypur e të shfrytëzuar nga kapitali botëror e imperializmi ka marrë përpjesëtime të gjera dhe forma të larmishme, të papara ndonjëherë. Klasa punëtore dhe të gjithë të shfrytëzuarit, në një mënyrë ose në një tjetër, me më pak ose me më shumë intensitet, luftojnë kundër të

gjitha forcave sunduese kapitaliste, vendase ose ndërkombëtare, që i shfrytëzojnë, i varfërojnë dhe i shtypin ekonomikisht e moralisht.

Në të gjitha vendet kapitaliste është zgjeruar rezistenca e klasës punëtore ndaj sulmeve të borgjezisë dhe lufta e saj për mbrojtjen e nivelit të jetesës dhe të të drejtave demokratike. Grevat, demonstratat e manifestimet jo vetëm janë shpeshuar, por pjesëmarrja e punëtorëve në to ka arritur shifra të panjohura më parë. Me miliona janë punëtorët grevistë në SHBA, në Angli, në RFGJ, në Itali, në Francë, në Spanjë e gjetkë. Këto greva e manifestime po marrin një karakter gjithnjë e më shumë luftarak. Këtë e vërteton edhe fakti që në mjaft vende të Evropës e të Amerikës aparatet borgjeze të dhunës janë detyruar të përdorin armët dhe të përleshen me punëtorët, përveç marrjes së masave të tjera kufizuese e shtypëse. Janë shtuar rastet kur punëtorët nuk u binden sindikatave borgjeze dhe dalin në rrugë kundër dëshirës dhe urdhrave të bosëve sindikalistë.

Lufta e punëtorëve në periudhën e tanishme është drejtuar sidomos kundër pasojave të krizës ekonomike, barrën e së cilës borgjezia kërkon t'ia hedhë klasës punëtore. Kundër kësaj padrejtësie e grabitjeje të re janë ngritur masat punonjëse, të cilat kërkojnë që kjo barrë të mos bjerë mbi to, por mbi padronët. Ato luftojnë për ruajtjen e vendeve të punës dhe të nivelit të pagave reale, kundër inflacionit dhe shtrenjtësimit të jetesës, për shtimin e fondeve të destinuara për shëndetësinë, arsimin, asistencën sociale etj.

Në këtë ndeshje të përditshme ndërmjet klasës punëtore dhe borgjezisë zbulohet e demaskohet edhe demagogjia sociale e politike e kapitalizmit, oportunizmi dhe veprimtaria sabotuese e socialdemokracisë, e revizionizmit dhe e sindikatave të drejtuara prej tyre. Ky zemërim dhe kjo revoltë, që po godet në forma dhe me intensitet të ndryshëm borgjezinë kapitaliste e revizioniste, është një goditje e drejtpërdrejtë dhe e fuqishme edhe kundër forcave të errëta të luftës, që kërkojnë shkatërrimin e njerëzimit.

Klasa punëtore në vendet kapitaliste e revizioniste sot mbahet e mbërthyer nga shumë zinxhirë që shteti borgjez dhe partitë e ndryshme i kanë hedhur asaj përsipër. Por kjo gjendje nuk mund të vazhdojë përjetë. Acarimi i kontradiktave midis punës e kapitalit, përgjithësisht shtypja kapitaliste e imperialiste e shpejtojnë rritjen e ndërgjegjes politike e klasore të proletariatit dhe e bëjnë atë të ndërgjegjshëm se shpëtimi nga shtypja e shfrytëzimi mund të arrihen vetëm me luftë klasore, vetëm me revolucion.

Krahas rritjes dhe zgjerimit të luftës së klasës punëtore, aktualisht vihet re një zgjim i përgjithshëm i popujve të shtypur, një forcim i ndjenjave kombëtare dhe një dëshirë më e madhe për të qenë të lirë, të pavarur e sovranë. Lëvizjet çlirimtare të popujve janë rritur në gjerësi e cilësi, është forcuar karakteri i tyre antiimperialist, antisocialimperialist dhe antineokolonialist.

Një grusht i rëndë për imperializmin ishte lufta e popullit iranian, i cili u ngrit në revolucion dhe fshiu me fshesë të hekurt shahun e regjimin e tij mesjetar, flaku jashtë padronët e tij amerikanë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës pësuan në Iran një disfatë të madhe politike,

të cilën nuk janë në gjendje ta riparojnë jo vetëm me rrugë diplomatike e me shantazhe ekonomike, por as edhe me ndërhyrje ushtarake, siç tentuan dhe dështuan në Tabas. Në Iran imperializmi amerikan humbi një burim nafte nga më të rëndësishmit, humbi fitime kolosale, humbi besimin si protektor i pathyeshëm tek «aleatët» arabë të Gjirit Persik. U lëkund kompromisi egjiptiano-izraelit i Kemp Dejvidit, lindën mosmarrëveshje të hapëta dhe të nënujshme me partnerët e NATO-s.

Përmasa më të mëdha dhe një intensitet më të fuqishëm ka marrë lufta e popujve arabë kundër pushtuesve izraelitë dhe padronëve të tyre amerikanë. Në qendër të kësaj lufte qëndron populli heroik palestinez, i cili në kushte jashtëzakonisht të vështira po zhvillon prej dhjetëra vjetësh një betejë titanike për të rifituar atdheun e tij të mohuar, për të siguruar të drejtat e tij, që të jetojë i lirë e i pavarur në tokën e vet amtare. Me trimëri e guxim lufton populli i Afganistanit kundër socialimperialistëve sovjetikë e shërbëtorëve të tyre vendas për të rifituar pavarësinë e vet kombëtare.

Popujt e Amerikës Latine po ndeshen e po gjakosen me diktaturat fashiste që mbahen në fuqi me ndihmën e drejtpërdrejtë të imperializmit amerikan. Lëvizja revolucionare e çlirimtare atje po rritet e po thellohet dhe në mjaft raste arrin të mposhtë armiqtë e të dalë fitimtare. Dëshmi më e afërt janë fitorja e revolucionit në Nikaragua, që përmbysi një nga regjimet më reaksionare, siç ishte ai i Somozës, shpërthimi i revolucionit në Salvador etj. Në «oborrin e prapmë» të Shteteve të Bashkuara po fryjnë furtuna të mëdha, të cilat nuk mund të ndalen as me armë e as me dollarë.

Edhe kontinenti afrikan nuk është i qetë. Njëri pas tjetrit, në sajë të një lufte të gjatë e këmbëngulëse, shumica dërrmuese e vendeve afrikane fituan pavarësinë shtetërore. Edhe popullsia zezake e Zimbabves, nëpërmjet luftës së armatosur, mundi të fitojë të drejtat e saj, që ia mohonte një pakicë reaksionare kolonialistësh të vjetër. Por akoma mbetet pa u çliruar Namibia dhe populli i Afrikës së Jugut, i cili vazhdon të jetojë në segregacion dhe pa asnjë të drejtë. Popujt e Afrikës as janë pajtuar e as mund të pajtohen me racizmin. Ekzistenca e tij fyen e indinjon tërë popujt afrikanë.

Luftërat nacionalçlirimtare të popujve, gjaku i popujve që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e tyre, pasqyrojnë urrejtjen dhe zemërimin kundër shfrytëzimit kapitalist e zgjedhës imperialiste. Ato vërtetojnë tezat e Leninit për imperializmin si kapitalizëm në kalbëzim, si prag i revolucioneve proletare. Ato vërtetojnë se imperializmi shkon drejt gremisës, se ai nuk është më në gjendje të ndalë vrullin revolucionar të popujve që guxojnë të ngrihen kundër tij dhe që nuk kanë frikë nga presionet, kërcënimet e ndërhyrjet imperialiste, qofshin këto edhe me armë.

Acarimi i gjendjes ndërkombëtare dhe rritja e rrezikut të luftës bëhen edhe më të mprehta për shkak të krizës së rëndë ekonomike, politike, ideologjike që ka përfshirë sot botën kapitaliste e revizioniste. Kriza e tanishme ekonomike është shprehja më e qartë dhe më konkrete e thellimit të krizës së përgjithshme të kapitalizmit. Në krahasim me atë të viteve 30-të, që përfshiu sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e mëdha të zhvilluara, kriza e sotme ka futur në vorbullën e

saj të tëra vendet kapitaliste, pa përjashtim, të zhvilluara ose të pazhvilluara qofshin. Këtë shtrirje e këtë thellësi asaj ia kanë dhënë disa faktorë të rinj të zhvillimit të sistemit kapitalist pas Luftës së Dytë Botërore, siç janë: rritja e mëtejshme e koncentrimit dhe e ndërkombëtarizimit të kapitalit, vendosja e sundimit gati të plotë të dollarit në sistemin financiar botëror, zgjerimi i veprimtarisë së shoqërive shumëkombëshe dhe pesha gjithnjë në rritje e tyre në prodhimin botëror, rritja tej çdo kufiri e shpenzimeve inproduktive, sidomos për armatimet.

Në lindjen dhe zhvillimin e krizës së sotme kanë ndikuar, bile në një masë të madhe e vendimtare, luftërat klasore e çlirimtare, dobësimi i përgjithshëm i pozitave të imperializmit, që erdhi si rezultat i shkatërrimit të sistemit kolonial dhe i daljes në dritë të dhjetëra e dhjetëra shteteve të reja, të cilat në këtë ose në atë shkallë luftojnë për arritjen e pavarësisë së plotë politike dhe ekonomike.

Si të gjitha krizat e tjera, kjo e sotmja është krizë e superprodhimit, është pjellë dhe një fenomen i pashmangshëm i sistemit kapitalist. Kjo krizë, ndryshe nga të tjerat, po vazhdon për një kohë të gjatë dhe nuk po duken shenja të daljes prej saj.

Ekonomia kapitaliste vazhdon të ndodhet në stanjacion, në disa vende ka rënie të mëtejshme ose ndonjë rritje pa rëndësi. Eksportet në shkallë botërore, për shkak të ngushtimit të tregjeve, janë në rënie. Kapacitetet prodhuese në vendet e mëdha të industrializuara shfrytëzohen gjithnjë e më pak. Papunësia në këto vende ka arritur në 25 milionë veta. Inflacioni ngrihet vazhdimisht.

Si çdo krizë tjetër, por më tepër kjo e tanishmja provoi se sistemi borgjez, pavarësisht nga format e jashtme që mund të marrë gjatë zhvillimit të tij, nuk mund të sigurojë një rritje të harmonishme të ekonomisë, nuk mund të sigurojë punë e bukë për të gjithë punonjësit, nuk mund të evitojë katastrofat ekonomike dhe shkatërrimin e forcave prodhuese e të pasurisë kombëtare të krijuara me djersën dhe gjakun e punonjësve.

Kriza e sotme është kriza dhe dështimi i kapitalizmit shtetëror monopolist. Mekanizmi i rregullimit shtetëror monopolist të ekonomisë jo vetëm u tregua i paaftë për të mënjanuar krizat, por u shndërrua edhe në një faktor tjetër të shtimit të vështirësive ekonomike. U vërtetua kështu se ndërhyrjet e shtetit monopolist dhe programimi kapitalist nuk janë në gjendje të zhdukin konkurrencën, të sigurojnë zënien e plotë me punë të popullsisë dhe të mënjanojnë pengesat për riprodhimin e zgjeruar shoqëror.

Me krizën e tanishme mori një goditje të rëndë modeli i shoqërisë kapitaliste të «konsumit». Bashkë me të falimentuan edhe teoritë ekonomike të kapitalizmit të sotëm, të përhapura e të zbatuara në të gjitha vendet e mëdha kapitaliste e nga të cilat u frymëzuan edhe një numër vendesh revizioniste për reformat e tyre ekonomike.

Kriza e tanishme tregoi qartë kalbëzimin jo vetëm të sistemit kapitalist të formës klasike, por edhe të kapitalizmit të formës që sundon në Bashkimin Sovjetik, të kapitalizmit monopolist shtetëror dhe të superstrukturave të tij. As kjo formë kapitaliste sundimi e shfrytëzimi të punonjësve nuk i mënjanoi dot tronditjet në ekonomi, çrregullimin e

forcave prodhuese, rënien e prodhimit, uljen e nivelit të jetesës së masave punonjëse, zgjerimin e plagëve që krijon shoqëria borgjeze.

Në qoftë se do të bënim një karakterizim të përgjithshëm të ekonomisë së sotme kapitaliste e revizioniste botërore, do të thoshim se ajo gjendet në një amulli që degradon gjithnjë e më shumë raportet e brendshme shoqërore dhe marrëdhëniet midis shteteve. Ajo që duket më shumë është intensifikimi i një sulmi të përgjithshëm ndaj nivelit të jetesës së punonjësve dhe të drejtave të tyre. Pothuajse në të gjitha vendet po shkurtohen në mënyrë drastike shpenzimet për shëndetësinë, arsimin, ndihmat për fëmijët, pensionet etj.

Krahas keqësimit të gjendjes ekonomike të punonjësve, në pjesën më të madhe të vendeve kapitaliste po rriten kërkesat për qeveri «të fortë», me qëllim që t'i imponojnë popullsisë masat antipunëtore dhe të përmbajnë hovin e luftës klasore në rritje. Në disa vende kryhen puçe ushtarake, ka terrorizëm dhe anarkizëm, të organizuar nga qeveritë borgjeze kapitaliste në fuqi, ka kontrabandë kolosale, vjedhje të organizuara në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, ka një zhvillim të pakufishëm e të llahtarshëm të korrupsionit politik, moral e fizik. Fashizmi po troket në portat e mjaft vendeve.

Në të gjitha drejtimet e në të gjitha aspektet kriza e sotme provoi se analiza e Marksit për kapitalin dhe konkluzionet e Leninit për imperializmin mbeten jo vetëm të drejta, por edhe bazë themelore shkencore për të kuptuar proceset e sotme shoqërore të botës kapitaliste dhe tendencat e zhvillimit të tyre.

Kriza ekonomike dhe kursi agresiv i superfuqive kanë ashpërsuar të gjitha kontradiktat midis fuqive imperialiste, kanë goditur rëndë blloqet dhe aleancat e tyre. Marrëdhëniet ekonomike, politike dhe ushtarake në grupimet e ndryshme imperialiste e revizioniste janë tronditur. Pjesëtarët e grupimeve perëndimore e lindore po përpiqen të shfrytëzojnë të çara të ndryshme dhe të gjejnë arsye për të mos iu përmbajtur angazhimeve, traktateve e marrëveshjeve që ekzistojnë midis tyre. Konflikteve e rivaliteteve të vjetra u janë shtuar të reja. Kjo duket më hapur sidomos në bllokun perëndimor.

Politika amerikane e kërbaçit të madh kundër popujve shoqërohet edhe me një shtrëngim të fortë të vidhave ndaj partnerëve dhe klientëve të tij. Imperializmi amerikan kërkon nga Evropa, nga Japonia e e nga Kina jo vetëm bashkëpunim në të gjitha fushat, por edhe nënshtrim të plotë. Ai përpiqet t'u diktojë aleatëve të tij të NATO-s që të rritin buxhetet ushtarake, të pranojnë vendosjen në territoret e tyre të raketave të reja amerikane «Pershing» e «Kruiz», të mos dalin me një politikë më vete, të mos flirtojnë me Bashkimin Sovjetik ose me arabët. Por situata e sotme në botë dhe gjendja e vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk është më ajo e kohës së Trumanit dhe të planit Marshall.

Sot raporti i fuqisë politike dhe ekonomike të Shteteve të Bashkuara, në krahasim me atë të Evropës Perëndimore, vjen duke rënë. Konkurrenca nga ana e Tregut të Përbashkët dhe e Japonisë është bërë shumë e fuqishme dhe mjaft kërcënuese. Në qoftë se më 1950 prodhimi industrial i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte baras

me 2/3 e atij botëror, sot është 1/3 e tij. Në qoftë se në atë kohë SHBA dispononin 50 për qind të rezervave monetare botërore, sot kanë vetëm 7 për qind të tyre. Lidershipi i imperializmit amerikan është dobësuar shumë dhe pranohet me vështirësi.

Pjesëtarët evropianë të NATO-s tani e kanë organizuar dhe kanë forcuar potencialin ekonomik brenda dhe jashtë vendeve të tyre, kanë fuqizuar arsenalin e vet ushtarak dhe kanë krijuar organizmin e tyre reaksionar, Tregun e Përbashkët Evropian. Tendenca e tij është të kundërshtojë sa të jetë e mundur diktatin amerikan, të frenojë ekspansionin në tregjet e vendeve anëtare të tij, të konkurrojë tregun amerikan dhe të zgjerojë tregjet e veta. Qëndrimi prej shteteve të mëdha të Evropës Perëndimore ka filluar në shkallë të gjerë të rikrijojë e të forcojë zonat e veta të influencës.

Strategjia e monopoleve evropiane synon shndërrimin e Evropës në fillim në një superfuqi ekonomike, pastaj politike dhe më vonë edhe ushtarake. Por këto janë edhe fushat ku ajo do të ndeshet e do të përleshet me superfuqitë e me fuqitë e tjera imperialiste.

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës një gur shumë i favorshëm në tabelën e shahut të gjendjes aktuale është Kina dhe tok me të edhe Japonia. Vërtet Kina është partnere më e dobët se «Evropa e Bashkuar», por ajo ka më tepër nevojë për Amerikën dhe është në një armiqësi të madhe me Bashkimin Sovjetik. Për këtë arsye imperializmi amerikan ka vendosur t'i japë Kinës armatime të shumta, duke përfshirë edhe ato ofensive. Në të njëjtën kohë ai bën presion mbi Japoninë që kjo të rritë buxhetin ushtarak, ushtrinë dhe armatimet e saj.

Tanimë në Lindjen e Largme ka marrë formë një aleancë e re imperialiste ndërmjet Shteteve të Bashkuara, Japonisë dhe Kinës, që përbën një rrezik tjetër për shpërthimin e luftërave lokale e të luftës së përgjithshme. Përveç imperializmit amerikan, i cili hapësirat e gjera të Oqeanit Paqësor i ka konsideruar si zona të padiskutueshme të influencës së vet, me pretendime hegjemoniste tani ka dalë edhe Japonia, superfuqi ekonomike dhe me dëshira të reja perandorake. Synime të tilla në këtë zonë ka edhe Kina, që ëndërron të bëhet sundimtare e vetme e Azisë dhe e Oqeanisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga ana e tyre përpiqen që tendencat e Kinës e të Japonisë për ekspansion t'i drejtojnë nga Bashkimi Sovjetik.

Për të përballuar dhe për t'iu kundërvënë frontit amerikano-kino-japonez në Azi, Bashkimi Sovjetik përpiqet të futet në Afrikë, në Lindjen e Mesme, në Pakistan, në Indokinë e mundësisht edhe në Indi, ndërsa në Evropë ai kërkon të mbajë një «detantë» me Tregun e Përbashkët dhe ndjek një politikë për çarjen e fronteve. Me fjalë të tjera ai bën të gjitha përpjekjet që të dobësojë rrethimin e vet, të përçajë bllokun luftarak që përgatitet e zhvillohet në të dy krahët e tij, në Evropë e në Azi, të sigurojë pozita dominuese strategjike për një luftë eventuale. Por edhe Evropa, për të cilën Bashkimi Sovjetik përbën një kërcënim të madh, nuk do që të rrezikohet. Ajo është e gatshme të vërë të tjerët, sidomos frontin kino-japonez, që të ndeshet me Bashkimin Sovjetik dhe të nxjerrë për të gështenjat nga zjarri.

Për më tepër ajo ka edhe problemet e saj të brendshme, që ia lidhin shpesh duart e këmbët. «Evropa e Bashkuar» në vetvete nuk është e bashkuar. Problemeve të shumta të saj dhe kontradiktave që e brejnë Tregun e Përbashkët parlamenti i Strasburgut nuk u jep dot zgjidhje. Grindjet, rivalitetet, interesat e kundërta të çdo shteti, po shtohen aq tepër saqë vënë në rrezik vetë ekzistencën e këtij Tregu.

Kontradiktat e mosmarrëveshjet janë ashpërsuar shumë edhe brenda së ashtuquajturës bashkësi socialiste. Në situatat e vështira në të cilat ndodhet për vete Bashkimi Sovjetik, ai nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat e vendeve aleate për një zhvillim normal të ekonomive të tyre. Këto vende, që janë kthyer prej vitesh në shtojca të ekonomisë sovjetike, janë të detyruara t'u nënshtrohen uljeve e ngritjeve, kapriçove të saj.

Përkime e grindje ka edhe për shkak të tendencës së vendeve satelite për t'u afruar e për të bashkëpunuar me Perëndimin. Bashkimi Sovjetik përpiqet ta pengojë këtë afrim dhe t'i mbajë vendet e Evropës Lindore të lidhura me zinxhirë pas vetes së vet. Për këtë qëllim ai përpiqet me të gjitha mënyrat të forcojë Traktatin e Varshavës, KNER-in, organizmat e tjerë të integrimit ekonomik e politik, të fuqizojë garnizonet e tij ushtarake në këto vende etj. Kur nuk ia arrin me të mirë, ai vepron me anën e tankeve, siç bëri më 1968 në Çekosllovaki.

Për gjendjen e rëndë në «bashkësinë socialiste» dhe për kontradiktat e thella që e brejnë atë dëshmojnë më së miri ngjarjet e kohëve të fundit në Poloni, që e kanë çuar këtë vend në buzën e katastrofës ekonomike dhe në tronditje të mëdha shoqërore e politike. Këto janë pasojë e vijës së ndjekur nga partia revizioniste polake për rivendosjen e kapitalizmit, e nënshtrimit të gjithanshëm të vendit ndaj Bashkimit Sovjetik, e hapjes së dyerve për kapitalet perëndimore, janë pasojë e borxheve të mëdha të Polonisë, që kapin shumën kolosale prej 27 miliardë dollarësh. Këtu e kanë burimin edhe revoltat e klasës punëtore dhe të punonjësve polakë.

Revolta e punëtorëve në Poloni vërtetoi dy çështje kapitale e me rëndësi parimore. Ajo tregoi se forca e klasës punëtore është në gjendje të shkatërrojë një pushtet reaksionar, qoftë ky revizionist ose kapitalist.

Nga ana tjetër ajo dëshmoi se faktori subjektiv, forca politike që udhëheq klasën punëtore, luan një rol vendimtar. Në rastin e «Solidarnostit» klasa punëtore manipulohet dhe drejtohet nga kisha katolike dhe reaksioni polak e botëror, të cilët luftojnë për të vendosur, nëpërmjet një rruge plot me rreziqe e të papritura tragjike, një regjim tjetër revizionist — kapitalist. Në të kundërtën, në rast se faktori subjektiv do të ishte një parti e vërtetë komuniste marksiste-leniniste, klasa punëtore polake do të kryente një revolucion proletar dhe do të vendoste diktaturën e proletariatit.

Rruga e shpëtimit të klasës punëtore dhe të popullit të Polonisë, si dhe të të gjitha vendeve të tjera revizioniste nga shfrytëzimi kapitalist dhe nga shtypja e huaj nuk është as pajtimi me regjimin revizionist në fuqi dhe me skllavërinë e socialimperializmit sovjetik, as ba-

shkimi me kapitalin dhe me reaksionin perëndimor. Lufta e hapur dhe e vendosur e masave popullore, nën udhëheqjen e klasës punëtore, me një parti të vërtetë marksiste-leniniste në krye, është rruga e vetme për të siguruar edhe zhvillimin e ekonomisë, edhe lirinë e pavarësinë e vendit, edhe rivendosjen e socializmit.

Acarimi i kontradiktave ndërmjet fuqive imperialiste si dhe me partnerët e tyre në blloqet ushtarake dhe ekonomike çon gjithnjë e më shumë në tensione e konflikte të reja, në luftëra me karakter lokal e të përgjithshëm për rindarjen e tregjeve, të burimeve të lëndëve të para e të zonave të influencës. Ky është një ligj i zhvillimit të kapitalizmit.

Por kontradiktat dhe konfliktet ndërimperialiste shkaktojnë edhe dobësimin e sistemit imperialist në tërësi e në hallka të veçanta të tij. U takon forcave të ndërgjegjshme revolucionare që situatat e krijuara nga këto kontradikta të dinë t'i shfrytëzojnë për të mobilizuar masat, për t'i bërë të ndërgjegjshme dhe për t'i hedhur në luftë e në revolucion.

Aktualisht në një krizë të rëndë ka hyrë edhe sistemi neokolonialist i krijuar nga imperializmi pas Luftës së Dytë Botërore. Për të ruajtur sundimin e tyre politik dhe ekonomik, për të siguruar shfrytëzimin maksimal të pasurive të vendeve ish-koloniale, për të frenuar rritjen e lëvizjes liridashëse e çlirimtare të popujve imperialistët janë përpjekur të gjejnë e të përdorin forma të reja shtypjeje e skllavërimi, gjithnjë më mashtruese e më të sofistikuara.

Nëpërmjet sistemit të kredive, huave, ndihmave e fondeve të ndryshme ata i kanë kthyer këto vende në borxhlinj të përhershëm dhe të varur nga mëshira e kreditorëve, që për paratë e dhëna u kërkojnë jo vetëm tapitë, por edhe shpirtin. Bashkë me kreditë e ndihmat kanë hedhur rrënjë shoqëritë shumëkombëshe, që janë bërë jo vetëm koncesionarë monopolistë të shfrytëzimit të minierave, të naftës, të energjisë elektrike, të tregtisë me shumicë, të komunikacionit etj., por edhe qendra politike me të cilat lidhen grupet e ndryshme të pushtetit në vend. Bankat e mëdha me emra tërheqës, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Fondi Evropian i Zhvillimit etj., janë shndërruar në shtabe të neokolonializmit ndërkombëtar për sundimin dhe shfrytëzimin e vendeve të reja. Janë këto qendra financiare e politike që, së bashku me shoqëritë shumëkombëshe, organizojnë e nxitin grushtet e shtetit, rrëzojnë qeveritë dhe vënë të tjera, shkaktojnë edhe luftëra lokale kur e kërkon interesi i kapitalit të madh. Këto konflikte janë kthyer në një biznes të madh për shitjen e armëve dhe në një poligon të gjallë provash.

Por, krahas këtij shfrytëzimi të egër e të gjithanshëm, në strukturat ekonomike e shoqërore të vendeve ish-koloniale kanë ndodhur edhe disa ndryshime, të cilat janë rezultat i investimeve, i futjes së teknikës e të teknologjisë së re, i zgjerimit të komunikacionit e të ndërlidhjes etj., që imperialistët u detyruan të bëjnë për të grabitur më shumë e më shpejt pasuritë e mbitokës e të nëntokës. Kjo ka sjellë edhe krijimin e shtresave të reja shoqërore vendase, si të borgjezisë kombëtare, të punëtorëve të kategorive të ndryshme dhe të një inteligjencie të re

të domosdoshme për të punuar në sektorët ekonomikë, politikë, administrativë.

Zhvillimi u hapi sytë shumë njerëzve të këtyre shtresave, sidomos të inteligjencies së re, të cilët nuk pajtohen më me format dhe metodat që përdoren për shtypjen dhe për shfrytëzimin e popujve të tyre.

Ndërgjegjja kombëtare e revolucionare është rritur kudo. Kjo duket qartë edhe në zgjerimin e lëvizjes së vendeve e të forcave të ndryshme, që luftojnë për vendosjen e sovranitetit kombëtar mbi pasuritë e veta, për rivlerësimin e lëndëve të para e energjetike, për shkëmbime të barabarta e me përfitim reciprok në tregtinë ndërkombëtare, për ndryshimin e sistemit monetar ndërkombëtar të vendosur nga imperializmi, për kufizimin dhe mënjanimin e pushtetit ekonomik monopolist të shoqërive shumëkombëshe etj. Kjo lëvizje ka thelluar krizën aktuale ekonomike, veçanërisht krizën energjetike e të lëndëve të para, që ka përfshirë botën kapitaliste e revizioniste.

Fuqitë e mëdha kapitaliste, me naftën që u kanë grabitur popujve të tjerë dhe me blerjet e lëndëve të para me çmime të lira, kanë ngritur perandoritë e tyre industriale. Harxhimi parazitar dhe i pakontrolluar i burimeve energjetike e i lëndëve të para botërore ka krijuar gjendjen e sotme kritike në këtë sektor themelor të zhvillimit të ekonomisë së çdo vendi.

Energji dhe lëndë të para ka, por ato nuk gjenden më me çmime të lira. Fuqitë e mëdha imperialiste e kapitaliste tani nuk janë në gjendje të sundojnë plotësisht mbi burimet e lëndëve të para dhe të diktojnë çmimet e tyre. Presionit për çmime të ulëta të naftës e të lëndëve të para i kundërvihet rezistenca e vendeve prodhuese, që janë zgjuar dhe mbrojnë interesat e tyre, që kërkojnë të zhvillohen, të bëjnë investime në industri, në bujqësi e në sektorë të tjerë të ekonomisë kombëtare.

Rezistenca dhe lufta e popujve të sunduar nga neokolonializmi për mbrojtjen e të drejtave të tyre, të pasurive dhe të sovranitetit kombëtar është një proces i pandalshëm, i cili do të rritet e do të zhvillohet më tej në të ardhmen.

Këtë rrezik imperializmi dhe sistemi i tij i shtypjes e i shfrytëzimit neokolonialist po e ndien thellë, prandaj bën të gjitha përpjekjet, ku me demagogji e mashtrim e ku me forcë, për ta shtypur këtë lëvizje, për t'i topitur tehun e saj përparimtar e revolucionar, për ta devijuar e për ta futur në rrugë pa krye. Nga ana tjetër, për të mashtruar popujt e vendeve të shtypura e të varura dhe për të mbajtur gjallë me çdo kusht sistemin e kalbur neokolonialist, mbrojtësit e tij përpiqen të krijojnë në opinionin e përgjithshëm botëror përshtypjen se këto vende janë plotësisht të lira e sovrane, se kanë të drejtë të thonë fjalën e tyre «të pavarur» në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, bile edhe të mos jenë në një mendje e të kundërshtojnë superfuqitë.

Imperalizmi stimuloi dhe nxiti krijimin e lëvizjeve e të teorive të ndryshme që e krijonin këtë përshtypje. E tillë është edhe lëvizja e «të paangazhuarve». Baza e saj ka qenë predikimi i mosmarrjes pjesë në blloqe politike e ushtarake dhe i mbrojtjes së interesave të

vendeve të pazhvilluara ekonomikisht nga politika e superfuqive. Por tani, kur rivaliteti midis superfuqive është shtuar, kur kriza i ka ngushtuar fushat e manovrimit, duket qartë se një pjesë e madhe e vendeve «të paangazhuara» po bashkohen me njërën ose me tjetrën superfuqi. Bashkë me përçarjen e lëvizjes e me konfliktet e shumta midis vendeve të ndryshme të ashtuquajtura të paangazhuara, ranë edhe teoritë demagogjike të sajuara me shumë zor nga liderët e ndryshëm që kanë dashur të bëhen udhëheqës dhe ideologë të kësaj lëvizjeje, sidomos ata jugosllavë. Tani ajo ka mbetur një lëvizje e papërcaktuar, fluide dhe e ndryshueshme, që ndizet e shuhet sipas koniunkturave që krijohen dhe interesave të superfuqive.

Në një kohë doli si një teori në mbrojtje të neokolonializmit dhe veçanërisht të sundimit amerikan në botë edhe teoria kineze e «tri botëve». Por ajo u shkri si kripa në ujë. Karta e saj u dogj shumë shpejt. Partia jonë e demaskoi dhe e goditi këtë teori reaksionare e kundërrevolucionare.

Vitet e fundit po bëhet një propagandë e madhe rreth atij që e quajnë «rend i ri ekonomik ndërkombëtar», i cili duhet të zgjidhë morinë e madhe të problemeve që proekupojnë sot vendet e pazhvilluara ekonomikisht, siç janë ato të industrializimit, të ushqimit, të transformimit të strukturave të prodhimit etj. Rreth këtij «rendi të ri» janë krijuar edhe teori të ndryshme, janë paraqitur skema e projekte të tëra, janë ndërmarrë aksione konkrete, siç janë i ashtuquajturi dialogu Veri-Jug, konferenca e të 77-ve, mbledhjet e jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara etj.

Por vitet shkojnë dhe asgjë nuk realizohet, sepse imperialistët e neokolonialistët nuk heqin dorë nga privilegjet e pozitat e tyre dominuese. Ato që mbeten janë rezolutat pa bukë të mbledhjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe vendimet për të bërë mbledhje të reja.

Që duhet të ndryshojnë marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, kjo është e domosdoshme. Kjo është dëshirë dhe kërkesë e popujve, të cilët luftojnë për t'u shkëputur nga vargonjtë e neokolonializmit. Por në ç'rrugë mund të realizohen këto? Revizionistët dhe oportunistët e tjerë pretendojnë se kjo mund të arrihet me anë të propagandës, me anë të edukimit të kapitalistëve, me anë të bisedimeve. Mendimi se mund të arrihet një rend i ri ekonomik ndërkombëtar me predikime moralizuese jo vetëm që është jashtë çdo realiteti e mundësie, por ai është edhe një mashtrim keqdashës. Rruga e drejtë është lufta e popujve për mbrojtjen deri në fund të të drejtave të tyre, kundërshtimi i vendosur ndaj grabitjes neokolonialiste. marrja në dorë dhe administrimi sovran i pasurive kombëtare. Vetëm kështu vendet e pazhvilluara mund t'u imponojnë fuqive të mëdha imperialiste e kapitaliste kërkesat e tyre të drejta për shkëmbime të barabarta në fushën ekonomike, për bashkëpunim me përfitim reciprok etj.

Fuqitë e mëdha imperialiste dhe të tjerat më pak të mëdha mendojnë, veprojnë dhe teorizojnë se janë ato që kanë në dorë fatet e popujve e të njerëzimit, dhe mbi këtë bazë kërkojnë t'i nënshtrojnë popujt. Këto fuqi agresive e nënvleftësojnë forcën e popujve. Atyre u

është errësuar pamja dhe nuk duan të shohin se çdo hap i popujve përpara, drejt kundërshtimit të shtypjes e të skllavërimit të dyfishtë, të jashtëm dhe të brendshëm, është një çarje që do të zgjerohet në murin e burgut kapitalist e imperialist.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik bëjnë përpjekje të mëdha për t'u dukur si dy superfuqi të pamposhtshme. Ata vërtet kanë një potencial të madh ushtarak dhe ekonomik, influencojnë dhe ndërhyjnë në punët e brendshme të popujve dhe të shteteve të tjera, por, të kesh armë, të kesh dollarë ose rubla, nuk do të thotë se ke një fuqi të pamposhtshme. Superfuqitë imperialiste duhet të konsiderohen ashtu siç janë realisht, pa i nënvleftësuar, por edhe pa i mbivlerësuar. Ato janë të fuqishme e të egra, por janë edhe në kalbëzim, janë të krimbura, të degjeneruara dhe bazat e tyre janë të tronditura.

Kapitali botëror bën përpjekje të mëdha që të shpëtojë nga kriza, nga luftërat çlirimtare të popujve, nga revolucioni, nga kjo darë e tmerrshme, që e ka mbërthyer për fyti dhe po e mbyt. Por shpëtimi është i pamundur, sepse është vetë sistemi kapitalist që krijon krizat e tij politike, ekonomike, ideologjike, që i ushqen dhe i thellon ato deri në shkallën më të lartë. Për të dalë nga kaosi që krijon kapitalizmi, për të shpëtuar njëherë e mirë nga shtypja e shfrytëzimi kapitalist, nga zgjedha e huaj neokolonialiste e sundimi i reaksionit nuk ka rrugë tjetër përveç revolucionit, përmbysjes së imperializmit e të kapitalizmit.

Lufta e popujve, lufta e proletariatit kundër armiqve të tyre, do të ecë përpara. Ajo është një proces objektiv historik, të cilin s'ka forcë që ta ndalojë.

Situatat komplekse e të vështira që janë krijuar e krijohen në botë, shtrojnë përpara Partisë dhe shtetit tonë socialist detyrën që të mbajnë kurdoherë lart vigjilencën revolucionare dhe të marrin masa për forcimin e gjithanshëm të ekonomisë e të mbrojtjes, të unitetit të popullit e të ndërgjegjes politike të njerëzve. Këto situata kërkojnë, gjithashtu, që politika jonë e jashtme të jetë aktive, që t'u shërbejë gjithnjë e më mirë mbrojtjes së interesave të atdheut e të fitoreve të socializmit, përparimit të çështjes së revolucionit, të çlirimit të popujve e të paqes në botë, përkrahjes së të gjitha atyre proceseve që ndihmojnë në emancipimin dhe progresin e shoqërisë së sotme njerëzore.

Politika jonë e jashtme, si politikë e një shteti socialist, e një shoqërie pa klasa shfrytëzuese e me të vërtetë të lirë, është një politikë revolucionare e internacionaliste. Ajo është e çliruar edhe nga shenja më e vogël e nacionalizmit të ngushtë borgjez, e shovinizmit, e ekskluzivitetit nacional ose e nënvleftësimit të popujve të tjerë. Populli shqiptar ka respekt për çdo popull dhe u do të mirën të gjithë popujve.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë i përmbahet fort parimit se çdo popull ka të drejtë ta zgjedhë vetë rrugën e tij të zhvillimit dhe të vendosë vetë e në mënyrë sovrane për fatet e tij.

Shqipëria socialiste, si një vend krejtësisht i lirë, atë çka mendon e thotë hapur, pa asnjë druajtje dhe me sinqeritet të plotë. Ajo zbaton një politikë të jashtme sovrane, mbasi nuk kushtëzohet nga paktet politike, nga traktatet ushtarake ose nga organizatat e mbyllura ekonomike. Zhvillimin ekonomik e politik, mbrojtjen e saj, të ardhmen e saj ajo nuk e mbështet në kreditë, në huat, në ndihmat e shteteve të tjera, por në forcat e veta.

Kjo ka bërë dhe bën që zëri i Shqipërisë të jetë një zë i lirë, realist e objektiv në një botë ku varësia e nënshtrimi i shumë shteteve ndaj fuqive të mëdha imperialiste kufizon e shtrembëron çdo mendim e veprim të pavarur.

Gjatë periudhës që nga Kongresi i 7-të i Partisë, shteti ynë, duke u bazuar në parimet e njohura të barazisë, të respektimit të sovranitetit, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të leverdisë reciproke, ka zgjeruar marrëdhëniet e tij diplomatike, tregtare e kulturore me një numër gjithnjë e më të madh shtetesh dhe ka rritur vazhdimisht shkëmbimet me ta në fusha të ndryshme. Sot Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mban marrëdhënie diplomatike me 95 shtete, nga 74 me të cilat mbante marrëdhënie në kohën e Kongresit të 7-të të Partisë.

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë socialist ka qenë dhe do të jetë kurdoherë për forcimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të sinqerta, të miqësisë e të bashkëpunimit me gjithë popujt liridashës e paqedashës, me të gjithë ata që luftojnë kundër politikës agresive e hegjemoniste të imperialistëve. Ajo është për zhvillimin e një bashkëpunimi të sinqertë me të gjitha ato vende që janë dashamire e që mbajnë qëndrim korrekt ndaj saj.

Partia dhe vendi ynë janë kundër të gjitha praktikave imperialiste e neokolonialiste të pabarazisë, të diskriminimit dhe të diktatit të shtetit të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ne jemi për atë që marrëdhëniet midis shteteve, të mëdha ose të vogla qofshin, të jenë të lira nga çdo lloj presioni e diktati ekonomik, politik e ushtarak dhe t'u shërbejnë zhvillimit ekonomik, kulturor e shoqëror të tyre, forcimit të miqësisë midis popujve e shteteve sovrane, si edhe interesave të ruajtjes e të forcimit të paqes në botë.

Shteti ynë socialist ka qenë dhe është për zhvillimin normal e të lirë të tregtisë ndërkombëtare mbi bazën e barazisë e të përfitimit reciprok. Vendi ynë është për shkëmbime tregtare të balancuara, pa diskriminime e masa kufizuese, prandaj ai është shprehur kundër raporteve të pabarabarta në shkëmbimet tregtare, kundër manipulimit të çmimeve dhe në përgjithësi kundër makinacioneve dhe orvatjeve të kujtdoqoftë që synon t'i shfrytëzojë marrëdhëniet tregtare si mjet presioni, për t'i diktuar vullnetin dhe pikëpamjet e veta politike shtetit tjetër.

Shkëmbimet tregtare ne nuk i konfondojmë me marrjen e ndihmave e të kredive. Këto janë dy gjëra të ndara dhe s'kanë lidhje ndërmjet tyre.

Mënyra se si e kuptojmë dhe e zhvillojmë ne tregtinë e jashtme, i lë dorë të lirë shtetit shqiptar të veprojë e të vendosë vetë, të thotë

fjalën e tij ashtu siç e mendon, të ndërtojë vendin me forcat e veta ashtu siç dëshiron.

Vendi ynë ka përfunduar një varg marrëveshjesh kulturore me shumë vende dhe bën shkëmbime të rregullta në fushën e artit, të kulturës, të shkencës, të sportit etj. Këto shkëmbime kanë shërbyer për të njohur reciprokisht popujt tanë me arritjet dhe përparimin e njëri-tjetrit. Populli ynë vlerëson dhe shfrytëzon gjithçka të mirë e përparimtare që kanë popujt e tjerë. Eksperienca dhe kultura përparimtare janë thesar i mbarë njerëzimit. Në të njëjtën kohë ne bëjmë përpjekje që edhe popujt e tjerë të njihen me vlerat e kulturës sonë, që është sa e lashtë, aq edhe përparimtare.

Është politika e brendshme dhe e jashtme parimore dhe e pavarur e Partisë dhe e shtetit tonë socialist, është qëndrimi i tyre i drejtë në çështjet ndërkombëtare, është lufta e tyre në anën e popujve e kundër imperializmit që e kanë forcuar pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, që kanë rritur prestigjin e saj.

Fjala dhe vepra e Shqipërisë dëgjohen e priten me respekt nga popujt dhe punonjësit e vendeve të ndryshme, sepse ato përputhen me interesat dhe me aspiratat e tyre. Prandaj këtë politikë e çmojnë dhe e miratojnë popujt dhe opinioni përparimtar në botë, e ndjekin me interes dhe e simpatizojnë vende e shtete me sisteme të ndryshme shoqërore, kurse e sulmojnë reaksioni e revizionistët modernë sovjetikë, jugosllavë etj.

Një kujdes të veçantë, siç është e natyrshme dhe e kuptueshme, Partia dhe Qeveria jonë u kanë kushtuar marrëdhënieve me vendet fqinje e në një kuadër më të gjerë me vendet evropiane. Qëndrimet tona ndaj tyre janë të njohura dhe ato nuk ndryshojnë. Politika e jashtme e Shqipërisë në çdo kohë e në çdo situatë ka synuar të kontribuojë me sa mundet në forcimin e paqes e të sigurisë ndërkombëtare në kontinentin tonë, në forcimin e bashkëpunimit midis popujve të tij. Ne e kemi thënë dhe e themi se pjesëmarrja e shumicës së vendeve të Evropës në blloqet politike e ushtarake të superfuqive përbën fatkeqësinë e saj. Këtu e kanë burimin ndarjet e përçarjet në Evropë, tensionet e ballafaqimet e shpeshta midis vendeve të ndryshme të këtij kontinenti.

Është një politikë tepër e rrezikshme, një mashtrim ajo që kërkon t'i bindë popujt evropianë se duke u futur nën ombrellat atomike të superfuqive gjoja garantohet liria, pavarësia kombëtare dhe paqja e përgjithshmë. Kjo politikë nuk i siguron këto, por i sakrifikon. Fakt është se në emër të një sigurie të nesërme është sakrifikuar siguria e sotme, është cunguar sovraniteti, është kufizuar liria e veprimit dhe e qëndrimeve të pavarura të mjaft shteteve të Lindjes e të Perëndimit në arenën ndërkombëtare.

Si garanci për pavarësinë, sovranitetin dhe sigurimin e paqes vendeve evropiane u jepet Deklarata e Helsinkit. Ne e kemi shprehur qartë qëndrimin tonë ndaj Konferencës së Helsinkit dhe të ashtuquajturit sigurim evropian. Shqipëria socialiste nuk mori pjesë në të dhe e denoncoi si një farsë të kurdisur nga dy superfuqitë me qëllim

që të siguronin e të forconin zonat respektive të influencës në Evropë, të ligjësonin e të përjetësonin sundimin e tyre në këtë kontinent. Ngjarjet që kanë ndodhur në Evropë dhe rreth saj, që nga konferenca e Helsinkit e deri më sot, e kanë vërtetuar dhe justifikuar plotësisht qëndrimin e Shqipërisë. Koha tregoi se të ashtuquajturat «frymë e Helsinkit», «bashkëpunim paqësor», «qarkullim i lirë i njerëzve dhe i ideve» etj. nuk ishin gjë tjetër veçse parulla boshe për të mashtruar popujt evropianë, për të ngjallur tek ata iluzionin se gjoja lufta po largohet, se ruajtja e statukuosë imperialiste në Evropë është shpëtimi i tyre.

Pikëpamja jonë është se vetëm kundërshtimi i vendosur i imperializmit amerikan e i socialimperializmit sovjetik, likuidimi i blloqeve ushtarake dhe largimi i armëve atomike e i trupave të huaja mund të sigurojnë paqen në Evropë.

Problemet e Ballkanit janë po ato që preokupojnë Evropën në tërësi, por këtu, për shkak të pozitës strategjike që ka ky gadishull dhe të grindjeve të vjetra, konfliktet janë më të mprehta dhe rreziqet më të mëdha.

Situata bëhet më e komplikuar edhe nga fakti se superfuqitë, të nisura nga interesat e tyre hegjemoniste dhe nga dëshira për ta shndërruar Ballkanin në një «fuçi të përhershme baruti», përpiqen të ngjallin pasionet dhe ndjenjat shoviniste, t'i kundërvënë popujt e vendet e Ballkanit njërin kundër tjetrit, të pengojnë zhvillimin normal e në drejtimin pozitiv të marrëdhënieve ndërmjet tyre, të minojnë forcimin e miqësisë midis popujve fqinjë.

Rreziqet në Ballkan shtohen sidomos edhe nga pjesëmarrja e disa vendeve në blloqet ushtarake e ekonomike të superfuqive, nga ekzistenca e bazave të huaja ushtarake, nga lejimi i hyrjeve dhe i qëndrimit në portet e në ujërat territoriale të flotave amerikane e sovjetike etj.

Zhvillime të tilla krijojnë tensione dhe përmbajnë rreziqe për popujt ballkanikë. Ato në çdo drejtim e në çdo aspekt shkojnë kundër përpjekjeve dhe dëshirave të sinqerta të popujve të Ballkanit për vendosjen e besimit, të mirëkuptimit dhe të një bashkëpunimi të vërtetë midis vendeve të gadishullit tonë.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë i përmbahet pikëpamjes se aktualisht aspiratave të vërteta të popujve të Ballkanit, paqes e stabilitetit në këtë zonë mund t'u shërbehet më mirë duke mos i lejuar superfuqitë imperialiste të ndërhyjnë në punët e brendshme të vendeve të rajonit tonë dhe duke bërë hapa konkretë e konstruktivë për zhvillimin pozitiv të marrëdhënieve mbi bazën e politikës së fqinjësisë së mirë. Situata në Ballkan do të përmirësohej shumë në qoftë se vendet ballkanike do të angazhoheshin zyrtarisht për të mos u lejuar superfuqive që nga territori i tyre të kërcënohet e të rrezikohet vendi tjetër fqinj. Shqipëria socialiste, ashtu si në të kaluarën, edhe në të ardhmen do t'i përmbahet me konsekuencë kësaj politike dhe do të bëjë çdo përpjekje që në marrëdhëniet e saj me shtetet fqinje të zotërojë respekti reciprok dhe mirëkuptimi i vërtetë.

Nga këto parime e nga këto qëllime Shqipëria është udhëhequr edhe në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Ajo ka qenë e predispozuar dhe ka bërë tërë përpjekjet për zhvillimin normal e korrekt të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, siç janë ato në lëmin e tregtisë, të transportit, të shkëmbimeve kulturore e në fusha të tjera me interes reciprok.

Në marrëdhëniet tona me Jugosllavinë ne jemi nisur e nisemi nga fakti se popujt tanë jetojnë prej shekujsh njëri pranë tjetrit, se fatet historike shpesh kanë qënë të përbashkëta, se kur pushtuesit e huaj kanë sulmuar njërin nuk e kanë kursyer as tjetrin. Këto na kanë bërë e na bëjnë që me Jugosllavinë, pavarësisht nga kontradiktat ideologjike e politike që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë ndërmjet dy vendeve e që tashmë janë të njohura botërisht, pavarësisht nga polemika ideologjike që është zhvilluar e zhvillohet nga të dy palët, të kërkojmë gjithnjë të rrojmë në paqe e në fqinjësi të mirë, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe duke respektuar të drejtat e secilit.

Politika e Shqipërisë socialiste ndaj Jugosllavisë ka qenë kurdoherë konstante, e pandryshuar në bazat dhe në parimet e saj. Në qoftë se në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ka pasur ulje e ngritje, përmirësime e acarime, kjo ka ndodhur jo për fajin tonë, por për fajin e qarqeve drejtuese jugosllave. Edhe keqësimi i tanishëm në marrëdhëniet midis RPS të Shqipërisë dhe RSF të Jugosllavisë është pasojë e veprimeve shoviniste të autoriteteve të Beogradit ndaj popullsisë së Kosovës dhe e nxitjes nga ana e tyre të një fushate të re armiqësore kundër vendit tonë.

Për sa i përket Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë qëndrimet dhe sjellja e jugosllavëve ndaj saj nuk do ta lëkundin atë nga parimet, nuk do ta bëjnë të ndryshojë rrugë. Ajo dëshiron që marrëdhëniet shtetërore në fusha të ndryshme ndërmjet dy vendeve të zhvillohen normalisht. Por kjo do të varet nga qëndrimi i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë socialiste dhe nga trajtimi që do t'u bëhet shqiptarëve të Kosovës e të viseve të tjera në Jugosllavi.

Problemi i shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi nuk është problem i një «minoriteti», i ardhur apo i vendosur diku në një zonë «vakuum» si emigracion ekonomik, as i shkaktuar nga dyndja e Perandorisë Osmane dhe as nga rritja e natyrshme demografike e shqiptarëve që i shqetëson Maltusët e rinj serbomëdhenj. Shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë një etni, një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton, të cilin, siç dihet, e copëtuan dhe e shkëputën nga mëmëdheu i vet fuqitë e mëdha imperialiste dhe ia aneksuan Jugosllavisë. Këtë askush nuk mund ta fshehë. Çdo interpretim tjetër është arbitrar, është një falsifikim i rëndë e i dëmshëm i historisë.

Mëmëdheun e etnisë shqiptare populli shqiptar nuk ua la as pushtuesve fashistë, as kurrkujt tjetër që ta përcaktonte. Shqiptarët kanë luftuar pa pushim e në shekuj kundër armiqve të egër e shumë më të mëdhenj në numër për të mbrojtur identitetin kombëtar dhe

vetë ekzistencën e tyre. Në të gjitha këto luftëra, si në humbje dhe në fitore, në vitet e gjata të robërisë, në tërë historinë e tij, populli shqiptar nuk i humbi asnjëherë vetëqenien dhe vetëdijen e tij kombëtare, kompaktësinë dhe unitetin e tij. Në çdo rrethanë ai i ka manifestuar ato me një vitalitet të jashtëzakonshëm e shembullor.

Perandoritë dhe fuqitë e mëdha nuk e zhdukën dot etninë kompakte të shqiptarëve, as nuk mundën ta asimilonin, t'i ndërronin kulturën, gjuhën, doket dhe zakonet. Këtë e vërteton vetë ekzistenca e popullit shqiptar. Historia tregon se, pa asnjë përkrahje nga fuqi të huaja, të cilat i ka pasur kurdoherë kundër, ai ka luftuar me sukses për lirinë e kombit dhe për kompaktësinë e tij, për mbrojtjen e pavarësisë si shtet sovran, të kulturës së tij dhe të të drejtave të veta të natyrshme e të ligjshme. Kurdoherë vetëm lufta dhe gjaku i tij i derdhur kanë bërë që të arrihej fitorja.

Në Luftën e Dytë Botërore populli shqiptar dhe popujt e Jugosllavisë luftuan së toku e në aleancë të ngushtë armësh kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë. Edhe shqiptarët që jetonin në Jugosllavi luftuan me heroizëm tok me ne dhe me të gjithë popujt e Jugosllavisë kundër të njëjtëve armiq. Jo vetëm luftuan së toku, por Ushtria jonë Nacionalçlirimtare u shkoi në ndihmë partizanëve jugosllavë e vëllezërve kosovarë dhe në tokat e tyre derdhi gjakun e bijve e të bijave të popullit shqiptar. Ne vepruam siç na mësonte Partia Komuniste e Shqipërisë, me ndërgjegje e me frymë të lartë internacionaliste. Ne mendonim se kështu do të fitohej liria nga popujt e të dy vendeve tona, do të zhdukej robëria dhe do të ndreqeshin gabimet tragjike të historisë së kaluar. Ne besonim se pas fitores çdo gjë do të zgjidhej në rrugën marksiste-leniniste. Garanci për këtë ishin partitë komuniste që udhëhiqnin Luftën Nacionalçlirimtare në të dy vendet. Por bindja jonë te «komunizmi dhe internacionalizmi» i udhëheqësve jugosllavë, besimi te fjalët e tyre nuk u vërtetuan. Në fakt, udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë nuk e shikoi kurrë drejt e në rrugë marksiste-leniniste çështjen e së ardhmes së shqiptarëve në Jugosllavi, prandaj edhe do ta zgjidhte, siç e zgjidhi, gabim e shtrembër, në rrugë nacionaliste e shoviniste, plotësisht antimarksiste.

Zgjidhja e gabuar e kësaj çështjeje të madhe e parimore filloi që në mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, mbajtur në Jajce në nëntor të vitit 1943, ku viset shqiptare në Jugosllavi u përdorën si një mjet për të rregulluar përmasat tokësore e të popullsisë së republikave të Federatës, veçanërisht të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. E ardhmja e shqiptarëve të Jugosllavisë u vendos a priori nga lart, pa aprovimin dhe vetëvendosjen e popullit shqiptar të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe pa as më të voglin konsultim me aleaten e popujve të Jugosllavisë, e interesuar drejtpërsëdrejti në këtë çështje, Shqipërinë popullore. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në kundërshtim me «politikën e barazisë nacionale» të shpallur në mbledhjen e dytë të AVNOJ-it, shkeli pa të drejtë vullnetin e shqiptarëve

në Jugosllavi, të shprehur në mbledhjen themelvënëse të Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Metohinë, mbajtur në Bujan më 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944, që ishte në përputhje të plotë me të drejtën e «vetëvendosjes deri në shkëputje» të popujve që përbënin Jugosllavinë dhe që ishte përcaktuar në dokumentet themelore të Partisë Komuniste e të Lëvizjes Nacionalçlirimtare Jugosllave.

Për sa i përket konsultimit me Shqipërinë popullore për zgjidhjen e këtij problemi historik udhëheqja jugosllave e quante a priori të panevojshëm. Ajo ishte kundër një konsultimi të tillë, pse e dinte që një diskutim parimor, marksist-leninist e miqësor ndërmjet udhëheqjeve të të dy vendeve tona, duke marrë parasysh edhe vullnetin e lirë të shqiptarëve që banonin në trojet e tyre në Jugosllavi, do të çonte në një zgjidhje të drejtë dhe jo shovinisto-arbitrare e nacionaliste, si ajo që ndërmori udhëheqja jugosllave.

Pas luftës, në vitin 1946, një delegacion i vendit tonë, që kryesoja unë, bëri vizitën e parë zyrtare në Jugosllavi. Në bisedimet që u zhvilluan me këtë rast me Titon, ky kërkoi të dinte se ç'mendoja unë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Unë i shpreha mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen kësaj. Shqiptarët luftuan që të ketë një Shqipëri të lirë e sovrane, së cilës tani duhet t'i bashkohen edhe viset shqiptare të Jugosllavisë. Presidenti Tito u përgjigj: «Jam dakord me pikëpamjen tuaj, por tash për tash nuk mund ta bëjmë dot këtë gjë, sepse serbët nuk do të na kuptojnë». Ky premtim zyrtar i Titos për këtë problem të madh e parimor nuk u shoqërua me asnjë veprim të mëtejshëm nga ana e jugosllavëve. Çdo gjë ishte mashtrim nga ana e tyre.

Në zgjidhjen e gabuar në Jajce, në copëtimin e tokave shqiptare dhe në mohimin e shprehjes së vullnetit të lirë të shqiptarëve qëndron gabimi themelor, me karakter nacionalist e shovinist, i udhëheqjes jugosllave, që u pasua nga gabime të tjera po aq të rënda në lidhje me të drejtat e ligjshme e të natyrshme të shqiptarëve, të cilët akuzohen tani nga serbomëdhenjtë si «shovinistë», «nacionlistë» e «irredentistë». Në këtë zgjidhje shumë të gabuar dhe antilenininste të çështjes nacionale në Jugosllavi dhe sidomos të entitetit shqiptar prej afro 2 milionë banorësh, gati sa gjithë popullsia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e kanë burimin ngjarjet e kohëve të fundit në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi.

Shovinizmi serb, malazez e ai maqedonas që në fillim ndoqi ndaj shqiptarëve një politikë nacionaliste të egër, shtypëse e diskriminuese në të gjitha drejtimet, në arsim, në kulturë, në ekonomi etj.

Edhe në periudhën kur ndërmjet vendit tonë e Jugosllavisë dhe të dy partive kishte marrëdhënie të mira problemi i shqiptarëve në Jugosllavi ishte një «gjyle hekuri» në këmbët e jugosllavëve. Kërkesat e pakënaqësitë e shqiptarëve as nuk shqyrtoheshin, as nuk

zgjidheshin politikisht në rrugën e mirëkuptimit, por me dhunë, me masa të egra administrative. Shqiptarët akuzoheshin për nacionalizëm dhe kjo bëhej për të fshehur shovinizmin dhe nacionalizmin serb. Asgjë nuk mund t'i mbulojë e t'i justifikojë raprezaljet e përgjakshme kundër shqiptarëve më 1945, më 1968 e përsëri më 1981, diskriminimin e tyre, lënien në varfëri, shtypjen nacionale, mohimet e dallimet e mëdha në fushën e arsimit dhe të kulturës. Rënia në fatkeqësi e grupit serbomadh të Rankoviçit, në vitin 1966, e më vonë e grupit tjetër serbomadh të Nikeziçit shënojnë periudhën e demagogjisë politike të titistëve ndaj Kosovës dhe kosovarëve. Nevoja për balancimin e forcave të ndryshme brenda Federatës çoi në njëfarë rishikimi formal të statusit të Kosovës, e cila nga krahinë e thjeshtë e Serbisë, u emërtua krahinë «autonome» e saj.

Me dashje ose pa dashje të serbëve, kjo situatë e re u dha mundësi shqiptarëve në Jugosllavi, dhe sidomos kosovarëve, të zgjeronin arsimin, të ngrinin Universitetin e Prishtinës, të zhvillonin kulturën, të mësonin historinë e popullit të tyre, të vendosnin kontakte dhe marrëdhënie arsimore-kulturore dhe ekonomike me Shqipërinë, në bazë të ligjeve të Federatës dhe të marrëveshjeve zyrtare midis RPSSH dhe RFSJ. Por baza ekonomike e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës mbeti përsëri shumë e dobët, u la pas dore. Pasuritë e saj përsëri u shfrytëzuan pa skrupull nga republikat e tjera të Federatës, sidomos nga Serbia. Të gjitha «zgjidhjet» që u paraqitën me bujë të madhe gjatë kësaj periudhe ishin të shpëlara, koniunkturale e të dobishme për Beogradin dhe Shkupin. Sipas rastit, pa u thënë haptazi, ato konsideroheshin ose si «lëshime oportuniste të Titos», siç ndodhte me serbët, ose si «fitore të arritura në sajë të Titos», siç trumbetoheshin nga udhëheqës shqiptarë të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës. Ndërsa masat e shqiptarëve nuk patën shumë iluzione, pasi ajo çka u jepej ishte një gjë fare e vogël përpara të drejtave të mëdha që u ishin mohuar e rrëmbyer.

Ngjarjet që kanë ndodhur pas vdekjes së Titos kanë treguar se sa gabim e në ç'rrugë antimarksiste ishte zgjidhur çështja nacionale në Jugosllavi dhe veçanërisht çështja e shqiptarëve. Kërkesave të tyre të ligjshme brenda Kushtetutës iu dha një grusht i rëndë dhe i përgjakshëm nga ana e udhëheqjes shoviniste serbe dhe e të gjithë udhëheqjes jugosllave pas demonstratave që u bënë në Kosovë në mars e prill të këtij viti. Tani, më shumë se kurdoherë tjetër, mbi kosovarët dhe mbi gjithë shqiptarët në Jugosllavi, përveç gjendjes ekonomike të mjeruar rëndon edhe shtypja e egër nacionale. Mbi ta është vendosur ligji i terrorit, është derdhur policia dhe ushtria serbe, burgjet janë mbushur plot me të rinj e të reja. Masat që janë marrë e po merren shkojnë jo vetëm drejt zhdukjes së çdo të drejte të ligjshme e të atyre pak përfitimeve që u dukën në zhvillimin e arsimit e të kulturës, por edhe drejt shkombëtarizimit të shqiptarëve në Jugosllavi. Dhe kjo bëhet nga ata që pretendojnë se respektojnë dokumentet e Konferencës së Helsinkit mbi liritë e të drejtat e njeriut. Opinioni botëror duhet të mos qëndrojë indiferent, por të alarmohet për këtë gjendje dramatike të popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Ç'kërkuan, në fund të fundit, shqiptarët në demonstratat masive që u zhvilluan në qytete e fshatra të ndryshme në Kosovë?

Shqiptarët në Jugosllavi më se një herë, me demonstrata paqësore dhe pa demonstrata, kanë kërkuar që gjendja e tyre kushtuese, ekonomike dhe social-kulturore të ndreqej, të vihej në rrugë të drejtë brenda ligjeve të Federatës, ata kërkuan të kenë statusin e Republikës brenda RFSJ. Ata nuk kërkuan as shkëputjen nga Federata, as bashkimin me Shqipërinë. Por kërkesave të drejta e të ligjshme të studentëve, punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve kosovarë as ua vuri veshin kush. Jo vetëm kaq, por ata, si edhe herë të tjera kur kanë paraqitur kërkesa të tilla të ligjshme e të drejta, u cilësuan si nacionalistë, u presekutuan dhe u mbytën në gjak.

Por a mund të zgjidhen kështu këto probleme në kohën tonë? Kurrsesi. Është e pamundur të mbahet në varfëri e në mjerim një popull, toka e të cilit është e begatë dhe grabitet nga të tjerët. Është e pamundur të mbash nën frikën e tankeve e të bajonetave një popull trim si shqiptarët. Është e pamundur ta shtrembërosh ose ta zhdukësh historinë dhe kulturën e tij të lashtë. Është e pamundur t'ia zhdukësh ndjenjën patriotike dhe dashurinë për mëmëdheun.

Po të ecet në rrugën që ka zgjedhur dhe po ndjek udhëheqja e sotme jugosllave kundërshtimet e shqiptarëve do të vazhdojnë, do të rriten dhe do të acarohen akoma më shumë. Vetëm një zgjidhje e menduar mirë e çështjes nacionale, pa pasione nga të dy palët, një zgjidhje që të pranohet e të aprovohet nga populli i Kosovës, e likuidon këtë situatë shumë të ndërlikuar, të cilën e kanë krijuar jo kosovarët, por shovinizmi serbomadh. Kosovarët dhanë zgjidhjen më të drejtë e më të përshtatshme në këto situata të vështira për Jugosllavinë dhe për veten e tyre. Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e Republikës brenda Federatës është një kërkesë e drejtë, ajo nuk e cënon ekzistencën e Federatës. Krerët serbë e jugosllavë, në vend që të arsyetonin, dërguan tanket, gjakosën popullin dhe tash po zhvillojnë në shkallë të gjerë të famshmin diferencim, domethënë hetimin policor: kush ishte pro e kush kundër demonstratave. Kjo mënyrë veprimi, më parë me terror, pastaj gjoja me «diferencim», do të thotë të përpiqesh të frikësosh masat që nuk frikësohen, të zhdukësh patriotizmin që nuk zhduket, të kesh iluzionin se ke qetësuar gjendjen, por ke ngjallur mërinë dhe zemërimin, të mendosh se ke sjellë «njerëz të besuar» në pushtet, të cilin e ke spastruar nga «nacionalistët» etj., por ke hedhur të gjithë popullin në rezistencë të heshtur, që nesër më me forcë do ta ngrejë zërin kundër mizorive që po i bëhen. Këtë situatë s'duan ta kuptojnë udhëheqësit jugosllavë.

Pse ne i themi hapur këto të vërteta dhe kërkojmë që problemi i Kosovës dhe i gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, i zgjidhur gabim, të ristudiohet me gjakftohtësi dhe të mos shkohet në dhunë e në terror, pse kërkojmë t'u jepet fund persekutimeve dhe të lirohen nga burgjet djemtë e vajzat kosovare, RPSSH e akuzojnë se ndërhyn në punët e brendshme të Jugosllavisë, bile atë e akuzojnë se nxit turbullirat në Kosovë e gjetkë! Dhe si i nxit ajo këto turbullira? Nëpërmjet marrëdhënieve arsimore e kulturore zyrtare. Shkohet deri atje sa të thuhet se RPSSH bën kauzë të përbashkët me reaksionin politik shqiptar në mërgim, të cilin ne e kemi luftuar dhe e luftojmë me të gjitha forcat tona.

Asnjëherë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë. E kundërta ka ndodhur. Revizionistët jugosllavë komplotuan për likuidimin e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe për inkuadrimin e Shqipërisë në Federatën jugosllave si republikë e shtatë e saj, duke menduar që me këtë zgjidhnin një herë e mirë dhe në rrugë aneksioniste e imperialiste problemin e gjithë kombit shqiptar. Por këto komplote as u realizuan, as do të realizohen ndonjëherë. Shqipëria s'është e s'do të bëhet kurrë një mjet rregullimi për të qetësuar konfliktet e kontradiktat midis klaneve jugosllave. Ajo ka zot popullin e saj, një popull plot vitalitet, trim dhe atdhedashës, që s'ka frikë nga askush.

Shqipëria nuk ka bërë ndonjëherë rivendikime tokësore ndaj Jugosllavisë, asnjë kërkesë për rektifikim kufijsh nuk gjen në dokumentet e saj. Por, duke mbajtur këtë qëndrim, ne s'kemi mohuar dhe as do të mohojmë kurrë faktin se në Jugosllavi rron një pjesë e madhe e kombit dhe e popullit shqiptar. Ne kemi mbrojtur dhe do të mbrojmë edhe në të ardhmen, me të gjitha forcat e në rrugë marksiste-leniniste, të drejtat e ligjshme të vëllezërve tanë shqiptarë matanë kufirit, dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Kjo është e drejta jonë e pamohueshme.

Çështja e Kosovës është një tragjedi. Autoritetet jugosllave duhet të pushojnë terrorin dhe persekutimet ndaj shqiptarëve, të likuidojnë shtypjen nacionale dhe t'u njohin atyre të gjitha të drejtat që u takojnë. Për zgjidhjen me drejtësi të problemeve ata duhet të bisedojnë qetësisht, me gjakftohtësi dhe në barazi me popullsinë shqiptare në Jugosllavi.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë i ka kushtuar një kujdes të veçantë forcimit të marrëdhënieve miqësore me Greqinë. Vitet e fundit këto marrëdhënie kanë marrë një zhvillim të mëtejshëm në të gjitha fushat. Shkëmbimet tregtare janë zgjeruar dhe po zhvillohen me sukses në dobi të të dy palëve. Bashkëpunimi në fushën e kulturës, vajtja e ardhja e grupeve artistike, vizitat reciproke të njerëzve të artit, arsimit e të shkencës kanë ndihmuar që popujt tanë të njihen edhe më mirë me arritjet dhe përparimet e njëri-tjetrit. Ato i kanë shërbyer forcimit të miqësisë së lashtë e tradicionale që lidh dy vendet tona. E bindur se marrëdhëniet e miqësisë e të mirëkuptimit midis Shqipërisë e Greqisë u përgjigjen plotësisht interesave dhe aspiratave të përbashkëta të popujve tanë, RPS e Shqipërisë edhe në të ardhmen do të bëjë të gjitha përpjekjet për zgjerimin dhe zhvillimin e tyre.

Konstatojmë me kënaqësi se edhe qeveria greke e populli grek janë të predispozuar dhe dëshirojnë që marrëdhëniet midis dy vendeve tona të ecin përpara mbi bazën e miqësisë e të fqinjësisë së mirë. Ndjenjat e popullit shqiptar e të popullit grek puqen në shumë drej-

time, ata i duan të mirën dhe gëzohen për përparimet e njëri-tjetrit, duke u nisur nga parimi se secili është zot në shtëpinë e tij e në punën e vet. Miqësia midis popullit shqiptar e popullit grek është një miqësi e qëndrueshme, ajo do të forcohet e do të lulëzojë vazhdimisht për të mirën e popujve tanë, të paqes dhe të sigurisë në Ballkan. Orvatjet e kujtdo qoftë për të futur pyka në këtë miqësi do të dështojnë. Ne kemi bindjen se tani janë krijuar kushtet dhe mundësitë që, me përpjekje të përbashkëta, të mënjanohet çdo pengesë dhe t'i hapet rrugë e gjerë zhvillimit të marrëdhënieve të frytshme e me përfitim reciprok ndërmjet dy vendeve tona mike.

Me Italinë ne jemi të gatshëm të punojmë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve normale në përputhje me aspiratat dhe interesat e të dy popujve tanë fqinjë. Në fusha të ndryshme, siç janë ato të tregtisë, të transportit, të shkëmbimeve kulturore etj., ndërmjet Shqipërisë e Italisë kanë ekzistuar lidhje të shumta. Popujt tanë kanë dëshiruar gjithnjë të rrojnë në paqe e në miqësi me njëri-tjetrin. Megjithëse rrugët e historisë, disa herë, i kanë ndarë e armiqësuar, ata janë përpjekur të afrohen, të bashkëpunojnë dhe të forcojnë atmosferën e besimit dhe të mirëkuptimit reciprok.

Mundësitë për përparimin e mëtejshëm të marrëdhënieve shqiptaro-italiane ekzistojnë. Dëshira jonë është që të ecet në rrugë të mbarë, por kjo varet edhe nga predispozicioni dhe interesimi i palës italiane për të bashkëpunuar me Shqipërinë në një frymë të re, në miqësi e barazi të plotë.

Marrëdhëniet e vendit tonë me Republikën e Turqisë janë zhvilluar e po zhvillohen gjithnjë e më tepër në frymën e miqësisë dhe të bashkëpunimit. Dashamirësia dhe respekti në rritje midis dy popujve dhe vendeve tona krijojnë një bazë të mirë për zgjerimin dhe forcimin e tyre të mëtejshëm në të ardhmen.

Populli shqiptar dhe populli turk gjatë historisë së tyre kanë pasur lidhje miqësore e afinitet me njëri-tjetrin. Populli turk, me një histori dhe kulturë të lashtë, ka pasur respekt të madh për trimat e Shqipërisë, për dijetarët, filozofët, burrat e shtetit, arkitektët, shkrimtarët dhe poetët shqiptarë ose me origjinë shqiptare, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në përpjekjet përparimtare të popullit turk.

Populli shqiptar ka një admirim dhe respekt të veçantë për Mustafa Qemal Ataturkun, këtë personalitet e burrë shteti të shquar, i cili me kurajë të madhe i frymëzuar nga mendimi demokratik përparimtar, e çliroi Turqinë dhe popullin e saj trim nga kompleksi robëruës ndaj popujve të tjerë i perandorisë së sulltanëve, konsolidoi unitetin dhe pavarësinë e vërtetë të kombit turk, e futi Turqinë në rrugën e demokracisë e të progresit.

Populli shqiptar ka njohur ndjenjat e dashamirësisë së Qemal Ataturkut për Shqipërinë, i cili iu kundërvu mbretit Zog, tiran i popullit shqiptar.

Miqësia e sinqertë e popullit turk ndaj popullit shqiptar dhe frymëzimi i lartë i Ataturkut duket aq qartë në strehimin vëllazëror të qindra mijëra vëllezërve tanë kosovarë, që u dëbuan nga tokat e tyre në Jugosllavi. Ne e falënderojmë popullin vëlla turk për këtë dhe për miqësinë e tij ndaj popullit shqiptar, miqësi që është reciproke.

Në marrëdhëniet miqësore të vendit tonë me Republikën Franceze janë shënuar hapa të rinj pozitivë. Ne vlerësojmë përpjekjet e dashamirëve gjithnjë e më të shumtë të Shqipërisë në Francë për forcimin e miqësisë midis dy popujve tanë. Edhe populli shqiptar ushqen ndjenja miqësore dhe ka respekt për popullin e talentuar francez, për traditat revolucionare dhe përparimet e tij.

Ashtu si edhe në të kaluarën ne dëshirojmë sinqerisht që marrëdhëniet e shtetit tonë me Austrinë, Suedinë, Finlandën, Norvegjinë, Danimarkën, Zvicrën, Belgjikën, Holandën, Portugalinë të zhvillohen e të zgjerohen akoma më tej në drejtimin pozitiv e miqësor që kanë marrë vitet e fundit.

Qeveritë angleze të pasluftës së Dytë Botërore ndaj Shqipërisë së re kanë mbajtur qëndrime armiqësore dhe antidemokratike. Përveç kësaj, ato rrëmbyen arin shqiptar, të grabitur nga hitlerianët, dhe akoma sot e shfrytëzojnë në interesin e tyre, duke mos ia kthyer asaj që i përket, Shqipërisë socialiste.

A mund të flitet në këto rrethana për marrëdhënie diplomatike ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Anglisë? Qeveria angleze duhet t'i kthejë menjëherë arin Shqipërisë bashkë me interesat që i përkasin nga shfrytëzimi arbitrar i tij. Shqipëria socialiste, askush të mos dyshojë, do të mbrojë interesat e saj dhe do të luftojë kundër padrejtësive që i janë bërë dhe që po i bëhen.

Ndërmjet Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë nuk ekzistojnë pengesa të pakapërcyeshme për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ne besojmë se, me një mirëkuptim nga ana e të dy palëve për disa çështje të mbetura pezull që nga Lufta e Dytë Botërore, kjo gjendje mund të rregullohet.

Me vendet e Evropës Lindore janë të njohura mosmarrëveshjet e thella parimore, ideologjike e politike, të Partisë e të shtetit tonë. Pa hequr dorë nga lufta kundër revizionizmit modern, ne jemi për zhvillimin normal të marrëdhënieve me Rumaninë, Çekosllovakinë, Poloninë, Republikën Demokratike Gjermane, Bullgarinë e Hungarinë, për shkëmbime tregtare mbi bazën e barazisë dhe të leverdisë reciproke.

Me popujt vëllezër arabë popullin shqiptar e lidh një miqësi e sinqertë dhe e lashtë. Ne kemi mbështetur e do të mbështetim deri në fund dhe energjikisht luftën e drejtë të popujve arabë për çlirimin e territoreve të pushtuara nga agresorët sionistë izraelitë dhe rivendosjen e të gjitha të drejtave të ligjshme të popullit martir palestinez. Te Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe te populli shqiptar, populli heroik palestinez dhe përfaqësuesja e tij e ligjshme, Organizata për Çlirimin e Palestinës, kanë pasur e do të kenë vazhdimisht miq të sinqertë dhe mbrojtës të vendosur të çështjes së tyre të drejtë kombëtare.

Ne konstatojmë me kënaqësi të veçantë zhvillimin miqësor të marrëdhënieve të vendit tonë me Algjerinë, me Sirinë, Irakun, Libinë, Libanin, Tunizinë, Egjiptin dhe vende të tjera arabe. Ne dëshirojmë që këto marrëdhënie të gjejnë një konkretizim dhe zhvillim të mëtejshëm. Gjithashtu Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është për marrëdhënie miqësore me Republikën Islamike të Iranit dhe nuk do t'i kursejë përpjekjet për zhvillimin e forcimin e tyre.

Populli shqiptar dhe qeveria e tij kanë përshëndetur e përkrahur luftën e drejtë të popujve afrikanë për të shkulur nga rrënjët kolonializmin dhe racizmin nga kontinenti i Afrikës dhe kanë mbështetur përpjekjet e popujve e të vendeve liridashëse afrikane për t'i bërë ballë politikës dhe veprimtarisë agresive, neokolonialiste e grabitqare të imperializmit. Me Tanzaninë, me Guinenë, Malin, Zambian, Zimbabven dhe me shtete të tjera mike të Afrikës, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mban marrëdhënie miqësore dhe është për zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Vendi ynë ka marrëdhënie të mira edhe me një numër vendesh të Azisë. Me Republikën Socialiste të Vietnamit, me Laosin, me Republikën Demokratike Popullore të Koresë marrëdhëniet tona zhvillohen në rrugë miqësore dhe shprehim dëshirën tonë që në të ardhmen ato të forcohen më tej.

Për sa i përket Kamboxhias, Partia dhe shteti ynë kanë dënuar veprimet gjakatare të klikës së Pol Potit, vegël e socialimperialistëve kinezë. Ne i urojmë popullit kamboxhian të kapërcejë sa më parë vështirësitë me të cilat ndeshet dhe në liri të plotë e pa asnjë «kujdestari» të vendosë vetë për fatin dhe të ardhmen e tij.

Tashmë është botërisht e njohur se midis vendit tonë dhe Kinës, përveç marrëdhënieve formale diplomatike, nuk ekziston asnjë marrëdhënie tjetër konkrete. Kjo gjendje është krijuar jo për fajin tonë. Ajo është pasojë e politikës dhe e veprimtarisë armiqësore antishqiptare të udhëheqjes kineze.

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Japoninë krijon kushte dhe hap rrugën edhe për zhvillimin e tregtisë midis dy vendeve.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ka marrëdhënie normale me Meksikën, Perunë, Argjentinën, Panamanë dhe me vende të tjera të Amerikës Latine. Ajo është e gatshme të vendosë marrëdhënie të tilla edhe me shtete të tjera të këtij kontinenti që janë për një afrim miqësor dhe për shkëmbime tregtare e kulturore me vendin tonë.

Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Sovjetik, që janë armiqtë më të egër të lirisë e të pavarësisë së popujve, të paqes e të sigurisë në botë, vendi ynë nuk mban e nuk do të mbajë asnjë marrëdhënie. Ashtu si edhe në të kaluarën, ne do të vazhdojmë kurdoherë me vendosmëri luftën për demaskimin e politikës dhe të veprimtarisë së tyre agresive e hegjemoniste.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë edhe në të ardhmen do të punojë për zhvillimin në drejtim pozitiv të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në këtë frymë ajo nuk do të kursejë përpjekjet që edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në organizata të tjera ndër-

kombëtare të japë kontributin e saj për mbrojtjen e interesave dhe të aspiratave të popujve.

Politika e jashtme parimore e ndjekur nga Partia dhe vendi ynë shpreh aspiratat e popullit shqiptar dhe gëzon përkrahjen e mbështetjen e tij të plotë e të pakufishme. Partia edhe në të ardhmen do të luftojë për zbatimin me konsekuencë e me vendosmëri të kësaj politike që i siguron popullit lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar.

V

LUFTA KUNDËR REVIZIONIZMIT DHE LËVIZJA REVOLUCIONARE E ÇLIRIMTARE NË ETAPËN E SOTME

Në periudhën që na ndan nga Kongresi i 7-të, Partia jonë, duke i qëndruar si kurdoherë besnike marksizëm-leninizmit e internacionalizmit proletar, ka vazhduar pa ndërprerje luftën kundër revizionizmit modern. Është thelluar kritika ideologjike e politike kundër revizionizmit hrushovian, kinez, atij jugosllav e evropianoperëndimor, janë evidentuar në mënyrë më të plotë kushtet historike e social-ekonomike të lindjes e të përhapjes së këtyre rrymave, është analizuar më gjerë procesi i degjenerimit të atyre partive komuniste që u futën në rrugën e revizionizmit, gabimet e lëshimet e tyre në strategji e në taktikë. Në dritën e fakteve, nga e kaluara dhe nga e sotmja është argumentuar lidhja e revizionizmit modern me strategjinë që adoptoi imperializmi pas Luftës së Dytë Botërore për shkatërrimin e socializmit dhe shtypjen e revolucionit e të lëvizjes çlirimtare të popujve.

Këto analiza e konkluzione i kanë shërbyer Partisë për të njohur më mirë rreziqet që kërcënojnë socializmin e diktaturën e proletariatit në vendin tonë nga revizionizmi dhe për të marrë masat më efektive e më të përshtatshme për t'i shmangur këto rreziqe. Ato i kanë shërbyer gjithashtu edukimit të komunistëve e të masave, ngritjes teorike dhe kalitjes së ndërgjegjes së tyre revolucionare. Njohja më e thellë e strategjisë dhe e taktikave të imperializmit e të revizionizmit e ka bërë edhe më efektive luftën tonë për mbrojtjen e çështjes së proletariatit e të popujve.

Drejtësia e rrugës që zgjodhi që në fillim Partia jonë për t'iu kundërvënë revizionizmit dhe për ta luftuar atë deri në fund, është vërtetuar e po vërtetohet çdo ditë e më tepër nga degjenerimi politik dhe kriza e thellë ideologjike e revizionizmit modern, nga gjendja e rëndë ekonomike dhe qorrsokaku ku janë futur partitë revizioniste dhe vendet ku ato janë në fuqi.

Kur Partia jonë filloi luftën kundër revizionizmit hrushovian, partitë komuniste që u bashkuan me Hrushovin paraqiteshin pak a shumë si një bllok i tërë, me një vijë të vetme, që ishte ajo e Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por sot, pas 20

vjetësh, ato janë përçarë e ndarë në rryma e fraksione të shumta, ndodhen në luftë e në përleshje me njëra-tjetrën, i ka mbytur nacionalizmi borgjez dhe oportunizmi socialdemokrat. Këto parti ish-komuniste ose janë shndërruar në parti të mirëfillta të borgjezisë së re sunduese në vendet ku janë në fuqi revizionistët, ose janë kthyer në pjesë përbërëse të strukturave të shtetit borgjez, siç ka ndodhur në vendet e vjetra kapitaliste. Kriza e revizionizmit modern është shprehje e drejtpërdrejtë e krizës së kapitalizmit dhe të ideologjisë borgjeze në përgjithësi.

Tradhtia revizioniste, restaurimi i kapitalizmit në një varg vendesh ish-socialiste kanë krijuar një konfuzion të madh rreth problemit të socializmit, i cili është në qendër të luftës ideologjike që zhvillohet sot në botë. Çështja është se shoqërinë kapitaliste të rivendosur në vendet e tyre revizionistët e paraqesin si një shoqëri të kulluar socialiste, si një «socializëm real» «të zhvilluar» e bile «shumë të zhvilluar». Ky konfuzion shtohet edhe më tepër ngaqë për socializmin flasin edhe shumë parti e forca të ndryshme politike, të cilat janë larg socializmit shkencor, si dhe nga përpjekjet që bën borgjezia e propaganda e saj për të deformuar idealet e vërteta socialiste, për të larguar masat nga lufta për triumfin e tyre.

Qartësia për këtë çështje, vënia e një kufiri të prerë ndërmjet socializmit të vërtetë e pseudosocializmit është me rëndësi kapitale për zhvillimin me sukses të luftës së klasës punëtore e të masave punonjëse. Pa pasur një përfytyrim të qartë për shoqërinë socialiste, pa iu përmbajtur parimeve dhe ligjeve të përgjithshme të saj, revolucioni mbetet në mes të rrugës. Revolucioni edhe mund të kryhet, por kur mungon perspektiva e vërtetë socialiste, ai mund të devijojë dhe lufta e sakrificat e bëra për triumfin e tij të shkojnë dëm.

Korrenti i parë i revizionizmit në pushtet, që i vuri vetes për detyrë të minonte socializmin, ishte revizionizmi jugosllav, që lindi në një moment kyç të luftës midis socializmit e imperializmit.

Revizionizmi jugosllav i ka rrënjët të thella. Ai nuk u shfaq në vitin 1948 dhe nuk erdhi si reaksion kundër «stalinizmit» e as si rrjedhim i veprimeve të Informbyrosë. Ai është rrjedhim i botëkuptimeve borgjeze që kanë ekzistuar edhe më parë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë e që nuk u zhdukën gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Jugosllavia e re nuk mund të ndërtohej pa një orientim të qartë e pa një pjekuri politike të bazuar në teorinë shkencore të socializmit. Këtë vepër të madhe mund ta kryente vetëm një parti komuniste e fortë dhe me parime të shëndosha marksiste-leniniste. Vërtet ekzistonte një parti komuniste në Jugosllavi, por ajo nuk i kishte plotësisht këto tipare, as i fitoi gjatë kohës së luftës. Përkundrazi, edhe ato që kishte, i humbi pas luftës, kur nga rrethanat ishte e thirrur të ndërtonte Jugasllavinë e re në rrugën socialiste.

Po të dëgjosh vetëlavdërimet e titistëve dhe të borgjezisë jugosllave, mund të besosh se një parti e tillë ka ekzistuar dhe ekziston. Në këtë gjykim euforik, ashtu si edhe të tjerët, ramë edhe ne, komunistët shqiptarë, veçanërisht gjatë kohës së luftës dhe në vitet e para të pasçlirimit.

Ky gjykim kishte logjikën e vet, lidhej me luftën heroike të popujve të Jugosllavisë, që udhëhiqej nga Partia Komuniste.

Pas çlirimit të Jugosllavisë, si në teori, si në qëndrimet politike, ashtu edhe në ndërtimin e socializmit u dukën shmangie të mëdha nga parimet bazë të marksizëm-leninizmit. Gjithashtu në marrëdhëniet me vendet socialiste, veçanërisht me Shqipërinë, nga ana e Partisë Komuniste të Jugosllavisë u vunë re devijime të rënda, një arrogancë e një mendjemadhësi e huaj për një parti komuniste.

Ishte e qartë se kjo rrugë do të përfundonte në çarje, siç ndodhi, jo për fajin e Byrosë Informative, as të Stalinit dhe as të «stalinizmit», sikurse duan ta cilësojnë marksizëm-leninizmin revizionistët jugosllavë dhe miqtë e tyre. Konflikti me Informbyronë ishte rezultat i kontradiktave ndërmjet pikëpamjeve liberale-oportuniste të udhëheqjes jugosllave dhe pikëpamjeve marksiste-leniniste mbi ndërtimin e shtetit dhe të shoqërisë socialiste. Kundërshtimit të teorisë marksiste-leniniste Titoja dhe shokët e tij i dhanë ngjyrën e kundërshtimit ndaj Stalinit në fillim dhe ndaj sistemit socialist sovjetik më vonë.

Kthesa e titistëve duhej të bëhej dhe u bë. Ata morën kursin drejt kapitalizmit, duke adoptuar dhe duke i hyrë një ndërtimi «të ri» ekonomiko-shoqëror dhe një forme të re qeverisjeje shtetërore, të përshtatshme me kursin antisocialist, siç ishte sistemi i «vetadministrimit punëtor». Në fakt ky nuk ishte një sistem i ri. Ai nuk ishte as socialist dhe as krijim jugosllav. Prejardhjen e vet e kishte nga prudonizmi, nga anarkizmi i Bakuninit dhe i Kropotkinit, aq shumë të demaskuar nga Marksi në kohën e vet, më vonë nga Lenini, pastaj edhe nga Stalini.

Kthesës jugosllave drejt kapitalizmit iu bë një reklamë e shfrenuar, një hosanà e papërshkruar dhe «Barabait» një lavdë e madhe. Deviacioni jugosllav u trumbetua si një «periudhë e re», si një «brazdë e re», e çarë nga Titoja për ndërtimin e një «socializmi specifik», «human». Kjo kthesë u mbështet dhe u financua nga imperializmi dhe kapitalizmi botëror. U fry megalomania panjugosllave dhe Jugosllavia u paraqit si «kampione dhe shembull për popujt e botës në luftën e tyre çlirimtare».

I gjithë «sistemi vetadministrues» në formë dhe në emërtimet e strukturës e të superstrukturës, duhej të tregohej se ishte «marksist». Por në të vërtetë ai ishte krejt në kundërshtim me Marksin dhe me teorinë e praktikën e leninizmit.

Goditja e parë iu dha pushtetit të demokracisë popullore, që ishte një formë e diktaturës së proletariatit dhe që në Jugosllavi nuk e cilësuan kurrë si të tillë. Këtë revizionistët jugosllavë e justifikuan duke pretenduar se pushteti i këshillave popullorë, që u vendos gjatë luftës dhe jetoi deri në vitin 1948, nuk mund të ruhej më si i tillë me të gjitha prerogativat e tij. Ai duhej zëvendësuar me «këshillat e punëtorëve», pse, sipas tyre, i pari ishte gjoja etatist-burokratik, që lind «burokracinë dhe shtresën e borgjezisë së re», kurse «këshillat e punëtorëve» ishin një pushtet më i afërt me teorinë e Marksit. Nëpërmjet tyre gjoja «janë vetë punëtorët që drejtojnë dhe qeverisin drejtpërdrejt» pa

ndërmjetësinë e shtetit që, sipas logjikës së udhëheqjes jugosllave, duhet të rezultojë se nuk është i tyre. Shteti aktual jugosllav mbetet, pra, vetëm një «garant» që ky «sistem i ri» të mos preket, të mos shkoqet dhe për këtë Federata mban në duart e veta ushtrinë, UDB-në, politikën e jashtme dhe asgjë tjetër.

Pra, «sistemi i vetadministrimit» e decentralizoi, e liberalizoi dhe e minoi pushtetin e diktaturës së proletariatit. Shteti ishte i «proletarëve» dhe u bë i «punëtorëve», ishte «i dalë nga lufta, i dalë nga baza», ndërsa «sistemi i ri», që e kërkonte gjoja zhvillimi «dialektik», u vendos nga lart, nga Titoja e Kardeli.

Roli udhëheqës i partisë në këtë sistem duhej të likuidohej dhe në fakt ai u venit. Partisë iu la vetëm njëfarë roli i shpëlarë edukues, pa asnjë zë në gjithë kapitullin. Në pamje partia nuk u zhduk, por në realitet u bë e paqenë. Atë e quajtën «Lidhja e Komunistëve», që nga emri t'ia afronin sa më shumë apelacionit të Marksit, për ta larguar në fakt sa më shumë nga roli që Marksi dhe Lenini i përcaktojnë partisë komuniste.

Titistët e paraqesin çështjen sikur Jugosllavia me «vetadministrimin» ka hyrë në një etapë zhvillimi që e afron me shoqërinë komuniste. Duke u nisur nga kjo, ata pretendojnë se shteti po shkon drejt shuarjes dhe partia nuk mund të ketë më atë rol e ato funksione që kishte në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm.

Jo vetëm kaq, por «vetadministrimi», sipas tyre, ka zhdukur, gjithashtu, luftën e klasave brenda në parti, brenda në Jugosllavi dhe jashtë saj. Në të vërtetë Titoja, Kardeli dhe njerëzit që i pasonin, ia ndërruan drejtimin luftës së klasave. Ata e zhvilluan dhe e zhvillojnë atë për të mbrojtur sistemin e tyre «vetadministrues» kundër «informbyroistëve», «stalinistëve», «dogmatikëve» etj. Në të vërtetë këtu është fjala për luftën e elementëve kapitalistë kundër njerëzve revolucionarë, të sistemit kapitalist kundër sistemit socialist, të ideologjisë borgjeze kundër marksizëm-leninizmit.

Teoricienët jugosllavë bëjnë spekulime të mëdha lidhur me pronën mbi mjetet e prodhimit. Sipas tyre, prona e shoqërizuar mbi mjetet e prodhimit që ekziston në sistemin «vetadministrues», përbën formën më të lartë të pronës socialiste, ndërsa prona shtetërore formën më të ulët të saj. Kjo e fundit, pretendojnë ata, mund të përcaktohet si një lloj kapitalizmi shtetëror nga ku lind një kastë e re burokratike, që në fakt disponon në mënyrë kolektive të drejtën mbi pronën. Pra prona shtetërore edhe në socializëm, konkludojnë ata, nuk e zhduk tjetërsimin e punëtorit që bëhet nga kapitali. Raporti kapitalist fitime-rroga e punëtorit zëvendësohet me raportin akumulacion shtetëror-rroga e punëtorit. Me fjalë të tjera, sipas tyre, në të dy sistemet shoqërore punëtori mbetet kurdoherë rrogëtar.

Kjo është një tezë e njohur trockiste, e demaskuar dhe e hedhur poshtë prej kohësh. Në shoqërinë e vërtetë socialiste, ku prona e përbashkët drejtohet nga shteti i diktaturës së proletariatit me pjesëmarrjen e gjerë, të organizuar dhe efektive të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, sipas parimit të centralizmit demokratik, dhe

ku në shpërndarjen e produktit shoqëror nuk lejohen diferencime të mëdha që çojnë në krijimin e shtresave të privilegjuara, punëtori nuk është rrogëtar, ai nuk shfrytëzohet. Provë për këtë është realiteti i Shqipërisë socialiste, ku klasa punëtore është klasë në fuqi, që, nën udhëheqjen e Partisë së saj marksiste-leniniste drejton ekonominë dhe tërë jetën e vendit në interes të saj dhe të mbarë popullit.

«Vetadministrimi» jugosllav, i cili gjoja vë në qendër punëtorin, vetëm në teori ka emrin punëtor, në praktikë ai është antipunëtor, është antisocialist. Ky sistem, pavarësisht nga zhurma që bëjnë titistët, nuk e lejon klasën punëtore as të drejtojë, as të administrojë.

Në Jugosllavi çdo ndërmarrje «vetadministruese» është një organizatë e mbyllur në aktivitetin e saj ekonomik, ndërsa politika e administrimit është në duart e grupit udhëheqës të saj, i cili, njëlloj si në çdo vend tjetër kapitalist, manipulon fondet e akumulimit, vendos për investimet, rrogat, çmimet dhe shpërndarjen e prodhimit. Pretendohet se i gjithë ky veprim ekonomiko-politik aprovohet nga punëtorët nëpërmjet të deleguarve të tyre. Por ky është një mashtrim e një blof i madh. Këta të ashtuquajtur të deleguar të punëtorëve bëjnë kauzë të përbashkët me kastën e burokratëve dhe të teknokratëve në fuqi në kurriz të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse. Janë administratorët profesionistë ata që bëjnë ligjin dhe përcaktojnë politikën në organizatën «vetadministruese» që nga baza deri lart në republikë. Roli drejtues, administrativ, ekonomiko-shoqëror dhe politik i punëtorëve, i klasës së tyre është reduktuar në minimum, për të mos thënë është zhdukur fare.

Duke nxitur partikularizmin e lokalizmin, nga ai republikan në atë krahinor e deri në komunë, «sistemi vetadministrues», ka likuiduar unitetin e klasës punëtore, i ka vënë punëtorët në luftë me njëri-tjetrin, si individë, duke ushqyer egoizmin, dhe si kolektiv, duke ushqyer konkurrencën ndërmjet ndërmarrjeve. Mbi këtë bazë është minuar edhe aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, e cila gjithashtu është e copëtuar në ekonomi të vogla private dhe shfrytëzohet nga borgjezia e re në fuqi. E gjithë kjo ka krijuar autarkinë në ekonomi, anarkinë në prodhim, në shpërndarjen e fitimeve dhe të investimeve; në treg, në çmimet ajo ka çuar në inflacion e në papunësi të madhe.

Qenia e klasës punëtore në udhëheqjen e sistemit «vetadministrues punëtor» në Jugosllavi, është një iluzion i rremë, një utopi. Në këtë sistem klasa punëtore nuk është në drejtim, nuk është hegjemone. Diktatura e proletariatit është likuiduar, udhëheqja e klasës punëtore, partia komuniste, ose siç quhet në këtë vend Lidhja e Komunistëve, nuk drejton as pushtetin, as ekonominë, as kulturën, as jetën shoqërore.

Në këtë sistem rrëmuje të përgjithshme dikush tjetër i ka marrë pozitat dominuese e drejtuese politike. Kjo është kasta e re e burokratëve politikë dhe e teknokratëve, e dalë nga shtresa e inteligjencies së borgjezuar dhe e aristokracisë punëtore. Ajo është larg çdo morali proletar dhe mbi të nuk ushtrohet asnjë kontroll politik.

Kjo shtresë e re burokratike vetëtrumbetohet si armike e burokracisë etatiste, kurse ajo është një burokraci akoma më e rrezikshme, që

lulëzon e forcohet në një sistem ekonomik të decentralizuar, i cili ruan dhe zhvillon pronën private.

«Vetadministrimi punëtor», që ka në themel të tij ideologjinë e anarkosindikalizmit, ka pjellë nacionalizmin republikan, që ka hartuar deri edhe ligje e rregullore të veçanta për të mbrojtur interesat e veta të ngushta. Monopoli ekonomik i republikave, që përbëhet nga monopoli i ndërmarrjeve dhe i trusteve të tyre, është kthyer në fakt në një fuqi politike dhe në një nacionalizëm republikan, që shfaqet jo vetëm në çdo republikë, por në çdo krahinë, në çdo komunë, në çdo ndërmarrje. Cilido, si individ, si grup, si republikë, përpiqet si e si të pasurohet më shumë dhe më shpejt në kurriz të tjetrit.

Nacionalizmi borgjez është shtruar pajdash në Jugosllavi dhe parulla «bashkim-vëllazërim», që ishte e drejtë gjatë luftës nacionalçlirimtare, kur luftohej kundër pushtuesve dhe reaksionit të vendit për një shoqëri të re të bazuar në marksizëm-leninizmin, në sistemin aktual jugosllav, i cili përçan e shpërndan çdo gjë, ka mbetur një parullë boshe e pa asnjë efekt. «Bashkim-vëllazërimi» i popujve, i kombeve dhe i kombësive, i republikave dhe i krahinave mund të realizohet vetëm në një sistem të vërtetë socialist, që udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste.

Bashkimi federativ jugosllav nuk u krijua mbi baza marksiste-leniniste, prandaj, pa asnjë dyshim, do të lindnin, siç lindën, antagonizmat nacionalë. Vetë sistemi i bart këto kontradikta, ushqen separatizmin e kombeve dhe të kombësive, të republikave dhe të krahinave.

Edhe kreditë e shumta të kapitalizmit botëror vepruan në këtë drejtim. Përdorimi i tyre për të kënaqur gustot dhe kapriçot borgjeze e megalomane të kastës në fuqi, shpërndarja e pabarabartë dhe pa kritere të shëndosha midis republikave të ndryshme, krijoi disnivele ekonomike dhe shoqërore në republikat e në krahinat, çka i thellon më tej antagonizmat nacionalë.

Sistemi i «vetadministrimit» nuk do të kishte pasur jetë të gjatë po të mos e kishin ndihmuar dy faktorë: antisovjetizmi i udhëheqjes jugosllave, që nuk ishte tjetër veçse antimarksizmi e antileninizmi i saj, me të cilin ajo siguroi përkrahjen politike të tërë reaksionit botëror dhe mbështetja ekonomike me anë kredish të mëdha e të gjithanshme nga vendet kapitaliste. Por, megjithëkëtë, këta dy faktorë nuk mundën ta shpëtonin këtë sistem antisocialist. Përkundrazi, ata e dobësuan më tej atë dhe e shtynë drejt falimentimit ekonomik dhe politik.

Fajin për dështimin e këtij sistemi dhe për të gjitha të këqijat që lindën prej tij, Kardeli me Titon ia hidhnin «mosperfeksionimit» sa duhet të vetë sistemit, ndërgjegjes së punonjësve «që nuk ishte ngritur akoma sa duhet», ekzistencës së burokracisë etj. Ata e panë falimentimin e sistemit të tyre antisocialist, por nuk mund të tërhiqeshin dot prapa. Prandaj janë paliative edhe të gjitha masat që mori Titoja, që kur ishte gjallë, për drejtimin e Federatës e të republikave pas vdekjes së tij. Bashkë me Titon e Kardelin u zhduk edhe euforia për sistemin «vetadministrues». Pasardhësit e Titos ndodhen në një konfuzion e çoroditje të madhe dhe nuk dinë nga të kapen për të dalë nga situatat e vështira në të cilat gjendet vendi i tyre. Tash Jugosllavia titiste ka hyrë në një krizë të rëndë e të përgjithshme të strukturave e të superstrukturave të saj, në një krizë ekonomike e politiko-morale.

Revizionizmi sovjetik ka qenë dhe mbetet rryma më e rrezikshme e revizionizmit modern. Ai ruan më shumë se çdo variant tjetër revizionist maskat socialiste e frazeologjinë leniniste për të mbuluar realitetin e sotëm kapitalist në Bashkimin Sovjetik dhe politikën e tij të jashtme imperialiste e agresive. Ai është një revizionizëm që ka marrë pushtetin në një shtet i cili përfaqëson një fuqi të madhe dhe që ka mjete e mundësi të shumta të ushtrojë ndikimin e tij në botë, të veprojë në shumë drejtime e në përpjesëtime të mëdha.

Ashtu si korrentet e tjera revizioniste, edhe revizionizmi hrushovian ka procesin e tij të lindjes e të zhvillimit, derisa arriti në formën e sotme të një revizionizmi të plotë, që deformon të gjitha çështjet e teorisë marksiste e të praktikës socialiste. Si një fenomen shoqëror, edhe revizionizmi hrushovian ka rrënjët e shkaqet e tij ideologjike, shoqërore e historike.

Partia e Punës e Shqipërisë u ka bërë një analizë të thellë marksiste këtyre shkaqeve. Nga kjo analizë ajo ka nxjerrë konkluzione dhe ka marrë një varg masash për t'i mbyllur shtigjet lindjes së një fenomeni të tillë regresiv në vendin tonë. Por në këtë problem ne duhet të thellohemi vazhdimisht, me qëllim që revizionizmi kurrë të mos kalojë në Shqipëri.

Grupi i Hrushovit qysh në fillim i vuri vetes si qëllim kryesor të likuidonte diktaturën e proletariatit, të minonte bazat e shoqërisë socialiste, ta fuste Bashkimin Sovjetik në rrugën kapitaliste dhe ta kthente atë në një superfuqi imperialiste. Tani të gjithë e shohim këtë transformim të madh kundërrevolucionar që ka ndodhur në Bashkimin Sovjetik. Vetëm borgjezia dhe imperializmi e reklamojnë atë si vend komunist. Duke e paraqitur Bashkimin e sotëm Sovjetik kapitalist si vend socialist, ata duan të diskreditojnë marksizëm-leninizmin dhe socializmin e vërtetë.

Revizionizmi hrushovian është ideologjia dhe politika e kapitalizmit shtetëror që sundon në tërë jetën e vendit. Kthimi në kapitalizëm i Bashkimit Sovjetik nuk mund të mos kishte veçoritë e veta dhe rendi kapitalist këtu nuk mund të mos merrte forma të posaçme. Këto veçori e forma përcaktohen nga fakti se atje kapitalizmi u rivendos si rezultat i përmbysjes së socializmit, si një proces regresiv, ndryshe nga kapitalizmi i tipit klasik që vjen pas përmbysjes së rendit feudal, si një proces progresiv.

Veçoria themelore e këtij lloj kapitalizmi është se këtu ruhen shumë forma socialiste të pronës, të organizimit e të drejtimit, por përmbajtja e tyre ka ndryshuar rrënjësisht. Mjetet e prodhimit sot në Bashkimin Sovjetik janë në fakt pronë kapitaliste, shtetërore ose kolektive, sepse përdoren në interes të klasës së re borgjeze që është në fuqi, sepse është pikërisht kjo klasë që përvetëson punën e punëtorëve e të fshatarëve.

Ligjet, traditat dhe praktikat e vjetra u zëvendësuan me të reja, që i lënë burokracisë shtetërore e asaj të partisë dorë të lirë për të

shprehur e zbatuar pa pengesë vullnetin e vet. Kompetencat e reja që u morën nga ajo në bazë të reformave ekonomike, u përdorën për të siguruar e zgjeruar të ardhurat e privilegjet e kastave të ndryshme drejtuese, për të ruajtur pushtetin e për t'u mbrojtur nga pakënaqësitë e revoltat e klasës punëtore dhe të masave punonjëse.

Vërtet mbeti prona shtetërore dhe fabrikat nuk iu shpërndanë privatëve, kolkozet mbetën ekonomi kolektive të përbashkëta dhe bankat nuk iu dhanë aksionistëve, por ajo që ndryshoi ishte shpërndarja e produktit shoqëror, destinacioni i tij.

Ndonëse thuhet se zbatohet parimi i shpërblimit sipas punës, në realitet grupet e ndryshme të borgjezisë së re përvetësojnë mbivlerën e krijuar nga punëtorët e fshatarët. Gjithë kjo grabitje paraqitet si një lloj stimulimi material, gjoja për nxitjen e veprimtarisë prodhuese, të punës shkencore e të krijimtarisë artistike etj. Në të vërtetë ky është një shfrytëzim tipik kapitalist.

Për t'i hapur rrugën rivendosjes së kapitalizmit, revizionistët hrushovianë goditën tezat themelore të teorisë marksiste-leniniste mbi prodhimin e mallrave dhe veprimin e ligjit të vlerës në socializëm. Në teori dhe në praktikë ata identifikuan prodhimin socialist të mallit me prodhimin kapitalist. Mbi këtë bazë ata reformuan gjithë mekanizmin ekonomik. Gradualisht ndërmarrjet ekonomike, por edhe mjaft institucione kaluan në një pavarësi më të madhe nga plani shtetëror. Drejtuesve të ndërmarrjeve e të institucioneve të ndryshme u janë dhënë të drejta e fuqi të mëdha për të drejtuar dhe manipuluar prodhimin dhe shpërndarjen, për të marrë në punë dhe për të pushuar nga puna, për të ndarë fitimet etj. U kufizua financimi i centralizuar shtetëror për ndërmarrjet ekzistuese dhe u zgjerua gradualisht përdorimi i vetëfinancimit dhe i kreditit.

Revizionistët sovjetikë pretendojnë se ekonomia e tyre drejtohet e zhvillohet në bazë të planeve që hartohen gjoja sipas parimit të centralizmit demokratik. Mirëpo plani shtetëror, ashtu siç e konceptojnë në teori dhe siç e zbatojnë ata në praktikë, nuk është dhe nuk mund të jetë në asnjë mënyrë një plan i një ekonomie të vërtetë socialiste. Në Bashkimin Sovjetik bashkëjetojnë centralizmi burokratik i tipit monopolist me liberalizmin ekonomik të gjerë në bazë. Jepet imazhi i një drejtimi të planifikuar të ekonomisë, ndërsa në praktikë kanë fushë të lirë veprimi ligjet dhe kategoritë ekonomike të mënyrës kapitaliste të prodhimit.

Konsumi parazitar ka marrë përpjesëtime të papara. Raporti i shpërblimit midis punëtorëve e administratorëve burokratë e teknokratë të prodhimit, në bazë të pagës nominale arrin mbi 1 me 10, kurse së bashku me të ardhurat nga ndarja e fitimeve, nga shpërblimet e shumëllojshme, nga privilegjet e panumërta e të tjera, këto raporte distancohen me shifra akoma më të mëdha. Këto diferenca në paga dhe në mënyrën e jetesës zor se dallohen nga ato që ekzistojnë ndërmjet administratorëve borgjezë dhe punëtorëve në vendet e Perëndimit.

Në kushtet kur paga për vlerën e fuqisë punëtore në masën 35 deri 40 për qind formohet në mënyrë të decentralizuar nga shpërndarja e

fitimeve, kur normat e punës nuk janë unike dhe zbatohen, gjithashtu, në mënyrë të decentralizuar, kur stimuli material në favor të borgjezisë së re ka përparësi absolute dhe kur inflacioni, sidomos për shkak të militarizimit të ekonomisë, që gëlltit 1/3 e të ardhurave kombëtare, rritet vazhdimisht, shoqëria në thelb e ka humbur kontrollin e vërtetë mbi masën e punës e të konsumit, të cilët janë dy çelësa kryesorë për një ekonomi socialiste.

Këto dhe një varg masash të tjera me karakter kapitalist, që u trumbetuan si zhvillim krijues i teorisë dhe i praktikës ekonomike marksiste-leniniste, kishin si synim dhe çuan në shkallmimin e bazave të ekonomisë socialiste.

Pasojat e këtij kursi duken në jetën e përditshme të popullit sovjetik. Në treg ka mungesa të artikujve të dorës së parë, është rritur inflacioni, papunësia, fluktuacioni i fuqisë punëtore, vihet re ngritja e shpallur dhe e pashpallur e çmimeve të mallrave të ndryshme. Është zgjeruar sektori privat i ekonomisë, i janë hapur dyert kapitalit të huaj monopolist, lulëzojnë tregu i zi, spekulimet, shpërdorimet, ryshfetet e mashtrimet.

Realiteti i sotëm sovjetik tregon se procesi nuk shkon drejt «zhdukjes së dallimeve klasore» dhe «krijimit të një uniteti të ri social», siç propagandojnë revizionistët hrushovianë-brezhnjevianë, por drejt një diferencimi të thellë shoqëror ndërmjet klasës së re borgjeze, të përbërë nga shtresa e burokratëve dhe e teknokratëve, dhe masave të gjera punonjëse, të cilat ndodhen në pozitat e një force thjesht prodhuese. Hendeku midis tyre vjen vazhdimisht duke u thelluar sa më shumë rritet shkalla e shrytëzimit të punonjësve dhe sa më shumë shtohen përfitimet e borgjezisë. Kjo gjendje ka krijuar edhe një ideologji e politikë të tërë, që justifikon e mbron këtë sistem të ri të shfrytëzimit kapitalist.

Pushteti i sovjetëve nuk është më i sovjetëve, i punëtorëve dhe i fshatarëve. Ai është shkëputur prej tyre dhe është bërë si një forcë më vete dhe e huaj për ta. Edhe formalisht revizionistët hrushovianë e kanë shpallur të likuiduar diktaturën e proletariatit. Shtetin e kanë quajtur të të gjithë popullit për të fshehur realitetin se ai nuk është më i popullit, por një diktaturë e borgjezisë së re sovjetike. Karakteri kapitalist i tij duket qartë nga tërë politika e brendshme dhe e jashtme që ai ndjek, politikë që u shërben interesave të klasës borgjeze në fuqi. Shteti sovjetik, që ka në duart e tij mjetet kryesore të prodhimit dhe drejton tërë ekonominë, është shndërruar në një përfaqësues e mbrojtës të interesave të klasës sunduese.

Revizionistët sovjetikë, për të ruajtur maskat e tyre socialiste dhe «për të vërtetuar» se Bashkimi Sovjetik është një vend socialist, thonë se atje ka vetëm një parti, se kjo është një parti komuniste dhe se roli i saj udhëheqës është sanksionuar me kushtetutë. Fakti që ka vetëm një parti drejtuese dhe që pushteti i saj i pandarë njihet me ligj nuk e bën që ajo të jetë komuniste. Ka shumë vende borgjeze ku ka një parti të vetme sunduese. Karakterin e një partie politike nuk e përcakton pozita e saj në shtet. Karakteri i një partie përcaktohet, në radhë të

parë, nga fakti se cilës klasë i përket dhe kujt i shërben, nga ç'ideologji udhëhiqet e ç'politikë ndjek.

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik aktualisht është përfaqësuesja e drejtpërdrejtë e klasës borgjeze në fuqi, ushtron pushtetin në emër të saj, i shërben zhvillimit dhe forcimit të rendit kapitalist të restauruar. Ajo vetëm emrin ka komuniste. Mbajtja e emrit komunist dhe përdorimi nga ana e saj i disa frazave marksiste e parullave socialiste kanë një karakter hipokrit e thjesht demagogjik. Kjo bën pjesë në atë propagandë mashtruese që kërkon t'i mbajë masat në errësirë dhe t'i bëjë të besojnë se jetojnë në socializëm dhe jo në një shoqëri kapitaliste, shtypëse e shfrytëzuese. Për traditë, për maskim, ose thjesht për inerci, shumë partive u kanë mbetur apelacionet «demokratike», «popullore», «socialiste» etj. në një kohë kur ato janë tipike borgjeze e reaksionare.

Politika revizioniste e kapitaliste që zbatohet në Bashkimin Sovjetik, ka ngjallur demonët e vjetër të perandorisë cariste, siç janë shtypja nacionale, antisemitizmi, racizmi sllav, misticizmi fetar ortodoks, kulti i kastave ushtarake, aristokratizmi i inteligjencies, çinovnizmi burokratik etj. Teoritë e revizionistëve sovjetikë mbi krijimin gjoja të një «bashkësie të re historike», të «popullit unik sovjetik» janë shpikur pikërisht për të fshehur këtë realitet plot kontradikta të thella sociale, klasore e nacionale.

Ajo që dominon sot në Bashkimin Sovjetik është forca e ushtrisë sovjetike. Militarizimi i sforcuar i jetës së vendit, barra e rëndë e shpenzimeve ushtarake, që kanë arritur shifra astronomike dhe po e tronditin gjithnjë e më shumë ekonominë sovjetike, deformojnë zhvillimin e saj, varfërojnë popullin.

Rivendosja e kapitalizmit brenda vendit nuk mund të mos çonte edhe në një përmbysje të madhe në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare e të politikës së jashtme të partisë komuniste e të shtetit sovjetik. Revizionizmi hrushovian u shndërrua gradualisht në ideologji e politikë të superfuqisë së re imperialiste, që justifikon e mbron ekspansionin, agresionin e luftërat për vendosjen e sundimit botëror. Pjellë e kësaj ideologjie e politike janë teoritë famëkeqe të «sovranitetit të kufizuar», të «ndarjes ndërkombëtare të punës», të «integrimit ekonomik, politik e ushtarak» të vendeve të së ashtuquajturës bashkësi socialiste, të cilat u kanë lidhur këtyre vendeve duar e këmbë, i kanë shndërruar në shtete vasale. Këto marrëdhënie Brezhnjevi në Kongresin e 26-të të PK të BS i quajti «marrëdhënie midis popujve», për të fshirë kështu çdo identitet kombëtar e shtetëror.

Për të realizuar objektivat e tij ekspansionistë e neokolonialistë, socialimperializmi sovjetik ka krijuar një teori, sipas së cilës asnjë vend nuk mund të çlirohet e të mbrohet nga imperializmi dhe të zhvillohet në mënyrë të pavarur pa ndihmën e tutelën sovjetike. Ai spekulon me parullën e «ndihmës internacionaliste» për të ndërmarrë agresione e për të grabitur pasuritë e vendeve të tjera.

Gjithë politika e jashtme ekspansioniste, hegjemoniste e agresive e Bashkimit Sovjetik socialimperialist është një provë dhe një dëshmi

tjetër se rendi sovjetik është një rend kapitalist, sepse vetëm një rend i tillë mund të ndjekë një politikë të tillë në arenën ndërkombëtare. Siç ka thënë Lenini, politika e jashtme është vazhdim i politikës së brendshme dhe të dyja së bashku janë shprehje e koncentruar e marrëdhënieve ekonomike që ekzistojnë në një vend. Maskat socialiste e komuniste që përpiqen ende të ruajnë revizionistët sovjetikë, po u grisen çdo ditë përballë realitetit të tyre kapitalist e politikës socialimperialiste që ata ndjekin.

Sa do të vazhdojë të zërë vend mashtrimi i madh i popullit sovjetik se gjoja rron në socializëm, sa do të vazhdojë klasa punëtore sovjetike të jetojë me iluzione, varet nga shumë faktorë, të brendshëm e të jashtëm. Kuptimplote për situatat që i presin vendet ku sundon revizionizmi hrushovian janë ngjarjet e Polonisë. Fakt është se këtu shpërtheu konflikti klasor midis punonjësve dhe klasës borgjeze në fuqi të përfaqësuar nga partia revizioniste. Pavarësisht se si u manipulua nga forcat e djathta, në thelb revolta e klasës punëtore polake tregon se ajo u bë e ndërgjegjshme për pozitën e saj si klasë e shtypur dhe e shfrytëzuar, se pushteti ekzistues në Poloni i përket një klase antagoniste me të, se socializmi është tradhtuar. Kush do të vijë pas Polonisë? Proceset e diferencimit klasor ziejnë në të tëra vendet revizioniste. Konfliktet klasore po rriten me shpejtësi. Nga këto nuk bën përjashtim as Bashkimi Sovjetik, megjithëse në pamjen e jashtme duket si më i qëndrueshmi ndërmjet tyre. Plagët që ka hapur restaurimi i kapitalizmit, mund të shërohen vetëm me përmbysjen e revizionizmit dhe me rivendosjen e socializmit.

Partia jonë ka zhvilluar një luftë të madhe, të hapur e parimore kundër revizionizmit kinez, ideologjisë, politikës, qëndrimeve dhe veprimeve të Partisë Komuniste të Kinës. Revizionizmi kinez është një korrent oportunist në lëvizjen komuniste botërore dhe maocedunideja, baza e tij, është një ideologji me tipare arkaike, një amalgamë teorish të vjetra kineze të Konfucit e të Mencit dhe teorish të reja të perifrazuara, pa një lidhje organike e strukturore, të lyera me një frazeologji marksiste. Maocedunideja përfaqëson një ideologji hegjemoniste të sundimit botëror, të bazuar në një bagazh teoremash dhe mendimesh heterogjene, kontradiktore dhe pragmatiste. Në ujërat e kësaj ideologjie lundronte barka kineze sa djathtas e majtas, me një drejtim të çoroditur, kur Kina filloi ndërtimin e shtetit të ri kinez të dalë nga lufta çlirimtare. Këtej vinin ato lëkundje të Kinës dhe ai karakter i papërcaktuar i sistemit politik dhe ekonomik të saj.

Teoria që udhëhiqte Kinën e re nuk ishte marksizëm-leninizmi. Penelatat marksiste të fasadës të linin përshtypjen e rreme se ekzistonin disa tipare të socializmit shkencor. Ato pengonin që të dalloheshin qartë deviacionet e vazhdueshme.

Kur në Kinë theksohej roli i diktaturës së proletariatit, nën të fshihej dhe zhvillohej diktatura e grupeve rivale dhe e personaliteteve. Kur theksohej roli udhëheqës i partisë, nën të fshihej një organizim kaotik dhe një udhëheqje e paqenë e saj. Kur flitej për hegjemoninë e klasës punëtore, roli udhëheqës në fakt i lihej fshatarësisë, sepse ishte ideologjia e saj mikroborgjeze që sundonte në Kinë. Kur flitej për ndry-

shimin e strukturave klasore, në thelb asgjë nuk lëvizte nga vendi.

Ekonomia kineze ecte duke çaluar rëndë pa orientime dhe perspektiva të qarta, pavarësisht nga ekzistenca e njëfarë plani që as për së largu nuk kishte tiparet shkencore dhe ca më pak të një plani të bazuar në një sistem të centralizuar. Bile ai nuk kishte as tiparet e një plani të decentralizuar. Ekonomia kineze ecte për inerci.

Në këtë organizim dhe në këtë ideologji pa shtyllë kurrizore dominonte ideja e hegjemonizmit të shtetit të madh kinez, që «ishte thirrur nga historia» të përfaqësonte modelin e ri të shoqërisë socialiste, të përfaqësonte «marksizëm-leninizmin e kohërave të reja», që ishte maocedunideja.

Duhej të dallonim në këtë zhvillim të Kinës se nën petkun e «revolucionit» fshihej kundërrevolucioni, se nën petkun e maocedunidesë fshihej antimarksizmi, fshihej një rrymë e revizionizmit modern që kërkonte forma e struktura politike, ideologjike, organizative dhe shtetërore të përshtatshme për «kontinentin kinez» dhe për aspiratat e tij kapitaliste e imperialiste.

«Antiimperializmi», «antisovjetizmi», «antiamerikanizmi» i Kinës së Mao Ce Dunit, që alternoheshin ndërmjet tyre, ishin koniunkturalë. Ata nuk ishin bindje ideologjike, nuk ishin qëndrime parimore, por manovra për balancimin e pushteteve të fuqishme në botë, një lojë me fuqitë politiko-ushtarake imperialiste për fuqizimin e Kinës në skakierën botërore.

Me këto botëkuptime, me këto qëndrime eklektike e oportuniste, si në planin e brendshëm të Kinës, ashtu edhe në atë të jashtëm, u zhvillua «Revolucioni Kulturor Proletar» i hunveibinëve dhe po zhvillohet aktualisht «revolucioni» revanshist i pleqve reaksionarë e i të gjitha mbeturinave të Kinës së vjetër. Mbi këto baza u hartua teoria e pafat e «tri botëve» dhe e «aleancave të këtyre tri botëve», u bënë kthesat e forta kineze në politikën ndërkombëtare me rrjedhimë shumë të rrezikshme për paqen botërore.

Iu desh Partisë sonë një kohë pak a shumë e gjatë që të dallonte këtë rrugë antimarksiste të Partisë Komuniste të Kinës dhe të shtetit kinez, me të cilët ne kishim marrëdhënie të mira miqësore. Për Partinë tonë kishte rëndësi të madhe thelbi teoriko-politik i kësaj miqësie, kishte rëndësi çështja e luftës për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, çështja e socializmit dhe e revolucionit.

Në fillim ne bëmë një luftë parimore me debate, si në mes shokësh, por gradualisht ajo u ashpërsua për arsye të qëndrimeve antimarksiste të Kinës. Kjo ishte një luftë pa lëshime nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë, por edhe një luftë e pabarabartë dhe e vështirë. Po të mos bëhej kjo luftë, do të rrezikohej ndërtimi i socializmit në Shqipëri.

Rëndësia e luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë qëndronte në atë se ajo rrëzoi dy mite: atë të Kinës, si vend ku ndërtohej socializmi dhe atë të maocedunidesë, si marksizëm-leninizmi i kohës sonë. Në këtë luftë, për të mbrojtur parimet, Partia jonë mori parasysh çdo vështirësi ekonomike që mund t'i krijohej vendit.

Maocedunideja, e propaganduar si «zhvillimi i mëtejshëm shkencor i marksizëm-leninizmit», mund të influenconte, siç influencoi, në

lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe veçanërisht në disa parti marksiste-leniniste. Këto parti, për shumë rrethana, duke mos mundur dot t'i bënin një analizë të thellë kësaj rryme ideologjike revizioniste, mendonin se te Kina e madhe dhe te Mao Ce Duni kishin prijësit e revolucionit proletar, ndihmësit e vendosur në luftën kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, mbrojtësit e natyrshëm të luftërave të drejta nacionalçlirimtare të popujve.

Duhej të bëhej, pra, një luftë parimore dhe e vendosur për të zhgënjyer të gënjyerit. Këtë luftë e ndërmori Partia e Punës e Shqipërisë. Ky është një fakt i jetuar dhe i vërtetuar si në kohën kur rronte vetë Mao Ce Duni, ashtu edhe pas vdekjes së tij. Nga kjo luftë Shqipëria socialiste nuk u izolua në botë, siç pretendojnë revizionistët jugosllavë. E kundërta ngjau, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë i forcuan akoma më shumë pozitat e brendshme dhe ato ndërkombëtare.

Në këtë luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe për kundërshtimin e ideologjisë pseudomarksiste të maocedunidesë luftuan me mençuri, me vendosmëri revolucionare dhe dhanë një kontribut të vlefshëm edhe parti të tjera motra marksiste-leniniste.

Demaskimi i Kinës si vend josocialist dhe i maocedunidesë si një teori antimarksiste zhduku një iluzion të rrezikshëm në lëvizjen marksiste-leniniste ndërkombëtare, ashtu siç ngjau dhe me revizionizmin sovjetik, jugosllav dhe me rrymat e tjera reaksionare revizioniste.

Çdo maskim, çdo falsifikim, çdo devijim nga teoria shkencore e marksizëm-leninizmit nuk mund ta ketë jetën të gjatë. Ai shpejt ose vonë demaskohet, pse bie në kundërshtim me idealet e klasës punëtore, të popujve që luftojnë për çlirim, për demokraci të vërtetë, për socializmin, për një shoqëri pa shfrytëzues dhe të shfrytëzuar.

Zhvillimet e sotme në Kinë, gjithë politika e brendshme dhe e jashtme e udhëheqjes kineze, vërtetojnë se analizat dhe konkluzionet e Partisë së Punës të Shqipërisë ishin plotësisht të sakta e të drejta. Udhëheqja kineze i la fushë të lirë zhvillimit të ekonomisë kapitaliste, i hapi dyert vërshimit të kapitaleve të huaja skllavëruese, u bashkua në një aleancë të ngushtë me imperializmin amerikan dhe me reaksionin më të zi ndërkombëtar. Kina doli hapur si një fuqi imperialiste agresive e me pretendime për hegjemoni në botë. Ajo është bërë një nga qendrat kryesore të kundërrevolucionit botëror, që lufton me të gjitha mjetet për të penguar çlirimin e popujve, për të mbytur revolucionin. Revizionizmi kinez ka dalë sot si një rrymë e hapët reaksionare, ai ka prerë çdo lidhje jo vetëm me lëvizjet revolucionare e çlirimtare, por edhe me çdo lëvizje demokratike e përparimtare. Në çdo rast ai mban anën e forcave më të errëta, më obskurantiste e fashiste në botë.

Rrëmuja, çoroditjet, konfuzioni e përleshjet që kanë ndodhur e po ndodhin në Kinë, janë pasojë e drejtpërdrejtë e maocedunidesë. Kritika që i bëjnë sot udhëheqësit kinezë Mao Ce Dunit, nuk ka të bëjë aspak me kritikën marksiste që i bëjmë ne. Ajo nuk lidhet me përmbajtjen e ideve të tij, të cilat udhëheqësit e sotëm kinezë i ruajnë dhe i zbatojnë

në praktikë. Kritika e tyre është shprehje e luftës për pushtet midis grupeve të ndryshme maoiste rivale. Mao Ce Dunin këto grupe nuk mund ta hedhin poshtë, pse në idetë e tij të gjithë gjejnë mbështetje e justifikim për veprimet e tyre. Proletariati dhe populli kinez, pa u çliruar nga maocedunideja, nuk do ta gjejë dot rrugën e drejtë që çon në socializëm.

Partia e Punës e Shqipërisë edhe në të ardhmen do të vazhdojë me konsekuencë luftën parimore për demaskimin e plotë të revizionizmit kinez, për të vënë një kufi të qartë e të prerë midis marksizëm-leninizmit dhe ideve antimarksiste të Mao Ce Dunit. Pa denoncuar e hedhur poshtë maocedunidenë, pa luftuar e çrrënjosur çdo ndikim të saj në lëvizjen revolucionare nuk mund të flitet seriozisht për luftë kundër revizionizmit kinez dhe as kundër revizionizmit modern në tërësi, nuk mund të konsolidohet e të zhvillohet si duhet lëvizja marksiste-leniniste dhe të çohet përpara me sukses çështja e revolucionit.

Sa më shumë thellohen kontradiktat e kapitalizmit e të imperializmit dhe sa më shumë afrohet vala e revolucionit, aq më tepër zbulohet fytyra antimarksiste e kundërrevolucionare e korrentit tjetër revizionist, e eurokomunizmit.

Eurokomunizmi është produkt i degjenerimit të partive komuniste që u futën në rrugën e revizionizmit, i përçarjes që ndodhi në kampin revizionist, si rezultat i epërsisë që mori në gjirin e tij nacionalizmi borgjez.

Ai është ideologji e aristokracisë punëtore të ushqyer me thërrime nga fitimet e borgjezisë. Eurokomunizmi, që është ideologjia më e kulluar e reformizmit borgjez, luan rolin e «kolonës së pestë» në gjirin e lëvizjes punëtore.

Eurokomunistët, të cilët ishin ndër ithtarët më të zjarrtë të fushatës kundër Stalinit, për t'u kthyer gjoja te Lenini, tani janë bashkuar haptazi me tërë korin e borgjezisë e të socialdemokratëve për të sulmuar Leninin e leninizmin. Vetë termi «eurokomunizëm» është shprehje e largimit nga marksizëm-leninizmi, e mohimit të ligjeve të përgjithshme të revolucionit dhe të ndërtimit të shoqërisë socialiste. Eurokomunistët kanë nxjerrë nga varri e kanë rivënë në qarkullim teoritë e vjetra oportuniste të Lasalit e të Bernshtajnit, të Kautskit e të Internacionales së Dytë, të cilat i reklamojnë si fjalën e fundit të zhvillimit krijues të marksizmit në ditët tona. Sulmi frontal e i hapur nga pozitat antikomuniste kundër mësimeve themelore të marksizëm-leninizmit është përfundimi logjik i tërë revizionizmit modern, i të gjitha rrymave të tij.

Predikimet e eurokomunistëve për shtetin kapitalist mbiklasor, për demokracinë për të gjithë, për rrugën paqësore, parlamentare, demokratike për në socializëm, për reformat e strukturës në kuadrin e kushtetutës borgjeze etj. kanë vetëm një qëllim: sabotimin e revolucionit, mbrojtjen e përjetësimin e rendit kapitalist. Kur revizionistët italianë, francezë e spanjollë flasin për «kompromis historik», për «bllok historik të së majtës» etj. ose kur luftojnë për t'u futur në qeveritë borgjeze, këtë e bëjnë jo për t'ia rrëmbyer pushtetin borgjezisë, jo për të likuiduar rendin kapitalist, por për ta ruajtur atë nga revolucioni dhe për

të marrë përsipër ata vetë drejtimin e punëve të borgjezisë. Në këtë rol ata kërkojnë të zëvendësojnë socialdemokracinë e kompromet uar e tanimë të diskreditu ar në sytë e masave si shërbëtore e hapur e borgjezisë.

Ndërsa zbukurojnë kapitalizmin, eurokomunistët shprehin një armiqësi të hapur për socializmin. Sipas tyre, deri më sot as ka ekzistuar dhe as ekziston ndonjë socializëm i vërtetë. Për ta «socializmi i vërtetë» është ai që kanë shpikur ata vetë, i ashtuquajturi «socializëm demokratik», «socializëm pluralist» ose «rruga e tretë».

«Socializmi» i përfytyruar nga eurokomunistët është një socializëm pa diktaturë të proletariatit, pa udhëheqje të pandarë të partisë komuniste, pa teori marksiste-leniniste. Në këtë socializëm pushteti do të jetë i të gjitha klasave, në udhëheqje do të vijnë parti të ndryshme sipas votave që do të marrin në zgjedhje, ideologjia marksiste do të bashkëjetojë me të gjitha ideologjitë e tjera borgjeze, mikroborgjeze e fetare. Në socializmin e eurokomunistëve do të ekzistojnë forma të ndryshme të ekonomisë, prona e shoqërizuar dhe iniciativa private, kapitalet imperialiste dhe shoqëritë shumëkombëshe.

Pra në këtë shoqëri të ashtuquajtur pluraliste do të pleksen e do të bashkëjetojnë në paqe e harmoni të plotë, klasa, parti, ideologji, prona të ndryshme, elemente socialiste e kapitaliste në ekonomi e politikë, në bazë e superstrukturë, në tërë jetën e shoqërisë. Por një shoqëri e tillë e përzier kapitalisto-socialiste as ka ekzistuar as mund të ekzistojë ndonjëherë. Ajo mund të ekzistojë vetëm në imagjinatën e eurokomunistëve. Socializmi e kapitalizmi janë dy rende shoqërore që përjashtojnë njëri-tjetrin. Shoqëria e re e predikuar nga eurokomunistët nuk është gjë tjetër veçse shoqëria e sotme kapitaliste e lyer me bojë socialiste.

Dalja e eurokomunizmit u reklamua me shumë zhurmë nga borgjezia, e cila pati shpresë se ideologjia reformiste e tij do të errësonte ideologjinë revolucionare të marksizëm-leninizmit. Ajo shpresonte se eurokomunizmi do të merrte një përhapje të madhe dhe do të bëhej një flamur që do të bashkonte të gjithë revizionistët, të Perëndimit e të Lindjes. Por dështimi qe i plotë. Në vetë partitë eurokomuniste u shtuan fraksionet e përçarjet; ndërmjet partive të ndryshme eurokomuniste filloi lufta për lidërship. Grindjet e ndarjet me partitë e tjera revizioniste u bënë edhe më të mëdha. Partia e Marshesë e braktisi kampin eurokomunist dhe po afrohet gjithnjë e më shumë me revizionistët sovjetikë. Partia Komuniste e Spanjës është ndarë në fraksione të ndryshme, në eurokomunistë ortodoksë e heretikë, në prosovjetikë e antisovjetikë. Kurse partia e Berlinguerit kalon një krizë të rëndë ideologjike e politike. Çka është më e rëndësishme, partitë eurokomuniste kanë humbur shumë nga ndikimi që kanë pasur në masat, gjë që vihet re edhe në disfatat që po pësojnë vazhdimisht në fushatat elektorale, të cilat i konsiderojnë si kalin e tyre të betejës.

Idetë e socializmit të vërtetë kanë qenë dhe mbeten një forcë e madhe frymëzuese, mobilizuese e organizuese e luftës revolucionare të masave.

Sot nuk ka nevojë të shpiken «socializma» të rinj, as të kopjohen të ashtuquajturit socializma të revizionistëve modernë, si ai sovjetik, jugosllav, kinez e të tjera, që vetëm emrin kanë socializëm.

Se çfarë është socializmi, ç'përfaqëson dhe ç'realizon ai, si arrihet e si ndërtohet shoqëria socialiste, nuk është ndonjë gjë e panjohur. Ekziston një teori dhe një praktikë e socializmit shkencor. Këtë teori na e mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini. Praktikën e tij e gjejmë në atë eksperiencë të pasur të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik në kohën e Leninit e të Stalinit, këtë e gjejmë sot edhe në Shqipëri, ku shoqëria e re ndërtohet sipas mësimeve të marksizëm-leninizmit.

Sigurisht, socializmi, siç ka thënë Lenini, do të marrë pamje të ndryshme dhe do të ketë veçoritë e veta në vende të ndryshme, që rrjedhin nga kushtet shoqërore-ekonomike, nga rruga në të cilën zhvillohet revolucioni, nga traditat, nga rrethanat ndërkombëtare etj. Por parimet bazë dhe ligjet e përgjithshme të socializmit mbeten të patundura dhe janë të domosdoshme për të gjitha vendet.

Marksistë-leninistët i studiojnë me kujdes proceset revolucionare në vendet e tyre, si edhe kushtet kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ato zhvillohen. Ata nuk janë dogmatikë as në teori, as në praktikë. Për ta marksizëm-leninizmi, si një botëkuptim materialist dialektik, është një doktrinë e gjallë krijuese e në zhvillim të pandërprerë.

Marksistë-leninistët nuk janë konservatorë e fanatikë, siç i akuzojnë revizionistët e borgjezët. Përkundrazi, ata janë njerëzit më përparimtarë, luftëtarë të vendosur kundër çdo gjëje të vjetër e prapanike. Ata qëndrojnë fort në pozitat e së resë dhe luftojnë me të gjitha forcat për fitoren e saj. Konservatorë e reaksionarë janë revizionistët dhe gjithë oportunistët e tjerë, të cilët, si shërbëtorë të borgjezisë, mbrojnë një kauzë të humbur, mbrojnë një rend të vjetër shtypës e shfrytëzues. Është pikërisht kjo pozitë reaksionare ajo që e ka futur revizionizmin modern në një krizë të thellë.

Çlirimi i ndërgjegjes së proletariatit e të popujve nga ndikimet frenuese të revizionizmit, përhapja e marksizëm-leninizmit, i cili tregon rrugën e vetme të drejtë të luftës e të fitores, është sot detyrë e dorës së parë për të çuar përpara procesin revolucionar në çdo vend e në shkallë botërore.

Kjo detyrë bëhet edhe më aktuale nga rritja e revoltës dhe e lëvizjeve të masave, nga zgjimi i ndërgjegjes klasore e kombëtare të popujve, nga fakti se bota ndodhet përpara tronditjeve të mëdha ekonomiko-shoqërore.

Përpjekjet e gjithë armiqve bëhen për t'i larguar masat nga revolucioni. Borgjezia, socialdemokracia, revizionistët modernë dhe oportunistët e çdo ngjyre bëjnë çmos për të mashtruar klasën punëtore dhe masat, për të mbjellë konfuzion ideologjik e përçarje, për të përhapur pesimizmin e fatalizmin, për të ngjallur në popull mosbesim te revolucioni e te socializmi, për të ngjallur psikozën se është e pamundur që kapitalizmi dhe imperializmi të thyhen e të munden. I vetmi problem për këta armiq është që kapitalizmin ta bëjnë «me një fytyrë më njerëzore», çka do të thotë që kapitalistët e mëdhenj të vazhdojnë të sun-

dojnë, por të lëshojnë disa thërrime për popullin e varfër. Në këtë kor bashkohen ideologët borgjezë, apologjetët e imperializmit sovjetik, predikuesit e teorisë së «tri botëve», të «mosangazhimit» dhe të dialogut Veri-Jug, papa i Romës dhe bosët e sindikatave.

Një presion i madh bëhet mbi klasën punëtore evropiane. Për shkak të sundimit të reformizmit lëvizja punëtore në Evropë nuk është rritur akoma në një lëvizje të vërtetë revolucionare. Ajo nuk ka fituar ndërgjegjen e plotë se për të ndryshuar gjendjen e saj duhet ndryshuar sistemi kapitalist, duhet vendosur shoqëria socialiste.

Por proletariati evropian nuk mund të vazhdojë t'u bindet përjetë krerëve sindikalistë dhe partive socialdemokrate e revizioniste, që llomotitin se me anë të zhvillimit të strukturave borgjeze ekzistuese, të rrugës parlamentare, të reformave ose nëpërmjet «Evropës së Bashkuar» do të sigurohet një e ardhme më e mirë për masat punonjëse. Shtypja, dhuna, shfrytëzimi i egër, papunësia, drogat, degjenerimi, inflacioni, që kanë përfshirë vendet e Evropës, nuk do të mund të frenojnë revoltën e forcave të shëndosha të popujve evropianë kundër sundimit të kapitalit. «Evropa e Bashkuar» nuk është veçse një zgjidhje efemere, një politikë reaksionare kapitaliste, që shpejt ose vonë, do të gjendet përpara vështirësish të panumërta e të natyrave të ndryshme. Prandaj do të vijë një moment kur revolta e klasës punëtore të Evropës do të arrijë në atë pikë që do të kërkojë patjetër një zgjidhje revolucionare.

Në këto kushte rëndësi të dorës së parë ka që komunistët dhe jokomunistët, njerëzit përparimtarë dhe gjithë masat e popullit të kuptojnë mirë se armiku i tyre i vërtetë është kapitalizmi, se ai duhet e mund të përmbyset me luftë revolucionare. Kështu do të zhduket pesimizmi, do të shtohet kuraja dhe besimi në fitoren. Këtë besim proletariatit dhe masave ua rrit e ua bën të pathyeshëm shkenca e Marksit dhe e Leninit.

Partia dhe proletariati që përgatiten për revolucion dhe për marrjen e pushtetit, përpiqen t'i analizojnë e t'i zotërojnë mirë situatat, të përcaktojnë shkencërisht karakterin dhe etapat e revolucionit në çdo rast konkret dhe, mbi këtë bazë, të përpunojnë strategjinë dhe taktikat e përshtatshme. Ata studiojnë me kujdesin më të madh rrymat e ndryshme revolucionare popullore që ndeshen me kapitalizmin dhe me partitë e tij, vlerësojnë drejtimet e tyre, raportin e forcave në situatën konkrete dhe, mbi këtë bazë, përcaktojnë dhe vënë në jetë të gjitha ato taktika të shkathëta që duhet të përdoren për të çuar në rrugë të drejtë e fitimtare masat popullore, për të kanalizuar mijëra përrenj në lumin e madh të revolucionit, ku do të mbytet borgjezia kapitaliste.

Partia dhe proletariati nuk shkojnë vetëm në revolucion. Në shoqërinë borgjeze ka edhe shtresa të tjera të shtypura që e urrejnë rendin kapitalist, ka forca përparimtare në fshatarësi, në rini, ka elementë të tjerë demokratë e liridashës që nuk e durojnë shfrytëzimin. Komunistët i afrojnë të gjitha këto forca e këta elementë, ndërtojnë me ta aleanca të përbashkëta për çështje të ndryshme e për objektiva të caktuar. Marksistë-leninistët nuk janë as sektarë, as liberalë, ata janë revolucionarë të patundur në parime, por elastikë në taktikat. Frontet që ndërtojnë partitë marksiste-leniniste me forcat e tjera përparimtare në ven-

det kapitaliste kundër borgjezisë, kundër fashizmit dhe imperializmit bëjnë pjesë në strategjinë e revolucionit. Në çdo aleancë e front partia ruan personalitetin e vet edhe kur ajo, për arsye objektive, nuk e drejton vetë atë.

Problemi kyç në vendet kapitaliste ka qenë dhe mbetet uniteti i proletariatit. Proletariatin borgjezia përpiqet ta futë në një mengene të hekurt, të mos e lejojë të ecë në rrugën që i ka caktuar historia për përmbysjen e shfrytëzuesve, për rrëzimin e pushtetit të kapitalit. Një nga këto mengene janë sindikatat, të cilat, në shumicën e rasteve, i nënshtrohen borgjezisë. Komunistët punojnë jo vetëm të futen e të hedhin rrënjë të patundura në klasën punëtore, por edhe luftojnë që të realizojnë unitetin e saj. Sot, kur kriza ka hedhur në rrugë dhjetëra milionë punëtorë dhe miliona të tjerë ngrihen në greva e demonstrata për rivendikime ekonomike e politike, është më lehtë të organizohen e të bashkohen punëtorët në luftë kundër kapitalit.

Uniteti i klasës punëtore arrihet në luftë e në veprime revolucionare konkrete për realizimin e kërkesave ekonomike dhe politike të proletariatit. Për këtë qëllim marksistë-leninistët punojnë që sindikatat ekzistuese të shkëputen nga sundimi i agjentëve të borgjezisë, të revizionistëve e të socialdemokratëve e të kthehen në instrumente lufte kundër rendit shfrytëzues. Krahas me këtë, sipas kushteve dhe nevojave, ata krijojnë edhe sindikata të reja revolucionare.

Rinia është gjithashtu një forcë e madhe, që aspiron dhe lufton për ndryshimin e shoqërisë së padrejtë kapitaliste, që e do të renë e përparimtaren. Këtë rrugë asaj ia çel vetëm marksizëm-leninizmi dhe revolucioni, vetëm këta i shpëtojnë masat e rinisë nga degjenerimi politik e shoqëror ku i çon borgjezia, u hapin perspektivën e një jete të re, të pastër e të lumtur, ku mund të shpërthejnë e të zhvillohen plotësisht energjitë e tyre të pashtershme në shërbim të shoqërisë e të përparimit. Lëvizja e rinisë merr forcë dhe mund të arrijë objektivat e vet kur shkrihet në lëvizjen revolucionare të klasës punëtore.

Procesi i sotëm revolucionar e ka bërë edhe më të mprehtë problemin e qëndrimit ndaj ushtrisë borgjeze, jo për ta konsideruar atë si forcën që do të bëjë revolucionin, por për ta shthurur e desintegruar atë, që të mos jetë në gjendje t'i kundërvihet revolucionit. Komunistët punojnë që masat e ushtarëve, të cilët janë bij të popullit, kur të shpërthejë revolucioni, të mos i binden kastës së oficerëve, por t'i kthejnë armët kundër forcave reaksionare në fuqi dhe të bashkohen me kryengritësit, ashtu siç ndodhi në Iran.

Revolucioni është detyrë kryesore e klasës punëtore. Por ai përgatitet në luftë për zgjidhjen e problemeve politike, ekonomike, shoqërore, kulturore që shqetësojnë çdo ditë masat punonjëse. Janë këto aksione, këto beteja të përditshme ato që rritin ndërgjegjen e klasës, që forcojnë organizimin e bashkimin e saj, që e përgatitin dhe e çojnë atë në revolucion. Nëpërmjet këtyre betejave partia lidhet me masat e vihet në krye të tyre. Partitë e vërteta të klasës punëtore janë parti të aksioneve revolucionare.

Për të frikësuar masat dhe për të përgatitur ardhjen e fashizmit kapitali i madh po nxit edhe terrorizmin, i cili në shumë vende ka ma-

rrë përpjesëtime të gjera. Me anë të terrorizmit borgjezia kërkon, gjithashtu, të njollosë edhe lëvizjen e vërtetë revolucionare, të futë në rrugë të gabuar elementë të ndryshëm që revoltohen kundër shtypjes së saj. Ajo me qëllim identifikon luftën revolucionare me terrorizmin, për të krijuar në masat përshtypjen sikur edhe komunistët, patriotët e revolucionarët, që luftojnë kundër shtypjes kombëtare e shoqërore, janë terroristë e anarkistë, që vrasin e grabisin. Revolucionarët e vërtetë janë kundër terrorizmit e anarkizmit, në teori e në praktikë.

Klasa punëtore e masat punonjëse në vendet kapitaliste po ndeshen gjithnjë e më shumë edhe me problemin kombëtar, që aktualisht është bërë mjaft i mprehtë. Socialdemokracia dhe revizionistët e mohojnë ekzistencën e një problemi të tillë në vendet e zhvilluara kapitaliste, siç janë ato të Evropës Perëndimore, Japonia, Kanadaja etj. Ata nuk duan ta shohin faktin që gjithnjë e më shumë, si rezultat i sulmit të shoqërive shumëkombëshe, prapa të cilave qëndron imperializmi amerikan, zgjerimi i kompetencave mbinacionale të blloqeve ushtarake e të organizatave ekonomike ndërkombëtare, zgjerimi i bazave dhe vendosja e armëve amerikane në territoret e tyre kufizojnë edhe më tepër sovranitetin kombëtar, kufizojnë veprimin e pavarur politik të vendeve të tyre, i kthejnë gradualisht në shtete vasale.

Mbrojtjen e sovranitetit e të pavarësisë kombëtare, që borgjezia dhe krahu socialdemokrat e revizionist e kanë braktisur, duhet ta marrë në dorë klasa punëtore. Proletariati evropian e i vendeve të tjera nuk duhet të mashtrohet nga propaganda e Shteteve të Bashkuara, e Bashkimit Sovjetik ose e Kinës, që, secili për interesat e veta, tundin gogolin e rrezikut që i vjen lirisë e pavarësisë kombëtare nga superfuqia rivale. Me këtë propagandë ata kanë për qëllim ta grabitin lirinë e pavarësinë dhe të vendosin sundimin imperialist të kësaj ose të asaj superfuqie.

Momentet klasore e kombëtare përbëjnë një problem të madh edhe në vendet ku sundojnë revizionistët. Në mënyrë të veçantë në këto vende nuk mund të arrihet çlirimi shoqëror pa kundërshtuar e hedhur poshtë zgjedhën e socialimperializmit sovjetik, i cili ka vendosur këtu sundimin e tij të plotë ekonomik, politik e ushtarak.

Imperializmi amerikan dhe fuqitë e tjera kapitaliste perëndimore hiqen sikur janë përkrahëse të lëvizjes punëtore dhe nacionale në këto vende, sikur mbështetin aspiratat çlirimtare të popujve të këtyre vendeve. Kjo është demagogji dhe një lojë e rrezikshme që synon të mashtrojë proletarët dhe masat punonjëse. Borgjezia imperialiste kërkon vetëm t'i shkëputë këto vende nga zona e ndikimit të socialimperializmit sovjetik dhe t'i futë në sferën e saj të sundimit.

Çështja e revolucionit proletar është e pandarë nga zhvillimi i lëvizjes çlirimtare të popujve. Një tipar i rëndësishëm i luftërave të sotme nacionalçlirimtare është se zgjimi politik për të fituar e për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e plotë kombëtare po shoqërohet edhe me një zgjim shoqëror. Lëvizjet aktuale të popujve të shtypur po drejtohen gjithnjë e më shumë jo vetëm kundër imperializmit të huaj, por edhe kundër agjenturave të tij brenda vendit. Fakt është se popujt e vendeve të shtypura, me gjithë prapambetjen ekonomiko-shoqërore,

janë duke treguar një vitalitet të madh dhe po japin një kontribut të rëndësishëm në revolucionin demokratik antiimperialist, që i hap rrugën revolucionit proletar.

Vëmendje të posaçme meritojnë kryengritjet popullore me «frymëzim islamik», siç duan t'i përcaktojnë këto lëvizje borgjezia dhe revizionistët, me qëllim që t'u mohojnë karakterin e tyre antiimperialist e revolucionar. Është fakt se, në vendet myslimane ka lëvizje kryengritëse, por interpretimet që u bëjnë borgjezia dhe revizionistët janë keqdashëse dhe denigruese. Ato fshehin synime skllavëruese ndaj popujve.

Ne, marksistë-leninistët, e kemi thënë dhe e themi se feja është opium për popujt. Në asnjë rast nuk e ndërrojmë pikëpamjen tonë lidhur me këtë çështje. Edhe feja myslimane në përmbajtjen e saj nuk ndryshon nga të tjerat.

Masat e gjera të popujve myslimanë në vendet e ndryshme janë ngritur e po ngrihen në luftë jo për çështjen e fesë, por për çlirimin kombëtar e shoqëror. Besimi në fenë është relativ dhe nuk predominon mbi politikën. Njerëzit e këtyre vendeve e besojnë dhe e respektojnë islamin, por kur cenohen interesat jetike të popullit, liria dhe pavarësia e vendit, ata ngrihen në luftë kundër agresorit, qoftë ky edhe me të njëjtën fe. Nuk është frymëzimi fetar ai që i shkakton revoltat dhe zgjimin revolucionar të popujve, por janë kushtet politiko-shoqërore, janë shtypja e grabitja imperialiste, janë varfëria dhe vuajtjet që rëndojnë mbi ta.

Arabët dhe popujt e tjerë myslimanë janë luftëtarë trima e me kulturë të lashtë. Kryengritjet e luftërat antiimperialiste, antikolonialiste dhe antifeudale të këtyre popujve tregojnë se ata janë përparimtarë e liridashës. Po të mos ishin të tillë, ata nuk mund të ngriheshin në luftë për liri e pavarësi kombëtare, kundër shtypjes së dyfishtë, të brendshme dhe të jashtme.

Në rajonet e banuara nga popujt myslimanë imperialistët dhe socialimperialistët i kanë pozitat të vështira. Të vështira i kanë pozitat edhe kukullat e tyre. Gjendja në këto rajone flet për një situatë revolucionare, për një lëvizje të madhe shoqërore të këtyre popujve, pavarësisht se në pamjen e parë ato kanë karakter fetar e se i ndjekin njerëz besimtarë ose jobesimtarë.

Sot në mjaft vende ekzistojnë ose krijohen situata revolucionare, por jo kudo shtrohet si detyrë imediate revolucioni socialist. Në botë zhvillohen edhe lëvizje të tjera me karakter demokratik, antiimperialist, çlirimtar. Të gjitha këto janë pjesë përbërëse të procesit revolucionar botëror, janë luftëra të drejta, që dobësojnë frontin imperialist dhe kontribuojnë në shpejtimin e proceseve revolucionare, godasin dhe kalbëzojnë më tej sistemin kapitalist. Prandaj, siç na mëson Lenini, klasa punëtore si klasa më progresive dhe partia e saj komuniste, duhet t'i mbështetin, t'i përkrahin aktivisht këto luftëra dhe të vihen në drejtmin e tyre. Edhe në rast se në fillim ato nuk i kanë afirmuar pozitat e tyre udhëheqëse, përsëri duhet të qëndrojnë në ballë të luftës dhe të sakrificave, pse vetëm kështu mund të dalin në krye të lëvizjes dhe të sigurojnë objektivat e saj, vetëm kështu mund t'i hapet rruga

rritjes së revolucionit demokratik, popullor, antiimperialist në revolucion socialist.

Në luftën e tyre për çlirimin kombëtar e shoqëror klasa punëtore dhe masat punonjëse ndeshen çdo ditë me dhunën e egër të imperializmit, të borgjezisë dhe të forcave të reaksionit. Në këto kushte ato janë të detyruara t'i përgjigjen dhunës reaksionare me dhunën revolucionare, format e së cilës janë e nuk mund të mos jenë të ndryshme, sipas kushteve të çdo vendi e situatave që zhvillohen. Në disa vende kjo dhunë ka marrë e mund të marrë edhe formën e kryengritjes së armatosur. Ndaj kësaj çështjeje marksistë-leninistët mbajnë një qëndrim tepër serioz. Ata luftojnë si kundër qëndrimeve nihiliste, ashtu edhe kundër aventurizmit mikroborgjez, demaskojnë e hedhin poshtë si predikimet maoiste mbi «rrethimin e qytetit nga fshati» etj., ashtu edhe teoritë pseudomarksiste që mohojnë rolin vendimtar të masave popullore në luftë dhe udëheqjen e partive marksiste-leniniste.

Kohët për partitë tona marksiste-leniniste janë revolucionare. Partitë e reja marksiste-leniniste po rriten e kaliten në të gjithë botën, rritet roli dhe veprimtaria e tyre, lidhjet dhe ndikimi i tyre në klasën punëtore e në masat. Parti të reja janë krijuar në mjaft vende e zona të ndryshme. Ekzistojnë të gjitha kushtet që të krijohen edhe atje ku nuk ka parti të vërteta revolucionare të klasës punëtore. Kjo është një detyrë luftarake imperative e elementëve revolucionarë e më të ndërgjegjshëm të proletariatit.

Gjendja objektive e favorshme nuk i errëson aspak problemet e mprehta dhe detyrat e mëdha që qëndrojnë përpara marksistë-leninistëve. Vërtet forcat tona janë në rritje të vazhdueshme dhe situatat zhvillohen në favor të revolucionit, por edhe reaksioni vepron. Borgjezia, socialdemokracia dhe revizionistët e ndryshëm, pavarësisht nga kontradiktat e tyre të thella e të papajtueshme, në një gjë bashkohen e veprojnë së toku: në luftën kundër marksizëm-leninizmit dhe revolucionit. Ata përpiqen të mbjellin mosbesim e frikë në masat e popullit për t'i larguar nga revolucioni e socializmi, të godasin e të dëmtojnë partitë marksiste-leniniste në vende të veçanta dhe lëvizjen komuniste revolucionare në tërësi.

Më përpara, kur maocedunideja ushtronte influencën e vet në mjaft parti, imperialistët dhe socialimperialistët ishin më të qetë, sepse e dinin që kjo rrymë revizioniste bënte punën e vet minuese në lëvizjen marksiste-leniniste. Tani që kjo rrymë u demaskua, armiqtë orvaten të mbjellin konfuzion duke përhapur lloj-lloj teorish pseudomarksiste, të përçajnë e të dobësojnë partitë me luftë fraksioniste, të manipulojnë në forma të ndryshme të hedhin në pozita revizioniste elementë të dobët e të paformuar.

Por, tashmë, partitë marksiste-leniniste kanë një përvojë të madhe në luftën me rrymat e ndryshme antimarksiste dhe janë të armatosura më mirë kundër taktikave që përdorin borgjezia dhe revizionistët. Kjo përvojë i ndihmon ato të zhvillojnë më sukses luftën kundër armiqve, të rritin vigjilencën, të ngrenë vazhdimisht nivelin ideologjik e politik

të anëtarëve të partisë, t'i armatosin ata me teorinë marksiste-leniniste. Lufta revolucionare i ka mësuar partitë marksiste-leniniste të forcojnë lidhjet me masat, të futen në shtresat e ndryshme shoqërore dhe t'i organizojnë ato, të shfrytëzojnë e të kombinojnë drejt punën legale dhe ilegale në luftë me shfaqjet e legalizmit e të liberalizmit borgjez, si dhe me ato të sektarizmit të ngushtë e të punës së mbyllur.

Përballë veprimtarisë së koordinuar të imperialistëve dhe të revizionistëve kundër marksizëm-leninizmit dhe luftës revolucionare të proletariatit e të popujve, forcimi i mëtejshëm i unitetit të lëvizjes marksiste-leniniste është një nevojë e domosdoshme.

Forca e lëvizjes komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare qëndron në drejtësinë e ideve për të cilat lufton dhe në unitetin e saj. Partitë marksiste-leniniste në luftën e tyre udhëhiqen nga mësimet e klasikëve tanë të mëdhenj, shfrytëzojnë trashëgiminë e pasur dhe të gjithanshme të Kominternit, mbështeten në përvojën e luftës së tyre kundër tradhtisë revizioniste, mbajnë parasysh përvojën negative të partive që degjeneruan në revizionizëm. Gjithë këto mësime e kjo përvojë janë një thesar shumë i madh ideologjik, politik, organizativ, teorik e praktik, për të kalitur e forcuar partitë dhe lëvizjen marksiste-leniniste në çdo drejtim.

Një kontribut me vlerë për forcimin e unitetit të lëvizjes marksiste-leniniste japin takimet dhe bisedimet ndërmjet partive motra. Kështu përfitohet nga përvoja e njëri-tjetrit, arrihet në vlerësime të përbashkëta të situatave e në unitet mendimi e veprimi. Përvoja e një partie nuk mund të zëvendësojë përvojën e shumë partive, përkundrazi, janë përvojat e të gjitha partive marksiste-leniniste që e bëjnë lëvizjen të pathyeshme.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke u qëndruar besnike parimeve të internacionalizmit proletar, është përpjekur e do të përpiqet kurdoherë të japë kontributin e vet për forcimin e unitetit të lëvizjes marksiste-leniniste dhe të bashkëpunimit ndërmjet partive motra.

Partia jonë e Punës e ka për nder që, në luftën e madhe e historike për çështjen e marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit, qëndron krah për krah me partitë e tjera marksiste-leniniste, që janë reparte të barabarta të lëvizjes revolucionare të klasës punëtore. Komunistët shqiptarë dhe mbarë populli ynë çmojnë së tepërmi solidaritetin, dashurinë, dhe besimin që tregojnë ndaj Partisë së Punës dhe Shqipërisë socialiste partitë motra marksiste-leniniste, proletariati dhe popujt revolucionarë e liridashës. Këto janë një përkrahje dhe një inkurajim i fuqishëm për ne. Partia dhe populli ynë në çdo rrethanë e në çdo situatë do të luftojnë për t'i kryer me nder detyrat e tyre kombëtare e ndërkombëtare, për të ndërtuar me sukses socializmin në Shqipëri dhe për të mbrojtur me zjarr çështjen revolucionare të proletarëve e të popujve.

Të dashur shokë,

Sukseset që ka arritur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë janë të mëdha, betejat e fituara janë madhështore. Ato dëshmojnë se populli

ynë ka fuqi të pashtershme, se ai është optimist e i vendosur të ndërmarrë beteja të reja për ta bërë jetën e tij më të lumtur, për ta lartësuar akoma më shumë emrin e Atdheut të tij socialist, për të forcuar lirinë e pavarësinë, pushtetin popullor që lindi në flakët e revolucionit.

Është ky realitet i mrekullueshëm, është uniteti i pathyeshëm i popullit me Partinë, është pjekuria, guximi dhe vendosmëria e komunistëve që u japin siguri e garanci popullit e Partisë se objektivat që do të caktojë ky Kongres do të arrihen e do të tejkalohen.

Entuziazmi që kanë ngjallur Projektdirektivat e planit të shtatë pesëvjeçar, mobilizimi i masave punonjëse për realizimin e detyrave të këtij viti, rezultatet inkurajuese që po arrihen, e, mbi të gjitha, përkrahja unanime, e vendosur dhe e zjarrtë që njerëzit tanë i japin politikës së brendshme e të jashtme të Partisë, tregojnë se i gjithë vendi është i gatshëm dhe i mobilizuar për të ecur më besim e vendosmëri në rrugën ku na udhëheq Partia, për të arritur fitore të reja.

Këtë vrull revolucionar, këtë dashuri të pafund për Partinë tonë të lavdishme, këtë besim të patundur në të ardhmen le t'i kthejmë, të dashur shokë e shoqe, në një forcë të madhe lëvizëse për të realizuar detyrat në të gjitha fushat, për të kapërcyer të gjitha vështirësitë që do të na dalin, për t'i forcuar e konsoliduar më tej fitoret tona, bazat e pathyeshme të socializmit në Shqipëri.

Rroftë Kongresi i 8-të i Partisë!

Rroftë populli heroik, i talentuar e punëtor shqiptar!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja e urtë, trime dhe e sprovuar, organizatorja e të gjitha fitoreve tona në rrugën e ndritur të ndërtimit socialist!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Raporti i shokut Enver Hoxha u dëgjua me interesim të veçantë dhe me vëmendje të madhe. Ai u ndërpre shpesh herë nga duartrokitje, brohoritje e ovacione të zjarrta të të gjithë delegatëve. Shpesh në sallë buçitnin thirrjet «Rroftë Partia e Punës së Shqipërisë», «Rroftë shoku Enver Hoxha», «Parti — Enver jemi gati kurdoherë», «Lavdi Marksizëm-leninizmit», «Rroftë internacionalizmi proletar», «Rrofshin partitë marksiste-leniniste» etj. Delegatët ngriheshin në këmbë dhe brohorisnin për unitetin e çeliktë Parti-popull, për fitoret e Partisë e të popullit tonë, për proletariatin ndërkombëtar dhe për popujt që janë ngritur në revolucion e luftojnë me vendosmëri kundër superfuqive, — imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e atij kinez, kundër revizionizmit e reaksionit.

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Janar 1982
Viti XXIX i botimit

登录

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

051651

Përmbajtja:

ENVER HOXHA — Përvoja juaj, si dhe ajo e kooperativave të tjera të përparuara, do të shërbejë si nxitje për të realizuar me sukses detyrat e mëdha për zhvillimin dhe intensifikimin e pandërprerë të bujqësisë e të blegtorisë së vendit tonë (Letra drejtuar kooperativës së tipit të lartë të Dajçit në rrethin e Shkodrës) 5

PROBLEME TË KONGRESIT TË 8-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

KRYEARTIKULLI — Ta ngremë më lart mobilizimin për të realizuar detyrat e planit të vitit 1982 8

RITA MARKO — Me ndjenjë të lartë përgjegjësie, të mobilizojmë tërë energjitë për realizimin e detyrave 17

P. DODE — Zgjerimi dhe përsosja e lidhjeve kooperuese — kërkesë e domosdoshme e stadit të arritur në zhvillimin e forcave prodhuese 29

N. SIMAKU — Rritja e shpejtë e të ardhurave kombëtare dhe përdorimi me efektivitet i tyre — një nga detyrat kryesore të pesëvjeçarit 39

P. KACORI — LL. PASHKO — Studimi e përvetësimi i thellë i literaturës marksiste-leniniste kërkon dhe një informacion të gjerë shkencor 49

BIBLIOGRAFI

A. POPA — Komplote dhe dështime (Rreth librit të shokut Enver Hoxha «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», Kujtime) 57

PËRVOJË NGA PUNA E PARTISË

DH. MAÇUKA — Për një efektivitet më të madh në punën e byrove të organizatave-bazë të Partisë 71

S. OSUMI — Si po shkon Jugosllavia titiste në Kongresin e 12-të të LKJ 78

PËRVOJA JUAJ, SI DHE AJO E KOOPERATIVAVE TË TJERA TË PËRPARUARA, DO TË SHËRBEJË SI NXITJE PËR TË REALIZUAR ME SUKSES DETYRAT E MËDHA PËR ZHVILLIMIN DHE INTENSIFIKIMIN E PANDËRPRERË TË BUJQËSISË E TË BLEGTORISË SË VENDIT TONË

KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË

Dajç - Shkodër

Të dashur shokë e shoqe kooperativistë e kooperativiste, specialistë e kuadro drejtues të kooperativës së tipit të lartë të Dajçit,

Mora letrën me të cilën më bëtë të ditur për rezultatet e mira që keni arritur në realizimin e tejkalimin e treguesve të prodhimeve bujqësore e blegtorale e në ato financiare, si dhe për arritjet e tjera të rëndësishme tuajat në fushën e mirëqënies materiale e kulturore për vitin 1981, viti i parë i pesëvjeçarit të shtatë. Këto arritje janë rezultat i këmbënguljes e ndërgjegjes së lartë socialiste, i punës së frytshme politike dhe udhëheqjes së drejtë e të vazhdueshme të organizatës së Partisë, i organizimit të punës, i zbatimit të agroteknikës etj.

Në këto drejtime ju jeni bërë nga shembujt më të mirë jo vetëm për kooperativat e rrethit të Shkodrës, por edhe të mbarë vendit tonë. Prandaj, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, ju përgëzoj për të gjitha arritjet dhe për punën që vazhdoni të bëni për zhvillimin e pandërprerë ekonomik e kulturor të kooperativës suaj.

Të dashur shokë e shoqe kooperativistë,

Ju tashmë keni grumbulluar një përvojë të mirë në trajtimin e tokës e zbatimin në praktikë të arritjeve të shkencës bujqësore, po njihni gjithnjë e më mirë sekretet e prodhimit bujqësor e blegtoral për të siguruar rendimente të larta e prodhime të bollshme. Por ato nuk janë kulmi i arritjeve. Ashtu siç më shkruani në letër, rendimentet që keni marrë janë vetëm fillimi dhe një mbështetje e fuqishme për arritje akoma më të larta në të ardhmen. Prandaj përpara jush dhe gjithë kooperativistëve të vendit dalin detyra të mëdha në këtë drejtim.

Krahas përpjekjeve për zotërimin e njohurive shkencore agroteknike e zooveterinere dhe zbatimit të tyre me pasion e këmbëngulje nga gjithë punonjësit e bujqësisë, rëndësi vendimtare për realizimin e për kapërcimin e objektivave që përcaktoi Kongresi i 8-të i Partisë kanë drejtimi e organizimi shkencor i punëve dhe ndjekja sistematike e realizimit në kohë të çdo detyre. Ju keni dhënë një shembull të mirë dhe unë shpreh bindjen se përvoja juaj, si dhe ajo e kooperativave të tjera të përparuara, do të shërbejë si nxitje për të realizuar me sukses detyrat që ka përpara bujqësia jonë socialiste.

Tani ekonomia juaj, ashtu si gjithë bujqësia e vendit, ndodhet në pragun e një aksioni shumë të madh, siç është fushata e mbjelljeve të pranverës dhe kryerja e shërbimeve bimëve të arave dhe frutikulturës. Përfundimi me sukses i kësaj fushate përbën një domosdoshmëri për kurorëzimin me sukses edhe të fushatave të tjera që vijnë njëra pas tjetrës, siç është ajo e korrje-shirjes dhe e grumbullimit etj. Për këtë që llim nga të gjithë duhet shfrytëzuar përvoja e mirë që keni grumbulluar ju dhe ekonomi të tjera të përparuara, duke marrë masa për një organizim sa më të përsosur të punëve, për t'i dalë përpara me koh kryerjes së çdo detyre. Për fushata të tilla, si mbjelljet e pranverës rëndësi vendimtare ka veprimtaria e çdo njësie prodhimi e sidomo e shtabeve drejtuese që, ashtu siç veprojnë në kohë lufte shtabet ushta rake, është e domosdoshme të bashkërendojnë, të organizojnë dhe t kontrollojnë me kujdes çdo gjë, që nga përgatitja e mirë e tokës, zgje dhja e sigurimi i farës me cilësi të lartë, grumbullimi e shpërndarj e plehut, hapja dhe pastrimi i kanaleve kulluese e ujitëse, mbajtj në gatishmëri e mjeteve dhe e mekanikës bujqësore, si dhe gjithë bazë materialo-teknike të domosdoshme etj. Organizimi i mirë i punës, kryer ja e detyrave nga secili e me përgjegjësi të plotë, vendosja e kontrolli të nevojshëm dhe forcimi i punës edukative të Partisë me kooperat vistët e thjeshtë, me specialistët e kuadrot drejtues, një përgatitje drejtim i tillë i përsosur, bën të mundshëm përfundimin me sukse të çdo pune, me cilësi e në afatet e parashikuara.

Bujqësia jonë socialiste e fuqishme nuk mund të ecë përpara p një organizim të shëndoshë e drejtim shkencor në nivelin e kërkesav të kohës, ashtu sikundër nuk mund të ecë pa u udhëhequr nga shkenc e përparuar agroteknike. Kjo duhet kuptuar mirë nga të gjithë, pa pë jashtim, në mënyrë të veçantë nga drejtuesit e prodhimit bujqësor blegtoral, nga brigadierët, agronomët, zooteknikët, veterinerët, ekon mistët, institucionet kërkimore e shkencore etj.

Të dashur shokë e shoqe,

Kongresi i 8-të i Partisë ka caktuar detyra të rëndësishme e të mëdh në fushën e zhvillimit e të intensifikimit të pandërprerë të bujqësisë e blegtorisë së vendit tonë, plotësimi i të cilave do të çojë në fuqizimin e m tejshëm të ekonomisë sonë socialiste, në rritjen e mirëqënies së mbarë p nonjësve dhe në forcimin gjithnjë e më shumë të mbrojtjes së Atdheut.

Le të bëhet viti 1982 viti i mobilizimit të përgjithshëm për të rea zuar e tejkaluar detyrat e mëdha të caktuara nga Kongresi i 8-të fushën e zhvillimit e të përparimit në sektorin e bujqësisë dhe në

gjithë sektorët e tjerë. Partia është e bindur se fshatarësia jonë patriote, gjithë punonjësit e bujqësisë, kuadrot e specialistët, nën udhëheqjen e organizatave të Partisë e me komunistët në ballë dhe duke punuar sipas përvojës së përparuar të individëve, brigadave, sektorëve dhe kooperativave e ndërmarrjeve pararojë, do të vënë në jetë detyrat e këtij viti dhe ato në perspektivë.

Edhe një herë ju përgëzoj për sukseset tuaja dhe ju uroj arritje akoma më të mëdha në interes të fuqizimit të ekonomisë suaj të përbashkët, të ekonomisë së rrethit dhe në atë të të gjithë Atdheut.

SEKRETARI I PARË I KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË
PUNËS TË SHQIPËRISË

ENVER HOXHA

Tiranë, më 27.1.1982.

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Mars 1982
Viti XXIX i botimit

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH — Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Përmbajtja:

ENVER HOXHA — Vendosmëria e vullneti juaj janë shprehje e frymës së lartë revolucionare dhe e besimit tuaj të patundur në vijën e udhës të Partisë (Letra drejtuar kooperativës së tipit të lartë Hero i Punës Socialiste të Cakranit në rrethin e Fierit). 5

— Arritjet e deritanishme në transformimin socialist të fshatit na kanë rritur entuziazmin dhe vendosmërinë për të marrë përsipër e për të realizuar objektiva më të mëdha (Letra drejtuar shokut Enver Hoxha nga kooperativistët e kooperativës së tipit të lartë Hero i Punës Socialiste të Cakranit në rrethin e Fierit) 7

PROBLEME TË KONGRESIT TË 8-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

RAMIZ ALIA — Rritja e cilësisë — detyrë themelore e letërsisë dhe e arteve (Fjala e mbajtur në plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, që zhvilloi punimet më 19-20 mars 1982) 10

F. BABARAMO — Rritja e efektivitetit të ekonomisë — detyrë nga më kryesoret e pesëvjeçarit të shtatë 25

SH. PRIZRENI — Mundësi të shumta për pakësimin dhe shfrytëzimin e dobishëm të mbetjeve teknologjike 33

F. SALIÇAJ — Të trajtohen me të njëjtin shqetësim si problemet e realizimit të planeve ashtu dhe ato të kujdesit për punonjësit 42

A.ÇARÇANI — «Revolucioni i gjelbër» — formë e kamufluar e shfrytëzimit neokolonialist 50

BIBLIOGRAFI

N. MYFTIU — Mësime të çmuara me vlera aktuale për revolucionarizimin e vazhdueshëm të organizatave të Partisë (Rreth vëllimit të 35-të të Veprave të shokut Enver Hoxha) 58

(Vijon në faqen prapa)

PËRVOJË NGA PUNA E PARTISË

S. BUSHATI — Realizimi i detyrave në ekonomi — objekt nga më kryesorët i punës së organizatave të Partisë

NGA VEPRIMTARIA E ORGANIZATAVE TË MASAVE

L. REXHA — Të rrisim më tej cilësinë e punës edukative me rininë

VENDOSMËRIA E VULLNETI JUAJ JANË SHPREHJE E FRYMËS SË LARTË REVOLUCIONARE DHE E BESIMIT TUAJ TË PATUNDUR NË VIJËN E URTË TË PARTISË

KOOPERATIVISTËVE TË KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË HERO I PUNËS SOCIALISTE TË CAKRANIT

FIER

Të dashur shokë kooperativistë e kooperativiste, brigadierë, specialistë e kuadro drejtues të kooperativës,

Më gëzoi shumë letra që më dërguat, me të cilën më njoftuat për arritjet tuaja gjatë vitit që kaloi, pse ato i shërbejnë fuqizimit të kooperativës suaj dhe gjithë ekonomisë së Atdheut tonë e, në të njëjtën kohë, vërtetojnë drejtësinë e vijës së Partisë në zhvillimin socialist të fshatit. Më gëzoi gjithashtu zotimi juaj për t'i konsideruar këto arritje vetëm si hapat e para, vendosmëria e vullneti juaj për përparime akoma më të mëdha që do ta forcojnë më tej kooperativën e do t'jua bëjnë jetën më të begatë.

Kjo vendosmëri e ky vullnet janë shprehje e frymës së lartë revolucionare që ju karakterizon dhe e besimit tuaj të patundur në vijën e urtë të Partisë. Jam i bindur se ju do t'i arrini objektivat e reja që i keni caktuar vetes. Këtë ju e keni vërtetuar me punën e palodhur, me qartësinë e kuptimin e drejtë politik e ideologjik të detyrave. Të jeni të sigurt se në çdo hap, si kurdoherë edhe në të ardhmen, do të keni mbështetjen e plotë të Partisë dhe ndihmën e pakursyer të pushtetit popullor. Ju dërgoj me këtë rast, në emër të Partisë, të Komitetit Qendror të saj dhe timin, përgëzimet më të mira për çka keni bërë dhe shpreh bindjen se do të ecni gjithnjë përpara e pa u ndalur në rrugën e drejtë që keni nisur.

Të dashur shokë e shoqe të Cakranit,

Kooperativa juaj bën pjesë në krahinën e bukur të Mallakastrës, ku jeton e punon një popull trim me tradita patriotike e revolucionа-

re, i lidhur që në fillim si mishi me thoin me Partinë, së cilës i ka qëndruar e i qëndron vazhdimisht besnik pa ia bërë asnjëherë fjalën dy. Bijtë e bijat e Mallakastrës, ashtu si të të gjithë Shqipërisë, luftuan heroikisht, shumë prej tyre dhanë jetën gjatë Luftës së madhe Nacionalçlirimtare dhe sot nuk kursejnë asgjë për ndërtimin socialist dhe mbrojtjen e Atdheut.

Por Mallakastra nuk është vetëm një vatër e zjarrtë patriotike e luftëtarëve për liri, për dije e përparim, ajo është edhe një krahinë nga më pjelloret e Atdheut për prodhimin e drithërave, të bimëve industriale e rritjen e blegtorisë, një krahinë shumë e përshtatshme për frutikulturën dhe për pemën me viera të mëdha të ullirit.

Ashtu si për të gjithë vendin, Partia ka pasë menduar e mendon edhe për zhvillimin ekonomik të Mallakastrës, për përmirësimin e jetës së popullit të saj trim e patriot në rrugën e socializmit. Përparimet në këtë drejtim të gjithë i shohim me sytë tanë, ndërsa të mirat e tij i gëzon vetë populli i kësaj krahine. Ballshi, nga një qytet i rregjuar e pa perspektivë zhvillimi në të kaluarën, është bërë sot një qendër e fuqishme e industrisë sonë të re socialiste. Edhe fshatrat e Mallakastrës, gjithashtu, me transformimin socialist të bujqësisë, kanë ndryshuar si nata me ditën.

Partia është kujdesur vazhdimisht, edhe vetë personalisht jam interesuar dhe kam kërkuar që terreni i thyer i krahinës suaj të vihej nën ujë dhe të kthehesh sa më shpejt në blloqe të mëdhenj pemësh frutorë të të gjitha llojeve si dhe me ullinj, vreshta etj., kaq shumë të dobishme për ushqimin e njerëzve tanë dhe të nevojshme si lëndë e parë për industrinë ushqimore.

Sot me kënaqësi konstatoj se nën kujdesin e vazhdueshëm të Komitetit Qendror të Partisë, të ndihmës së organizatës të Partisë e të pushtetit në rreth, si dhe të punës suaj të madhe, bujqësia e blegtoria, duke përfshirë edhe pemëtarinë tek ju, janë futur në rrugën e zhvillimit. Vazhdojeni këtë punë më me vrull në mënyrë që të çohet gjithnjë e më përpara zhvillimi ekonomiko-shoqëror si i kooperativës suaj, edhe ai i Mallakastrës, pse kjo është për të mirën tuaj, të mallakastriotëve dhe të të gjithë popullit e Atdheut tonë socialist.

Përfitoj nga ky rast për t'ju dërguar juve e nëpërmjet jush gjithë popullit punëtor, trim e patriot të Mallakastrës së Rrapo e Dervish Hekalit, të Ramiz Aranitasit, të Dino Kalenjës e të sa e sa heronjve e dëshmorëve të tjerë, përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat, si dhe urimet më të mira në punë e në jetë.

Juaji

ENVER HOXHA

Tiranë, më 24 mars 1982

ARRITJET E DERITANISHME NË TRANSFORMIMIN SOCIALIST TË FSHATIT NA KANË RRITUR ENTUZIAZMIN DHE VENDOSMËRINË PËR TË MARRË PËRSIPËR E PËR TË REALIZUAR OBJEKTIVA MË TË MËDHA

SHOKUT ENVER HOXHA

SEKRETAR I PARË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

TIRANË

I dashur shoku Enver,

Ne, anëtarët e kooperativës bujqësore të tipit të lartë të Cakranit Hero i Punës Socialiste, në krahinën e Mallakastrës të rrethit të Fierit, me një ndjenjë të lartë krenarie për rezultatet e arritura analizuam përfundimet ekonomiko-financiare të vitit 1981.

Gjatë vitit që kaloi hodhëm një hap tjetër përpara në rrugën e intensifikimit të prodhimit bujqësor. Në krejt sipërfaqen prej 950 ha të mbjellë me grurë morëm 42,3 kv për ha. Sektori i Cakranit dhe ai i Gorishovës morën 48 kv për ha grurë. Brigadat pararojë që drejtohen nga Zakie Mihaj, Luftar Dalipaj etj., morën nga 52 deri 57 kv grurë për ha. Në misër, ku kemi fituar përvojë dhe kemi rritje të përvitshme të rendimenteve, morëm 75 kv për ha në tërë sipërfaqen e mbjellë. Ne mbjellim 1000 ha me pambuk dhe në këtë bimë të rëndësishme për ekonominë tonë morëm 13 kv për ha. Brigada të veçanta, si ajo e 9-ta dhe e 6-ta në sektorin e Varibopit, morën 26 dhe 24 kv për ha.

Ne kemi treguar kujdes për zhvillimin harmonik të të gjithë degëve të bujqësisë: bimëve të arave, blegtorisë, pemëtarisë e pyjeve. Gjatë këtyre viteve kemi dyfishuar numurin e krerëve të lopëve dhe kemi rritur 2,5 herë prodhimin blegtoral. Kodrat e Cakranit, që i rrinë si kurorë fushës së sistemuar e të begatë, janë veshur me 122000 rrënjë ullinj, me 225 ha vreshta dhe me 90000 rrënjë pemë frutore. Pemëtaria është bërë një sektor i fuqishëm dhe jep 13 për qind të të ardhurave të kooperativës. Tokat e zëna me pemë e ullinj po shfrytëzohen intensivisht dhe nga

ato sigurohen edhe foragjere të njoma e koncentrate, me të cilat ushqehen 8000 krerë bagëti të imta, 20000 gjela deti etj.

Zhvillimi i pandërprerë i prodhimit, sidomos gjatë këtyre 10 vjetëve të organizimit të Cakranit si kooperativë e tipit të lartë, ka siguruar rritjen e vazhdueshme të nivelit tonë të jetesës. Brenda kësaj periudhe të ardhurat e përgjithshme të ekonomisë sonë të përbashkët janë rritur më shumë se dy herë. Në këtë zonë, si në të gjithë Mallakastrën, jetojnë të gëzuar e të lumtur 15000 banorë nga 3700 që kishin të nëntë fshatrat e ekonomisë sonë në vitet e para të Çlirimit. Çdo fshat në kooperativë është bërë pothuajse krejtësisht i ri, me banesa të bukura e të mobiluara, me institucione social-kulturore që plotësojnë më së miri nevojat tona.

Këtë zhvillim të pakrahasueshëm me të kaluarën, ne mallakastriotët, si i gjithë populli ynë, ia dedikojmë udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë me Ju në krye i dashur shoku Enver. Populli i krahinës sonë, i lidhur si mishi me kockën me Partinë dhe me Ju, që në ditët e para të luftës e vazhdimisht, ka punuar e ka luftuar gjithmonë për të vënë në jetë mësimet e Partisë dhe tuajat. Arritjet e deritanishme në transformimin socialist të fshatit, detyrat që shtroi Kongresi i 8-të i Partisë për intensifikimin e bujqësisë, na kanë rritur entuziazmin dhe vendosmërinë për të marrë përsipër e për të realizuar objektiva më të mëdha. Jemi të ndërgjegjshëm se ende kemi rezerva. Duke studiuar letërkëmbimet tuaja me kooperativistët e Dajçit dhe punëtorët e NB-së së Maliqit, duke u njohur konkretisht me përvojën e vyer të këtyre ekonomive dhe të ekonomive të tjera të dalluara, të gjithë ne, komunistë, kooperativistë dhe kuadro të kooperativës vendosëm që të avancojmë detyrat e pesëvjeçarit.

Duke marrë 80 kv për ha misër, 20 kv për ha fasule e sojë dhe 100 kv për ha patate, qysh këtë vit realizojmë rendimentet e vitit 1985. Në grurë do të marrim 44 kv për ha, ndërsa më 1984 do të realizojmë rendimentin e vitit të fundit të pesëvjeçarit 46,2 kv për ha në 900 ha me grurë. Në pambuk do të marrim 15,5 kv për ha dhe objektivin e pesëvjeçarit do ta arrijmë në vitin 1983 duke marrë 18 kv për ha në 1000 ha.

Zotimet tona do t'i bëjmë realitet. Bazë për këtë janë vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë, mësimet tuaja i dashur shoku Enver, është puna e ndërgjegjshme e 4900 kooperativistëve, frymëzim është shembulli pararojë i 370 komunistëve të kooperativës sonë. Mobilizimit tonë gjithmonë në rritje po i përgjigjet organizimi dhe drejtimi më i mirë i punës nga shtabet, të cilët funksionojnë gjatë gjithë kohës si shtabe lufte, ashtu siç na porositni Ju, shoku Enver.

Hapa të rëndësishme kemi bërë për përqëndrim — specializimin e prodhimit. Brigadat e arave tani kultivojnë nga dy kultura. Më mirë se çdo herë tjetër po zbatojmë teknologjitë e përparuara. Këtij qëllimi i shërben puna e 1550 kooperativistëve që kanë kryer e vazhdojnë shkollën e mesme bujqësore. Kujdes po tregojmë që t'i kryejmë në kohë të gjitha punët e stinës. Gruri, në sajë të shërbimeve, paraqitet i mbarë. Jemi hedhur frontalisht për përgatitjen e tokave dhe është pluguar 70 për qind e sipërfaqes që do të mbillet me bimët e pranverës. Kemi rikonstruktuar gjithë rrjetin kullues e ujitës, po vazhdojmë me shpejtësi dërgimin e plehut në arë, kemi siguruar farna të zgjedhura, të cilat lejojnë marrjen e

rendimenteve të larta. Masa të mira kemi marrë e po marrim për shtimin e bazës ushqimore, për remontin dhe mbarështimin e bagëtive. Kemi vënë si detyrë që, në muajt prill-maj, të bëjmë 6000 tonë silazh pranveror, sa dyfishi i planifikuar duke siguruar më mirë nevojat e blegtorisë së kooperativës dhe ato të tufëzuara. Pranverën e kemi kthyer në një betejë luftarake për të realizuar në kohë çdo detyrë.

I dashur shoku Enver,

Duke pasur në mendje e në zemër direktivat e Partisë dhe mësimet tuaja, do t'i çojmë më përpara fitoret e arritura në zhvillimin e ekonomisë dhe në forcimin e mbrojtjes të Atdheut tonë socialist.

Të rrojë Partia jonë e lavdishme!

Të rroni sa malet tona kreshnike i dashur shoku Enver!

NGA KOOPERATIVISTËT E KOOPERATIVËS SË TIPIT TË LARTË HERO I PUNËS SOCIALISTE TË CAKRANIT, RRETHI I FIERIT

Cakran, më 14.3.1982

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Nëntor 1982
Viti i botimit XXIX

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
Jashtë shtetit:
për 6 muaj 18 lekë, 1 vit 36 lekë

Përmbajtja:

ENVER HOXHA — Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës nr. 210 të Tiranës 5

NGA PUNIMET E PLENUMIT TË 5-TË TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

— Komunikatë mbi mbledhjen e Plenumit të 5-të të Komitetit Qendror të PPSH 24

PALI MISKA — Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shërbim të ekonomisë dhe të popullatës (Raport i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PPSH) 34

ME RASTIN E 70-VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARËSISË KOMBËTARE

SH. BALLVORA — Pavarësinë kombëtare populli ynë e ka fituar dhe mbrojtur me forcat e veta 40

PROBLEME TË KONGRESIT TË 8-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

R. LIKA — Krahas zhvillimit të forcave prodhuese përsosen edhe anë të veçanta të marrëdhënieve socialiste në prodhim 50

H. DIBRA — Përsosja e standardeve — faktor i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së prodhimeve 62

M. BALANI — Vetëm rendi i vërtetë socialist garanton e respekton personalitetin dhe të drejtat e njeriut punonjës 71

G. PASHKO — Manipulimet imperialiste të çmimit të naftës — përshpejtues të thellimit të krizës energjetike 79

N. SHEHU — M. FERRA — Demagogjia revizioniste dhe e vërteta mbi natyrën e marrëdhënieve të pronësisë në bujqësinë sovjetike 89

ENVER HOXHA

FJALA NË TAKIMIN ME ZGJEDHËSIT E ZONËS NR. 210 TË TIRANËS

Të dashur shokë e shoqe, zgjedhës e zgjedhëse,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem këtu midis jush, njerëzve të dashur të kryeqytetit tonë të shtrenjtë dhe t'ju falënderoj për nderin e madh që më bëtë, duke më caktuar si kandidatin tuaj për deputet në Kuvendin Popullor. Besimi juaj ndaj personit tim i përket Partisë sonë të lavdishme, që na solli këto ditë të bardha që gëzojmë sot dhe që na udhëheq me mendje të kthjellët e dorë të sigurt drejt një të ardhmeje akoma më të mirë e më të bukur. Partia na mësoi ne, bijtë e saj, si të luftojmë e si të punojmë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ishte ajo që na bëri të ndërgjegjshëm për çështjen e klasës punëtore, ajo na dha mendtë e fuqinë për t'i shërbyer çështjes së ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Prandaj, si në çdo moment tjetër, edhe në këto çaste solemne, kur po përgatitemi të votojmë për ripërtëritjen e Kuvendit Popullor, mendimet tona më të mira, ndjenjat tona të dashurisë e të mirënjohjes së thellë i drejtohen Partisë, vijës së saj të drejtë, besnikërisë së saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit.

Po bëhen katër dekada që ne jetojmë e punojmë të lirë në atdheun tonë. Kur shikojmë rrugën e përshkuar, të gjithë ndiejmë një gëzim të madh për sukseset e arritura dhe një krenari të ligjshme për mundin që kanë bërë e për djersën që kanë derdhur njerëzit tanë. Kjo periudhë do të mbetet në histori si periudha kur u shfaqën me tërë forcën e tyre vitaliteti dhe gjallëria e popullit tonë, fryma e tij luftarake dhe këmbëngulja në punë, etja e madhe për të mësuar dhe shpirti përparimtar. Ishin këto virtyte të larta, që Partia diti t'i nxjerrë në dritë dhe t'i shndërrojë në një forcë të madhe lëvizëse, që bënë të mundur kryerjen e shpejtë dhe me sukses të të gjitha atyre transformimeve të mëdha shoqërore-ekonomike që i kemi jetuar. Ishte ai karakter liridashës e revolucionar i njerëzve tanë, ishin mësimet që ata kishin nxjerrë nga e kaluara e hidhur, kur Shqipërinë e sundonin dhe e shtypnin të huajt, që i shtynë ata të bashkohen grusht rreth Partisë dhe, nën udhëheqjen e saj, të luftojnë e të dalin fitimtarë mbi komplotet e ndërhyrjet e imperialistëve dhe mbi tradhtinë e revizionistëve modernë, jugosllavë, sovjetikë e kinezë.

Për të gjithë ne, për mbarë popullin tonë, zgjedhjet e Kuvendit Popullor janë një rast për t'u takuar e biseduar, për të bërë bilancin e punës së kryer dhe për të shqyrtuar detyrat që na presin.

Zgjedhjet e reja e gjejnë Shqipërinë të sigurt në fatet e veta, një vend që qëndron fort mbi këmbët e tij, që perspektivën e ka të qartë dhe të ardhmen të garantuar. Kurrë ndonjëherë populli shqiptar nuk ka qenë i bashkuar në interesa, në pikëpamjet politike e ideologjike, në normat morale e në sjelljet shoqërore siç është sot. Ky unitet i çeliktë, i farkëtuar nga Partia në betejat heroike të çlirimit të atdheut dhe në transformimet e mëdha socialiste, qëndron sot në themelet e pushtetit popullor, të lirisë e të pavarësisë së atdheut dhe i bën ato të patundura e të pathyeshme. Është ky unitet ajo forcë e madhe monolite që u ka bërë ballë armiqve të egër e që ka shpartalluar intrigat e komplotet e tyre.

Në këtë unitet të Partisë e të popullit theu kokën edhe Mehmet Shehu, një nga tradhtarët dhe armiqtë më të rrezikshëm të Shqipërisë socialiste. Ai ishte kritikuar shumë herë nga Partia për gabime të rënda, por kishte mundur të kamuflohej. Sipas dokumenteve të zbuluara dhe dëshmive të pakontestueshme, vërtetohet se ai, qysh para luftës, ka qenë vënë në shërbim të zbulimit të fshehtë amerikan. Gjatë luftës e pas çlirimit, Mehmet Shehu luftoi e punoi në Shqipëri si mercenar i të huajve dhe nën urdhrat e tyre. Ai, që kur ishte në Brigadën I, u rekrutua edhe nga zbulimi i fshehtë jugosllav (OZNA, sot UDB), pastaj edhe nga KGB-ja sovjetike, të cilëve u ka shërbyer me zell. Me porosi dhe sipas udhëzimeve të qëndrave të huaja të spiunazhit, veçanërisht të CIA-s e të UDB-së, ai dhe grupi i komplotistëve të lidhur me të, të cilët tashmë i janë dhënë hetuesisë, kanë punuar për të shkatërruar Partinë e pushtetin popullor dhe për ta vënë Shqipërinë nën sundimin e huaj.

Për të zbatuar planet diversioniste e banditeske të caktuara nga padronët e tyre në Uashington, Beograd e gjetkë, Mehmet Shehu dhe shokët e tij ishin përgatitur për krime të rënda. Mehmet Shehu kishte marrë urdhër nga UDB-ja jugosllave të vriste Sekretarin e Parë të Komitetit Qendror dhe udhëheqës të tjerë të Partisë e të shtetit, si dhe të shtypte me mjete terroriste të gjithë ata që do të ngriheshin kundër kësaj tradhtie të madhe. Në qoftë se ata nuk mundën të vepronin për të realizuar qëllimet e tyre kriminale, kjo lidhet me frikën e madhe që kishin nga populli e Partia, nga uniteti i tyre i çeliktë, i cili nuk lë asnjë armik të bëjë hap, sado dinak e i djallëzuar qoftë. Mehmet Shehu nuk mundi kurrë ta lëvizte e ta shtrembëronte vijën e Partisë, mbasi po të orvatej ta bënte këtë, do të demaskohej menjëherë.

Mehmet Shehut, i vënë mes dy zjarresh, kërkesës së UDB-së, së cilës i digjej toka nën këmbë në Kosovë, dhe frikës nga uniteti i Partisë dhe i popullit, nuk i mbeti tjetër, veçse rruga e turpshme e vetëvrasjes.

Bashkimi i madh i popullit tonë e ka burimin e vet te vija e drejtë e Partisë, që ka mishëruar e shprehur kurdoherë kërkesat historike të masave. Populli ëndërronte të jetonte i lirë dhe i pavarur në vendin e vet, të zhdukte shfrytëzimin e shtypjen shoqërore, të kapërcente prapambetjen shekullore. Ai kërkonte emancipimin e përgjithshëm të shoqërisë shqiptare, çlirimin e të gjitha forcave krijuese, zhvillimin e lirë

të aftësive e të talenteve të ndrydhura nga regjimet e kaluara. Ai donte të ishte zot në vendin e vet dhe i barabartë në marrëdhëniet me kombet e tjera.

Këto aspirata populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, i realizoi plotësisht. Ato janë një realitet i gjallë, të cilin e shohim, e prekim, e jetojmë përditë. Shqipëria socialiste është një vend dhe një shtet krejtësisht i lirë e i pavarur, që nuk i detyrohet askujt e për asgjë. Për të janë të huaja e të papranueshme tutelat e diktatet, ndërhyrjet e borxhet, nga të cilat vuajnë jo vetëm shumë shtete të vogla, por edhe të mëdha. Kurrë Shqipëria nuk ka pasur një pozitë ndërkombëtare më të fortë se sa sot.

Brenda një kohe relativisht shumë të shkurtër Shqipëria nga një vend i varfër, që vuante edhe për bukën e gojës, është bërë një vend plot me fabrika e kombinate, me miniera e hidrocentrale, me fusha të bonifikuara e të ujitura, me shkolla e institute shkencore. Njerëzit tanë janë të ngritur politikisht e ideologjikisht, të arsimuar e të kulturuar, të aftë për të kryer me forcat e veta çdo punë që i nevojitet përparimit të atdheut e mbrojtjes së vendit. Te ne po rritet dhe edukohet një brez i ri revolucionar e patriot, i cili, me siguri, do ta çojë gjithnjë e më përpara stafetën e revolucionit, do ta ngrejë gjithnjë e më lart lavdinë e atdheut tonë socialist.

Populli ynë ka mundur t'i arrijë këto rezultate të shkëlqyera, ai ka ecur dhe ecën përpara, pse në zhvillimin ekonomik e në fushat e tjera është mbështetur tërësisht në forcat e veta, pse Partia jonë në gjithë veprimtarinë e saj ka zbatuar në mënyrë krijuese e me besnikëri parimet e marksizëm-leninizmit. Në Shqipëri marksizëm-leninizmi dha një provë të madhe të forcës së tij revolucionarizuese e transformuese kur ai zbatohet drejtë e me konsekuencë.

Sot, i madh e i vogël te ne e sheh me sytë e tij dhe e ndien me zemër drejtësinë e pushtetit popullor, epërsinë e padiskutueshme dhe vitalitetin e rendit tonë shoqëror socialist.

Me mundin, djersën dhe talentin krijues të popullit tonë, duke u mbështetur në burimet tona natyrore e financiare, u krijua një industri krejt e re dhe shumëdegëshe, e fuqishme dhe moderne, e shpërndarë në të gjithë territorin e vendit.

Është një krenari e ligjshme kur shikojmë të ngritur gjigantë të tillë, si: Kombinati Metalurgjik dhe sistemi unik energjetik me hidrocentralet mbi lumin Drin, puset e naftës dhe uzinat e përpunimit të thellë të saj, uzinat kimike dhe kombinatet e tekstilit, dhjetëra miniera, kombinate e fabrika të përpunimit të metaleve, si dhe shumë vepra të tjera madhështore.

Me prodhimet tona industriale ne plotësojmë tani nevojat e domosdoshme të popullit për një konsum që zgjerohet pa ndërprerje, plotësojmë nevojat e ekonomisë, që zhvillohet në mënyrë dinamike, plotësojmë kërkesat për fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut. Industria është bërë tashmë burimi kryesor i akumulimit socialist dhe i të ardhurave nga eksporti. Ajo është faktor i dorës së parë i mbështetjes plotësisht në forcat tona.

Është meritë e Partisë sonë që krijimin dhe zhvillimin e industrisë

i lidhi ngushtë me zhvillimin e përparimin e bujqësisë e të fshatit në rrugën e socializmit. Duke iu përmbajtur vijës që ka caktuar Partia, bujqësia jonë socialiste është fuqizuar pa ndërprerje, ajo po ecën me vendosmëri në rrugën e intensifikimit dhe të sigurimit të rendimenteve të larta. Fushat e bonifikuara e të sistemuara, kodrat e malet, të kthyera në toka buke e në plantacione me pemë frutore, krijimi i një sistemi kompleks të ujitjes, shtimi i bagëtive dhe modernizimi i blegtorisë, ngritja e parkut të gjerë të mekanikës bujqësore - ja disa nga ato arritje, që ia kanë ndryshuar rrënjësisht pamjen bujqësisë sonë.

Forcën e bujqësisë sonë socialiste dhe përparimet e saj i dëshmon edhe fakti që, me gjithë thatësirën e jashtëzakonshme të këtij viti, u prodhua grurë e misër më shumë se çdo vit tjetër në periudhën e pasçlirimit. Bujqësia siguron tani në mënyrë të pavarur ushqimin e popullit, lëndët e para për industrinë e lehtë e ushqimore dhe burime të rëndësishme akumulimi e valutore. Fshati ynë socialist është i populluar dhe i lulëzuar, mënyra e jetesës së tij po afrohet gjithnjë e më shumë me atë të qytetit.

Është krijuar një sistem i gjerë transporti me hekurudha që shtrihen qindra kilometra, me një park të shumtë automjetesh dhe me një flotë detare që po fuqizohet pareshtur. Ky sistem ka forcuar karakterin unik të ekonomisë dhe ka gjallëruar së tepërmi jetën ekonomike e shoqërore të vendit.

Zhvillimi i ekonomisë, përparimi i jetës materiale, intelektuale e shpirtërore, janë shoqëruar e mbështetur nga një revolucion i vërtetë në fushën e arsimit e të kulturës, të përgatitjes së kuadrove, të shkencës e të teknikës. Njerëzit tanë, të udhëhequr nga Partia, asnjëherë nuk e kanë ndarë punën dhe veprimtarinë e tyre nga çështja e madhe e garantimit të fitoreve socialiste, e forcimit të aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë të shtrenjtë.

Katër vjet më parë, në prag të zgjedhjeve për legjislaturën e kaluar, ne denoncuam botërisht tradhtinë e revizionistëve kinezë dhe veprimtarinë e tyre antishqiptare. Armiqtë shpresuan se Shqipëria socialiste do të gjunjëzohej dhe do të drejtohej për ndihmë jashtë. Por ata dështuan në llogaritë e tyre. Pati edhe njerëz të paanshëm, që menduan se ne nuk do të bënim dot pa ndihma e kredi të huaja.

Koha e vërtetoi se Shqipëria as u përkul, as u gjunjëzua, por eci përpara ballëlart me forcat e veta dhe pa ndihmën e kurrkujt, bile ecëm më shpejt dhe shkuam më larg. Por më mirë për këtë flasin faktet.

Gjatë katër vjetëve të kaluar u vunë në shfrytëzim me dhjetëra vepra industriale, bujqësore, të transportit e socialkulturore. Periudhës së legjislaturës që kaloi i takojnë vënia në shfrytëzim e hidrocentralit «Drita e Partisë» në Fierzë, furrnalta e dytë, bateria e koksit dhe uzina e materialeve refraktare në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», uzina e ferrokromit në Burrel, uzina e shkrirjes së bakrit në Laç, hekurudha Laç-Shkodër, dyfishimi i kapacitetit të kombinatit të sheqerit në Maliq, ngritja e tetë rezervuarëve të mëdhenj për ujitje, si ai i Gjançit në Korçë, i Tapizës në Tiranë, i Izvorit në Tepelenë etj., ndërtimi i Muzeut Historik Kombëtar dhe i më shumë se 53 mijë apartamenteve e ndërtesave të banimit, ku u strehuan mbi 250 mijë veta në qytete e në fshatra.

Vetëm gjatë katër vjetëve të kaluar u futën në punë kryesisht në

prodhim, afro 160 mijë veta, duke aktivizuar kështu të gjitha forcat e reja të punës. Financat tona kanë forcuar qëndrueshmërinë e tyre, duke bërë të mundur që për përmirësimin e kushteve të jetesës së punonjësve, për zhvillimin e arsimit e të shëndetësisë, për sistemin e gjerë të sigurimeve shoqërore e të pensioneve dhe për nevoja të tjera të përbashkëta të përdoren afro 40 për qind e fondeve të buxhetit të shtetit. Në Shqipërinë socialiste nuk ka papunësi, s'ka inflacion, s'ka taksa e tatim mbi popullsinë. Qiratë e shtëpive janë fare të vogla.

Ulja e re e çmimeve në një sërë mallrash të konsumit të gjerë e të shërbimeve komunale është një shfaqje tjetër e kujdesit të Partisë për mirëqenien e popullit, e forcës së ekonomisë dhe e ecurisë në rrugë të drejtë të proceseve ekonomike e shoqërore në vendin tonë socialist.

Rezultatet që kemi arritur dalin edhe më mirë në pah, po të kemi parasysh se në të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste ka një rënie të madhe në ekonomi, rënie të prodhimit, papunësi, ngritje çmimesh, inflacion të madh dhe ulje të nivelit të jetesës.

Kriza e sotme ekonomike botërore në esencë është si të gjitha krizat e tjera të mëparshme. Ato, siç i ka shpjeguar Marksi dhe siç i ka vërtetuar historia, janë fenomene të pashmangshme të sistemit kapitalist. E reja në krizën aktuale është se ajo demonstroi falimentimin e teorive dhe të praktikave borgjeze e revizioniste, të shpikura për t'i shmangur ato. U vërtetua në praktikë se nxitja e prodhimit nëpërmjet shtimit artificial të konsumit të brendshëm, duke i kthyer gjithë njerëzit në borxhlinj të monopoleve, ishte e mbarsur me pasoja katastrofike për mbarë vendin. Ranë edhe mburrjet boshe për ngritjen e nivelit të jetesës me para borxh, si në Jugosllavi, ku njerëzit po detyrohen ta kalojnë këtë dimër pa zjarr dhe me mungesa të mëdha të mallrave të përdorimit të gjerë e të dorës së parë.

Po kështu, mbështetja e zhvillimit ekonomik në borxhet e huaja, e cila u trumbetua për një kohë si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, si rruga e shpëtimit të njerëzimit, doli se ishte një strategji e robërimit të vendeve të varfëra e të dobëta nga ana e imperializmit dhe e fuqive të mëdha të industrializuara.

Përparime të mëdha janë bërë te ne në fushën e arsimit e të kulturës, të teknikës e të shkencës. Kujdesi i madh që ka treguar Partia për këta sektorë, si dhe përpjekjet që ka bërë pushteti popullor për zhvillimin e tyre kanë dhënë rezultate të shkëlqyera. Sistemi ynë arsimor është nga më të përparuarit në botë, nga më demokratikët e më popullorët. Fëmijëve tanë, kudo që ndodhen, u është krijuar mundësia të ndjekin shkollën 8-vjeçare. Shkollat e mesme kanë shkuar edhe në fshat, ku tërheqin gjithnjë e më shumë një numër tepër të madh nxënësish. Mundësi të shumta janë krijuar kudo për të ndjekur arsimin e mesëm e të lartë pa shkëputje nga puna.

Një krijimtari letrare e artistike e shëndoshë në përmbajtje dhe e larmishme në formë, po pasuron jetën shpirtërore të njerëzve tanë. Letërsia, muzika, artet figurative, filmi, teatri, televizioni etj., të udhëhequr nga Partia, kryejnë një punë të madhe edukuese, politike e ideologjike dhe luajnë një rol të madh në formimin e karakterit socialist të njerëzve tanë, në ngulitjen e normave të moralit komunist.

Partia i ka kushtuar një vëmendje të posaçme përvetësimit e zhvillimit të shkencës e të teknikës në vendin tonë. Megjithëse tradita në këtë sektorë ka qenë e paktë, ky kujdes i Partisë u dha mundësi njerëzve tanë, të talentuar e të etur për dije, të mësojnë e të zbatojnë me kompetencë teknikat e ndërlikuara, që kërkon zhvillimi i shpejtë e modern i ekonomisë dhe i sektorëve të tjerë. Ngritja e një numri të konsiderueshëm institutesh të posaçme për studime shkencore, krijimi i byrove teknologjike, i grupeve të shumta të studimit etj., dëshmojnë për atë gjerësi që ka marrë te ne puna shkencore, si dhe për nevojën që ka ekonomia dhe e gjithë shoqëria për të. Në të njëjtën kohë, Partia ka punuar e punon që studimet e metodat shkencore në prodhim, organizim, drejtim e kudo të bëhen një praktikë e përditshme e njerëzve tanë.

Dëshmi e gjallë e forcës së pushtetit popullor dhe e vitalitetit të rendit shoqëror janë edhe ndryshimet e mëdha në kryeqytetin e atdheut tonë të dashur. Në këto vite Tirana është transformuar krejt. Ajo ka një popullsi mbi tetë herë më të madhe se në periudhën e paraçlirimit dhe mbi 80 për qind e saj banon në ndërtesa të reja. Vetëm numri i nxënësve në shkollat e mesme është më i madh se gjithë popullsia e qytetit të Tiranës para luftës. Sot në kryeqytet punojnë e krijojnë 70 mijë punëtorë dhe sigurohet një e pesta e prodhimit industrial të vendit. Kështu si Tirana janë transformuar e rinuar të gjitha qytetet e fshatrat tona.

Me perspektivat që ka çelur Kongresi i 8-të i Partisë popullin tonë e pret një e ardhme më e lumtur dhe më e begatshme. Legjislatura e re e Kuvendit Popullor koincidon në kohë me zbatimin e planit të shtatë pesëvjeçar. Gjatë kësaj periudhe ne i kemi të gjitha mundësitë njerëzore, materiale e financiare për të ecur me vendosmëri përpara dhe për të arritur rezultate më të mëdha në të gjitha fushat. Dhe, me siguri, me punën dhe me djersën tonë ne do të arrijmë të kemi më shumë naftë e minerale, më shumë çelik, energji elektrike, drithë e produkte të tjera bujqësore e blegtorale, më shumë mallra industriale të konsumit të gjerë dhe të një cilësie më të mirë.

Ekonomia jonë do të fuqizohet akoma më shumë, zhvillimi i forcave prodhuese do të çohet akoma më përpara. Do të ndërtohen qindra vepra të rëndësishme ekonomike e socialkulturore. Industrisë do t'i shtohen vepra të tilla të mëdha si hidrocentrali i Komanit, uzina e vajrave lubrifikante, uzina e prodhimit të nikelit dhe kobaltit metalik. Do të dyfishohet prodhimi i metalurgjisë së ferrokromit, do të ngrihen disa fabrika të pasurimit të mineraleve dhe për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, do të kryhen zgjerime dhe rikonstruksione të kombinateve tekstile, të trikotazheve etj.

Gjithashtu, do të fillojnë së ndërtuari mjaft vepra të rëndësishme të metalurgjisë së zezë e me ngjyra, të hidroenergjetikës, të materialeve të ndërtimit etj. Në këtë mënyrë, industria do të fuqizohet më tej dhe do të luajë akoma më mirë rolin e saj vendimtar për përparimin e përgjithshëm të vendit.

Bujqësia do të futet më gjerësisht e mbi baza shkencore në rrugën e intensifikimit, duke hapur perspektiva të mëdha për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, për zhvillimin e mëtejshëm të jetës socialiste në fshat dhe për forcimin e pavarësisë së vendit. Në një zonë të

gjerë fushore do të bëhet intensifikimi me përparësi i prodhimit. Investime të mëdha do të bëhen për tokën, për ujitjen, për mekanizimin, për shtimin dhe përmirësimin e plantacioneve me pemë frutore, agrume dhe ullinj.

Siç jeni në dijeni, në bazë të planit të shtatë pesëvjeçar dhe të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë, do të zbatohet një program i tërë për fuqizimin e mëtejshëm të transporteve tona, duke i dhënë prioritet transportit hekurudhor, që tashmë është shtrirë në drejtimet kryesore të lëvizjes së mallrave e të udhëtarëve.

Plotësimi i objektivave për zhvillimin e prodhimit do ta garantojë dhe do ta çojë akoma më përpara mirëqenien e popullit, si në qytet edhe në fshat. Do të përmirësohet pareshtur furnizimi i tregut me mallra industriale e ushqimore, do të përmirësohet struktura e konsumit të ushqimit të popullit, investime të rëndësishme do të bëhen për strehimin e popullatës, si dhe do të merren një varg masash të tjera, që synojnë të përmirësojnë më tej mirëqenien e popullit në të gjitha aspektet e jetës.

Si kurdoherë, në qendër të vëmendjes së Partisë dhe të shtetit tonë socialist do të jenë zhvillimi arsimor e kulturor i punonjësve, ruajtja dhe forcimi i shëndetit të tyre. Hapa të rinj do të bëhen edhe në sektorët e ndryshëm të kulturës, me synim që puna e tyre të shtrihet thellë në masat dhe t'i shërbejë më mirë edukimit të gjithanshëm të tyre.

Mbrojtjes së atdheut, në çdo situatë e në çdo kohë, Partia e pushteti popullor i kanë kushtuar kujdesin më të madh. Sot vendi ynë ka një mbrojtje të fuqishme që garanton lirinë e pavarësinë, të fituara me aq gjak e sakrifica, punën e tij paqësore. Detyra jonë është që këtë mbrojtje ta çelikosim gjithnjë e më shumë, për të qenë kurdoherë në gjendje dhe në gatishmëri të plotë për të shpartalluar çdo armik që do të orvatet të prekë tërësinë tokësore e sovranitetin tonë kombëtar.

Uniteti i popullit tonë është i çeliktë. Situata jonë e brendshme është e shëndoshë. Këtë e vërteton edhe dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor, që do të shpallet nesër, me anën e të cilit u falet ose u zbritet dënimi mjaft të burgosurve të dënuar për faje të ndryshme.

Kur në të gjitha vendet e botës çdo ditë ngrihen çmimet, në Shqipërinë socialiste ato ulen; kur në të gjitha vendet e botës mbushen burgjet, në Shqipërinë socialiste këto zbrazen. Kjo tregon forcën ekonomike dhe politike të pushtetit tonë të diktaturës së proletariatit.

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor kanë qenë kurdoherë një manifestim i demokracisë sonë socialiste, i karakterit popullor të shtetit tonë. Njerëzit tanë kanë shkuar kurdoherë të gjithë me entuziazëm në votime dhe kanë votuar të gjithë për kandidatët e Frontit Demokratik, pse kanë qenë të ndërgjegjshëm e të bindur se kështu shprehin dashurinë për Partinë dhe besnikërinë ndaj vijës së saj, përkrahjen që ata i japin njëzëri pushtetit popullor, dënimin që u bëjnë armiqve, të jashtëm e të brendshëm, vendosmërinë për të ecur me guxim e ballëlart në rrugën e ndritur të socializmit.

Kështu ka ndodhur në të kaluarën. Kështu do të ndodhë edhe në votimet e tanishme. Pjesëmarrja në zgjedhje dhe vota për kandidatin e Frontit Demokratik janë një shprehje e pjekurisë politike e ideologjike, e ndërgjegjes klasore e patriotike, e përgjegjësisë për fatet e vendit.

Të dashur shokë e shoqe,

Aktualisht, ne po jetojmë në një situatë ndërkombëtare mjaft të nderë dhe të mbushur me kërcënime e rreziqe të mëdha për lirinë e pavarësinë e popujve, si dhe për paqen e sigurinë ndërkombëtare. Kjo gjendje është rezultat i intensifikimit të politikës dhe të veprimeve agresive të superfuqive imperialiste dhe të një rigjallërimi të forcave të ndryshme reaksionare, fashiste e luftënxitëse.

Si në shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe në Bashkimin Sovjetik po merr epërsi një kurs militarist e aventuresk në politikën e jashtme, po vihet në zbatim një strategji e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta ushtarake si mjet për të siguruar ekspansionin dhe hegjemoninë e tyre politike dhe ekonomike në botë. Tani objekt i kësaj mësymjeje të përgjithshme të superfuqive janë bërë jo vetëm popujt e vendet që kanë qenë jashtë zonave të sundimit të tyre, por edhe partnerët e vet më të ngushtë në aleancat ushtarake e në blloqet ekonomike.

Në këto situata popujt, natyrisht, nuk rrinë duarlidhur. Forcat revolucionare, patriotike, demokratike e paqedashëse, kudo në botë, i bëjnë një rezistencë të hapët e të vendosur politikës agresive e çnjerëzore të imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik. Në Afganistan, në Lindjen e Mesme, në Salvador etj. luftohet me armë për të rifituar lirinë e shkelur dhe pavarësinë e humbur. Populli i Iranit po bën përpjekje të mëdha për të mbrojtur revolucionin e tij nga kërcënimet e shantazhet, që i bëjnë të dyja superfuqitë. Në të gjitha vendet kapitaliste, pa përjashtim, është zgjeruar shumë rezistenca e klasës punëtore për të mbrojtur të drejtat demokratike dhe ato të punës, të fituara në beteja të gjata klasore. Në një shkallë më të lartë dhe në përpjesëtime më të gjera po zhvillohet lufta e mjaft vendeve për sovranitetin kombëtar mbi lëndët e para dhe për një zhvillim të pavarur.

Këto luftëra e përpjekje përbëjnë edhe ata faktorë kryesorë që godasin sistemin kapitalist e imperialist botëror, që shkaktojnë krizat në aleancat kapitaliste dhe acarojnë kontradiktat ndërimperialiste, që frenojnë e pengojnë realizimin e planeve skllavëruese e luftënxitëse të imperializmit.

Partia dhe Qeveria jonë, si kurdoherë, i ndjekin me vëmendje proceset e ndryshme që ndodhin në botë dhe nxjerrin konkluzionet përkatëse për qëndrimet që duhet të mbajnë ndaj tyre e që t'u përgjigjen mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit e të vendit tonë. Ne mbajmë parasysh se situatat në botë nuk qëndrojnë kurrë në vend, të palëvizshme. Ato ndodhen gjithnjë në ndryshim dhe evuluojnë për mirë ose për keq, sipas raportit të forcave klasore në botë, të zhvillimit të kontradiktave të ndryshme, të krizave etj.

Tani vëmë re se në Evropë, në Mesdhe, në Lindjen e Mesme e në Ballkan, si rezultat i politikës hegjemoniste dhe i ndërhyrjeve brutale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, po krijohen tensione e konflikte të reja, të cilat rrezikojnë drejtpërdrejt paqen e sigurinë e shumë vendeve të këtyre rajoneve.

Vendet e Evropës Perëndimore e Lindore janë vënë në mengenenë e dy superfuqive, që kërkojnë tani t'u marrin jo më pasuritë, por edhe

shpirtin. Me shumë të drejtë masat e gjera popullore në shumë vende janë ngritur në demonstrata e protesta kundër vendosjes së armëve atomike amerikane e sovjetike dhe kërkojnë me këmbëngulje largimin e tyre nga kontinenti ynë i vjetër. Ato janë të ndërgjegjshme se superfuqitë, duke i futur vendet e tyre nën ombrellën e vet atomike, kërkojnë t'i mbajnë gjithnjë të nënshtruara politikisht dhe ekonomikisht dhe që Evropa e gjithë të bëhet mish për top për amerikanët e sovjetikët.

Dërgimi i njësive ushtarake të disa vendeve evropiane në Liban, krahas atyre të Shteteve të Bashkuara, pavarësisht nga justifikimet që mund të bëhen, përbën një precedent shumë të rrezikshëm për ndërhyrje ushtarake të drejtpërdrejtë në punët e brendshme të shteteve të pavarura. Ky veprim, në njëfarë mënyre, është një kthim te politika e vjetër e fuqive të mëdha evropiane, që, nën pretekstin e «shuarjes së turbullirave» e «të vendosjes së rregullit», dërgonin trupa në vende të ndryshme për të vendosur sundimin e tyre.

Mendimi i Partisë sonë është se forcimi i paqes dhe i sigurisë në Evropë, në Mesdhe ose në Lindjen e Mesme, zhvillimi e prosperiteti i shteteve evropiane, mbrojtja e kulturës, e traditave dhe e qytetërimit të tyre, ruhen e forcohen duke kundërshtuar politikën hegjemoniste të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik, duke mos u dhënë atyre asnjë mundësi të shfrytëzojnë lidhjet politike, ekonomike etj., që ekzistojnë me to, për të goditur e sulmuar vendet e tjera, për të vënë në rrezik lirinë e pavarësinë e popujve, paqen e sigurinë ndërkombëtare.

Mbrojtjen e vendeve evropiane, zhvillimin e lirë e të pavarur të tyre, sovranitetin dhe tërësinë e tyre tokësore, nuk i garantojnë as Pakti i Atlantikut, as Traktati i Varshavës, as bazat ushtarake të vendosura në shtetet e ndryshme dhe as armët atomike të superfuqive. Ato sigurohen duke i prishur këto pakte dhe duke i dërguar në shtëpitë e tyre ushtarët amerikanë e sovjetikë, duke i këputur e bërë copë-copë vargonjtë politikë, ekonomikë e ushtarakë, me të cilat Uashingtoni e Moska kanë lidhur Evropën.

Një gjë e tillë duhet bërë edhe në Ballkan, ku superfuqitë, duke përfituar nga situatat e vështira të krijuara në ndonjë vend, kanë filluar të lëvizin, të bëjnë presione të ndryshme e të kërkojnë koncesione të reja në favor të tyre. Paqen dhe sigurinë në Ballkan i rrezikon dhënia e bazave ushtarake ose e lehtësive të ndryshme Shteteve të Bashkuara e Bashkimit Sovjetik, i rrezikon futja në borxhe deri në grykë te superfuqitë, gjë që përbën rreziqe të shumta, jo vetëm për pavarësinë e atij vendi që i ka këto borxhe, por edhe për fqinjët e tij. Dihet se, kur tapitë i ke vënë rehem dhe s'ke me se paguan, vjen një ditë që borxhdhënësi të merr jo vetëm shtëpinë, por edhe tokën ku ajo është ngritur.

Popujt e Ballkanit, në të kaluarën, kanë vuajtur mjaft dhe ata nuk dëshirojnë që harta e gadishullit tonë të ndryshojë në favor të kësaj cse të asaj superfuqie. Prandaj shtetet ballkanike nuk duhet t'u lejojnë fuqive imperialiste, në asnjë rast e në asnjë mënyrë, të futen në Ballkan, të trazojnë paqen e sigurinë e vendeve të tyre.

Shumë shqetësuese është bërë aktualisht situata në Lindjen e Mesme. Agresioni i ri izraelit kundër Libanit, i organizuar, i financuar dhe i

nxitur nga imperialistët amerikanë, ka krijuar rreziqe e kërcënime të drejtpërdrejta, jo vetëm për popujt e zonës përreth, por edhe në një hapësirë më të gjerë.

Izraeli, duke përfituar nga ndihma e madhe amerikane dhe nga përçarjet e popujve arabë, ka lëshuar brezin dhe kërkon t'i shkatërrojë, njërin pas tjetrit, të gjitha ato vende që nuk pajtohen me grabitjen e tokave arabe dhe me gjenocidin kundër popullit të shumëvuajtur palestinez.

Politika e veprimtaria ekspansioniste e Izraelit në dëm të arabëve nxitet e favorizohet edhe nga politika e Bashkimit Sovjetik, nga pazarllëqet dhe komplotet e tij në prapaskenë në kurriz të popujve arabë.

Pas Kemp Dejvidit Izraeli sulmoi Libanin. Tani kërkon nënshtrimin e Jordanisë dhe kërcënon me luftë Sirinë. Nesër kujt do t'i vijë radha, Irakut, Arabisë Saudite, Iranit? Shtabet amerikane e izraelite për këtë mendojnë e punojnë. Por a do t'i lejojnë popujt trima arabë Izraelin dhe padronin e tij amerikan të shijnë si të duan mbi kurrizin e tyre? A do të qëndrojnë këta popuj kështu të përçarë që ata t'i thyejnë e t'i shtypin një nga një, sikurse po bëjnë?

Ne besojmë se kjo nuk do të ndodhë. Popujt arabë janë popuj liridashës e me tradita shumë të lashta luftarake, popuj që i kanë dhënë njerëzimit një qytetërim të tërë. Ata, me siguri, do të gjejnë forca për t'u bashkuar dhe për të ndaluar agresorët sionistë që të grabisin tokat arabe dhe të shfarosin njerëzit e tyre. Sado e gjatë të jetë lufta, sado të mëdha të jenë vështirësitë dhe sado të shumta të jenë sakrificat, që do të kërkohen, fitorja do të jetë e tyre. Me ta është e drejta, me ta është mbarë njerëzimi përparimtar. Populli ynë gjithnjë ka qenë përkrah popujve vëllezër arabë dhe çështjes së tyre të drejtë, përkrah popullit heroik palestinez. Edhe në të ardhmen lufta e drejtë e arabëve dhe e palestinezëve do të ketë mbështetjen e plotë e pa rezerva të popullit shqiptar.

Në Amerikën Latine, kohët e fundit, sidomos pas ardhjes së Reganit në fuqi, vihet re një shtim i ndërhyrjes amerikane, si dhe i intrigave të sovjetikëve. Këtij sulmi popujt e Amerikës Latine po i përgjigjen duke rritur rezistencën kundër planeve skllavëruese imperialiste. Popului shqiptar e ka përkrahur dhe e përkrah këtë luftë të popujve latinoamerikanë, që u shpreh edhe në rastin e konfliktit për Malvinet, ku ne përkrahim të drejtat e pamohueshme të popullit argjentinas.

Lufta e popullit tonë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë është në favor dhe një mbështetje aktive për luftën që bëjnë popujt kundër imperializmit e reaksionit. Në të njëjtën kohë, luftën e popujve për liri e pavarësi ne e shohim si luftën tonë, si një përkrahje të madhe për çështjen tonë.

Shokë,

Në Kongresin e 8-të të Partisë janë përcaktuar dhe shprehur qartë parimet nga udhëhiqet politika e jashtme e vendit tonë, si dhe qëndrimet tona ndaj problemeve të mëdha aktuale ndërkombëtare, ndaj vendeve të veçanta, si dhe ndaj forcave e lëvizjeve të ndryshme politike në botë. Kjo politikë, si në të kaluarën, edhe sot, ka mbështetjen e plotë

të popullit tonë, mbasi ajo shpreh mendimet e dëshirat e tij, mbron interesat më të lartë të atdheut.

Populli ynë e përkrah këtë politikë, pasi ajo është një politikë krejtësisht e pavarur, që nuk influencohet nga asnjë kufizim i jashtëm, i çfarëdo natyre qoftë. Zëri i Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare është vetëm zëri i saj. Kjo është edhe një arsye që ai dëgjohet, respektohet e merret në konsideracion.

Qëndrimet tona janë të njohura. Ne e kemi thënë dhe e themi se asnjë afrim e asnjë pajtim nuk do të kemi me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik, të cilët janë armiqtë më të mëdhenj tanët dhe të të gjithë popujve. Ne do t'i kundështojmë me vendosmëri synimet e tyre hegjemoniste dhe do të demaskojmë pandërprerë planet agresive. Mendimi ynë është dhe jeta e ka vërtetuar se lufta dhe papajtueshmëria me imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik përbëjnë një kusht të domosdoshëm për ruajtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut, të përparimit në rrugën tonë socialiste.

Me vendet e tjera, pavarësisht nga sistemi i tyre shoqëror, si: me Francën, me Vendet Skandinave, me Zvicrën, me Belgjikën, me Holandën etj., ne jemi për marrëdhënie normale, mbi bazën e mosndërhyrjes, të barazisë e të interesit reciprok. Ne jemi për atë që këto marrëdhënie duhet t'i shërbejnë zhvillimit ekonomik, kulturor e shoqëror të të dyja palëve, forcimit të miqësisë midis popujve e shteteve sovrane dhe, në të njëjtën kohë, interesave të ruajtjes e të forcimit të paqes në botë.

Vendi ynë ka qenë dhe është për zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, gjë që e konsideron si një mjet të dobishëm e të nevojshëm për secilin vend. Por ne kërkojmë nga të gjithë partnerët tanë që ajo të bazohet vetëm në leverdinë reciproke dhe në barazinë e plotë, që ajo të jetë e lirë nga çdo presion e diskriminim. Aq më tepër, ne nuk pranojmë që marrëdhëniet tregtare të shfrytëzohen si mjet për të ndërhyrë në punët e brendshme ose për të imponuar koncepte politike e ideologjike të huaja për ne. Tregtia për ne është tregti, domethënë shkëmbim i lirë e i ekuilibruar mallrash dhe ne nuk e konfondojmë kurrë atë me marrjen e kredive, që është një gjë krejt tjetër.

Shqipëria socialiste, njerëzit tanë kanë një stimë shumë të lartë për arritjet përparimtare në kulturë, në shkencë e në teknikë nga çdo vend, për të gjitha ato vlera që i shërbejnë zhvillimit e përparimit të njerëzimit. Prandaj ne jemi për shkëmbime normale kulturore me vendet e tjera, për njohjen reciproke të arritjeve përparimtare e demokratike në këtë fushë, pa diskriminime e pa paragjykime.

Një vëmendje të veçantë, siç është e natyrshme, vendi ynë u kushton marrëdhënieve me shtetet fqinje. Ajo që e ka frymëzuar dhe e frymëzon këtë qëndrim është dëshira për të jetuar në fqinjësi të mirë, për të pasur kurdoherë marrëdhënie të dobishme dhe për të ndërtuar një bashkëpunim normal, që bazohet në parimet e barazisë së plotë e të mosndërhyrjes në punët e brendshme të të tjerëve, të respektimit të sovranitetit kombëtar e të moscenimit të tërësisë tokësore, të shkëmbimeve mbi bazën e interesit reciprok.

Me popullin italian ne kemi lidhje të mira dhe nuk e konfondojmë atë me fashistët e Musolinit që na dogjën dhe na vranë. Në shënimet e mia të

kohës së luftës lexoj me kënaqësi fjalët që më tha në fshatin Arbanë, në afërsi të Tiranës, kur u takuam, gjeneral armate Azzi, i cili, pas kapitullimit të ushtrisë musoliniane, me gjithë armatën e tij, u dorëzua në besim të Shtabit tonë të Përgjithshëm partizan dhe të popullit shqiptar, «U jemi mirënjohës popullit dhe partizanëve shqiptarë, që shpëtuan dhe strehuan me mijëra ushtarë të mi, bij të popullit italian. Unë dhe populli italian nuk do ta harrojmë këtë bujari. Unë, — vazhdoi të më thotë gjeneral Azzi, - derisa të vdes, do të jem mik i popullit shqiptar». Dhe ai i tillë qëndroi derisa vdiq.

Regjimet e dy vendeve tona janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, ne kemi ligjet dhe mënyrën tonë të jetesës, Italia ka të vetat. Megjithatë, ne kemi marrëdhënie normale tregtare dhe kulturore me Italinë, të cilat jemi gati t'i zgjerojmë sipas leverdisë reciproke dhe pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Në qoftë se ndonjë qeveri italiane i konsideron këto marrëdhënie pa interes për të, ajo mund të bëjë si të dojë, ne kjo nuk na prish shumë punë. Por ne mendojmë të kundërtën, marrëdhëniet janë të dobishme për të dyja palët. Ne s'jemi një vend i izoluar dhe i mbyllur, ne kemi ç't'i shesim Italisë dhe çfarë të blejmë me pare në dorë prej saj, ashtu si dhe nga shumë shtete të tjera.

Një komunitet i lavdishëm arbëresh na lidh, gjithashtu, me popullin italian. Si ne, edhe italianët nuk duhet t'i harrojmë fjalët e mira dhe çmimin e lartë të Garibaldit për shqiptarët dhe për arbëreshët.

Arbëreshët rrojnë që prej pesë shekujsh në Kalabri dhe në Sicili. Ky komunitet u ka dhënë Italisë dhe Shqipërisë njerëz të shquar. Duke jetuar në miqësi në mes të popullit italian, arbëreshët kanë ruajtur në shekuj zakonet dhe gjuhën shqipe. Ky komunitet, që na afron me popullin italian, është një faktor miqësie.

Populli shqiptar dhe populli turk duhen shumë me njëri - tjetrin. Ne me askënd nuk bëjmë «dashuri diplomatike». Kjo nuk është në zakonin e shqiptarit, por, kur japim fjalën, këtë e mbajmë dhe nuk lëvizim nga të fryjë era. Kush e shkel miqësinë dhe mirëbesimin tonë, ne e dënojmë. Me popullin vëlla turk asnjëherë nuk është lëkundur miqësia e madhe dhe e sinqertë që na lidh. Format e ndryshme të regjimit nuk e kanë lëkundur asnjëherë këtë miqësi, mbasi ajo bazohet në ndjenjat e mira të popujve tanë, bazohet në ato lidhje vëllazërore e gjaku të qindra mijë shqiptarëve, që jetojnë, punojnë, martohen, bëjnë fëmijë, vdesin e varrosen në një tokë të përbashkët me turqit.

Ne e kemi nderuar dhe e nderojmë me respekt udhëheqësin e madh të popullit turk, Mustafa Qemal Ataturkun, i cili, si një demokrat i shquar, shkatërroi Perandorinë Osmane e kalifatin dhe krijoi Turqinë e re demokratike. Le të marrin shembull nga Qemal Ataturku, që preu me shpatë «nyjen gordiane» të Perandorisë Osmane, të gjithë ata pseudodemokratë dhe pseudosocialistë që shtypin popujt, që marrin nëpër këmbë të drejtat e tyre dhe që mbajnë gjallë kolonializmin të sheqerosur me fjalë pompoze. Ne dëshirojmë që miqësinë me popullin vëlla turk ta kalitim vazhdimisht dhe ta zhvillojmë më tej në çdo fushë.

Ne e duam dhe e respektojmë popullin grek, pse edhe ky ushqen të njëjtat ndjenja miqësie ndaj popullit shqiptar. Ne jemi të sinqertë ndaj

njëri - tjetrit. Asnjëri s'ia do tjetrit të keqen, po i do të mirën. Këto janë lidhje historike, të mbrujtura me gjakun e përbashkët, kundër të njëjtëve okupatorë. Ne nuk i kcnfondojmë ndjenjat e popullit grek me ato të shovinistëve.

Marrëdhëniet e miqësisë që kemi me popullin grek do t'i zhvillojmë më tej. Kapedanët shqiptarë të revolucionit grek të vitit 1821, që luftonin nën komandën e Ipsilantit, populli grek i cilëson «**arvanites penemeni** e **palikaria arvanites**» (Greqisht - arvanitë të lavdishëm, shqiptarë trima). Kapo d'Istria dhe carët rusë, kralët serbë e vojvodët moldavë e tradhtuan revolucionin grek, por arvanitasit, me Marko Boçarin në krye, me Ali pashë Tepelenën dhe me Çaparajt, i qëndruan deri në vdekje besnikë atij.

Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe qeveritë greke, të djathta, të demokracisë së re ose socialiste, miqësinë në mes popullit shqiptar dhe popullit grek e kanë konsideruar gjithnjë një ekzigjencë të domosdoshme politike. Por, për fat të keq dhe pa asnjë arsye, që prej 40 vjetësh po mbahet në Greqi i ashtuquajturi «ligj i gjendjes së luftës me Shqipërinë», një ligj absurd, pa baza, që e dënojnë edhe populli grek, edhe populli shqiptar, edhe opinioni botëror. Çdo njeri i arsyeshëm e realist në Greqi e kupton se një ligj i tillë pengon shkurtimin e rrugëve për një zhvillim akoma më miqësor në drejtim të Artës, Prevezës, Janinës, si dhe të gjithë Greqisë.

As që kisha ndër mend të flisja sot për marrëdhëniet tona me Jugosllavinë, pse qëndrimet tona shtetërore ndaj këtij vendi i kemi shprehur me mijëra herë dhe mbetemi në ato që kemi thënë. Por detyrohem të flas, sepse krerët e Beogradit jo vetëm kanë bërë veshin e shurdhër për sa kanë vënë në dukje Partia dhe Qeveria jonë, por me të gjitha mjetet propagandistike e diplomatike kanë ngritur një fushatë të tërë shpifjesh e sulmesh kundër Shqipërisë socialiste e politikës së saj të qartë si drita e diellit. Për 40 vjet me radhë, për të mos u ngjitur më lart, krerët e Beogradit kanë nxitur sllavët e Jugut, dhe veçanërisht serbët, të rrojnë kurdoherë në armiqësi me shqiptarët që banojnë në trojet e veta në Jugosllavi, ashtu edhe me Shqipërinë e pavarur e socialiste. Kjo armiqësi ndaj shqiptarëve, ky shovinizëm i egër, kjo përbuzje, kjo prirje dhe ky oreks i papërmbajtur për të aneksuar Shqipërinë, janë ataviste në ta. Çka e bën akcma më të rrezikshme çështjen është se popujt e tjerë sllavë të Jugut s'kanë guximin ta ndalojnë këtë valë egërsie.

Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare ne i deshëm sinqerisht jugosllavët, Titon e kemi respektuar dhe nderuar më shumë se ç'e meritonte. Dërguam njësi të mëdha partizane, që luftuan krah për krah me njësitë partizane jugosllave dhe kosovare shqiptare në Jugosllavinë Jugore e Qendrore. Me qindra e qindra bija e bij heroikë të Shqipërisë ranë dhe u plagosën për çlirimin e Jugosllavisë, kurse tash na del një qen serb, me emër Sinan Hasani, që hedh baltë mbi gjakun e tyre. Ai bile arrin deri atje, sa të thotë se janë jugosllavët që formuan Partinë tonë, që organizuan Luftën Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe i dhanë çdo gjë Shqipërisë. Po le të lehë, ai për atë punë paguhet.

Titoja dhe shokët e tij, si më parë dhe deri në këtë moment që po flas, dorën tonë miqësore gjithnjë e kanë refuzuar dhe kanë bërë çmos ta

pritnin. Për 40 vjet me radhë, Titoja dhe pasuesit e tij, haptazi dhe nëpërmjet agjenturave të fshehta, kanë kurdisur vazhdimisht komplote për të shkatërruar Shqipërinë socialiste, për të shkatërruar Partinë tonë, për të eliminuar fizikisht shokë kryesorë të udhëheqjes. Këtë u orvatën të bënin edhe me agjentin e tyre të vjetër, tradhtarin Mehmet Shehu. Por të gjitha komplotet e tyre dështuan dhe kurdoherë do të dështojnë.

Dikur krali serb, Karagjorgjeviçi, me bandat rusomadhe të Vrangelit, solli në Shqipëri agjentin e tij, banditin Ahmet Zogu, i cili, si tradhtar i madh i atdheut, i dha Jugosllavisë dhuratë për këtë ndihmë, Shën-Naumin e Pogradecit dhe Vermoshin. Këtë gjë duan të bëjnë edhe sot krerët e Beogradit me bandat kriminele, terroriste të njëfarë vagabondi dhe trafikanti armësh, drogash dhe grash, Leka Zogut, të cilit, për çudi, një vend mik yni i jep strehim dhe e lejon të japë intervista për shtypin dhe të bëjë thirrje për përmbysjen e pushtetit popullor në Shqipëri. Ne e kemi të faktuar se janë titistët jugosllavë ata që dërguan në bregdetin tonë grupin e banditëve të Xhevdet Mustafës, të cilët, pa marrë akoma frymë dhe pa e parë diellin e Shqipërisë, i shpartalluam pa mëshirë. Në momentin e përshtatshëm bota do t'i marrë vesh në hollësi ndodhinë dhe qëllimet e saj. Por e rrezikshme është ajo që jugosllavët, duke shkelur sovranitetin e dy vendeve mike tona dhe pa dijeninë e tyre, përgatitën dhe hodhën kriminelë te ne. Të përgatitësh banda terroriste dhe t'i hedhësh në një vend tjetër, është një akt i rëndë kriminal, i dënueshëm në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Tashti ne duam vetëm t'u themi titistëve jugosllavë: mos luani me zjarrin, se, po filloi zjarri, do të digjeni vetë në të. Sa na përket neve, ne mbrohemi dhe dimë të mbrohemi, dimë të luftojmë dhe dimë të fitojmë mbi çdo armik. Por ne s'e duam këtë rrugë të errët e me plot rreziqe që ndiqni ju. Megjithatë, në rast se na e impononi, edhe ne do t'ju përgjigjemi. Por ne u themi udhëheqësve jugosllavë të mos shkojnë nga kjo rrugë pa krye e me shumë rreziqe për të dy vendet tona, për Ballkanin, mundet edhe për Evropën. Ju, popuj sllavë të Jugut, jini përgjegjës se lejoni serbomëdhenjtë të ndezin urat e zjarrit, në vend që t'i bëni ata të arsyeshëm dhe t'i detyroni të kthejnë rrugë, t'u përmbahen parimeve e praktikave të fqinjësisë së mirë me Shqipërinë socialiste dhe të vendosin sjellje normale e paqësore me shqiptarët që rrojnë në Jugosllavi.

Ne kemi bindjen se te popujt e tjerë sllavë të Jugut, përfshirë këtu edhe serbët, ka elementë përparimtarë. Përveç rrugës së një kthese politike në qëndrimet ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve që rrojnë në Jugosllavi, nuk ka rrugë tjetër zgjidhjeje. Ne do të vazhdojmë rrugën që caktoi Kongresi i 8-të i Partisë së Punës të Shqipërisë, raportin kryesor të të cilit udhëheqësit jugosllavë e lexuan së prapthi. Propozimet tona ishin sa të urta, aq dhe pajtuese, kurse rruga juaj është me shumë rreziqe për Jugosllavinë, të cilën ne e duam të qëndrojë kështu siç është. Ju nuk i merrni seriozisht fjalët tona, që janë shprehje të ndjenjave të sinqerta të popullit shqiptar. Por kjo është keq për ju. Bota do t'ju ngarkojë me përgjegjësi të rëndë.

Disa qeveri të vendeve të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po luajnë me ndjenjat dhe me interesat tona. Ne u themi atyre se nuk mund të luhet si përpara me Shqipërinë dhe me interesat e saj.

S'janë më kohërat e kaluara, kur fatet e vendit tonë mund të merreshin lehtë nëpër këmbë dhe kur prekej e copëtohej Shqipëria.

Vëllezërit tanë shqiptarë, që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi, si kurdoherë, ne do të vazhdojmë t'i mbrojmë me të gjitha forcat e zemrës në të drejtat e tyre që ua njeh kushtetuta. Asnjë dyshim të mos kenë për këtë si jugosllavët, ashtu edhe opinioni botëror. Kjo është e njohur nga e drejta ndërkombëtare dhe kështu veprohet nga të gjitha ato shtete që kanë minoritete përjashta.

Në Kongresin e 8-të të Partisë së Punës të Shqipërisë ne e bëmë të qartë qëndrimin tonë ndaj Jugosllavisë dhe mbetemi të patundur në këtë qëndrim. Shkatërrimi dhe shpërbërja e Jugosllavisë nuk do të vijnë kurrë nga ne. Ne jemi për stabilitetin e Federatës. Por shovinistëve serbomëdhenj, maqedonas e malazez nga një vesh u hyn dhe nga një vesh u del fjala jonë pajtuese. Atyre u janë errësuar sytë nga shovinizmi dhe megalomania. Kur ne u bëmë thirrje arsyes dhe logjikës së shëndoshë, ata vazhduan terrorin më të egër kundër shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi. Ata kanë hedhur nëpër burgje me mijëra djem e cuca heroike të Kosovës, të cilët i torturojnë barbarisht dhe u kanë ngjitur një mijë epitete ofenduese. Ne u themi jugosllavëve të lirojnë të rinjtë nga burgjet, se shqiptari nuk mund t'i durojë gjatë të tilla shkelje, që u bëhen nderit të të rinjve dhe të rejave të tij, të drejtave të tyre. Të mos e mbushin kupën, se përgjigjja mund të jetë me rreziqe të mëdha.

Tërë Kosova dhe viset shqiptare në Jugosllavi janë vënë nën një presion të egër shovinist ushtarak. Tash po zhvillohet në gjerësi «diferencimi», që do të thotë spiunimi i shqiptarëve nga shqiptarët në favor të forcave të errësirës serbe. Por kosovarët nuk mund ta pranojnë këtë rrugë të turpit, mbasi kjo çon në vëllavrasje, kurse serbomëdhenjtë do të qeshin e do të fërkojnë duart.

Serbët po nxitin hakmarrjen në mes shqiptarëve. Kosova po mbulohet në varfëri dhe në varre. Njerëzit s'dinë ku i kanë djemtë e vajzat. Inteligjencia shqiptare po kositet, atë e ofendojnë, e poshtërojnë, e lënë rrugëve. Të tilla persekutime s'kanë ngjarë veçse në kohën e inkuizicionit. Jo, populli shqiptar që jeton në Jugosllavi nuk do të lejojë t'i shtypet çdo gjë e shenjtë kombëtare. Shqiptari në çdo kohë e në çdo vend, kur i shkelin lirinë dhe të drejtat e ligjshme, s'e ka ulur kurrë kurrizin dhe asnjëherë s'i ka kthyer krahët armikut.

Ju, zotërinj të Beogradit, dërguat në Kosovë 60 mijë ushtarë serbë për të shtypur e për të vrarë kosovarët dhe për të frikësuar Shqipërinë socialiste. Ne nuk frikësohemi, ne gati jemi, në këmbë si një trup. Ju flitni me gjuhën e forcës, kur ne përpiqemi të flasim me gjuhën e arsyes. Por edhe ne dimë të flasim me gjuhën e forcës.

Shqipëria është një nyjë nevralgjike dhe strategjike. Evropa duhet ta ketë parasysh këtë. Disa tallen me fortifikatat tona, ndërsa vetë armatosen deri në dhëmbë e me çdo lloj armësh, të tjerë e nënçmojnë forcën tonë. Aq më keq për ta. Disa gazetarë, që shkruajnë për të marrë ryshfete, disa politikanë të kafeneve, me «analizat e planeve strategjike» të tyre dhe serbomëdhenjtë, në radhë të parë, përhapin idera dhe bëjnë insinuata se në këto ose në ato koniunktura, bile në të tëra koniunkturat, Shqipëria do të gëlltitet nga rusi, do të anojë nga sovjeti etj.

Ne u themi serbomëdhenjve, miqve të sigurtë e të fshehtë të rusëve, se dy rrugë ka për revizionistët ruso-bullgarë që të sulmojnë Shqipërinë për të dalë në pjesën e Adriatikut tonë. Njëra është rruga e Vardarit dhe e Kosovës dhe tjetra kanali i Otrantos. Në rastin e parë, pa as më të voglin dyshim, gjithë populli shqiptar, që jeton në Kosovë e në vise të tjera të Jugosllavisë, që nga Shkupi e Kaçaniku, nga Tetova e Gostivari, nga Llapi e Plavë-Gucia, do t'i presin agresorët me pushkë. Zjarr do të ndizet edhe tërë Jugosllavia dhe invadorët revizionistë ruso-bullgarë, po të arrijnë në Alpet tona, do të vijnë si nazistët gjermanë kur dolën nga Stalingradi.

Në rastin e dytë, kyçin e Otrantos e kemi ne, shqiptarët. Sazani dhe Karaburuni, pa pasur frikë se them ndonjë sekret, janë shkëmbinj të veshur me hekur e beton, ku s'kalon dot flota ushtarake sovjetike.

Në të tilla aventura, në rast se dëshirojnë të futen armiqtë ruso-bullgarë e të tjerë, duhet të dinë se shqiptarët nuk janë një shtet prej 3 milionësh, por një komb prej 6 milionësh. Populli i vogël ishte ky yni në Luftën e Dytë Botërore, por, vetëm për vetëm dhe i paarmatosur, theu e likuidoi një numër të konsiderueshëm divizione fashistësh italianë e nazistësh gjermanë. Tash kohët kanë ndryshuar në favorin e Shqipërisë socialiste, prandaj: Larg duart nga Shqipëria!

Shqipëria nuk kërcënon kërkënd, ajo dëshiron të rrojë në miqësi me të tjerët, por, po t'i preken të drejtat dhe kufijtë e saj, do t'i përgjigjet cilitdo po me atë violencë. Po kështu do t'u përgjigjet në mënyrën më të rreptë padrejtësive dhe ofezave që mund të përdorë ndokush kundër saj.

Çiltër po flas dhe ky është mendimi i patundur i gjithë popullit tonë. Ç'mendojmë, i themi, të tjerët s'kanë munguar të flasin kundër nesh, bile ata shpifin. Ne asgjë të pabazuar dhe shpifje nuk bëjmë. Këtu qëndron edhe forca jonë, prandaj popujt përparimtarë kanë respekt për Shqipërinë socialiste, ashtu sikundër edhe ne kemi shumë respekt për ta. Për këtë qëndrim të drejtë e dashamirës ne i falenderojmë nga zemra.

Zotërinjtë udhëheqës jugosllavë ia njohin vetes të drejtën për të ngritur zërin për «padrejtësitë» që bullgarët, grekët ose shqiptarët u bëkan maqedonasve të Pirinit e të Egjeut dhe pakicave fare të vogla maqedonase në Shqipëri, kurse ne, sipas tyre, nuk e paskemi këtë të drejtë. Ata na akuzojnë se «ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme» kur mbrojmë të drejtat e vëllezërve tanë brenda ligjeve të Federatës, që jo vetëm ua shkelin, por edhe i vrasin, i burgosin, i dëbojnë në emigracion, kurse në vendlindjet e tyre i zëvendësojnë me kolonë serbë dhe malazez.

Është zoti Stamboliç ai që hodhi parullën «Kosova etnikisht e pastër», që gjoja e kërkonin «nacionalistët shqiptarë». Kjo nuk është parulla e shqiptarëve, po e serbomëdhenjve, e hedhur për të mbytur në gjak Kosovën. Kjo politikë terrori i trembi me të drejtë serbët dhe malazeztë që filluan të largohen nga frika dhe nga varfëria që mbulon Kosovën. Këtë krim serbomëdhenjtë kërkojnë t'ua hedhin tani shqiptarëve, kurse janë ata vetë përgjegjës për shpërnguljen e serbëve e të malazezve.

Kohët e fundit jugosllavët, të ndihmuar edhe nga mikja e tyre, Rusia,

po mbledhin nga janë e nga s'janë «maqedonas të Egjeut» që t'i kenë këta dhe si pararojë për Greqinë. Një mëngjes do të na dëgjojnë veshët se edhe Aleksandri i Madh na qënkësh sllav. Pse të mos e bëjnë edhe këtë? Kanë një precedencë «historianin» rusomadh të shekullit të 19-të, Vasilievskin. Në librin e tij mbi Bizancin, ky arrin të shkruajë të zezë mbi të bardhë, se grekët e sotëm, meqë janë ortodoksë, janë sllavë, pra nuk janë pasardhësit e grekëve të vjetër të antikitetit që i lanë njerëzimit qytetërimin nga më të shkëlqyerit e botës. Thjesht dhe me bindje të plotë prej shovinisti rusomadh, Vasilievski në librin e tij thotë se «grekët e sotëm janë me origjinë sllave».

Kështu veprojnë edhe shovinistët vorio-epirotë dhe disa dhespotë grekë, të cilët, duke u mbështetur në statistikat e Fanarit, që në kohën e Sulltan Hamitit të dytë, të gjithë ortodoksët e Shqipërisë i konsiderojnë grekë. Dhe ka gati 80 vjet që këta të ashtuquajtur grekë 400 000 kanë qenë dhe 400 000 kanë mbetur deri më sot. Të ashtuquajturit grekë vorio-epirotë, sipas tyre, as janë shtuar as janë pakësuar, as lindin, as vdesin. Po ashtu, edhe në «burgjet shqiptare», thonë ata, në çdo kohë e në çdo sezon, dergjen 28 mijë vorio-epirotë. Por, për fatin e keq të atyre dhespotëve grekë, që s'kanë të bëjnë fare me popullin grek, unë mund t'u them me plot përgjegjësi popullit dhe qeverisë greke se në burg, me dënime të vogla për faje të ndryshme, ndodhen vetëm 33 minoritarë grekë nga gjithë Shqipëria dhe prej tyre vetëm 4 për çështje politike. Pse ndodh kjo me minoritetin grek në vendin tonë? Se minoritarët grekë janë njerëz të mirë, të ndershëm, si vetë populli grek, pse ata gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzon çdo nënshtetas shqiptar, pse kudo në minoritetin grek çdo gjë është në dorë të tyre. Atje, në Parti, në pushtet s'ka veçse kuadro minoritarë. Në çdo fshat të minoritetit grek ka shkolla fillore, të mesme bujqësore dhe në Gjirokastër shkollë pedagogjike greqisht. Të gjithë kuadrot e tjerë, si doktorë, agronomë, veterinerë, ekonomistë, mësues, profesorë, janë minoritarë, kudo ka shtëpi kulture. Të ardhurat e minoritarëve janë nga më të lartat në vendin tonë. Ne, shqiptarët, rrojmë si vëllezër me minoritarët grekë në atdheun tonë të përbashkët. Minoriteti grek në Shqipëri nuk rënkon, zotërinj shovinistë vorio-epirotë, por këndon dhe lulëzon.

Sa për besimin fetar, ju s'keni pse bëheni merak. Të besojë njeriu apo të mos besojë është një e drejtë e secilit, një çështje ndërgjegjeje dhe jo një çështje institucionale dhe as dëshirë e vullnet i hoxhallarëve, i dhespotëve dhe i papës së Romës.

Unë e ndjek shtypin grek dhe kam parë ç'pyetje u kanë bërë disa gazetarë grekë e gjermanoperëndimorë banorëve të minoritetit grek në vendin tonë dhe ç'përgjigje kanë marrë prej këtyre. Njëri prej këtyre gazetarëve i ka bërë këto pyetje një plake minoritare:

- «Ku e keni kishën dhe papanë?»

Ajo iu përgjigj: «As kisha, as papai nuk më shpëtuan nga agallarët dhe bejlerët. Kur sundonin ata, as bukë më dhanë të haja, as më dhanë ujë të pija, as elektrik të ndritesha, as m'i bënë djemtë dhe vajzat të mësuara. Të gjitha këto të mira m'i dha vetëm Lufta Nacionalçlirimtare, m'i dha Partia ime e Punës. Prandaj unë dua Partinë dhe jo papanë».

Gazetari vazhdoi ta pyesë plakën: «Po mëkatet që ke bërë, kujt do t'ia rrëfesh?».

Plaka përsëri iu përgjigj me një humor të hollë: «Djali më ka thënë: rro mirë në këtë botë, mitera (Greqisht - nënë), pa, kur të prezantohesh në «botën tjetër», m'i hidh mëkatet mua dhe Partisë sime».

Në botë ka me qindra e qindra milionë njerëz që s'duan të besojnë në fenë, pse çuditen atëherë me Shqipërinë socialiste?

Shteti ynë, me vullnetin e popullit të tij, është ateist dhe s'ka forcë morale dhe materiale që t'i imponojë atij diçka tjetër. Ai është zot i fateve dhe i ndjenjave të tij. Klithmat e shovinistëve vorio-epirotë nuk e shqetësojnë aspak minoritetin grek dhe Shqipërinë socialiste, edhe po të nxiten e të paguhen nën dorë nga dikush tjetër, që nuk është populli vëlla grek.

Shokë e shoqe,

Zgjedhjet e reja për deputetët e Kuvendit Popullor zhvillohen në prag të një ngjarjeje të madhe, të festimit të 70-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare.

Populli shqiptar, të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen, e kanë kremtuar gjithnjë me gëzim të madh ditën e shënuar të 28 Nëntorit 1912, kur plaku i urtë e patriot Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë dhe shpalli Pavarësinë e vendit.

Duke festuar këtë përvjetor të lavdishëm, ne kujtojmë luftërat legjendare që për shekuj me radhë populli shqiptar ka bërë për lirinë e pavarësinë e atdheut, përpjekjet titanike për të ruajtur e zhvilluar gjuhën e kulturën e tij, dashurinë e tij të zjarrtë për trojet e traditat e veta.

Mirënjohja jonë dhe e brezave që do të vijnë u drejtohet atyre patriotëve shqiptarë që, edhe në kushtet më të vështira, edhe në momentet më të rënda, e mbajtën të ndezur pishtarin e atdhedashurisë, besimin e patundur se ditë të mira do të vinin medoemos edhe për popullin e tyre. Vepra e këtyre patriotëve mbetet kurdoherë frymëzuese e mobilizuese. Ajo na fton për të mbrojtur me vetëmohim lirinë e pavarësinë e atdheut, për t'i shërbyer kurdoherë me devotshmëri e deri në fund popullit, për të punuar gjithnjë pa u lodhur për të mirën dhe për nderin e Shqipërisë sonë të dashur.

Më lejoni të përfitoj nga kremtimi i jubileut të 70-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë për të përshëndetur të gjithë popullin tonë, si dhe të tërë shqiptarët patriotë në botë dhe t'i uroj me rastin e kësaj dite të shtrenjtë për zemrat tona.

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor e gjejnë tërë vendin në kulmin e punëve për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 8-të të Partisë, për të realizuar detyrat e rëndësishme të planit të shtatë pesëvjeçar. Le të shërbejnë këto si frymëzim e nxitje për forcimin e mëtejshëm të unitetit të çeliktë të popullit rreth Partisë, për një mobilizim e vrull më të madh

në punë, për të punuar me disiplinë e dije, për të zbatuar kudo parullën luftarake të Partisë: «Punë e vigjilencë», për ta bërë pushtetin popullor gjithnjë e më të fortë, Shqipërinë tonë socialiste më të bukur, më të pasur, më të lumtur.

Rroftë populli ynë!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë pushteti ynë popullor!

RRUGA E PARTISË

ORGAN
TEORIK DHE POLITIK
I KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË

Tetor 1983
Viti XXX i botimit

Adresa:
«RRUGA E PARTISË»
pranë KQ të PPSH – Tiranë

Pajtimet:
për 6 muaj 15 lekë, 1 vit 30 lekë
[illegible] shtetit:
[illegible]8 lekë, 1 vit 36 lekë

Përmbajtja:

— Përshëndetje e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha 5

ENVER HOXHA — Fjala me rastin e marrjes së Përshëndetjes të Komitetit Qendror të Partisë 10

NGA PUNIMET E KONFERENCËS SHKENCORE KUSHTUAR MENDIMIT TEORIK MARKSIST-LENINIST TË PPSH DHE TË SHOKUT ENVER HOXHA

— Fjala e shokut Ramiz Alia 13

F. ÇAMI — Revolucioni dhe ndërtimi socialist në Shqipëri — shembull i gjallë i vitalitetit dhe i zbatimit krijues të teorisë marksiste-leniniste 22

S. POLLO — Mbrojtja dhe zhvillimi nga ana e PPSH i teorisë marksiste-leniniste të revolucionit 40

P. KONDI — PPSH dhe shoku Enver Hoxha për Partinë dhe rolin e saj udhëheqës 54

H. PAPAJORGJI — Politika e PPSH dhe përvoja e saj në ndërtimin e ekonomisë socialiste 67

— Fjala e mbylljes e shokut Ramiz Alia 82

ME RASTIN E 15-VJETORIT TË FILLIMIT TË BOTIMIT TË VEPRAVE TË SERISË TË SHOKUT ENVER HOXHA

S. TARIFA — Vijë e kristaltë, vepra revolucionare 84

(vijon në faqen prapa)

NGA PUNIMET E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË

— Komunikatë mbi mbledhjen e Plenumit të 7-të të Komitetit Qendror të PPSH 96

PROBLEME TË ZHVILLIMIT INTENSIV DUKE U MBËSHTETUR PLOTËSISHT NË FORCAT TONA

XH. DAUTI — Mundësitë e rritjes së prodhimit bujqësor dhe e të ardhurave janë të shumta edhe në kooperativat e zonës kodrinore e malore 97

NGA VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË PUSHTETIT DHE E ORGANIZATAVE TË MASAVE

L. GJOLIKU — Aktivizimi dhe aftësimi i vazhdueshëm i ndihmësgjyqtarëve popullorë rrit rolin dhe autoritetin e gjykatave. 107

ENVER HOXHA

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë

PËRSHËNDETJE E KOMITETIT QENDROR TE PARTISE SË PUNËS TË SHQIPERISE ME RASTIN E 75-VJETORIT TË DITELINDJES SË SHOKUT ENVER HOXHA

I dashur shoku Enver,

Në këtë ditë të shënuar Tuajën e të Atdheut, në emër të Partisë dhe të të gjithë popullit, Ju dërgojmë Juve, shoku Enver, udhëheqësi e mësuesi ynë i shtrenjtë, përshëndetjet më të zjarrta revolucionare me rastin e 75-vjetorit të lindjes dhe Ju urojmë nga zemra të rroni sa malet tona të larta, për të mirën e Atdheut dhe të çështjes së socializmit në Shqipëri.

Të gjitha fitoret historike të popullit tonë — krijimi i Partisë, çlirimi i vendit dhe vendosja e pushtetit popullor, ndërtimi i shoqërisë së re socialiste, janë të pandara nga emri dhe vepra Juaj. Në të tëra etapat e në çdo moment kyç, kur vendoseshin fatet e popullit e të vendit, kur është zgjedhur rruga që duhej ndjekur, mendimi dhe udhëheqja Juaj kanë qenë kurdoherë udhërrëfyese e përcaktuese.

Nën udhëheqjen e Partisë dhe duke ecur në rrugën e ndriçuar nga mësimet Tuaja marksiste-leniniste, Shqipëria, për herë të parë në historinë e saj mijëravjeçare, u bë një vend me të vërtetë i lirë e i pavarur, ku vetë populli është zot i plotfuqishëm, ku ndërtohet shoqëria socialiste, shoqëria më e përparuar e më e drejtë që ka njohur njerëzimi, ku zhvillohet me ritme të larta ekonomia e lulëzon kultura popullore.

Gjithë punonjësit e vendit tonë Ju shprehin mirënjohjen e tyre të pakufishme për gjithçka keni bërë për popullin e Atdheun, për jetën e lumtur që gëzojmë. Ju përshëndet e Ju uron klasa e çliruar punëtore, fshatarësia e rilindur socialiste, gruaja shqiptare e emancipuar, rinia jonë revolucionare, inteligjencia popullore.

Tërë jetën Tuaj, shoku Enver, të gjitha energjitë ia keni kushtuar çështjes së madhe të çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit, ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Në veprën Tuaj janë mishëruar tiparet më të mira të udhëheqësit revolucionar, të urtë e larg-

pamës, të patriotit të flaktë e të internacionalistit konsekuent. Në mënyrë krijuese Ju keni zbatuar në vendin tonë mësimet e marksizëm-leninizmit dhe si nxënës besnik i Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit keni mbrojtur e zhvilluar më tej idetë e tyre në kushtet e kohës së sotme dhe në luftë të papajtueshme me renegatët e armiqtë e komunizmit.

Në ditët e errëta të pushtimit e të shtypjes së egër fashiste Ju, shoku Enver, bashkë me komunistët e vërtetë shqiptarë, kryet veprën që do të shënonte kthesën rrënjësore në fatet e popullit e të vendit tonë: themeluat Partinë tonë heroike. Populli shqiptar siguroi udhëheqjen e tij besnike, që do t'i tregonte atij rrugën e luftës për çlirimin kombëtar e shoqëror, rrugën e ndritur të socializmit.

Partia jonë ka pasur kurdoherë një vijë të drejtë revolucionare. Kjo i detyrohet faktit që Ju, në krye të Komitetit Qendror, keni luftuar dhe shkrirë tërë forcat Tuaja që Partia të vihet mbi baza të shëndosha ideologjike e organizative marksiste-leniniste, të edukohet dhe të bëhet një parti e vërtetë proletare, një parti që do t'u rezistonte të gjitha provave dhe do ta kryente me nder detyrën e saj revolucionare përpara popullit të vet e proletariatit botëror.

Partia jonë, me Ju në krye, shoku Enver, udhëhoqi epopenë më të lavdishme në historinë e luftërave shekullore të popullit tonë, Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, revolucionin e madh popullor. Sipas mësimeve Tuaja e nën udhëheqjen Tuaj, Partia realizoi atë bashkim të madh të popullit në Frontin Nacionalçlirimtar, i paparë për nga forca, kohezioni e vitaliteti i tij. Juve u takon merita historike që luftën për çlirimin kombëtar Partia jonë e lidhi ngushtë dhe e bashkoi në një të vetme me çështjen e përmbysjes së pushtetit të vjetër e të vendosjes së pushtetit popullor. Nën komandën Tuaj Ushtria e lavdishme Nacionalçlirimtare, me përkrahjen e mbarë popullit, çliroi me forcat e veta vendin dhe siguroi fitoren e rendit demokratik popullor. Ju, shoku Enver, keni dhënë një kontribut të madh për forcimin, modernizimin e revolucionarizimin e Ushtrisë Popullore e të strukturave të tjera të mbrojtjes, për përpunimin e Artit tonë Ushtarak Popullor. Nën kujdesin Tuaj të drejtpërdrejtë, Atdheu ynë socialist ka sot një mbrojtje të çeliktë, të garantuar nga tërë populli i armatosur.

Dyzet e dy vjet më parë, populli u besoi komunistëve shqiptarë fatet e veta dhe të ardhmen e Atdheut. Partia jonë, me Ju në krye, shoku Enver, e meritoi këtë besim me veprën e saj të madhe: çlirimin e vendit, fitoren e revolucionit popullor dhe krijimin e Shqipërisë socialiste. E ndriçuar nga mësimet Tuaja marksiste-leniniste, shoku Enver, Partia krijoi armën e fuqishme të revolucionit fitimtar, shtetin tonë të ri, themelet e të cilit u hodhën në vitet e zjarrta të Luftës Nacionalçlirimtare. Duke ecur në rrugën e treguar prej Jush e në sajë të kujdesit të vazhdueshëm të Partisë, diktatura e proletariatit në vendin tonë qëndron e patundur, është zhvilluar e lulëzon demokracia socialiste, masat e gjera punonjëse marrin pjesë aktive në qeverisjen e vendit, thonë fjalën e tyre për gjithçka e për këdo. Porositë Tuaja për çrrënjosjen e burokratizmit e të liberalizmit qëndrojnë në themel të procesit të pandërprerë të revolucionarizimit të pushtetit tonë popullor. Ju, shoku Enver, jeni frymëzuesi e krijuesi i Kushtetutës sonë, e cila sanksionon fitoret e mëdha të arritura nga populli e Partia dhe mishëron tiparet e një shoqërie të vërtetë socialiste.

Vepra e Partisë dhe mësimet Tuaja, i dashur shoku Enver, janë mishëruar në realitetin e gjallë të Shqipërisë së re socialiste, të ndërtuar me përpjekjet titanike të popullit tonë. Në krye të Partisë, Ju përpunuat orientimet dhe udhëhoqët në praktikë luftën historike për futjen e Shqipërisë në rrugën e socializmit, për realizimin e shndërrimeve të mëdha ekonomike e shoqërore, për industrializimin socialist dhe kolektivizimin e bujqësisë, për kryerjen e një revolucioni të thellë në fushën e ideologjisë e të kulturës, për edukimin e njeriut të ri të shoqërisë sonë.

Atdheu ynë, duke ecur në rrugën që na tregon Partia, ka ndryshuar krejtësisht pamjen. Brenda një periudhe të shkurtër, prej më pak se katër dekadash, u bë ajo që s'qe bërë në shekuj. Nga vendi më i varfër i Evropës, i varur për çdo gjë nga të huajt, Shqipëria është sot një vend socialist i përparuar, me një ekonomi të zhvilluar, të qëndrueshme e të pavarur, atdhe i njerëzve të lirë nga çdo shtypje sociale e shpirtërore, vend i mirëqenies në rritje për të gjithë, i arsimit, e i kulturës për masat më të gjera të popullit. Ajo është vendi që nuk i shtrin dorën askujt për kredi e borxhe, por ndërton socializmin dhe mbrohet duke u mbështetur në forcat e veta, vendi që nuk e përkul kokën përpara asnjë presioni e diktati, por ndjek pa iu trembur syri rrugën e vet revolucionare, vendi që nuk njeh kriza, degjenerim dhe plagët e tjera të rënda, të cilat në ditët tona gërryejnë nga themelet tërë sistemin kapitalisto-revizionist botëror.

Populli dhe komunistët shqiptarë të gjitha këto fitore ia dedikojnë Partisë sonë trime, vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, ua dedikojnë Juve, shoku Enver, udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit tonë.

Rruga e Partisë është rruga e një lufte të lavdishme e heroike. Partisë dhe popullit tonë u është dashur të përballojnë plot vështirësi e pengesa, të kapërcejnë prapambetjen e trashëguar nga e kaluara, të ndeshen dhëmb për dhëmb me veprimtarinë e armiqve të brendshëm e të jashtëm, të hapët e të maskuar, që janë përpjekur të pengojnë përparimin dhe zhvillimin tonë, të minojnë revolucionin e të përmbysin socializmin në Shqipëri. Në të gjitha këto beteja ne kemi dalë kurdoherë fitimtarë. Kjo i detyrohet vijës së drejtë të Partisë, vigjilencës së lartë të saj dhe zhvillimit me konsekuencë të luftës së klasave, i detyrohet largpamësisë e mprehtësisë politike, qëndrimeve të papërkulura dhe orientimeve Tuaja marksiste-leniniste. Këto kanë bërë që revolucioni ynë të ecë kurdoherë përpara, që liria e pavarësia e Atdheut të ruhen e të konsolidohen, që rendi ynë socialist të forcohet vazhdimisht, që t'i mbyllen shtigjet degjenerimit borgjezo-revizionist e kthimit prapa në kapitalizëm.

Një faqe të ndritur në historinë e Partisë e të vendit tonë përbën lufta parimore e paepur kundër imperializmit e socialimperializmit, me atë amerikan e sovjetik në krye, dhe kundër revizionizmit modern të

të gjitha ngjyrave — titizmit, hrushovizmit, eurokomunizmit e maoizmit. Në këtë luftë, të zhvilluar për çështjet e mëdha parimore të lëvizjes komuniste e revolucionare botërore, në përkrahje e në interes të forcave marksiste-leniniste, të proletariatit e të popujve, të mbrojtjes së paqes e të sigurimit ndërkombëtar, kanë dalë në pah me një forcë të madhe besnikëria e pafund e Partisë sonë ndaj marksizëm-leninizmit, principialiteti i palëkundur dhe pavarësia e mendimit të saj. Kjo luftë, që Ju, shoku Enver, e keni udhëhequr me një urtësi, vendosmëri e guxim të rrallë revolucionar, ka qenë dhe është jetike për vetë Partinë tonë, për mbrojtjen e pavarësisë dhe të interesave kombëtare të Atdheut tonë socialist e të mbarë popullit shqiptar. Ajo ka qenë dhe është me rëndësi edhe për të gjithë marksistë-leninistët e revolucionarët e vërtetë, për triumfin e çështjes së revolucionit e të socializmit.

Politika e jashtme revolucionare e internacionaliste e Partisë dhe e shtetit tonë, e përpunuar dhe e zbatuar nën udhëheqjen Tuaj, ka bërë që zëri i Shqipërisë të dëgjohet e të respektohet. Ajo ka rritur shumë autoritetin e prestigjin e saj në arenën ndërkombëtare dhe i ka siguruar vendit tonë përkrahjen e fuqishme të popujve e të forcave revolucionare.

Gjithë rruga e Partisë sonë të Punës, e revolucionit dhe e ndërtimit tonë socialist, politika e brendshme dhe e jashtme që është ndjekur në çdo etapë të zhvillimit tonë, sipas mësimeve Tuaja e nën udhëheqjen Tuaj të drejtpërdrejtë, përbëjnë një përvojë revolucionare me vlera të mëdha teorike e praktike.

Kjo përvojë origjinale ka gjetur pasqyrim e përgjithësim të thellë shkencor në veprën Tuaj teorike, në shkrimet Tuaja të shumta dhe në gjithë ato materiale të rëndësishme të Partisë që janë hartuar nën drejtimin Tuaj. Ato përfaqësojnë një vepër kolosale të gjithanshme dhe përbëjnë një kontribut me vlerë të madhe në pasurimin dhe zhvillimin e teorisë marksiste-leniniste. Nga ky thesar i paçmuar komunistët dhe punonjësit tanë nxjerrin mësime shumë të vlefshme për punën e luftën e tyre të përditshme, për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit dhe ndërtimin me sukses të socializmit.

I dashur shoku Enver,

Jeta dhe veprimtaria Juaj revolucionare janë për ne një shembull i shkëlqyer, nga i cili mësojmë e udhëhiqemi që t'ua kushtojmë të gjitha forcat tona idealeve të larta komuniste, çështjes së madhe të Partisë, të revolucionit e të socializmit, mbrojtjes së interesave të popullit e të Atdheut tonë të dashur socialist. Ne, shokët e nxënësit Tuaj, që kemi fatin e madh të punojmë nën drejtimin Tuaj, mësojmë e frymëzohemi nga lufta dhe puna Juaj si të forcojmë pareshtur Partinë tonë të shtrenjtë, si të forcojmë unitetin e mendimit e të veprimit të saj, lidhjet e saj të pandashme me popullin, rolin e saj udhëheqës, si të ruajmë kurdoherë të pastër ideologjinë tonë fitimtare, marksizëm-leninizmin. Ne mësojmë shumë nga metoda e stili Juaj në punë, nga principialiteti i lartë në zgjidhjen e çdo çështjeje, nga vigjilenca revolucionare ndaj armikut e ndaj çdo gjëje të huaj, nga urtësia e gjykimeve dhe vendosmëria në qëndrime, nga shpirti i iniciativës e guximi komunist.

Ne mësojmë e përvetësojmë nga Ju virtytet e mëdha të popullit e të klasës sonë punëtore, atdhedashurinë e flaktë, frymën luftarake dhe shpirtin e sakrificës, dashurinë e thellë për shokët e për njerëzit e punës, thjeshtësinë proletare dhe fisnikërinë e popullit tonë. Me shembullin Tuaj, Ju na mësoni se puna e palodhur për ndërtimin e socializmit, devotshmëria ndaj marksizëm-leninizmit, dashuria dhe besnikëria pa kufi për popullin e Partinë janë ato tipare themelore që duhet të karakterizojnë komunistin aktiv e militant.

Ju sigurojmë, shoku Enver, se do të ecim kurdoherë të papërkulur në rrugën marksiste-leniniste që na tregoni Ju dhe do të zbatojmë me besnikëri e konsekuencë mësimet Tuaja të çmuara. Nën udhëheqjen Tuaj të sigurt, Partinë dhe popullin tonë e presin gjithnjë fitore të mëdha.

Me rastin e 75-vjetorit të lindjes, Ju urojmë edhe një herë, i dashur shoku Enver, jetë të gjatë dhe shëndet të plotë, punë e luftë të frytshme për të mirën e Partisë, për lumturinë e popullit tonë, për përparimin dhe forcimin e mëtejshëm të socializmit në Shqipëri, për lavdinë e marksizëm-leninizmit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Tiranë, më 16 Tetor 1983

FJALA E SHOKUT ENVER HOXHA ME RASTIN E MARRJES SË PËRSHËNDETJES TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË*

Shokë të mi të dashur,

Megjithëse sot mbush 75 vjeç, e ndiej veten të ri, pse jam komunist dhe për komunistët s'ka pleqëri.

Partia dhe populli po më bëjnë shumë ndere, që më prekin dhe më emocionojnë shumë. Partia dhe populli, atdheu dhe socializmi janë gjithçka për mua, jeta, gëzimi, besimi në të ardhmen e tyre të ndritur.

S'ka mision më të lartë për njeriun sesa të jetosh, të punosh, të luftosh me popullin e për popullin. Ky mendim dhe ky besim më kanë udhëhequr edhe mua gjithë jetën, prandaj jam komunist.

Marksizëm-leninizmi është projektori që ndriçon mendjen e ndërgjegjen e njerëzve dhe rrugën e popujve për çlirim e revolucion. Ai, si shkenca e zhvillimit shoqëror, të tregon rrugën për veprim, për luftim, për krijim, për transformim të shoqërisë drejt socializmit e komunizmit.

Teoria e lavdishme e marksizëm-leninizmit e ka udhëhequr, e udhëheq Partinë tonë heroike në gjithë betejat e luftës e të punës dhe i ka siguruar gjithë këto fitore që gëzon sot populli ynë.

Shqipëria jonë socialiste ecën vazhdimisht përpara me guxim, flet lirisht, ashtu si mendon, nuk frikësohet nga askush, i do popujt, e do paqen dhe lufton kundër armiqve të saj imperialistë, socialimperialistë e forcave reaksionare e agresive të çdo lloji.

Në furtunat dhe në stuhitë, nëpër të cilat po kalon njerëzimi, populli ynë i vogël, por trim, bujar, i thjeshtë, i mençur, punëtor dhe i drejtë, qëndron i papërkulur, i palëkundur, ashtu si malet tona.

Të gjitha këto virtyte e kanë mbrojtur dhe e kanë mbajtur gjallë popullin tonë. Për këtë ai ka të drejtë të jetë krenar. Për këtë popull edhe ne kemi të drejtë të jemi krenarë.

Ideologjia e Partisë u pleks fort me të gjitha virtytet e lavdishme të

* Më 16 tetor 1983 shokët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë uruan shokun Enver Hoxha me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes dhe i dorëzuan Përshëndetjen e Komitetit Qendror të Partisë. Duke marrë Përshëndetjen, shoku Enver falenderoi nga zemra Partinë dhe Komitetin Qendror të saj për urimet që iu bënë.

popullit tonë. Fara e mirë ra në një terren bujar dhe mbiu e shëndetshme. Parti e popull ndenjën në këmbë e syhapur për ta rritur këtë farë bujare, prandaj Shqipëria socialiste lulëzon.

Uniteti Parti-popull mbetet vendimtar për të gjitha kohët, ai është burim i forcës, i mendimit krijues, i fitoreve revolucionare. Armiqtë tanë të çfarëdollojtë kjo forcë i shtyp. Uniteti brenda në Parti, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, dhe uniteti në udhëheqje është faktori tjetër po aq vendimtar sa edhe uniteti Parti-popull.

Historia e Partisë sonë dhe historia e ish-partive të tjera komuniste ka vërtetuar dhe vërteton se armiku i klasës, për të dobësuar e penguar çështjen e madhe të klasës punëtore, të proletariatit botëror, përpiqet kurdoherë të godasë marksizëm-leninizmin dhe atë udhëheqje që e mbron këtë e i qëndron besnike.

Armiqtë tanë, të jashtëm dhe të brendshëm, shumë herë janë orvatur e do të orvaten edhe në të ardhmen ta bëjnë këtë kundër nesh, por ata kanë dështuar dhe do të dështojnë, derisa çdo hap që ne hedhim dhe do të hedhim në jetë e në luftën tonë do të jetë fryt i një refleksimi të urtë e gjakftohtë, që të përputhet me dëshirat dhe aspiratat e popullit, si dhe me ideologjinë e Partisë sonë, marksizëm-leninizmin.

Të mos kemi asnjëherë frikë nga armiqtë, t'i godasim ata kurdoherë që përpiqen e komplotojnë të përçajnë Partinë e popullin, kur përpiqen të errësojnë ose komplotojnë të dëmtojnë e të shkatërrojnë fitoret madhështore që ka arritur populli shqiptar me gjak e me djersë. Asnjë kompleks inferioriteti ose lëkundjeje nuk duhet të kemi ndaj armiqve, të brendshëm a të jashtëm qofshin, kur jemi në të drejtë. Në mbrojtjen e së drejtës qëndron forca e Partisë sonë e mbrujtur me forcën e popullit.

Kundër armiqve të jemi vigjilentë, të dimë ç'gatuajnë, por gjellën të mos ua hamë.

Duke ecur me vendosmëri në rrugën e Partisë, populli shqiptar do të jetë kurdoherë i lirë, i pavarur e sovran në atdheun e tij të lulëzuar e të begatë.

Shokë të dashur e bashkëluftëtarë,

Unë falenderoj me përunjësi Partinë dhe popullin për nderin që po më bëjnë, u jam atyre mirënjohës përjetë dhe u siguroj se, derisa të rroj, për asnjë minutë nuk do të harroj detyrat, që kam ndaj tyre.

Unë, të dashur shokë, s'kam bërë më shumë se ju e se shokët heroikë që dhanë jetën për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e socializmit.

Me popullin dhe tok me të ne, komunistët, i kemi vënë shpatullat punës dhe do të vazhdojmë ta bëjmë një gjë të tillë pa u lodhur për asnjë çast, pa kursyer asgjë, duke luftuar me vetëmohim, me guxim, me trimëri, me diturinë dhe mençurinë që na ka dhënë e na jep Partia, për lavdinë e Partisë dhe të popullit.

Me këtë rast, më lejoni t'ju falenderoj për gjithë kujdesin e dashurinë që tregoni ndaj meje. Bashkëpunimi juaj aktiv ma lehtëson barrën, më mbush zemrën me gëzim e me besim në të ardhmen, kur shoh me sa vetëmohim, entuziazëm e pjekuri të lartë punoni e luftoni

për realizimin e detyrave që ju ka ngarkuar Partia e populli. Puna juaj, e gjithë Partisë dhe e popullit, dashuria juaj, e gjithë komunistëve dhe e popullit, më japin forca e më rinojnë. Kur Partia është e fortë dhe e bashkuar, kur populli është i fortë e i bashkuar, unë ndiej një kënaqësi të tillë, të pakufishme, që më bën më të fortë e më zgjat jetën.

Të gjithëve ju faleminderit.

Qofshin gjithmonë të gëzuar Partia, populli dhe ju, të dashur shokë.

Jua shpërblefsha në gëzime.

Nga punimet e Konferencës Shkencore kushtuar mendimit teorik marksist-leninist të PPSH dhe të shokut Enver Hoxha*

FJALA E SHOKUT RAMIZ ALIA

Shokë dhe shoqe,

Sot fillon punimet Konferenca Shkencore kushtuar studimit të mendimit teorik të Partisë sonë të Punës dhe të shokut Enver Hoxha.

Kurdoherë është mirë të mendojmë e të reflektojmë mbi historinë e luftërave revolucionare të zhvilluara nën udhëheqjen e Partisë, të betejave madhështore për ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut, të shohim nga jemi nisur e ku kemi arritur. Kjo na ndihmon të sintetizojmë përvojën e fituar, të nxjerrim mësime të dobishme për punën tonë të përditshme dhe të qartësojmë perspektivën.

Me të drejtë krenohemi për industrinë tonë të re, për fabrikat e kombinatet, për fushat e transformuara, për shkollat e spitalet, për gjithë atë begati materiale e shpirtërore që ka sjellë socializmi. Por jo më pak kemi të drejtë të krenohemi për atë mënçuri, dituri e urtësi të Partisë sonë të Punës me shokun Enver Hoxha në krye, që programoi dhe udhëhoqi realizimin e këtyre transformimeve, që diti të gjejë udhët më të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve historike që qëndronin përpara vendit. Nuk do të ishte e tepërt të thoshim se përvoja e revolucionit tonë popullor dhe e ndërtimit të socializmit, mendimi marksist-leninist i Partisë dhe i shokut Enver Hoxha përbëjnë pasurinë tonë më të madhe, në kuptimin që përvetësimi dhe zbatimi i tyre me korrektësi e konsekuencë garantojnë atë që kemi arritur deri më sot dhe na sigurojnë ecjen e pandalshme përpara drejt komunizmit.

Konferenca jonë i zhvillon punimet e saj në prag të 75-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha. Me këtë ne duam të shprehim dashurinë tonë të zjarrtë për udhëheqësin e shquar të Partisë e të popullit tonë, respektin e thellë dhe admirimin e madh për jetën e ve-

* Konferenca i zhvilloi punimet në Tiranë më 3-4 tetor 1983. Në të u mbajtën nëntë referate. Në këtë numër të revistës po botojmë katër prej tyre. Pesë të tjerat do të botohen në numrin e ardhshëm.